

ISSN 2410-759X (print)  
ISSN 2411-9725 (online)

Balkan Journal of Interdisciplinary Research

# Balkan Journal of Interdisciplinary Research


Vol. 3, No. 2  
September, 2017

Vol. 3, No. 2  
September, 2017

ISSN: 2410-759X



IIPCCL Graz, Austria  
Access this Journal online at [www.iipcl.org](http://www.iipcl.org)



INTERNATIONAL INSTITUTE FOR PRIVATE  
COMMERCIAL AND COMPETITION LAW  
(IIPCCL)

**IIPCCL PUBLISHING, Graz-Austria**

# **Balkan Journal of Interdisciplinary Research**

ISSN 2410-759X (print)  
ISSN 2411-9725 (online)

**Vol 3, No. 2 - September 2017**

**Graz, Austria 2017**

**Editor in Chief  
Assoc. Prof. Endri Papajorgji**

**Editing  
Dr. Angelika Kogler**

**Scientific Cordinator  
Prof. Dr. Horst-Dieter Westerhoff**

**Editorial Assistant  
Ines Todhe**

**Graphic Design  
Dr. Dejan Vujtan**

---

**Copyright © 2015 IIPCCL – International Institute for Private, Commercial and  
Competition Law**

ISSN 2410-759X (print)  
ISSN 2411-9725 (online)

**Vol 3, No. 2 - September 2017**



**This work is licensed under a CC License of  
Attribution-Noncommercial-NoDerivatives 4.0 International (CC BY-NC-ND 4.0).  
Based on a work at iipcl.org.**

**PUBLISHER**

**© IIPCCL- International Institute for Private, Commercial and Competition Law**

**Schönbrunnngasse 12,  
8043 Graz, Austria**

**Email: [bjir.journal@gmail.com](mailto:bjir.journal@gmail.com), [research@iipcl.org](mailto:research@iipcl.org)**

**Web: <http://www.iipcl.org/>**

**This Journal is printed for IIPCCL  
by Drimm Publishing House  
Vienna, Austria**

# Balkan Journal of Interdisciplinary Research

**Vol 3, No. 2 - September 2017**

ISSN 2410-759X (print)  
ISSN 2411-9725 (online)

## About the Journal

Balkan Journal of Interdisciplinary Research is an international peer-reviewed journal published three times a year by International Institute for Private, Commercial and Competition Law. The need for different approaches in science, such as in business, economics, law, social sciences and other fields is a must in the whole field of scientific research. Academics, Professors, Researchers, Students and the whole world is in a new era of communication, which causes fast changes and gives birth to scientific and cultural debates. Our Journal is interested in promoting the exchange of idea, and to bring together researchers and academics from all over the countries. In this sense, we welcome papers not only in the above cited fields, but also in other fields of scientific research. Welcome to **BJIR**, which is open for the academic world, universities, research institutions, PhD students, academic and non-academic researchers. Aiming at scientific excellence and quality, this journal will promote the best inputs in scientific and academic research, on the prospective of local, international, global developments in business, economics, law, social-, but also natural sciences. All manuscripts will be double blind peer reviewed by the members of the editorial board who are noted experts in the appropriate subject area.

*Editor in Chief,*  
*Prof. assoc. Dr. PhD (Uni Graz) Endri Papajorgji*

# **Balkan Journal of Interdisciplinary Research**

*Editor in Chief, Prof.assoc. Dr. PhD (Uni Graz) Endri Papajorgji*

## **International Editorial Board**

**Prof. Dr. Jürgen Wolfbauer**  
*Montanuniversitaet Leoben (Austria)*

**Prof. Dr. Rajmonda Duka**  
*University of Tirana (Albania)*

**Prof. Dr. Horst-Dieter Westerhoff**  
*Universität Duisburg-Essen (Germany)*

**Dr. Afërdita Berisha-Shaqiri**  
*University of Pristina (Kosovo)*

**Dr. Mladen Andrić**  
*Croatian Diplomatic Academy (Croatia)*

**Prof. Ass. Dr. Naim Baftiu**  
*University of Prizren (Kosovo)*

**Prof. Dr. Iraj Hashi**  
*Staffordshire University (UK)*

**Prof. Dr. Nabil Ayad**  
*University of East Anglia, London (UK)*

**Dr. Eda Bezhani**  
*University of Durres (Albania)*

**Prof. Ass. Dr. Arseno Gjipali**  
*University of Tirana (Albania)*

**Prof. Dr. Bektash Mema**  
*University of Gjirokastra (Albania)*

**Prof. Dr. Ilia Kristo**  
*University of Tirana (Albania)*

**Prof. Dr. Azem Hajdari**  
*University of Pristina (Kosovo)*

**Prof. Dr. Abdylmenaf Bexheti**  
*University of SEEU (Macedonia)*

**Prof. Dr. Joseph Mifsud**  
*University of East Anglia, London (UK)*

**Prof. Dr. Lindita Milo-Lati**  
*University of Tirana (Albania)*

**Dr. Hans-Achim Roll**  
*Rechtsanwalt (Germany)*

**Prof. Ass. Dr. Evis Kushi**  
*University of Elbasan (Albania)*

**Prof. Dr. Mimoza Karagozi (Kore)**  
*University of Tirana (Albania)*

**Prof. Em. Heinz Dieter Wenzel**  
*University of Bamberg (Germany)*

**PhD (Argosy University) Gerti Dajçi**  
*Tirana Business University (Albania)*

**Dr. Sasha Dukoski**  
*University of Bitola (Macedonia)*

## TABLE OF CONTENTS

<b>Reformacioni Protestant dhe Nacionalizmi Shqiptar.....</b>	<b>9</b>
<i>Ylli H. Doçi</i>	
<b>Disa aspekte mbi bashkepunimin e veprës penale dhe VUGJL nr. 4/2011 ....</b>	<b>23</b>
<i>Dorina Hoxha</i> <i>Vladimir Skenderi</i>	
<b>Përgjegjësia civile e administratorëve në shoqëritë e kapitalit .....</b>	<b>38</b>
<i>Mitat Dautaj</i>	
<b>Vulnerability to corruption in public procurement review system .....</b>	<b>50</b>
<i>Ketrina Çabiri Mijo</i>	
<b>Initial jurisdiction of the high court and constitutional reform in Albania ..</b>	<b>57</b>
<i>Elsa Miha</i> <i>Lirime Çukaj (Papa)</i>	
<b>Sexual assault trends and effects in the post war Kosovo’s eastern region ....</b>	<b>66</b>
<i>Zejnullah Surdulli</i>	
<b>Freedom, would it survive with the abolition of social inequalities? .....</b>	<b>75</b>
<i>Anila Kashnjeti</i>	
<b>Price perceptions and consumer shopping behavior: A case study of Albania..</b>	<b>80</b>
<i>Marietta Poshi</i>	
<b>Violence in school and good educational performance in Kosovo .....</b>	<b>86</b>
<i>Bujar Thaçi</i>	
<b>The development of technology and its role in teaching.....</b>	<b>94</b>
<i>Anila Aliko</i>	
<b>Lidhja mes Voskopojes dhe Vithkuqit ne shek. XVII dhe XVIII dhe situata e tyre ekonomike në këtë periudhë.....</b>	<b>99</b>
<i>Rozela Dhimgjini</i>	
<b>Adoptimi i shërbimeve mobile qeveritare në Republikën e Kosovës .....</b>	<b>104</b>
<i>Fakije Zejnullahu</i> <i>Bekim Stafai</i> <i>Indrit Baholli</i>	

<b>Rehabilitimi i një populli pas përjetimit të traumës kërkon rregullimin e mirëqenies socio-ekonomike dhe sundimin e ligjit në vend: Shembulli i Kosovës .....</b>	<b>118</b>
<i>Edona Berisha Kida</i>	
<b>Këngët kreshnike – shtrirja e tyre modale .....</b>	<b>127</b>
<i>Kushtrim Jakupi</i>	
<b>Joint property of spouses – According to Kosovo legislation .....</b>	<b>134</b>
<i>Nehat Idrizi</i>	
<b>Revolta e qenies Post-modernizmi, filozofia e ndryshimit të natyrshëm ....</b>	<b>141</b>
<i>Eriseld Kalemaj</i>	
<b>Historia e kërkimeve arkeologjike në Anamoravë .....</b>	<b>149</b>
<i>Riza Fazliu</i>	
<b>Together for Autism.....</b>	<b>155</b>
<i>Klorela Rexhahmataj</i> <i>Florida Bonjo</i>	
<b>The role of the parenting style in the importance of the close friendship functions in middle adolescence .....</b>	<b>162</b>
<i>Ingrit Luani</i>	
<b>Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me theks të veçantë në të drejtën e aksesit të gjykatë.....</b>	<b>172</b>
<i>Artan Qerkini</i>	
<b>Roli i terapisë psikologjike në burgje .....</b>	<b>180</b>
<i>Edlira Jahiu Ylli</i>	
<b>Vet-koncepti dhe çrregullimet e të ngrënit .....</b>	<b>185</b>
<i>Semiramida Manaj</i>	
<b>The role of human resources in economic development in the Republic of Kosovo .....</b>	<b>194</b>
<i>Ibrahim Kryeziu</i>	

**Calopteryx xanthostoma (Odonata, Zygoptera) present in the southernwest areas of Albania ..... 201**

*Enilda Shkëmbi*

*Bledar Pepa*

*Kastriot Misja*

*Anila Paparisto*

**Women's mindset in Indonesian novels in the pre and post-independence era ..... 207**

*Suroso*

**Struktura logjike e teoremës dhe metodika e hartimit të testeve..... 216**

*Yllka Hasani*

*Irilda Olldashi*

*Dhurata Çabja*



## Reformacioni Protestant dhe Nacionalizmi Shqiptar

Ylli H. Doçi

### Abstrakt

Lidhja e Reformacionit Protestant me nacionalizmin në përgjithësi është e kuptueshme, nëse dallohet natyra intelektuale e çlirimit të përgjithshëm nga një kuptim i kufizuar i autoritetit të dukshëm të Mesjetës në hapësirën e autoritetit të perceptuar subjektivisht që solli reformacioni. Lidhja e ndikimit emancipues të Reformacionit me Rilindjen Kombëtare Shqiptare bëhen të dukshme nëse kuptohen jo vetëm formacionet kuptimore të influencuara nga Reformacioni, por edhe disa dimensione historike të gjuhës dhe arsimit shqip, prandaj po propozojmë një arsyetim për tezën që ndikimi i Reformacionit Protestant është i dallueshëm edhe në historinë e nacionalizmit Shqiptar.

**Fjalë kyç:** Reformacioni, Protestantizmi, Moderniteti, Nacionalizmi, Autoriteti, Arsimi.

### Hyrje

Crane Brinton, Profesor i Historisë në Harvard, shkruan: "Humanistët nuk ishin aspak arkitektët kryesorë të botës moderne dhe as formatuesit e mendjes moderne. Për sa u përket këtyre dy shekujve që na bëjnë ne ata që jemi [1450-1650], pa krahasim formatuesit më të rëndësishëm ishin protestantët, racionalistët dhe shkencëtarët (Brinton, 1963, fq. 53)." Pa frikë ekzagjerimi mund të themi se pothuaj çdo aspekt i jetës moderne është rezultat direkt ose rrjedhojë zhvillimi e Reformacionit Protestant që filloi në 1517 në zemrën e shoqërisë Europiane.

Arsyeja pse ky reformacion është në qendër të gjithë zhvillimeve moderne është sepse konsiston në çlirimin e përgjithshëm nga një kuptim i kufizuar i autoritetit të dukshëm të Mesjetës në hapësirën e autoritetit të perceptuar subjektivisht të modernitetit. Për të kuptuar zhvendosjen e pakthyeshme të pikës së rëndesës së kulturës Europiane, që konsiston në vendosjen e shtratit të epokës moderne, duhet kuptuar fuqia e zhvendosjes konceptuale të Martin Luterit në kontekstin e kohës së tij. Mënyra si lidhet kjo zhvendosje konceptuale, "*paradigm shift*," me humanizmin pararendes dhe racionalizmin apo edhe iluminizmin pasues, është kuptimi që shpjegon çelësin që përfaqëson reformacioni për historinë intelektuale të periudhës së fillimit të epokës moderne.

### Reformacioni dhe autoriteti

Fillimet e marrëdhënieve të ngushta midis pushtetit papal dhe pushtetit politik në hapësirën që filloi të konsiderohet si Evropa Perëndimore, lidhen me marrëdhënien e Papës dhe pushtetarit të parë të madh të Europës Perëndimore, Karli i Madh (768-814). Papa Leo III është ai që kurorëzoi Karlin e Madh në krishtlindjen e vitit 800 duke e quajtur mbretin e Frankeve si "Augusti... Perandor i Romakëve (Harrison and Sullivan, 1980, fq. 199)." Papët e mëvonshëm e konsideruan

këtë ngjarje si një precedent për të drejtën e tyre të caktonin udhëheqësin e botës së krishterë dhe të drejtën për të gjykuar sjelljen e tij, por gjithsesi paralelisht me këtë, u zhvilluan edhe idetë e disa europianëve që u përpoqën të përkufizojnë synimet e një qytetërimi perëndimor në lidhje me fushën politike, shoqërore dhe fetare të cilat krijojnë një bazë kuptimore të rëndësishme në kohën e Reformacionit (Harrison and Sullivan, 1980, fq. 2004).

Reformacioni që shpërtheu me Martin Luterin në vitin 1517, plot 500 vjet më parë, ishte “syri i stuhisë” apo pika ku uragani transformues shoqëror preku mesjetën, duke hapur rrugën për botën moderne që sot ka pushtuar pothuajse gjithë globin. Rilindja Europiane që filloi në shekullin e 15-të, Reformacioni i shekullit të 16-te dhe Racionalizmi, pastaj Iluminizmi i shekullit të 18-të, ishin forcat e ndryshme të grumbulluara të uraganit transformues, që preku tokën me Reformacionin si faktor vendimtar. Këto forca përbërëse të uraganit modernizues, që do të përbënte mentalitetin modern, ecën së bashku me ndikim të përbotshëm duke ndryshuar jetën me formatimin e kombeve të shtyrë nga revolucioni Francez dhe zhvillimet që pasuan në vazhdimësi.

Për ta kuptuar arsyen e fuqisë së reformacionit Luteran, duhet kuptuar konteksti i shoqërisë së asaj kohe që për më shumë se 1000 vjet kishte konsoliduar një kontekst kulturor jetësor ku Krishtërimi përshkonte çdo aspekt të jetës dhe çdo institucion shoqëror, dhe ku kisha katolike, por në veçanti Papa, konsistonte në autoritetin me të pakalueshëm përfundimtar në gjithçka. Erazmi i Roterdamit, një humanist i kohës së Luterit, megjithëse mbeti një katolik i betuar, kritikonte me fjalët më të rënda papatin e kohës së tij (Reid, 1995, fq. 191) por shoqëria e kohës së Erazmit dhe Luterit ishte një shoqëri e krishterë dhe sado rezerva që të kishin kundër kishës dhe Papës nuk mund të ngriheshin dot moralisht mbi autoritetin e tyre. Nëse ata ishin të krishterë dhe papa personifikonte Krishtin, atëherë si mund të ngrihej kristiani kundër Krishtit? Por, ashtu siç bëri Luteri, nëse Krishtërimi përkufizohej nga Bibla, dhe vetëm Bibla ishte e pagabueshme, atëherë kristiani mund të ngrihej kundër çdo autoriteti tjetër. Luteri nuk e bëri këtë duke synuar rrëzimin e autoritetit të Papës, përkundrazi, ai ishte katolik i ndërgjegjshëm dhe u kthye kundër Papës vetëm kur u detyrua të zgjidhte midis autoritetit të Biblës apo të Papës dy vjet pas 1517-s kur gozhdoi 95 tezat kundër indulgjencave.

Luteri kishte arritur në një kuptim biblik për natyrën e shpëtimit nga mëkati duke zbuluar thelbin e ungjillit – lajmit të mirë, kur thote: “...si rezultat i të berit dhe i të qenurit i drejtësuar ne bëjmë vepra të drejta. Së pari, personi duhet të ndryshojë, pastaj të veprojë. Së pari, Abeli është i pranueshëm, pastaj ofertat e tij (Sheldon, 1994, fq. 55)” e megjithatë ne fillim nuk dyshonte që ky kuptim i tij ishte njësoj siç kuptohej edhe nga Papa (Sheldon, 1994, fq. 61). Ai madje i shkroi Papës Leo X në 30 Maj 1518, duke i deklaruar motivet e tij të ndershme dhe të pastra dhe u shpreh i gatshëm t’i bindej vendimit të Papës me fjalët: “... e paraqes veten time tek këmbët e tua, me gjithçka jam dhe gjithçka kam... Zërin tënd do ta pranoj si zërin e Krishtit (Sheldon, 1994, fq. 64).”

Vetëm kur u ballafaqua me ata që mbronin indulgjencat, së pari me 1518 në Augsburg, që në parim ishin sipas kuptimit të shpëtimit me anë të meritave dhe jo siç e kuptonte Luteri shpëtimit nga Bibla; me anë të hirit me besim pa merita dhe pa vepra, atëherë ai u bë gati për qëndresë parimore deri në fund duke thënë:

“... duhet t'i bindesh Perëndisë dhe jo njëriut (Sheldon, 1994, fq. 66).” Ai u kthye kundër Papës me deklaratat e tij kur u ballafaqua në Lajpcig në fillim të verës 1519 (Sheldon, 1994, fq. 69–72). Pasi u kthye kundër Papës, menjëhere pas Lajpcigut, u kthye nga populli Gjerman për të filluar reformimin me “Apelin ndaj Perandorit dhe fisnikëve të kombit Gjerman.” Ky apel ishte “... adaptuar shkëlqyeshem për ndjenjat kombëtare (Sheldon, 1994, fq. 74)” dhe “divorci i përjetshëm nga Papati” u konfirmua me 10 Dhjetor 1520 (Sheldon, 1994, fq. 79). Shpejt pas kësaj Luteri përktheu Biblën në Gjermanisht dhe i dha popullit të tij shtysen me të rëndësishme drejt kristalizimit të nacionalizmit Gjerman.

### Çarja e Mesjetës dhe agimi i botës moderne

Në Janar 1521, në vitin e parë të divorcit nga Papa, Luteri u thirr në Worms dhe duke ditur si ishin trajtuar heretiket e tjerë, Luteri ishte i gatshëm të vdiste duke shkruar: “... jeta ime është pa shumë rëndësi... çështja e rrezikut apo sigurisë nuk duhet të na preokupojë; në vend të kësaj duhet të kemi mendjen të mos e lëmë ungjillin që kemi përqaftuar të përdhosen ... duke u dhënë rasë kundërshtarëve tanë me mburrje të tallën se ne s'kemi guxim të deklarojmë atë që kemi mësuar apo kemi frike të derdhim gjakun tonë për hir të tij [ungjillit]. ... Edhe sikur të ndezin një zjarr nga Wittenergu ne Worms me flaket që arrijnë deri në qiell, unë prapëseprapë do dal para tyre në emrin e Zotit... duke deklaruar Zotin Jezus Krisht (Sheldon, 1994, fq. 80-1).” Kur arriti para këtij gjyqi në Prill të atij viti, Luterit vërtet iu desh të qëndronte para kërcenimit të shkatërrimit total. për shkak të bindjeve të tij për të vërtetën, kuptimit të tij të shenjtërisë së ndërgjegjes personale, besimit të tij në sovranitetin e Perëndisë para çdo pushteti tjetër, Luteri deklaroi me guximin dhe me fjalët e njëriut modern: “nëse nuk jam bindur nga dëshmia e Shkrimeve ose nga një arsyetim i qartë, nëse nuk me mbushet mendja nga shpjegimi i atyre teksteve që kam përmendur, dhe nëse ndërgjegjia ime nuk është e lidhur kështu nga fjala e Zotit, unë atëherë nuk mundem dhe nuk do të tërhiqem; sepse është e rrezikshme dhe dëmtuese të veprësh kundër ndërgjegjes tënde. Këtu qëndroj, nuk mund të bej ndryshe: Zoti më ndihmoftë! Amen (Sheldon, 1994, fq. 82).”

Ajo që e frymëzonte Luterin të mos ndalej as para vdekjes ishte bindja se kishte kuptuar të vërtetën jetëdhënëse të mesazhit kryesor të Biblës; ungjillin. Ungjilli është jetëdhënës por paraqitet si një fjalë, një kumt, një mesazh. Si i tillë është një çështje fjalësh dhe kuptimi. Krishtërimi si një fenomen historik shfaqet si një lëvizje që u zhvillua si rezultat i përhapjes se këtij lajmi; ungjillit. Ai që Bibla e quan FJALA e mishëruar, Jezusi, e tha dhe e bëri lajmin e mirë që deklaroi se: drejtësia e Perëndisë është nga hiri me besim në Krishtin (Bibla, Romakëve 3:21ff). Lidhja që ekziston midis Perëndisë dhe fjalës se Tij është shumë e ngushtë. Analogjia e një njëriut dhe fjalës komunikuese të tij edhe pse jo e përsosur është e mjaftueshme për të ilustruar këtë lidhje, dhe nëse jemi dakord për autoritetin suprem të Perëndisë, patjetër nuk ka debat për konsiderimin e fjalës se tij si autoritet përfundimtar, pavarësisht nga çështja e interpretimit.

Krahasimi pra i autoritetit bëhetë midis atij të Perëndisë dhe fjalës se njëriut, qoftë ky edhe Papa. Diskutimi i Luterit dhe një nga çështjet e rëndësishme të kohës së tij ishte çështja e autoritetit përfundimtar. Kuptimi i kësaj çështjeje ne atë periudhë

shprehet kështu nga një historian: "Besimi Katolik qëndron mbi një nen të padiskutueshëm; shprehimisht, autoriteti i pagabueshem i Kishës (Sheldon, 1994, fq. 2)." për njërezit e asaj kohe autoriteti i Kishës me Papën si autoriteti absolut, ishte autoriteti përfundimtar, por Luteri, megjithëse ishte rritur dhe formuar në këtë kontekst, kuptoi nga Bibla lidhjen e drejtpërdrejtë të çdo njëri me FJALËN ndriçuese (Bibla, Gjoni 1:9). Luteri pra theksoi diferencën e autoritetit të Kishës ose të Papës nga autoriteti i Perëndisë dhe Fjalës së Tij duke vendosur çdo njëri direkt nën autoritetin e Perëndisë sipas Fjalës së Tij duke nënkuptuar një zgjedhje personale.

Është kjo zgjedhje personale, kjo vetëdije e zërit të se vërtetës në ndërgjegjen e personit, që ilustron edhe nga vetë përjetimi i Luterit para përfaqësuesve të Papës në Worms. Nga një pranim apriori i autoritetit të caktuar tradicional kishtar dhe kulturor apo shtetëror Luteri vjen tek roli i ndërgjegjes personale, bazuar në të vërtetën e Fjalës së Perëndisë, duke hapur rrugën për të drejtën baze njërezore të lirisë personale të pranimit të autoritetit që, megjithëse është objektivisht jashtë nesh, mund vetëm të pranohet subjektivisht pa dhunuar ndërgjegjen në lirinë për të dalluar dhe pranuar të vërtetën. Kjo zgjedhje çliroi gjithë kulturën Europiane nga autoriteti i "njëriut," siç konsiderohej tashmë në mënyrë denigruese edhe papati si institucion, dhe hapi rrugën e lirisë së afirmimit të autoritetit të se vërtetës, të bukurës dhe të mirës ngado që të vijë që për protestantët kishte Biblën si pikë referimi.

Thelbi i Protestantizmit duhet kuptuar në zhvendosjen nga presioni konformues ndaj autoritetit të traditës, tradicionalizmit obskurantist, në afirmimin e lirisë së dallimit subjektiv dhe pranimit personal të autoritetit. Duhet kuptuar gjithashtu që fuqia e qendrueshmerisë dhe bindshmërisë së protestantëve, në lidhje me këtë të drejtë bazë njërezore që sot merret si e mirëqenë, ishte për shkak të besimit në Perëndinë që me FJALËN e Tij ndriçon çdo njëri që vjen në këtë botë (Bibla, Gjoni 1:1-4, 9). Siç shkruan Brinton: "... rëndësia ëryesore e Protestantizmit është si një shpërbërës – me i forti në këto vite – i autoritetit mesjetar (Brinton, 1963, fq. 106)." Kjo e zhvendosi përpjekjen konformuese ndaj urdhrave të një autoriteti të padiskutueshem tek bindja ndaj ndërgjegjes së brendshme (nga feja tek besimi); nga pasiviteti i interpretimeve të gatshme tek analiza e informuar e të vërtetës në mënyrë kritike (nga rituali tek adhurimi); nga ndarja në princer të kishës dhe popull analfabet në të gjithë si prifterinj dhe arsim masiv (bibla dhe arsimi); nga privilegje të hierarkisë së trashëguar në meritokracinë e dinjitetit të çdo profesioni (biznesi dhe politika).

Për Luterin kjo ishte së pari një çështje të vërtetë biblike, me vlere të përjetshme për çdo individ, por sigurisht që interesat politike të aktorëve të tjerë të kohës iu veshën lehtëzi këtij preokupimi të admirueshem. Theksimi i arsyeshëm i rolit të individit për të ekuilibruar theksin e rëndësisë së komunitetit u kthye në lajtmotiv dhe fokus të tepert qysh nga ajo kohë në botën perëndimore duke sjellë shumë shtremberime dhe sëmundje në shoqërinë Europiane dhe më vonë atë Amerikane. Por pavarësisht nga mbitheksimet dhe shtremberimet e kohërave dhe grupeve e interesave të shumta që u çliruan në atë kohë, mbetet e rëndësishme të kuptohet natyra krejtësisht biblike e theksimit të lirisë individuale sipas të vërtetës objektive, kuptuar si një dallim i cilësisë së deklaratave përshkruese të realitetit objektiv,

me pasoja ndricuese dhe transformuese për individin dhe gjithë shoqërinë. Ajo trashëgimi e arsimit të shëndoshë që reflektohet në shprehjen “mendim kritik” është fëmijë i denjë i këtij mentaliteti që e ka burimin tek Reformacioni. Arsyeja pse duhet vlerësuar aspekti biblik i këtij transformimi është se Reformacioni ishte kryesisht një çështje clirimi shpirtëror sepse ky dimension i jetës së Mesjetës ishte preokupimi bazë dhe formatues i gjithë kulturës së tyre. Ky dimension i jetës është si të thuash fusha e preokupimit më të lartë të jetes. Edhe sot, nëse dikush prek fushën e preokupimit me të lartë të jetës tënde, do kishte të njëjten rëndësi për ty si prekja nga Reformacioni në kohën e Mesjetës. Kohezioni ideologjik i Mesjetës shpjegon efektivitetin e fuqisë eksplozive të shpërthimit të Reformacionit në këtë pikë qëndrore të preokupimit të shoqërisë së Mesjetës. Interpretimet e epokës sonë natyrshëm e kanë të veshtirë të vlerësojnë rëndësinë e këtij aspekti shpirtëror. Megjithatë në dallojmë që historianet më afër reformacionit, edhe ata të kohës së Iluminizmit, e dallonin theksin shpirtëror më mirë se ata të mëvonshmit, kur theksohet aspekti politik dhe ekonomik. Deri tek Iluminizmi akoma jemi në qerthullin e fuqisë së ideve që lidhen me natyrshëm me Rilindjen dhe Reformimin, kurse pas revolucionit industrial dhe afirmimit të nacionalizmit, në preokupimet politike, edhe interpretimi vjen e fokusohet të këto aspekte që gjithësesi janë së pari pasoja të shpërthimit në sferën shpirtërore dhe intelektuale të Mesjetës. Konkluzioni i një teksti të historisë nënvizon edhe një herë rëndësinë e Reformacionit kur thotë se: “Shumica e historianëve janë dakord që çarja e Kishës së gjithëpushtetshme të Mesjetës ishte faktori më i rëndësishëm në mbylljen e epokës Mesjetare, dhe Reformacioni kështu del si i rëndësishëm madhore për ngritjen e qytetërimit Perëndimor modern (Harrison and Sullivan, 1980, fq. 369).”

### **Lidhja e Reformacionit me Nacionalizmin**

Nëse arrijmë në konkluzionin që Reformacioni ishte kyç në mbarsjen e botës moderne me mentalitetin e lirisë, mendimin kritik dhe të barazisë shoqërore, atëherë është më e lehtë të dallosh ndikimin e pakrahasueshem që pati Reformacioni edhe mbi zhvillimin e nacionalizmave (Harrison and Sullivan, 1980, fq. 369). Çështja e përkufizimeve për kombin dhe fillimeve të shfaqjes së kombeve, apo për nacionalizmin si i përkufizuar më shumë kulturalisht apo politikisht, është një diskutim i gjatë dhe i komplikuar (Hutchinson and Smith, 1994, fq. 4) por, për qellimin tonë këtu, mund të themi se nuk ka dyshime për rolin kryesor të modernitetit dhe, në këtë kontekst, të protestantizmit në shfaqjen e kombeve apo nacionalizmit.

Në lidhje me tiparet e nacionalizmit dy nga studiuesit me ne ze të çështjes thonë në librin e tyre: “Në këndvështrimin e tyre [baballarëve të nacionalizmit si Rousseau, Herder, Fichte, Korais, dhe Mazzini], dhe të nacionalisteve me të rinj, lëvizja [nacionaliste] sjell bashkë aspiratat jetësore të botës moderne: për autonomi dhe vetëqeverisje, për unitet dhe autarki, dhe për identitet autentik (Hutchinson dhe Smith, 1994, fq. 4).” Është pikërisht të ky kuptim ideologjik, që nënkupton lirinë që u shfaq me Reformacionin protestant si pjesa kryesore e aspekteve që sollen botën moderne, që unë dalloj kontributin e Reformacionit në shfaqjen e nacionalizmit.

Një tjetër shenjë e kësaj rëndësie të Reformacionit për shfaqjen e nacionalizmit, duke qenë në qendër të shfaqjes se botës moderne, del gjithashtu nga pyetja dhe përgjigjia e Anthony D. Smith: “Pse kombet dhe nacionalizmi së pari u shfaqen në Evropën Perëndimore? Përgjigjia nuk qëndron në ardhjen e kapitalizmit apo të shtetit të centralizuar modern, as në rolin e gjeografisë politike theksuar nga Hugh Seton-Watson... por në influencën e fesë, dhe veçanërisht Krishtërit. Kombi, sipas Hastings, është një fenomen i krishterë... (Guibernau dhe Hutchinson, 2001, fq. 15).”

Epoka e lëvizjeve të medha shoqërore që filluan pas Iluminizmit të shekullit XVIII me revolucionin Francez, kur shfaqen edhe shumica e formimeve të kombeve, shoqërohet nga një vale rizgjimi dhe zgjerimi i jashtezakonshem i Protestantizmit. Përhapja e protestantizmit dhe veçanërisht ai ungjillor, dallohet në atë që nga historianet quhet “rizgjimi i madh” rreth 1750-s me George Whitfield dhe vëllezërit Wesley që zgjati rreth 40 vjet. Pastaj një valë e dytë e ngjashme filloi rreth vitit 1800 me Charles Finney kur misionet ungjillore ndërkombëtare gjithashtu u intensifikuan. Sipas historianit Kenneth Latourette, duket se Protestantizmi përjeton një zgjerim të shpejte nga kjo kohë deri në mesin e shekullit XX kur ia ka kaluar shumë zgjerimit të Ortodoksise, dhe është në të gjitha vendet ku është edhe Katolicizmi, por në numër më të vogël (Latourette, 1975, fq. 1018).

Një tjetër koleksion shkrimesh për nacionalizmin konfirmon të njëjten bindje të përgjithshme të lidhjes së nacionalizmit me modernizmin, që përsëri nuk mund të kuptohet në fillimet e veta pa ndikimin dominant të Reformacionit dhe përhapjes së protestantizmit. Në këtë analizë të pikëpamjeve për nacionalizmin dhe lidhur me spekulimet e kohës së shfaqjes së kombeve konkludohet se ka dy “kalendarekontrastues: *modernistet* e datojnë formimin me ardhjen e modernitetit, në çfarëdo forme që përkufizohet kjo e fundit; *perenialistet* i shohin [kombet] si të përjetshëm, ... madje fenomene mijëvjeçaresh sigurisht paraprires të modernitetit. Modernizmi mbetet një nga postulatet e pakta i përfaquar nga shumica e studiuesve, në vetvete një arritje e rrallë kjo (Leoussi and Grosby, 2007, fq. 18).” Sigurisht që kur themi “modernist” ne lidhje me kuptimin e shfaqjes së kombeve nuk mund të themi se ka dakordësi për shumë gjera por minimalisht “... nëse modernistet kanë të drejte atëherë nuk mund të këtë as kombe dhe as nacionalizem në periudhën para-moderne (Smith, 1991, fq. 44).”

Adrian Hastings, megjithëse merret si shembull i një perenialisti (Ozkirimli, 2010, fq. 58), në lidhje me kuptimin e tij për etninë dhe kombin është i kujdesshem të diferencojë “nacionalizmin” si ideologji që ai nuk e konsideron të mundshme para modernitetit. Teza qëndrore e Hastings është: “kombet moderne mund të dalin vetëm nga etni të caktuara, nën ndikimin e zhvillimit të një gjuhe dhe presioneve të një shteti. ... Origjina përkufizuese e kombit, arsyetën Hastings, ashtu si çdo realitet tjetër i madh i përvojës moderne perëndimore, duhet të përcaktohet në një epokë shumë më heret se shumica e historianëve moderniste ndihen rehat për ta konsideruar, ajo e formatimit të shoqërisë mesjetare (Ozkirimli, 2010, fq. 59).” Kjo teza duket se mbështet edhe më mirë se sa thjesht kategoria e gjerë e “modernitetit” kuptimin e Reformacionit si bartes i modernitetit, influencues në lidhje me kombet dhe nacionalizmin; kjo edhe për faktin se teza e Hastings konsideron që etnitetet kthehen në kombe kur gjuha e tyre specifike kalon nga një

faze orale në përdorimin e shkruar, në masën që përdoret rregullisht për prodhimin e një letërsie, dhe veçanërisht për perkthimin e Biblës (Hastings, 1997, p.fq. 11–12).

Kur merr parasysh që Hastings e konsideron Biblen si atë që siguron modelin original për kombin duke iu referuar rastit të Hebrenjve, që mbetet një rast i pashmangshëm i një realiteti kombëtar aq sa vetëm përkufizimet e lodhshme mund të të ngaterrojnë të mos e dallosh, përsëri vijmë tek i njëjti argument që interpretimi i krishterë, dhe veçanërisht ai protestant, bën të mundur që kombet të ekzistojnë në kuptimin që kemi sot për kombet (Ozkirimli, 2010, fq. 60).

Kisha mesjetare deri në kohën e Luterit, ishte jo kombëtare. Rezultati i reformimit duket tek kishat Kalviniste që ishin kisha kombëtare (Svicerane, Hollandeze, Gjermane, Skoceze dhe Kisha Anglikane) që janë në kontrast të dallueshëm me kishën Mesjetare. Nuk mund të mohohet dot influenca e Protestantizmit në këtë drejtim kombëtarizues packa se nuk ishte qëllim në vetvete. Qëllimi i parë i protestantëve duhet parë i lidhur me misionin biblik. Duke kuptuar karakteristikën kryesore të ungjillit, si lajm dhe si kumt, që nënkupton një gjuhë të kuptueshme për individin dhe komunitetin gjuhësor, kuptojmë edhe kontributin e natyrshëm të përkthimit të Luterit të Biblës në Gjermanisht, jo vetëm për komunikimin e ungjillit si një preokupim fetar por, pa kontradikte në të njëjtën kohë, edhe një kontribut për kulturën gjermane si edhe për kristalizimin e kombit gjerman.

Reformacioni që shpertheu me Luterin vuri në qendër nevojën e arsimit në gjuhën e popullit për të mesuar dhe zbatuar Biblen dhe indirekt ky fokus tek Bibla konsolidoi bazën me të mirë të zhvillimit të ideve kombëtare me arsimin kombëtar që është vendimtar në formimin e kombit. Megjithëse ideja e kombit kishte filluar me përvijimin e disa fuqive rajonale Europiane si Anglia, Gjermania, Franca, vetëm me reformimin e kishës dhe riformatimin e jetës kulturore në reagimet e ndryshme ndaj reformacionit kishtar, mori hov ideja kombëtare dhe fuqia e arsimit kombëtar që realizoi shtetin kombëtar. Përsëri mund të nenvizojmë se ky theks tek Reformacioni nuk është në kontradikte me efektin që solli grumbullimi i influencave të Rilindjes Europiane përkrah Reformacionit me Racionalizmin, Klasicizmin, Iluminizmin dhe madje edhe Romantizmin duke u bere një dallje e madhe që gjeti dalje dhe u përhap në gjithë botën me revolucionin francez dhe luftërat Napolonike dhe solli një rezultat formatues për botën me epokën e kombeve moderne.

Këtu hyn edhe Shqipëria dhe roli i protestanteve shqiptare, si analog me atë që luajti Luteri në kombin e tij, si ilustrim i rolit të protestantizmit në përgjithësi në shfaqjet e kultures moderne, duke kultivuar gjuhën pamvaresisht se motivimi ishte me i lartë se thjesht ai kombëtar.

### **Reformacioni dhe Shqipëria**

Nëse shikojmë lidhjen e Reformacionit me lëvizjet kombëtare që moren flakë edhe nga revolucionin Francez, që ishte në vetvete një zhvillim i asaj lirie të ciluar nga reformacioni, do të pranohet që nuk ishte rastesi që zgjimet kombëtare në atë periudhë duken pothuaj si një epidemi. Kapja e kësaj ndjenjë të përhapjes së ideve kombëtare, pothuaj si një fenomen natyror, “koha e rilindjes kombëtare,”

është e kuptueshme, por duhet theksuar që pamvaresisht nga rrymat dhe lëvizjet shoqërore të periudhave me ndikimet nga ekonomia apo politika apo faktore të tjerë të shumte, roli i ideve, dhe ne këtë rast roli i ideve të cliruara nga reformati protestant, nuk mund të neglizhohet. Këtu është me vlere të theksojme që nuk duhet të nenvleftesojme rolin e ideve perballe rolit të interesave dhe aspekteve materiale të jetës sepse ashtu sic thotë edhe Brinton: "... ne historine njërezore nuk ka fakte të rëndësishme që nuk janë të lidhura me idetë. ... Asnjë historian i ideve s'ka nevojë të debatojë nëse idetë apo interesat i shtyjne njërezit të veprojnë ne shoqëri, as se kush vjen se pari. Ashtu si makina nuk ecën pa benzinen dhe ndezjen ashtu edhe pa të dyja; idetë dhe interesat (orekset, shtysat, apo faktoret materiale) nuk ka shoqëri njërezore funksionale dhe as histori njërezore (Brinton, 1963, fq. 12)." Sigurisht që ne periudhen e rilindjes kombetare ishin pjekur disa kushte shoqërore për veprimtaritë që u ndermoren nga njërez e grupe të ndryshme dhe kishte edhe shumë arsye të tjera pse njërezit benin ato që benin, por kjo nuk anulon të vërtetën e influences se ideve protestante nëse ne jemi të gatshëm ta shqyrtojmë këtë interpretim. Dallimi i formave tipike të influencuara nga Reformati ka të beje kryesisht me shkollën kombetare dhe gjuhën kombetare. Duke qene pa dyshim një nxitje protestante, pikësepari për përhapjen e ungjillit clirues të individit nga çdo tradicionalizem i mbyllur dhe armatosjen e njërit me aftësitë shqyrtuese të një lidhjeje direkt me Perendinë, shkolla ne të njëjten kohe është edhe një avantazh i shumanshem formatimi kombetar.

Duke ardhur me specifikisht ne rastin e Shqiperise, kemi shoqërinë Biblike Britanike, një organizatë protestante, jo rastesisht e krijuar ne vitin 1804 ne mes të rizgjimeve ungjillore të përmendura me lart, që është e interesuar ne menyre specifike të sjelle biblen ne gjuhën e kombeve të ndryshme ku perfshihet Shqiperia qysh ne 1816 (Lloshi, 2012, fq. 37). Xhevat Lloshi, studiues i mirenjohur shqiptar, shkruan për ideatorin e parë të perkthimit shqip: "Robert Pinkertoni jepte ndihmese të cmuar për kulturen shqiptare, pikërisht që të beheshin me të arrira vetite e shqiptareve të rrepte (Lloshi, 2012, fq. 67)," duke lidhur kështu interesimin e paster protestant për biblen me aspiratat e zgjuara kombetare të popujve.

Përsëri studiuesi Lloshi pershkruan me objektivitet, duke treguar një kuptim jo të zakonshem midis studiuesve shqiptare lidhur me sfondin kuptimor të protestanteve, se motivimi protestant ishte i sinqerte ne lidhje me besimin e tyre por ne një vijimesi të natyrshme me interesat kombetare të Shqiptareve dhe jo si një duel i heshtur kontradiktash të fshehura që zakonisht na serviren, sidomos nga brezi i studiuesve të formuar me dyshim ndaj fese ne përgjithësi; "sidomos pa asnjë dije nga gjithë konceptimi protestant për Biblen (Lloshi, 2012, fq. 115)." Ja si na e pershkruan ai kuptimin e tij për shoqërinë Biblike të lartpërmendur dhe protestantet ne përgjithësi:

"Ndonëse libri i parë shqip i Gj. Buzukut (1555) ka pjese të gjera nga Bibla dhe perpjekje të tjera janë bere për perkthimin e Shkrimeve të Shenjta shqip, deri ne shekullin XIX nuk kemi pasur asgje të tille të botuar. Dy kishat e medha, katolikja dhe ortodoksja, për arsye të nderlikuara, e shperfillen këtë fushe kaq të rëndësishme dhe e lane djerr. Atë e zune protestantet, të cilet do të kishin sukses jo vetëm sepse ditën ta leronin e ta mbillnin me mjeshtërine nga përvoja boterore, por edhe sepse pengesave nga kundërshtaret e tyre iu pergjigjen me një



*konceptim kulturor të punes.* Ky konceptim e pranonte gjuhen e vendit si mjet, madje edhe e vlerësonte dhe e perpunonte me seriozitet. Ai që ndihmonte shqipen ne shekullin e Rilindjes sone, e kishte historikisht të fituar betejën. për afër një shekull e gjysme perkthimet shqip për Shqiperine i ka realizuar Shoqeria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (Lloshi, 2012, fq. 29)."

Ajo që me fjalë të tjera thuhet Këtu është se protestantet ne përgjithësi e lidhnin frymezimin biblik për përhapjen e lajmit të mirë - ungjillit, me levrimin e gjuhes kombetare dhe arsimin, që ishin kontribute të vetedijshme për kulturen e kombit. Dhe mund të themi me argumentet e meposhtme se protestantizmi ne Shqiperi ka ardhur pikërisht me këtë dashuri për gjuhen dhe kombin shqiptar duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm. Qysh ne dokumentin e themelimit të Vellazerise Ungjillore ne 1892, që sot konsiston ne komunitetin e peste zyrtar fetar ne Shqiperi, konfirmohet pikërisht ky konceptim kulturor i punes për ungjillin kur thuhet se "Vellazeria Ungjillore... ka si qellim të vetëm përhapjen e Ungjillit dhe zhvillimin e letersise shqipe ne Shqiperi me të gjitha mjetet e ligjshme (Kuanrud, 1998, fq. 190)."

Kur flet për vendimin e themelimit të Shoqerisë Biblike Britanike për perkthimin e Biblës ne gjuhet e kombeve Lloshi thote: "... nga fryma e saj, një ngjarje e tille do të krahasohej me vete Reformacionin e shekullit XVI, kur ze fill protestantizmi (Lloshi, 2012, fq. 30)." Ky është edhe argumenti im ne këtë prezantim: protestantizmi ishte fryma që solli levrimin e gjuhes kombetare dhe arsimin kombetar permes motivimit biblik që ungjilli, lajmi i mire, t'u shkoje të gjitha kombeve.

Roli katalizator i Biblës, për shkak të përhapjes se saj dhe fleksibilitetit përdorues nga europiane të ndryshem për studimin e gjuhes, është një faktor i pamohueshem ne fillimet e studimeve të albanologjise qysh me J. Ksilanderin ne 1835, e me pas J. G. Hani, Dh. Kamarda, G. Majeri (Lloshi, 2012, fq. 110–112). Studiuesi Lloshi shkruan për botimin nga protestantet ne 1827 të "... se pares Dhiatë të re për gjuhen shqipe... si tekst i mirefillte i gjuhes se shkruar të njërit prej popujve me të lashte të Ballkanit" duke thene se "Interesimi i dijes europiane për shqipen iu drejtua atij si burimit më të vlefshem dhe të besueshem (Lloshi, 2012, fq. 108)."

Një studjues Amerikan<sup>1</sup> që ka jetuar e punuar ne Shqiperi për mbi 20 vjet, po ndricon disa aspekte të panjohura ne historine e nderveprimit të protestanteve me Shqiperine qysh ne fillimet e shekullit të XIX, por nga studimet e tij duket se edhe dokumenti i parë shqip nga Buzuku ne 1555 ka shumë të ngjare të jete i lidhur me idetë protestante që qarkullonin ne botën katolike të Ballkanit të asaj kohe. këto ide protestante shfaqen ne jeten e sllovenit Primoz Trubar (1508-1586), ish-prift katolik që u be reformator i njohur si autori i librit të parë të shtypur ne Sllovenisht, për të cilin Buzuku yne patjetër kishte dijeni.

Pra formacionet kuptimore si: ungjilli/Bibla – gjuhe/kulture – liri/vetevendosje, janë të pakten kuptimisht të dallueshem si forma të natyrshme të mendimit të cliruar protestant. Historikisht edhe ne Shqiperi kemi ndikimin pionier të Shoqerisë Biblike dhe botimit të parë të Biblës ne 1827, si edhe shkollat e para kombetare të lidhura me protestantet e parë Shqiptare. Shumë Shqiptare akoma nuk e dine se filmi i famshem "Mesonjëtorja" është një dramatizim i historisë se perpjekjeve të ungjilloreve të pare, Qiriazeve, për hapjen e shkollës shqipe.

Ndikimi ne formatimin e ndërjegjes kombetare Shqiptare të protestanteve

të parë Shqiptare me Qiriazet ne krye është e vështirë të matet, por është i paneglizhueshem. Ne diskutim të pyetjes se c'rol ze protestantizmi ne radhen e besimeve tradicionale Shqiptare, profesori Giovanni Cimbalo është mjaft i qarte ne konkluzionin e tij të argumentuar pergjatë librit: "E kemi parë tashme se historia e tij [protestantizmit shqiptar] kryqezohet thellesisht me perpjekjet për emancipimin e popullit shqiptar; me gjallerimin dhe përhapjen e gjuhes shqipe; me alfabetizimin e vendit dhe luften për pavaresi (Cimbalo, 2013, fq. 244)." Ne analize të historisë se ndikimit të ungjilloreve ne Shqiperi kemi përsëri një linjë të qarte të lidhjes se mesazhit biblik të ungjillit me gjuhen kombetare dhe formimin e ndërgjegjes kombetare: Fjala/Bibla shqip - Ndricimi/shkolla shqipe - Kombi Shqiptar emancipohet.

Gjerasim Qiriaz (Kuanrud, 1998) kuptoi lajmin e mirë nga ungjillore protestante (David Hosaflook ne studimet e tij akoma ne doreshkrim për botim se shpejti po dokumenton rigorozisht ato shenja të hershme të punes protestante midis Shqiptareve) anglishtfoles rreth vitit 1870 kur jetonte ne Manastir, dhe kjo e shtyu të linte zanatin e kepuçarit për të mesuar si t'u predikonte të tjerëve këtë lajm të mirë të dashurise se Perëndisë dhe të punonte për shkrimin shqip, shkollen shqipe dhe perparimin e kombit shqiptar. Qiriaz ne fillim shkoi si ungjilltar edhe tek Bullgaret ashtu si edhe Thanas Sina, një tjetër ungjillor Shqiptar i të njëjtes periudhe, por kombi i tyre kishte me shumë nevojë prandaj u kthyen me lajmin e mirë ne Shqiperine e tyre prej dashurise se Perëndisë për kombin e tyre. Nuk kishte kontradikte për ungjilloret shqiptare midis kombit dhe ungjillit sepse ungjilli ishte e mira për kombin dhe kombi nuk mund të ndricohej pa ungjillin. Nëse e donin kombin do të sillnin ungjillin dhe nëse e donin ungjillin do t'ia shpallnin kombit, por që kombi të kuptonte ungjillin duhej të kuptonte vetveten, të ndërgjegjesohej, të kultivonte gjuhen e vet sic kishte ndodhur ne Evropën e Luterit. Ky motivim është vështirë të kuptohet kur nuk kupton ungjillin por të pakten duhet kuptuar si lajmi i mirë për të miren e kombit që ne atë kohe lidhej direkt me të miren tjetër, atë të ndertimit të ures komunikuese mes zemres dhe mendjes se kombit, ne rritjen ndërgjegjesuese të gjuhes se shkruar kombetare dhe arsimit kombetar si hap paraprak emancipues.

### Ungjilloret dhe patriotet e tjerë shqiptare

Kombi Shqiptar, kjo familje etnike unike, ka ditur gjithmone të ruaje kontributin e mirë për jeten kombetare pamvaresisht nga cfare kendi ideologjik apo fetar ka ardhur kjo e mire, dhe ne këtë rast, ne fillimet e viteve 1820 me perkthimin e Biblës shqip, ishin të krishterët ungjillore që kishin iniciativen. Por për realizimin e botimeve shqip dhe shkollës shqipe u desh mbështetja e fuqishme e Shqiptareve të te gjitha besimeve; si atyre Myslymane e Bektashinj që ishin ne balle të lëvizjes kombetare me Naim Frasherin dhe vëllezërit e tij Abdylin e Samiun; apo Katolikeve të veriut që kishin levruar shqipen me dashuri qysh ne mesin e viteve 1500 (me Buzukun, Bogdanin, Budin, dhe Bardhin) dhe tanë vinin plot ide me Fishten dhe Mjeden ne Kongresin e Alfabetit. Sigurisht këto projekte kombetare u zhvilluan edhe me dashamiresine e popullsisë shqiptare ortodokse ku fillimisht u mboll ky filiz ungjillor si bekim për kombin Shqiptar. Ajo që e bëri të pranueshem kontributin

ungjillor ishte dashuria për shqipen, sepse patriotet mbështëteshin ne unitetin e genesishem brenda familjes shqipfolese si perkatesi e njëjte kombetare, por edhe dallonin protestantizmin si kontribut pozitiv para ideologjive të tjera që nenvleftesonin shqipen.

Kontributi i ungjilloreve për gjuhen Shqipe ishte mjaft i qarte perkrah patrioteve të tjerë të rrymave të ndryshme të dukshme sidomos ne Kongresin e Manastirit ne 1908 kur u diskutua alfabeti Shqip; një nga ngjarjet me të rëndësishme të kultures dhe kombit Shqiptar. Nga protestantet, Gjergj Qiriazit, që ishte edhe zevendes president i klubit Bashkimi, bashke me Grigor Cilken, pastor i kishës ungjillore ne Korce, moren pjese si delegatë votues të kongresit të alfabetit ku nga gjithë pjesemarrësit vetëm 32 vete kishin të drejte vote. Gjergj Qiriazit u votua si president i perkohshem ndersa pritej ardhja e Mid'hat Frasherit, dhe Parashqevi Qiriazit e vetmja delegate femer ne Kongres ishte sekretare dhe mbajti fjalim aty. Madje të dy ungjiloret gjithashtu u zgjodhen si anetare të komisionit prej 11 anetaresh me autoritet të plote të caktonin një alfabet dhe e konkluduan punen me sukses pas diskutimeve disa ditore (Young, 2011, fq. 34–37).

Duke raportuar për këtë ngjarje madhore kombetare Gjergj Qiriazit shkruan me 16 Janar 1909: "Jam shumë i kenaqur të them se thujse të gjithë të deleguarit të cilet ishin të pranishem ne këtë Kongres shprehen mirenjohjen e tyre të madhe dhe sa ne borxh ndjehen ndaj Shoqerisë Biblike për gjithcka që ajo ka bere për kombin... Midis atyre të cilet e shprehen këtë mirenjohje kishte edhe shumë myslimane dhe shumë prej tyre me kerkuan t'i shpreh falenderimet e tyre të perzemerta Shoqerisë nga ana e tyre (Young, 2011, fq. 38)."

Ne vitin 1910, një demonstrimin masiv 12.000 vetash ne Korce therriste 'Rrofte alfabeti shqip!' duke perfshire baballare bektashinj dhe hoxhallare myslimane. Poeti dhe hoxha Hafuz Aliu tha atë që të gjithë shqiptaret kuptojne: "Shkronjat e shqipes nuk lidhen me fene dhe nuk sjellin asnjë pengese." Aty u kendua edhe kenga për alfabetin, kompozuar nga Parashqevi Qiriazit duke u bere një himn kombetar (Young, 2011, fq. 41).

Gjithashtu, për ne Shqiptaret nuk përbën cudi fakti që Kongresi i Manastirit, që caktoi alfabetin prioritar me germa latine, kishte inkurajuar hapjen e një "shtypshkronjë shqiptare ne Manastir nen drejtimin e Gjergj Qiriazit, i krishterë ungjillor, kur kjo shtypshkronjë u financua nga një grup bejleresh myslimane (Young, 2011, fq. 40)." Ne një raport të vitit 1911 Hodgson i Shoqerisë Biblike thotë se "ne Manastir e gjetem shtypshkronjën shqiptare ne funksionim të plote... Kryetari dhe bordi drejtues i shtypshkronjës janë shqiptare muhamedane të cilet me sakrifice të konsiderueshme kanë ngritur fondet për sigurimin e saj. Ata e konsiderojne shtypjen e Biblës ne shqip si thirrjen dhe detyrën e tyre të parë dhe e kanë vendosur shtypshkronjën ne dispozicion të plote të Shoqerisë Biblike për këtë qellim (Young, 2011, fq. 44)."

Naim Frasheri dhe i vellai Samiu, që ishin ne poste të larta ne qeverine turke, ofruan ndihme të rëndësishme për shkrimet shqipe dhe shkollen shqipe të protestanteve ungjillore Shqiptare. Edhe nipi i tyre Mid'hat Frasheri, që ishte minister i arsimit dhe komunikimit ne qeverine e perkohshme shqiptare, ishte gjithashtu një mbështëtes i palekundur i Shoqerisë Biblike. Ai shkroi një artikull, që e botuan ne anglisht ne vitin 1911, ne të cilin ai thoshte: "Ndjenja kombetare...

është e fuqishme për të vene ne heshtje çdo ndryshim që diversiteti i feve mund të këtë krijuar. Shqiperia kurre nuk e ka njohur hidherimin dhe urrejtjen fetare; dhe çfarëdo qoftë kredoja e tij qoftë katolik, ortodoks ose mysliman, shqiptari është gjithmone një patriot i mire....dhe ne një artikull vijues thote: “Mbi të gjitha, ndjehem i detyruar të ofroj një kontribut të duhur mirenjohjeje ndaj Shoqërisë Biblike Britanike dhe të Huaj, për shërbimet që i ka kryer vendit dhe literatures sone, me ane të perkthimit të Shkrimeve të Shenjta ne gjuhen shqipe. Ne fakt, është e pamundur të flasësh për gjuhen dhe literaturën e Shqipërisë pa përmendur punën dhe perkushtimin e atyre që për një kohe kaq të gjatë dhe kundrejt shumë vështirësive kanë vazhduar me këtë punë fisnike (Young, 2011, fq. 48).”

Patrioti Mihal Grameno ka shkruar për shkollën e parë të vashave: “Po nuku duhet mohuar edhe harruar kurre shërbimet e medha që i ka sjelle çështjes një ‘fole kombetare,’ e cila ishte një qendër dhe një fortëse ku mbledheshin edhe që ku përhapeshin ndjenjat e shëndijat kombetare. Kjo ‘fole’ ishte shkolla e vajzave ne Korce, e themeluar prej të pavdekurit dergimtar kombetar Gjerashim D. Qirias, emerit e të cilit, historia e Shqipërisë do t’ë shkruajne me shkronja të arta duke u mburur me veprat edhe me shërbimet e tija të pachmuara që ka sjelle mbi alltarin e atdheut (Kuanrud, 1998, fq. 166).”

### Ungjillore si ura lidhëse me Perëndimin

Lidhja e ungjilloreve me shtetet e fuqishme protestante të kohës, si Amerika dhe Britania e Madhe, ishte një gje që solli vetëm fryte të mira për kombin Shqiptar. Ne fakt pas një vit pasi ishte hapur shkolla shqipe e vajzave, Porta e lartë apo qeveria Osmane, me sebpin e regjistrimit të ndertesave që përdorshin për qellime arsimore, kishte ndermend të ndalonte funksionimin e shkollave dhe të kishave duke u ndaluar atyre përdorimin e ndertesave edhe pse leja ishte leshuar për një veprimtari të tillë. “Kryeministri britanik, Lord Salisbury, udhezoi ambasadorin e tij ne Stamboll që ‘te kundërshtonte çdo kufizim mbi lirinë e ndërgjegjes dhe të adhurimit.’ Ne Prill të vitit 1892 Ambasada Britanike se bashku me Legaten Amerikane, i bene të ditur Portes se lartë se ato nuk do të lejonin mbylljen arbitrarë e pa arsye të çdo shkollë të hapur nga cilido misionar, ‘qoftë kjo e hapur ne shtepinë e tij (Kuanrud, 1998, fq. 172–3).” Ne 1902 kur u mbyll shkolla e djemve, kjo shkollë rezistoi pa u mbyllur për shkak të lidhjeve me fuqitë e huaja. Përsëri kur ne 1910 të gjitha shkollat e tjera u mbyllën kjo ishte e vetmja që funksionoi për disa kohe si shkollë nen mbrojtjen Amerikane dhe u quajt edhe “shkolla amerikane.” Edhe sot, pak shqiptarë e bejne lidhjen e ndihmes se Presidentit Wilson, ne sigurimin e pavaresisë se Shqipërisë, me ungjillorete protestante të asaj periudhe. Phineas Kenedi, një misionar protestant ungjillor ne Korce për shumë vjet, kishte qene student kur Wilson ishte president i shkolles teologjike. Ishin protestantet ungjillore ata që informonin audiencat e tyre ne Amerike për gjendjen e Shqiptarëve dhe pak studiues si Mal Berisha (Berisha, 2012, fq. 162), kanë shkruar për kontributin e ungjilloreve si Charles Telford Erickson, që hapi shkollën bujqësore të Kavajës, dhe ishte perfaqësues për Shqipërinë ne Konferencën e Paqes ne Paris 1919; apo që Parashqevi Qiriazhi ishte atje gjithashtu si e vetmja grua delegatë ne këtë konferencë perkrah Ericksonit dhe Mihal Gramenos (Young, 2011, fq. 143).

Nëse sot nuk jemi një shoqëri ku duhet të ngrihet një vajze si Malala Yousafzai të ngreje zërin për arsimimin e vajzave, është sepse Shqipëria nuk është kthyer prapa në edukimin e vajzave të veta qysh nga ajo shkolle e parë me vajzen e parë Shqiptare të diplomuar në 1891, Sevasti Qiriazi. Shkolla e vashave nën drejtimin e protestanteve funksionoi deri në vitin 1914 kur kishte nisur Lufta e parë Botërore, por deri atëherë ishin diplomuar aty 1028 nxënëse. Motra e saj Parashqevia e vazhdoi këtë punë dhe formoi shoqatën e parë të grave shqiptare "Yll'i Mengjesit" qysh në 1909 duke formuar dege neper qytete të ndryshme të Shqipërisë. Parashqevia botoi gjithashtu në 1909 '*Abetare për Shkollat e Para*' duke u bërë kështu edhe autorja e parë femer e teksteve shkollore Shqiptare (Young, 2011, fq. 41). Mbreti Zog thuhet se ka thënë: "Nuk ka komb që ngrihet me lart sesa graria e vet" (Erickson, 2012, fq. 267) dhe në sot kemi ministren e arsimit një grua, si edhe ministre të tjera dhe gra në të gjitha frontet e jetës Shqiptare.

Protestantët nuk ishin as të vetmit as me të fuqishmit ndër veprimtarët e rilindjes kombëtare shqiptare, por ishin një faktor i vlerësuar i rilindjes kombëtare shqiptare, dhe format e mendimit protestant që ishin të natyrshme u bënë të zakonshme edhe për të tjerët pa u identifikuar si të tilla sepse nuk mund të monopolizohet një rrjedhë e logjikshme e mendimit njëzëz pamvaresisht se kush ishin të parët që e filluan atë rrugë. Për mua mbeten anektodike, fjalët që me tha me dashamirësi një akademik i njohur Shqiptar, në fund të ngjarjes perkujtimore me 23 Tetor 2016, për 125 vjetorin e Shkolles së parë Shqipe të Vashave të hapur nga Protestantët Shqiptarë patriotë: "... ndoshta duhet të them që jam protestant pas kësaj që pame sonte." Nënkuptimi ilustrues Këtu është që në dallimin e influencës së ndikimit të ideve protestante në shumë fusha të jetës moderne të gjithë duhet të themi, në këtë kuptim simbolik, se "jemi protestante."

## Konkluzion

Historikisht, Protestantizmi çliroi mendimin e lirë dhe themeloi rolin e autoritetit të shkrimit me inkurajimin e mendimit kritik dhe zgjedhjen vetevendosëse që pastaj mori rrugën e vet edhe përtej kufinjve të kultures Europiane duke arritur edhe në Shqipëri përmes formave të ndryshme ku gjithsesi dallohet linja e drejtperdrejte protestante në influencimin e gjuhës dhe arsimit kombëtar Shqiptar.

## Referenca

- Berisha, M., 2012. Jeta e jashtëzakonshme e amerikanit Charles Telford Erickson kushtuar Shqipërisë. Edualba, Tirana, Albania.
- Brinton, C., 1963. The shaping of modern thought. Prentice-Hall, Inc, Englewood Cliffs, New Jersey.
- Cimbalo, G., 2013. Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri, Studime të së drejtës së krahasuar. E drejta kishtarë dhe të drejtat njëzëzore. Naimi, Tirana, Albania.
- Erickson, C.T., 2012. Shqiptarët - Enigma e Ballkanit. Edualba, Tirana, Albania.
- Guibernau, M., Hutchinson, J. (Eds.), 2001. Understanding Nationalism. Polity Press, Cambridge CB2 1UR, UK.
- Harrison, J.B., Sullivan, R.E., 1980. A short history of western civilization to 1776, Fifth edition.

ed. Alfred A. Knopf, New York.

Hastings, A., 1997. *The Construction of Nationhood: Ethnicity, Religion and Nationalism*. Cambridge University Press, Cambridge.

Hutchinson, J., Smith, A.D., 1994. *Nationalism*. Oxford University Press, Oxford.

Kuanrud, X., 1998. *Bese, Shprese dhe Dashuri. Jeta e Gjerasim Qiriazit. Karte e Pende*, Tirana, Albania.

Latourette, K.S., 1975. *A history of Christianity. Reformation to the present*, Revised Edition. ed. Prince Press, New York, N.Y.

Leoussi, A.S., Grosby, S., 2007. *Nationalism and Ethnosymbolism. History, Culture and Ethnicity in the Formation of Nations*. Edingurgh University Press, Edingurgh.

Lloshi, X., 2012. *Perkthimi i V. Meksit dhe Redaktimi i G. Gjirokastritit 1810-1827*.

Onufri, Tirana, Albania.

Ozkirimli, U., 2010. *Theories of Nationalism. A Critical Introduction*, Second Edition. ed. Palgrave Macmillan, Hampshire RG21 6XS.

Reid, FQ.V., 1995. *Readings in western religious thought. II. The middle ages through the reformation*. Paulist Press, New York/Mahwah NJ.

Sheldon, H.C., 1994. *History of the christian church. The modern Church. Part One*. Thomas Y. Crowell and Co., New York.

Smith, A.D., 1991. *National Identity, Ethnonationalism in Comparative Perspective*. University of Nevada Press, Reno, Nevada 89557 USA.

Young, D., 2011. *Lëvizja Protestatë midis Shqiptareve 1908 - 1991*. Tenda, Prishtine, Kosova.

## Disa aspekte mbi bashkëpunimin e veprës penale dhe VUGJL nr. 4/2011

**Prof. Asoc. Dr. Dorina Hoxha**  
Lektore ne Fakultetin e Drejtesise, UT

**Dr. Vladimir Skenderi**  
Gjyqatr ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor, Durres

### Hyrje

Vepra penale mund te kryhet me veprimin e një personi apo të shumë personave. Në rastet kur në kryerjen e veprës penale marrin pjesë dy ose më shumë persona kjo në të drejtën penale quhet bashkëpunim. Ndërsa personat që me veprimin e tyre kanë kryer veprën penale quhen bashkëpunëtorë. Po kështu, nga studimi i vetë ndërtimit të shumë normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, nuk është e vështirë të kuptohet se është fjala për vepra penale që mund të kryhen vetëm nga një ose më shumë persona. Kështu p.sh “Grupi i strukturuar kriminal”, që parashikohet nga neni i 333/a., Kodit Penal, janë krime që kryhen nga tre ose më shumë persona. Nga kjo arrihet të kuptohet se përveç bashkëpunimit eventual të personave dallohet bashkëpunimi i domosdoshëm i tyre, në ato raste kur vetë norma e pjesës së posaçme kërkon për ekzistencën e veprës penale nga ana objektive dy ose më shumë persona. Nuk mund të vihet asnjë shenjë barazimi midis të njëjtës vepër penale të kryer, në një rast, nga një person dhe, në një rast tjetër, nga disa persona. Do të ishte gabim që midis veprës penale të thjeshtë dhe asaj të kryer në bashkëpunim nga disa persona, të shihet vetëm një ndryshim sasior d.m.th vetëm një ndryshim në numrin e subjekteve. Këtu, ndryshimi në numrin e subjekteve të çon në mënyrë të pashmangshme në ndryshime cilësore dhe, pikërisht në ndryshimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të vetë veprës së kryer<sup>1</sup>.

Normat penale të pjesën së përgjithshme që parashikojnë institutin e bashkëpunimit nga neni 25 deri në nenin 28 te Kodit Penal janë plotësuese të normave në pjesën e posaçme , të cilat nga mënyra se si janë formuluar i referohen *autorit të vetëm*. Në fakt normat e pjesës së përgjithshme mbi bashkëpunimin kanë një funksion të vetëm, që ka të bëjë me funksionin e tyre inkriminues: në një sistem normash ku mbizotëron parimi i ligjshmërisë, *disa norma* mbi bashkëpunimin (neni 25,26,27,28 te Kodit Penal) përcaktojnë ato veprime të cilat formojnë format e thjeshta dhe ato të veçanta të bashkëpunimit. Normat e pjesës së posaçme ku i referohen bashkëpunimit kanë një funksion te caktimit të dënimit, dukë individualizuar masën e tij për format e veçanta të bashkëpunimit por jo për bashkëpunëtorët e veprës penale.

Në të drejtën tonë penale, bashkëpunimi paraqitet disa herë si element i domosdoshëm i figurës së veprës penale, siç është rasti i organizatës kriminale etj, here si rrethane

<sup>1</sup> Shih A. Cela, N. Peza ,I. Elezi, G. Gjika, “E drejta penale e Republikës Popullore Socilaliste të Shqipërisë”, Shtepia botuese “8 nentori”, 1982, fq., 234. Sipas autorëve bashkëpunimi i disa personave jo vetëm krijon mundësi më të mëdha për të kryer vepra penale më të rënda, por në këtë rast, përkrahja reciproke dhe bashkimi i përpjekjeve rrit besimin, i ben keqbërësit të veprojnë më me guxim, të kapërcëjnë më lehtë pengesat, që mund t’u krijohen gjatë kryerjes së veprës penale, si dhe i lehtëson ata edhe në marrjen e masave për t’u shmangur nga përgjegjësia penale .

cilësuese, dhe here si rrethane renduese parashikuar nga neni 50 pika gj)- e Kodit Penal. Ne dallim nga të drejta të tjera, e drejta jonë penale, rregullon jo vetëm përgjegjësinë penale të personit që ekzekuton veprën penale, por edhe të pjesëmarrësve të tjerë, të cilët ndonëse nuk marrin pjesë direkt në të, në mënyra të ndryshme ndihmojnë në kryerjen e saj. Kodi Penal në lidhje me përgjegjësinë penale nuk bën dallim midis bashkëpunëtorëve, edhe pse ai i ndan ato të organizator, ekzekutor, shtytës dhe ndihmës.

## 1. Struktura e bashkëpunimit në veprën penale

Ajo që ka rëndësi të madhe në bashkëpunim në veprën penale është përcaktimi i bazës së përgjegjësisë penale. Sic dihet, kur është fjala për kryerjen e veprës penale nga një person, konstatimi i figurës së saj në veprën penale e kryer nga autori, përbën bazën e përgjegjësisë penale. Ky parim themelor, në të drejtën penale shqiptare, nuk ka ndryshuar dhe nuk ndryshon aspak dhe ne rastin e bashkëpunimit të shumë personave në kryerjen e veprës penale. Bazën e përgjegjësisë penale edhe këtu e përbën konstatimi i figurës së veprës penale në veprimin e çdo bashkëpunëtori, si dhe veprimi ose mosveprimi i këtij të fundit të ketë qenë faktor i domosdoshëm për të ardhur pasojat kriminale, d.m.th kërkohet si zakonisht lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit të bashkëpunëtorit dhe pasojës shoqërisht të rrezikshme. Sipas nenit 25 të Kodit Penal, "*Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje mes tyre*". Nga përcaktimi i bërë nga Kodi Penal rezulton se për ekzistencën e bashkëpunimit duhet të ekzistojnë disa elemente, të ndarë në anën objektive dhe në anën subjektive.

Bashkëpunimi i kryerjes së veprës penale përbëhet nga katër elementë<sup>2</sup>: a) dy ose më shumë persona (pluralitet personash); b)-realizimi e veprës penale në të gjithë elementët e tij material ( e konsumuar apo e tentuar); c)- dhënia e një kontributi relevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve; 4)- ana subjektive e përbërë nga dy kushtet e marrëveshjes : dijenia dhe vullneti i personave për të kryer veprën penale dhe për të bashkëpunuar për kryerjen e saj.

### a)- Dy ose më shumë persona (pluralitet personash)

Ky kusht është një element i anës objektive *conditio sine qua non* tek bashkëpunimi. Kombinimi i nenit 25 të Kodit Penal me normën që parashikon figurën e veprës penale formon një figurë të veçantë të veprës penale. Elementët përbërës të saj i referohen parimeve të përgjithshme të veprës penale dhe normave mbi bashkëpunimin., duke dalluar këtu :1) elementin e anës objektive e përbërë nga dy ose më shumë persona , nga realizimi i faktit material të veprës penale, nga kontributi relevant që secili nga bashkëpunëtorët ka dhënë; 2) – një element i anës subjektive që përbëhet nga dashja e pjesëmarrjes (mantovani, 2002, 535).

Përsa i përket anës objektive, kushti i parë dhe i qartë tek bashkëpunimi është që vepra penale të jetë kryer nga një numër personash , duke përcaktuar dyshtetë dhe e formuar prej se paku dy personash. Pra kërkohet të provohet që në kryerjen e saj kanë marrë pjesë më shumë se një person, pavarësisht rolit dhe veprimeve të kryera nga secili prej tyre, të cilat çmohen dhe përcaktohen rast pas rasti duke iu referuar

<sup>2</sup> Shih VGJL nr. 509 datë 29.10.2008 mbi nenin 26 të Kodit Penal.



rrethanave të faktit, në përputhje me parashikimet e nenit 26 të K.Penal.

E diskutueshme ka qenë çështja, e cila coi dhe në unifikimin e praktikës gjyqësore përmes VUGJL nr. 4/2011 në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale, ne kushtet kur njëri nga bashkëpunëtorët nuk është i identifikuar, apo për shkak të moshës ose paaftësisë së tij mendore nuk mban përgjegjësi penale. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për ti dhënë përgjigje dhe për të arritur në konkluzionet unifikuese, iu referua parimit të përgjegjësisë penale personale të personit që ka kryer veprën penale. Sipas këtij parimi, çdo person mban përgjegjësi penale sipas ligjit për veprimet e paligjshme të kryera nga ana e tij në kufijtë e fajit të tij, kjo pavarësisht rrethanave në të cilën është kryer vepra penale. Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë në përfundimin se bashkëpunimi sipas legjislacionit tonë ekziston që në momentin që plotësohen kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit, dhe bazuar mbi parimin e përgjegjësisë penale personale, pavarësisht karakteristikave personale të bashkëpunëtorëve të tjerë, vepra penale do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim, edhe në rastet kur autori tjetër i veprës penale nuk mban përgjegjësi penale.

Pra, në çdo rast, secili nga autorët e veprës penale të kryer në bashkëpunim, pavarësisht unitetit të anës subjektive të veprës, mban përgjegjësi personale për veprimet ose mosveprimet e tij. Si në rastet kur bashkëpunëtorët mbajnë përgjegjësi penale, ashtu edhe në rastet kur njëri apo disa prej tyre nuk mbajnë përgjegjësi penale, bashkëpunëtori apo bashkëpunëtorët që mbajnë përgjegjësi penale do të përgjigjen për veprën penale konkrete, të kryer në bashkëpunim, pasi për të gjithë elementët e bashkëpunimit ekziston dhe mjafton ekzistenca e tyre për t'u ndodhur në kushtet e bashkëpunimit, pavarësisht karakteristikave personale të bashkëpunëtorëve të tjerë, të cilat shërbejnë si bazë për përjashtimin e këtyre të fundit nga përgjegjësia penale, por kurrësi për eliminimin e cilësimit të veprës në bashkëpunim. Mbi këtë qëndrim është i qartë edhe pranimi i ekzistencës së bashkëpunimit në rastet kur bashkëpunëtori apo bashkëpunëtorët e tjerë janë të panjohur. E njëjta logjikë të con në përfundimin se, edhe në rastet kur njëri nga bashkëpunëtorët është i panjohur, ndodhemi në kushtet e veprës penale në bashkëpunim, pasi personi në gjykim përgjigjet për veprimet apo mosveprimet në shkallën e kryer nga ai vetë. Mosnjohja e karakteristikave personale të bashkëpunëtorit të panjohur nuk shmang ekzistencën e bashkëpunimit dhe nuk e bën të pa aplikueshme dispozitën e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

Pra nuk mund të pranohet mendimi sipas të cilit pët tu konsideruar bashkëpunëtor duhet të jesh i përgjegjshëm dhe i dënueshëm. Ligjvënësi në parashikimin e tij në nenin 12 dhe në nenin 17/1 të K.Penal për përjashtimin nga përgjegjësia penale e personave të mitur apo të atyre që vuajnë nga turbullime psikike apo neuropsiroke të përhershme apo të atëqastshme, për shkak të cilësive të veçanta të tyre, ka dashur të përjashtojë këta persona nga përgjegjësia penale, por kurrësi nuk ka pasur si qëllim që nga cilësitë e tyre personale të përfitojnë edhe personat e tjerë që mbajnë përgjegjësi sipas ligjit penal.

Me VUGJL 4/2011 është arritur në përfundimin unifikues : kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë apo moshës për përgjegjësisë penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë.

Këto konkluzione të praktikës gjyqësore të çojnë të kuptosh, në mënyrë të qartë, dallimin që ekziston në një veprë penale të kryer në bashkëpunim dhe problemit të dënueshmërisë të bashkëpunëtorëve duke arritur në dy përfundime:

1. Çdo person, që bashkëpunon materialisht në kryerjen e veprës penale, quhet bashkëpunëtor dhe bashkëpunimi mund të ekzistojë mes personash jo të gjithë të dënueshëm apo të gjithë, jo të dënueshëm.

2. Për të patur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale duhet kontributi i disa personave, por jo që të gjithë këta të jenë të përgjegjshëm dhe të dënueshëm dhe të kenë vepruar të gjithë me dashje apo të gjithë nga pakujdesia, pasi kjo nuk i referohet bashkëpunimit por vetëm dënueshmërisë së bashkëpunëtorëve.

Që të konsiderohet e kryer në bashkëpunim me pjesëmarrjen e të gjithë llojeve të bashkëpunëtorëve të parashikuar nga ligji, nuk është e domosdoshme që mes të gjithë këtyre bashkëpunëtorëve të ekzistojë **njohja fizike**, mjafton që ekzekutori të ketë njohje me bashkëpunëtorët, ose njërin prej tyre dhe nga ana objektive pasoja kriminale të jetë rezultat i aktivitetit kriminal të të gjithë pjesëmarrësve<sup>3</sup>.

Kur vepra penale kryhet në bashkëpunim, si rregull, bashkëpunëtorët duhet të përgjigjen për veprën penale të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posacme të Kodit Penal. Por, kjo ka të bëjë me përgjegjësinë penale të bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprës penale në rastet kur ndodhemi para ndarjes klasike të roleve, në orgazizatorë, shtytës dhe ndihmës, dhe jo kur shtrohet problemi i përgjegjësisë penale të bashkëekzekutorëve të një veprë penale, ku ndodhemi përpara ndarjes së punëve midis pjesëmarrësve në një veprimtari të caktuar kriminale, dhe jo përpara ndarjes së roleve. Në këtë përfundim arrihet duke u nisur edhe nga përmbajtja e paragrafit të parë të nenit 27 të K.Penal i cili parashikon :

Neni 27/1 “ *Organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi si dhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre*”. Sipas kësaj dispozite, organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi, si dhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre në kuptimin që dhe vepra e secilit prej tyre do të cilësohet nga gjykata me atë dispozitë të Pjesës së Posacme të Kodit Penal, me të cilën do të cilësohet vepra e kryer nga ekzekutori<sup>4</sup>.

### **b)-Kryerja e veprës penale në të gjithë elementët e tij material ( e konsumuar apo e tentuar)**

Kushti i dytë i bashkëpunimit është kryerja e veprës penale në të gjithë elementët e saj. Një veprë penale konsiderohet e kryer kur ajo është realizuar jo vetëm në formën e konsumuar por dhe në formën tjetër të tentuar, kur disa persona kanë dhënë kontributin e tyre minimal për realizimin e veprës penale. Ky kusht i cili parashikohet në qëllimin e nenit 25 të K.Penal, sanksionon *mosdënueshmërinë* e marrëveshjes mes personave dhe nxitjes nga personi i cili ka pranuar që të kryejë veprën penale, *kur vepra penale objekt i marrëveshjes nuk është kryer apo tentuar*. Formulimi që i ka bërë ligjvënësi kësaj dispozite , të lë të kuptosh që ai ka pranuar kriterin objektiv, ku kërkon që veprimet e bashkëpunëtorëve të konkretizohen në një fakt shoqërisht i rrezikshëm

<sup>3</sup> Shih VUGJL nr. 1/2002.

<sup>4</sup> Ismet Salihu, “E drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme”, Prishtine 2010, fq. 373. Sipas këtij autori për t’u konsideruar se ekziston bashkëpunimi në të drejtën penale midis pjesëmarrësve duhet të shprehet lidhja e caktuar objektive dhe subjektive.

për marrëdhëniën juridike të mbrojtur me ligj dhe jo kriterin subjektiv i cili i referohet shfaqjes së jashtme të vullnetit kriminal.

Minimumi i nevojshëm për të eksistuar bashkëpunimi realizohet atehere kur janë ndërmarrë veprime të drejtëpërdrejta dhe janë realizuar elementët e një forme të tentativës, si një tentativë e metë, me mjet të papërshtatshëm apo objekt të papërshtatësh.

Në këtë pikë është e nevojshme që të dallohet: 1) *bashkëpunimi në një veprë penale të ngjellur në tentativë*, e cila rezulton si kombinim i neneve 25 dhe 22 të K.Penal dhe nenit të pjesës së posacme; 2) *tentativa për bashkëpunim*, d.m.th veprime të kryera për të bashkëpunuar, të cilat nuk ndiqen nga kryerja e veprës penale, e konsumuar apo e tentuar. Ky dallim i referohet parimeve të rëndësishme si ai i nenit 22 të K.Penal ku shprehet se personi ndërmerr veprime të drejtëpërdrejta dhe nga neni 25 i K.Penal që shprehet kryerja e veprës penale. Kjo do të thotë që marrëveshja dhe shtytja për të kryer një veprë, dhe kur kjo nuk është kryer, nuk është e dënueshme, dhe ka të bëjë më fazën paraprake të shfaqjes së mendimit ose të përgatitjes.

### **c)- Dhënia e një kontributi relevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve**

Nuk mund të ketë bashkëpunim në kryerjen e veprës penale nëse veprimi i bashkëpunëtorit nuk ka ushtruar një ndikim sado të vogël në lidhjen shkakësore mbi figurën e veprës penale të realizuar nga bashkëpunëtorët e tjerë. Në mungesë të këtij ndikimi në lidhjen shkakësore, nuk mund të eksistojë asnjë kontribut për të cenuar ndonjë marrëdhënie juridike penale. Pra për tu konsideruar se ekziston bashkëpunimi në të drejtën penale, midis pjesëmarrësve duhet shprehur lidhja e caktuar nga ana objektive, ku qëndron pikërisht në faktin se secili bashkëpunëtor duhet të ndërmarrë ndonjë veprim me të cilin kontribuon në kryerjen e veprës penale. Të gjitha veprimet që i ndërmarrin bashkëpunëtorët, pa marrë parasysh ai ndërmarrin në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën vend, duhet të jenë të lidhura midis tyre dhe të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjtë, që të shkaktohet pasoja e caktuar. Me fjalë të tjera, pasoja e veprës penale duhet të jetë rezultati i përbashkët i veprimeve të të gjithë bashkëpunëtorëve”.

Ajo që është e rëndësishme është se për të pranuar që jemi në kushtet e bashkëpunimit, mjafton që pjesëmarrësi të ketë influencë mbi një detaj të veprimit kriminal të ndërmarrë, qoftë lidhur me të mirën apo të drejtën e mbrojtur, qoftë lidhur me planin organizues.

Në të drejtën tonë penale, përgjegjësia penale shtrihet në mënyrë të barabartë ndërmjet të gjithë bashkëpunëtorëve, pavarësiht rolit që kryen secili në kryerjen e krimit. “Organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit”, thuhet në nenin 27 të Kodit Penal, “për veprën penale të kryer prej tyre, kanë përgjegjësi si dhe ekzekutorët”. Dhe kjo është e natyrshme, pasi në veprën e cdo bashkëpunëtori ekzistojnë të gjithë elementët objektive dhe subjektivë të përgjegjesisë penale. Prandaj, në kuptimin e përgjegjesisë penale dhe vetëm në këtë kuptim, bashkëpunëtorët janë të barabartë me njëri tjetrin. Është e vërtetë se për cdo veprim që kryen një bashkëpunëtor, përgjigjet edhe bashkëpunëtori tjetër, derisa veprimi kryhet brenda kuadrit të marrëveshjes së bërë më parë midis bashkëpunëtorëve.

Me gjithë këtë barazi përsa i përket përgjegjesisë penale, midis bashkëpunëtorëve

mbeten të ndryshëm shumë faktorë që kanë të bëjnë me cilësitë individuale si dhe me shkallën e pjesëmarrjes të secilit në veprën penale, faktorë të cilët influencojnë shumë në përcaktimin e masës së dënimit. Kështu p.sh. megjithëse A, B, C përgjigjen penalisht njësoj për vrasjen e D, gjykata në caktimin e masës së dënimit të tyre, duhet të marrë parasysh rolin konkret që ka luajtur secili në kryerjen e kësaj vepre penale, d.m.th faktin që A ka ekzekutuar vetë krimin me armën e tij si dhe faktin tjetër që B dhe C e kanë ndihmuar atë, i pari duke i gjetur dhe duke e furnizuar me fishekë dhe i dyti duke i premtuar qysh më parë dhe duke e ndihmuar konkretisht në fshehjen e krimit.

Problemi kryesor tek bashkëpunimi ka të bëjë me përcaktimin e shkallës së pjesëmarrjes së secilit dhe në rolin e luajtur, sic shprehet neni 27 i kodit Penal apo kontributi relevant sipas VUGJL4/2011 në kryerjen e veprës penale, d.m.th sa duhet të jetë kjo shkallë minimale për të vlerësuar nëse ky kontribut është i mjaftueshëm për ta konsideruar personin si bashkëpunëtor.

Neni 27/2 i K.Penal parashikon shprehimisht qe: “Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale”. Kjo dispozitë i referohet shkallës së pjesëmarrjes në lidhje me caktimin e dënimit, në masë dhe në lloj të tij, por njekohesisht në një interpretim të dyfishtë kjo është e vetmja dispozitë ku gjykata duke vlerësuar pjesëmarrjen, kontributin e personit mund ta konsiderojë atë si një veprim që nuk ka asnjë ndikim në lidhjen shkakesore, duke mos e ngarkuar me përgjegjësi penale.

Dallimi mes aplikimit të parimit të autonomisë së përgjegjësisë në veprat penale me një autor të vetëm, nga ato të kryera në bashkëpunim, qëndron në faktin se në rastin e parë autori duhet të ketë kryer edhe materialisht veprën penale, ndërsa në rastin e bashkëpunimit mjafton edhe që ai të ketë lehtësuar kryerjen e veprës penale nga persona të tjerë.

Me kontribut relevant në kryerjen e veprës penale do të kuptojmë të gjitha ato raste kur personi është pjesëmarrës në fazën e idejimit, përgatitjes ose ekzekutimit të veprës penale dhe sipas një vlerësimi *ex post* ka dhënë :

1. Ose një kontribut të nevojshëm, duke kryer një veprim/mosveprim si kusht pa të cilin (*condicio sine qua non*) vepra penale nuk mund të kryhej. Kontribut i cili mund të identifikohet në : a) **pjesëmarrjeje morale**, duke krijuar ose forcuar bindjen e plotë për kryerjen e veprës penale tek një person tek i cili më parë ky mendim nuk ekzistonte (p.sh në përgatitjen e planit kriminal); b) **pjesëmarrje materiale**, e cila shfaqet në format nga më të ndryshmet të kontributit fizik (Mantovani, 2002, 543).

2. Ose kontribut ndihmës, duke lehtësuar realizimin e veprës penale, në kuptimin që vepra penale behet më e mundur, me e thjeshtë ose me pasoja më të rënda. D.m.th pa këtë kontribut vepra penale gjithsesi do të kryhej por me paqartësi më të medha ose vështirësi, ose me pasoja më të vogla. Kontribut i cili mund të ndodhe në : a) **pjesëmarrje morale** duke forcuar qëllimin kriminal të personit tjetër, i cili ekzistonte dhe me parë, ose mbështetje psikologjike e veprimeve të personit tjetër, përgatitore ose ekzekutive; b) **pjesëmarrje materiale** në të gjitha format e mundshme ku ndihma fizik mund të jepet (Mantovani, 2002, 543).

*Kështu në rastin e një kalimtare që u jep një dorë hajdutëve në ngarkimin e mallit apo të bashkëpunëtorit që i jep celsin e derës, të cilët edhe pa kontributin e këtij bashkëpunëtori do ta realizonin veprën penale por në një kohë më të gjatë.*

VUGJL nr 4/2011 shprehet se “*Parimi i autonomisë së përgjegjësive shfaqet në bashkëpunimin e dy ose më shumë personave në kryerjen e veprës penale në formën e dhënies të secilit prej tyre të një kontributi material ose moral në kryerjen e veprës penale*”.

Në të vërtetë si në doktrinë ashtu dhe në praktikë kontributi ndahet në dy forma: në kontributin material dhe në atë moral.

#### a) **Kontributi material**

Kemi të bëjmë me kontribut material kur veprimi i personit ka qënë kusht i nevojshëm për ekzekutimin e veprës penale nga ana e personit apo personave të tjerë. Ndiham materiale që ka kushtëzuar kryerjen e veprës penale mund të marrë nga format nga më të ndryshmet: si p.sh dhënia e një arme e cila perdoret për vrasjen apo për vjedhjen me dhunë, hapjen e nje dere e cila të lejon të hysh tek apartamenti ku do të vidhet, dhënia nga ana e drejtorit të bankës të kodit të hyrjes në sistemin informatik të atij instituti, që lejon një ekspert të informatikës të transferojë në llogarinë e tij rrjedhëse dhe në atë të drejtorit paratë e klientëve etj (Marinucci & Dolcini, 2015, 459).

Nga shembujt e mësipërm, ajo që e dallon një kontribut nga tjetri është se në rastin e parë (dorëzimi i armës) është një veprim në vetvetë i zëvendësueshëm, në kuptimin që arma mund të gjendej edhe nga persona të tjera apo dhe në tregun e zi, ndërsa në dy shembujt e tjerë (hapja e portës, komunikimi i kodit të hapjes) janë të pazëvendësueshëm: vetëm një njeri i familjes së të dëmtuarit apo një person tjetër që bashkëjeton me të mund ta lerë hapur derën e apartamentit; ashtu si në rastin e drejtorit që është i vetmi që ka kodin e hapjes të sistemit informatik të bankës.

Nga ana objektive, dhe atë të lidhjes shkakësore, të gjitha veprimet e bashkëpunëtorëve janë të barazvlefshme porsa i përket përgjegjësive penale: kur një fakt ka ndodhur dhe duhet përcaktuar nëse është apo jo pasojë e veprimeve të personit, nga koha që të gjitha veprimet kane qënë kushte të nevojshëm për kryerjen e veprës penale, është e panevojshme të besh një dallim mes atyre veprimeve. Pra të gjitha veprimet e bashkëpunëtorëve që kanë qënë të nevojshme për kryerjen e veprës penale do të mbajnë përgjegjësi penale pavarësisht shkallës së ndryshme të pjesëmarrjes në të.

I parëndësishëm është fakti i dallimit midis veprimeve të zëvendësueshme apo të pazëvendësueshme për ekzistencën e kontributit në kryerjen e veprës penale, pasi ky dallim ka rëndësi vetëm përse i përket shkallës së përgjegjësive penale apo caktimit të dënimit nga ana e gjykatës. Në kuptimin që një veprim i pazëvendësueshëm mund të dënohet më shumë se masë dhe në lloj dënimi, në krahasim me një veprim që është i zëvendësueshëm

*Nje shembul në rastin e mësipërm do të ishte kur personi i cili i ka bere të mundur personit tjetër dhëniën e një celsi, i cili për të kryer veprën penale mund të përdorte dhe mjete të tjera. Analiza e kontributit shkakësor analizohet në lidhje me mundësitë konkrete të kryerjes së veprës penale të vjedhjes. Nëse kasaforta është hapur me celës, veprimi i personit i cili i ka dhëne atë përben shkak për realizimin e kryerjes së veprës penale, sepse pa të vepra penale nuk do të ishte kryer në atë mënyrë.*

*Do të mungonte kontributi në lidhjes shkakësore, nëse celsi do të mbetej i papërdorshëm dhe kasaforta do të hapej përmes mjeteve të tjera. Ndikimi në lidhjen shkakësore të personit i cili ka dhënë celsin mund të kuptohet në ndikimin psikologjik: fakti nga i cili personi është i vetëdijshëm se ka në dispozicion një mjet, edhe pse nuk e perdor, mund të kerr përforcuar vendimin e ekzekutorit për të kryer veprën penale të vjedhjes. Kështu që ky lloj ndikimi në*

*veprën penale duhet të vlerësohet rast pas rasti, sipas një arsyetimi të drejtë, pasi kontributi moral, sic do ta analizojmë, kërkon një ndikim në motivimin e personit që e ka shtyre të tjerët në kryerjen e veprës penale.*

Pra nje kontribut material mund ti japë vendin kontributit moral në ato raste kur veprimet materiale rezultojnë të panevojshme ose të padëmshme dhe se veprimi ka ndikuar në një mënyrë apo tjetër të bashkëpunëtorit tjetër.

Ne veprën penale të kryer në bashkëpunim mjafton që personi ka thjeshtuar ekzekutimin e ndërmmarrë nga bashkëpunëtorët e tjerë, pasi në sajë të marrëveshjes bëhen të tijat edhe veprimet e kryera nga bashkëpunëtorët.

## **b) Kontributi moral**

Ndikimi në lidhjen shkakësore në formën e pjesëmarrjes morale realizohet nga ana e atij personi i cili, me veprime intelektuale (këshilla, kërcenime, dhurata, premtime et.) bën që **ti lindë** personit tjetër mendimi kriminal për të kryer veprën penale dhe që me vone kryhet ose **përforcon** një mendim i cili ekzistonte dhe me parë, por jo fort të konsoliduar në mendjen e tij.

*Sipas doktrinës dhe Kodit Penal neni 26/4, jepet përkufizimi i nje nga bashkëpunëtorët që është nxitësi. Pra, ligjvënësi i ka dhënë një vënd të vecantë ne të drejtën penale shqiptare këtij lloj bashkëpunëtorit, i cili përmes një kontributi moral, shtyt të tjerët në kryerjen e veprës penale. Edhe pse ligjvënësi ka qënë i kursyer në përkufizimin që i ka bërë nxitësit, ajo që duhet kuptuar nëkë përkufizim është jo vetëm ato veprime nga të cilat lind mendimi kriminal për të kryer veprën penale por edhe ato që e përforcojnë këtë mendim.*

Në kontributin moral, lidhja shkakësore kalon në dy hapa: a) nxitja duhet të lindë apo të përforcojë tek personi tjetër mendimin kriminal për kryerjen e veprës penale; b) kjo vepër penale duhet të jetë kryer. Këta dy hapa në mënyrë indirekte kuptohen nga një interpretim literal i nenit 25 të K.Penal, i cili kërkon domosdoshmërisht "*kryerjen e veprës penale*". Pra ajo që kërkohet së pari është që nxitja të pranohet nga personi tjetër dhe se dyti që personi i cili ka pranuar nxitjen duhet të kryejë veprën penale. Nëse nxitja nuk pranohet mungon lidhja shkakësore e ndikimit psikologjik. Nëse nxitja pranohet por nuk kryhet vepra penale për cdo lloj arsyeje, as në formën e tentativës, kontributi nuk ka asnje rendesi penale (Marinucci & Dolcini, 2015, 461).

Përsa i përket kontributit intelektual, për këtë nuk është dyshuar asnjëherë. Ne të vërtetë, nuk konsiderohet asnjëherë e nevojshme qe veprimi nxitës apo shtytës të konsiderohet si nje *condicio sine qua non* të ardhjes së pasojës por ajo që konsiderohet e mjaftueshme është përforcimi apo mbështetja. Edhe këshilla më e thjeshtë mund të përforcojnë qëllimin kriminal të personit tjetër.

Në të kundërt nuk kemi të bëjmë me bashkëpunim kur personi, ndaj të cilit bëhet nxitja ishte i bindur përfundimisht për kryerjen e veprës penale dhe nxitja për të nuk përben motiv të ndryshëm apo te ri për të. Sic është rasti i dhëniës së një shume shumë të vogël parash, të papërfillshme tek autori i veprës penale, i cili është i bindur në vetvete për kryerjen e veprës penale për arsyt e tij personale. Nuk mund të ketë një kontribut moral relevant, kur nuk ka nje ndikim efektiv moral në psiqikën e personit të nxitur dhe vlerësimi nëse ka ndikim ose jo, mund të bëhet vetëm pas një vlerësimi dhe pranimi të rrethanave objektive dhe subjektive.

Thjesht të qëniti prezent në vendin e kryerjes së veprës penale nuk përbën asnjë formë të bashkëpunëtorit, përvec rasteve kur vetë ai ka shprehur në mënyrë të dukshme

dhe të qartë pranimin e veprimit kriminal dhe se autori nga ky mendim i shprehur ka përforcuar mendimin e tij kriminal apo ka krijuar vetëbesim.

\* \* \*

Kontributi moral ose material mund të jepet përmes veprimeve por ashtu sic e ka parashikuar edhe doktrina ajo mund të shprehet edhe me mosveprim. Pra kemi të bejmë me një kontribut relevant përmes mosveprimit në një veper penale që bashkëpunëtori tjetër e kryen me veprim. Që të ekzistojë kontributi relevant përmes mosveprimit kërkohet:

1. Që edhe mosveprimi të jetë kusht i nevojshëm ose lehtësues në kryerjen e veprës penale, duke pranuar që edhe moskryerja mund të konsiderohet *condicio sine qua non* ose vetëm favorizon realizimin e veprës penale.

*Keshtu në rastin e personit, i cili ruan një vilë, dhe nuk vendos alarmin, nuk pengon ose e bën më të lehtë kryerjen e veprës penale, edhe pse bashkëpunëtorët e tjerë duke qënë të bindur në qëllimin e tyre, prapsëprapë do ta kryenin veprën penale duke përsor mënyra të tjera si ushtrimi i dhunes ndaj rezistencës së pronarit të vilës.*

2. Që ky mosveprim, i nevojshëm ose lehtësues, përbën shkelje të një detyrimi ligjor apo norme juridike urdhëruese, d.m.th të pengimit të kryerjes së veprës penale të kryer, për të cilën subjekti, duke mbajtur qëndrimin e duhur, mund të kishte pengur ose ta kishte bërë më të vështirë realizimin e veprës penale.

*Në mungesë të një detyrimi të tillë ligjor nuk ka bashkëpunim në veprën penale por thjesht pasivitet nga ana e personit, i cili e di që personi tjetër ka kryer ose po kryen veprën penale ose një bashkim moral me të. Detyrimi për të penguar veprën penale mund të referohet çdo lloj vepre penale: vepra penale të kryera me veprim, si në veprën penale formale ashtu dhe ajo materiale.*

Një aspekt të vecantë tek bashkëpunimi zë edhe vepra penale e cila mund të kryhet vetëm nga një subjekt i posaçëm dhe mund të jepi para rastit të bashkëkzekutimit nga një subjekt i posaçëm dhe një i përgjithshëm. Rasti tipik në këtë rast është ai të cilin e ka analizuar edhe Gjykata e Lartë përmes VUGJL nr. 1/2002 dhe VUGJL nr.3/2015.

Pyetja që është shtruar për diskutim i referohet faktit, kur kontrabanda kryehet në bashkëpunim midis dy ose më shumë personave, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen sipas të njëjtës dispozitë të Kodit Penal, e cila parashikon një lloj kontrabande dhe një apo disa të tjerë do të përgjigjen sipas një dispozite tjetër, e cila parashikon një lloj tjetër kontrabande dhe si do të përcaktohet përgjegjësia e bashkëpunëtorëve në rastet kur të gjithë ata janë në rolin e bashkëkzekutitorit?

Sa i takon bashkëpunimit të në të njëjtën veprën penale midis subjekteve bashkëpunëtorë që janë mbajtës të disa cilësive të veçanta, të veprës penale, (subjekte të posaçme) dhe subjekteve bashkëpunëtorë që nuk janë mbajtës të disa cilësive të veçanta, të veprës penale, por subjekte të çfarëdoshëm, domethënë në rastin e bashkëpunimit të subjektit me cilësi të veçantë të veprës penale dhe subjektit të jashtëm në raport me veprën penale që nuk i ka këto cilësi, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se me vendimin Unifikues nr.1, datë 12.03.2002, në lidhje me bashkëpunimin e subjekteve të veçanta (*intraeus*) në veprën penale të kontrabandës nga punonjësit e kontrabandës me subjekte të tjera (*extraneus*) që nuk e kanë këtë cilësi, kanë përcaktuar se, vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet sipas dispozitës përkatëse të nenit 175 të Kodit Penal, "kontrabandë nga punonjës të doganave". Ky konkluzion i përket vetëm zbatimit të nenit 175 të Kodit Penal, që parashikon veprën e kontrabandës nga punonjës të

doganave.

Në lidhje me çështjen e konkurrimit të subjekteve aktivë të përgjithshëm në një veprë penale të veçantë për të cilën, për autorin kërkohet pasja e një cilësie të posaçme, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se në rastin e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, bashkëpunimi i një subjekti të veçantë (*intraneus*) me një subjekt tjetër të përgjithshëm (*extraneus*) përbën një rast të veçantë, që është parashikuar shprehimisht dhe posaçërisht nga neni 175 i Kodit Penal, i cili disponon se “Kryerja e kontrabandës nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, **qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet**”.

Ndërsa në lidhje me veprat e tjera penale, për të cilat nuk është parashikuar në mënyrë posaçërisht të shprehur nga norma penale inkriminuese, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në **formën bashkëekzekutimit**, si rregull, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen për të “njëjtën veprë penale” të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Në rastin e personave të tjerë të përgjithshëm (*extraneus*) që nuk mbajnë cilësitë e veçanta apo nuk kanë pozitën subjektive të personit të cilësuar në veprën penale dhe që bashkëpunojnë me subjektin e cilësuar, të gjithë bashkëpunëtorët, qofshin ata të cilësuar apo të përgjithshëm, do të përgjigjen për të njëjtën veprë penale, **vetëm kur personat e përgjithshëm bashkëpunëtorë që janë të cilësuar (*extraneus*) janë të vetëdijshëm, duke pasur dijeninë në lidhje me cilësinë apo pozitën subjektive të personave të cilësuar dhe kjo cilësi e tyre ka lehtësuar bashkëpunimin për kryerjen e veprës penale të përbashkët**. Pra, nëse personat e tjerë nga ata që janë të cilësuar, kanë anën subjektive lidhur me cilësinë e veçantë të personit të veprës penale, qoftë në formën e pakujdesisë, ku personi duhej dhe mund ta kishte parashikuar rrethanën e cilësisë së veçantë të personit të veçantë, qoftë në formën e dashjes, të dy këto kategori bashkëpunëtorësh do të përgjigjen për të njëjtën veprë penale. Në mënyrë që bashkëpunëtorët e tjerë të përgjigjen për veprën penale të kryer nga bashkëpunëtorë me cilësi të veçanta (*intraneus*), ata duhet të kenë dijeni rreth bashkëpunimit (kontributit bashkëpunues) dhe pranisë së një subjekti të veçantë, domethënë të cilësuar që ka kontribuar në kryerjen e veprës penale që është rënë dakord edhe me të tjerët. Nëse mungon elementi subjektiv rreth dijenisë së rolit dhe subjektivit të posaçëm, nga të gjithë bashkëpunëtorët e tjerë, atëherë për këtë cilësi, kur konsiderohet jashtë marrëveshjes së të gjithë bashkëpunëtorëve do të përgjigjet vetëm personi që ka apo në rast bashkëekzekutimi vetëm ata persona që e kanë bashkëekzekutuar, duke u konsideruar kjo cilësi si ekseks i ekzekutorit, dhe mos iu atribuuar bashkëpunëtorëve të tjerë. Në arritjen e këtij përfundimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbajnë parasysh parimin themelor të së drejtës penale të përgjegjësisë personale të personit që kryen veprën penale<sup>5</sup>.

**ç) –ana subjektive e përberë nga dy kushtet e marrëveshjes : dijenia dhe vullneti i personave për të kryer veprën penale dhe për të bashkëpunuar për kryerjen e saj.** Dijenia dhe vullneti i personave për të kryer veprën penale dhe për të bashkëpunuar për kryerjen e saj. Është elementi i katërt tek bashkëpunimi dhe përben element të anës subjektive. Përgjegjësia e bashkëpunëtorit varet jo vetëm nga kontributi relevant por edhe nga faji në formën e dashjes. Struktura e vecantë e kryerjes së veprës penale

<sup>5</sup> Shih VUGJL nr.3/2015



në bashkëpunim bën që objekti i dashjes të përmbledhë jo vetëm kryerjen e veprës penale por edhe kontributin rlevant. Kështu, shtytësi duhet të ketë dashur dhe parashikuar të ndikojë në zgjedhjet e personit të nxitur , duke e orientuar ne kryerjen e faktit konkret, i cili më vonë është kryer. Në të njëjtën mënyrë, bashkëpunëtori i cili jep kontributin material ka parashikuar dhe dëshiruar ti japë ndihmë autorit, duke e bërë më të lehtë apo te mundur realizimin e faktit konkret<sup>6</sup>.

Atë që duhet të kontribuojë për të realizuar bashkëpunëtori ,është një fakt që mund edhe të ndalet në fazën e tentativës; por ajo që ai dëshiron dhe parashikon është dhënia e një kontributi për realizimin nga ana e të tjerëve të një vepëre penale të konsumuar. Është e mjaftueshme që bashkëpunëtori të dëshirojë dhe parashikojë një fakt konkret që përkon me atë të parashikuar nga dispozita e Pjesës së Posacme: nuk ka asnjë rëndësi dhe është e papërfillshme që bashkëpunëtori të ketë njohur mënyrat konkrete për të cilat autori do të kryeje veprën penale.

*Ai që nxit një person për të vjedhur një pikturë në një apartament vepron me dashje për ta nxitur , pasi ai nuk do ta dijë mënyrën se si do të futët në apartëmant dhe mjete konkrete që do të përdorë. Përsa i përket identitetit të viktimës, dashja e bashkëpunëtorit qëndron edhe në ratse kur, për një përfytyrim të gabuar të autorit, goditet një person i ndryshëm nga ai që bashkëpunëtoridëshirontë të cënontë . Ky përfundim rezulton konfrom rregullave të përfytyrimit të gabuar.*

*Nëse autori vendos, si zgjedhjen e tij personale, të vrasë një person të ndryshëm nga ai i caktuari, personi në këtë rast nuk përgjigjet për vrasje në bashkëpunim sepse zgjedhja e tij personale ka ndërprere lidhjen shkakësorë me sjelljen e tij.*

Nga ana subjektive marrëveshja nënkupton dy kushte : dijenia dhe vullneti i personave për të kryer veprën penale dhe për të bashkëpunuar për kryerjen e saj. Që një vepër penale të konsiderohet e kryer në bashkëpunim, ekzistenca e një marrëveshje paraprake në kryerjen e saj nuk është e domosdoshme, por mjafton edhe marrëveshja e parashikuar, e cila mund të shfaqet gjatë kryerjes së veprës penale, me kushtin që secili prej autorëve të jetë i ndërgjeshëm për veprimet e të tjerëve.

Kodi Penal parashikon shprehimisht ne nenin 25 që një nga elementet thelbësorë të bashkëpunimit është marrëveshja, e cila krijon lidhjen e fajësisë në formën e dashjes, unitetin organik të saj (Elezi, Kaçupi & Haxhia, 178).Në qoftë se mohojmë nevojën e marrëveshjes, atëherë fare lehtë mund të flasim për bashkëpunim dhe në veprat penale që kryhen nga pakujdesia , ose dhe në rastin kur disa persona kryejnë të njëjtën vepër penale, por disa veprojnë me dashje , ndërsa disa të tjerë nga pakujdesia. Nëse nuk do të parashikohej marrëveshja si një element i domosdoshëm, bashkëpunimi do të katandisej nga një unitet organik, në një bashkim të thjeshtë njerëzish që janë fajtorë në një vepër penale pra, si rrjedhim do injorohej një nga bazat kryesore të bashkëpunimit, pikërisht lidhja e fajësisë dhe gjithçka do përqëndrohej në lidhjen objektive, me ko incidencën e veprimeve të përbashkëta.

VUGJL nr. 4/2011, i cili është shprehur dhe mbi kater elementët e bashkëpunimit , i referohet doktrinës së huaj, perkatësisht të drejtës italiane. Në fakt elementi i katërt nuk mund të pranohet pasi ekzistenca e tij nuk pajtohet me formulimin e nenit 25 të

<sup>6</sup> Në dallim nga e drejta penale e Kosovës, sipas autorit Ismet Salihu, bashkëpunim quhet kur në kryerjen e veprës penale marrin pjesë dy ose më shumë persona. Ky formulim, ashtu si dhe e drejta italiane, përjashtojnë një element si marrëveshjen. Pra nuk e konsiderojnë atë të domosdoshëm për ekzistencën e vetë bashkëpunimit. Në dallim nga e drejta penale shqiptare , e cila i qëndron akoma traditës së saj të vjetër.

K.Penal, i cili kërkon domosdoshmërisht marrëveshjen dhe jo vetëm faktin e dijenisë e të paktën e njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e të njetit fakt penal.

Ne nuk mund të mbrojmë këtë pikëpamje sipas të cilës me bashkëpunim kuptohet kryerja së bashku, nga disa njerëz e të njejtës veprë penale edhe ne kushtet kur, të paktën nxitësi dhe ndihmësi dinë veprimtarinë që do të kryejë ekzekutori. Pasi nga kjo del se bashkëpunimi në krim ose në kundravajtje penale mund të ekzistojë dhe pa ekzistuar ndonjë marrëveshje e mëparshme, madje asnjë lloj marrëveshje midis bashkëpunëtorëve. Kështu sipas VUGJL 4/2011 do të na rezultonte se : A duke e ditur se B ka vendosur te vrase D, te cilin dhe ky kërkon ta zhdukë, me qellim lë revolverin në shtëpinë e B, ndërsa ky i fundit e merr këtë revolver pa e ditur se kush e ka lënë dhe kujt i përket dhe vret D.

Pra sipas qëndrimit te Gjykatës së Lartë, për të patur bashkëpunim në veprën penale është i mjaftueshëm konstatimi i lidhjes shkakësore dhe i lidhjes së thjeshtë subjektive, d.m.th që vepra penale të jetë kryer në të njejtën formë fajësie.

Në këtë rast, pjesëmarrësit në veprën penale i bashkojnë vetëm veprimet të kryera prej secilit dhe pasojës shoqërisht të rrezikshme që ka ardhur.

Sikurse është vënë në dukje dhe në fillim të këtij kapitulli, instituti i bashkëpunimit në veprën penalee justifikon ekzistencën e tij, vetëm për rrezikshmërinë shoqërore më të madhe që paraqet kryerja e krimit ose e kundravajtje penale nga disa persona në krahasim me atë të kryer nga një person i vecantë. Në qoftë se është vetëm fakti i incidences në kohë të veprimeve të disa personave në kryerjen e veprës penale, kuptohet se ky fakt nuk mund ta bëjë veprën shoqërisht më të rrezikshme nga rasti sikur ajo të ishte kryer nga një person.

Sipas interpretimit te VUGJL nr 4/2011 do ta bënte të pakuptueshme ekzistencën e bashkëpunimit, sipas të cilit bashkëpunimi në veprën penale ekziston mjaft që të ekzistojë lidhja shkakësore midis veprimeve të pjesëmarrësve dhe pasojës shoqërisht të rrezikshme të ardhur, si dhe lidhja e thjeshte subjektive, d.m.th forma e përbashkët e fajësisë , dashja ku shprehet në dijeninë e të paktit një prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar më të tjerët në kryerjen e faktit kriminal.

Karakteristikë për bashkëpunimin në veprën penale është fakti që pjesëmarrësit i forcojnë njëri-tjetrit- ndjenjën e besimit, të guximit për të kryer veprën penale, d.m.th pjesëmarrja e njërit ndikon në ndërgjegjen e tjetrit. Përvec të tjerave, edhe për këtë arsye vepra penale e kryer nga dis persona në bashkëpunim paraqet rrezikshmëri të shtuar shoqërore. Duhet kuptuar qartë që faji është element i përhershëm dhe i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, ndërsa marrëveshja është një element karakteristik i bashkëpunimit. Pa faj nuk mund të ketë përgjegjësi penale, ndërsa pa marrëveshje nuk mund të ketë bashkëpunim. Faji është element kryesor dhe i domosdoshëm i cdo figure të veprës penale , ndërsa marrëveshja është element jo kryesor , por i domosdoshëm në ato figura konkrete të veprës penale, kur kjo e fundit është kryer nga disa persona

Në veprat penale me pasoja materiale, secili nga bashkëpunëtorët e ka ndërgjegjen se ai vepron bashkë me bashkëpunëtorët e tjerë, se veprimet e tij janë kusht i nevojshëm për kryerjen e veprimeve të bashkëpunëtorit tjetër, parashikon ardhjen e pasojave kriminale dhe dëshiron ose me ndërgjeghe lejon ardhjen e tyre. Në cdo rast kërkohet ekzistenca e marrëveshjes midis bashkëpunëtorëve, por jo domosdoshmërisht njohja

midis të gjithë pjesëmarrësve<sup>7</sup>.

Marrëveshja e bashkëpunëtorëve mund të arrihet në faza të ndryshme të kryerjes së veprës penale para fillimit të kryerjes së veprës penale, në kohën e fillimit ose gjate kryerjes së veprës penale. Bashkëpunimi në veprën penale lind prej momentit që arrihet marrëveshja. Kuptohet që nuk mund të bëhet fjalë për bashkëpunim, kur marrëveshja është bërë mbas kryerjes së veprës penale. Prandaj, mos kallëzimi i nje krimi të kryer, fshehja e gjurmëve të saj dhe cdo lloj ndihme tjetër që i jepet autorit të veprës penale pas kryerjes së veprës penale, kur për këtë mungon marrëveshja e mëparshme, nuk mund të konsiderohen forma të bashkëpunimit. Kur ajo është bërë pas kryerjes së veprës penale nuk është element i bashkëpunimit por ndryshimi i cilësimit ligjor sic është "Perkrahja e autorit të krimit" parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, "Fshehja ose asgjësimi i kufomës" neni 303 i K.Penal etj.

Marrëveshja ndërmjet bashkëpunëtorëve mund të kryhet në cdo formë; me gojë, me shkrim, me gjeeste ose veprime të ndryshme. Kështu p.sh. A shikon një njeri të panjohur që po godet D. Në këtë rast A. merr pjesë në goditjen dhe së bashku me të panjohurin i shkaktojnë vdekjen D. Sic shihet, këtu marrëveshja është e heshtur dhe lind në kohën kur njëri nga bashkëpunëtorët ka filluar të kryejë krimin. Vetë marrëveshja mund të qëndrojë në dhënien e pëlqimit për kryerjen e veprës penale, në premtim për të gjetur mjete për kryerjen e saj, për të larguar pengesat e ndryshme ose për të fshehur gjurmët e veprës penale etj.

Ekzistenca e marrëveshjes nuk presupozon unitetin e qëllimit dhe të motiveve nga të cilat nisen pjesëmarrësit e ndryshëm në kryerjen e veprës penale. Cdo pjesëmarrës mund të këtë qëllimin os emotivet e tij në kryerjen e veprës penale, te cilat mund të jenë të ndryshme nga ato të pjesëmarrësve të tjerë. Ato i bashkon pjesëmarrësit në bashkëpunim është dëshira e tyre për të kryer veprën penale dhe jo qëllimet e tij dhe motivet nga të cilat ato nisen<sup>8</sup>.

Shkalla, karakteri i marrëveshjes, qëndrueshmëria e saj, janë faktorë që përcaktojnë format e bashkëpunimit, por këtu lind vetvetiu pyetja: midis kujt duhet të ekzistojë marrëveshja?

Zakonisht në praktikë ndodh që në lidhje me kryerjen e krimit ose të kundravajtjes penale, të gjithë pjesëmarrësot merren vesh me njeri tjetrin. Ka gjithashtu edhe mjaft raste, kur një marrëveshje e tillë midis të gjithëve mund të mos ekzistojë. Prandaj është e domosdoshme që marrëveshja të ekzistojë të paktën, midis ekzekutorit dhe secilit bashkëpunëtor, ose midis ekzekutorit dhe njërit prej bashkëpunëtorëve<sup>9</sup>. Pra do të jemi para bashkëpunimit në veprën penale edhe në rastin kur nxitësi dhe

<sup>7</sup> Shprehim rezervë në lidhje me kushtin e katërt të parashikuar nga VUGJL 4/2011 ku parashikon si element të katert të bashkëpunimit faktin se nga ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktit njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit penal. Ky kusht nuk përputhet me të drejtën tone penale pasi vetë neni 25 i k.Penal në dallim nga e drejta italiane, ku dhe vendimi i referohet, kërkon një element të domosdoshëm që është condition sine qua non, që është marrëveshja. Marrëveshje sipas fjalorit shqip rezultojn se: "Pajtim mendimesh ose pranimi i një qëndrimi të caktuar që arrihet ndërmjet dy ose më shumë vetave, palëve etj."

<sup>8</sup> Idem 13.

<sup>9</sup> Shih VGJL nr. 509 date 29.10.2008. Ky vendim shprehet se: "Që vepra të konsiderohet e kryer në bashkëpunim me pjesëmarrjen e të gjithë bashkëpunëtorëve të parashikuar nga ligji, nuk është e domosdoshme që mes të gjithë këtyre bashkëpunëtorëve të ekzistojë njohja fizike, mjafton që ekzekutori të ketë njohje me bashkëpunëtorët ose me njërin prej tyre dhe nga ana objektive pasoja kriminale të jetë rezultat i aktivitetit kriminal të të gjithë pjesëmarrësve.

ndihmësi nuk e njohin njëri-tjetrin, por secili prej tyre është i lidhur me ekzekutorin . Kështu p.sh A nxit B të shkatërrojë me zjarr makinën e hasmit të përbashkët C. Mbase vendos ta kryejë veprën B, duke i shpjeguar qëllimet e tij, i kërkon benzinin shoferit D i cili ja jep. Në rastin konkret D nuk e di se B është nxitur nga A.

Lidhur me kushtet që duhet të plotësojë marrëveshja mes dy ose më shumë personave për të kryer veprën penale në mënyrë që të ndodhemi përpara institutit të bashkëpunimit, gjykata e Larte vlerëson sipas Vendimit nr 4/2011, se mes marrëveshjes në kuptimin e ligjit civil dhe marrëveshjes në kuptimin e ligjit penal, ekziston një dallim thelbësor dhe se ligji penal zbaton një standard të ndryshëm nga ai civil lidhur me kuptimin e marrëveshjes<sup>10</sup>.

Ndërkaq, kuptimi i marrëveshjes, sipas nenit 25 të Kodit Penal, është krejtësisht i ndryshëm nga sa më sipër. Kuptimi i marrëveshjes në të drejtën penale, ndryshe nga e drejta civile, lidhet me shprehjen e vullnetit të dy ose më shumë personave për të kryer një veprim të paligjshëm dhe ligjrisht të dënueshëm. Kjo shprehje vullneti mund t'i paraprijë veprës penale, ose të jetë e atëçastshme.

Duke qenë një formë e shfaqjes së vullnetit për të kryer një veprim të paligjshëm, marrëveshja për të kryer një veprë penale nuk i nënshtrohet kushteve të vlefshmërisë që duhet të plotësojë marrëveshja si një veprim juridik në të drejtën civile. I vetmi kusht për pranimin e saj është të provuarit se mes autorëve ka ekzistuar një marrëveshje për kryerjen e veprës penale.

Cilësitë personale që mund të kenë eventualisht një apo disa nga autorët e veprës penale, si mosha e mitur, mungesa e përgjegjshmërisë mendore, etj., janë elemente që shërbejnë për përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale, por nuk çënojnë *marrëveshjen* e arritur për kryerjen e veprës penale.

Ndryshe nga ligji civil, Kodi Penal në dispozitat e tij nuk ka parashikuar asnjë kusht që duhet të plotësojë marrëveshja mes autorëve të veprës penale sipas nenit 25 të tij. Kjo pasi në nenet 12 dhe 17 të tij, Kodi Penal, duke përcaktuar rastet e përjashtimit nga përgjegjësia penale, indirekt ka përcaktuar edhe pasojat që vijnë në rastet kur vepra penale kryhet nga një person i mitur apo i paqëndrueshëm mendërisht. Në secilin nga këto raste vepra penale gjithsesi ekziston, por cilësitë e veçanta të personit bëjnë që ai të përjashtohet nga përgjegjësia penale apo t'i ulet dënimi.

Për rrjedhojë edhe marrëveshja e arritur për të kryer një veprë penale në bashkëpunim me një person që nuk mban përgjegjësi penale ekziston, por cilësitë e njërit apo disa prej autorëve, bazuar po në parimin e autonomisë së përgjegjësive, nëse është rasti, mund të bëjnë që personi konkret të përjashtohet nga përgjegjësia penale apo të përfitojë lehtësi që ligji parashikon.

Duke parashikuar parimin e autonomisë së përgjegjësive si një nga parimet themelore të së drejtës penale, ligjvënësi ka dashur të përjashtojë mundësinë që njëri autor i veprës penale të përfitojë nga cilësitë e autorit tjetër. Kjo është edhe arsyeja pse si kusht i vetëm për ekzistencën e *marrëveshjes*, sipas nenit 25 të Kodit Penal, mjafton vullneti i autorëve për të kryer veprën penale. Çdo rrethanë tjetër e faktit mund të

<sup>10</sup> Në të drejtën civile marrëveshja përbën një veprim juridik që , sipas nenit 189 të K.civil perkufizohet si "shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile". Duke qenë një formë e ligjshme e shprehjes së vullnetit, në të drejtën civile, një nga elementët e domosdoshëm për vlefshmërinë e marrëveshjes është dhe zotësia e plotë për të vepruar e personave ( me përjashtim të një kategorie të caktuar) në nënt 7 dhe 8 të k.Civil, te cilat mund të kryhen edhe nga personi pa zotësi për te vepruar ose personi me zotësi për yte vepruar.

ndikojë në përjashtimin apo llojin dhe masën e dënimit të secilit prej autorëve, por nuk cënon marrëveshjen e tyre si element i bashkëpunimit, gjë që merr përgjigje rast pas rasti sipas rrethanave të provuara të kryerjes së veprës penale.

### Bibliografia

- Ambrosetti E.M., *Abolitio criminis e modifica della fattispecie*, Padova, 2004.
- Antolisei, *Manuale di diritto penale, Parte generale*, 2008.
- Aurela Anastasi & Luan Omari "E drejta kushtetuese", ABC, Tirane 2010.
- Ashworth, *Principles of criminal law*, Oxford, 2003.
- Cadoppi A., *Il principio di irretroattività*.
- Capozzi, *Temporalitae norma nella critica della ragione giuridica*, Napoli.
- Cela, Elezi, Peza, Gjika, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme III*, 1976.
- Cela, Peza, Elezi, Gjika, *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme*, 1982.
- Crespi, Stella, Zuccala, "Commentario breve al codice penale", Ed. Cedam, Padova 1999.
- Eelezi, I., Kacupi, S., Haxhia. M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2012.
- Elezi, *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. (Pjesa e posacme)*, 1983.
- Elezi, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, 2008.
- Elezi, I., Kacupi, S., Haxhia, M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Botime Geer 2006.
- Elezi, Kaçupi, Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2011.
- Elezi.I., *E drejta penale, Pjesa e posacme*, Botime Erik, 2007.
- Engish K. *Die Zeit im Recht*, 1965.
- Engish, *die Zeit im Recht*.
- Fiandaca Musco, *Diritto penale, Parte generale*, botimi i dytë, 1995.
- Fiandaca.M., Musco.E. *Diritto penale, Parte generale*, Seconda edizione, 1997, Zanichelli Bologna.
- Fiandaca-Musco, *Diritto penale. Parte generale*, Bologna 2007.
- Ismet Elezi, *E drejta penale, Pjesa e posacme*, 2009.
- Ismet Elezi, Skënder Kaçupi, Maksim R. Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë* 2012.
- Ismet Salihu, *E drejta penale, Pjesa e Pergjithshme*, 2010.
- Kambovski Vllado, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Furkan, 2010.
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, 1995.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995.
- Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Ismet Elezi, Skënder Kaçupi.

## Përgjegjësia civile e administratorëve në shoqëritë e kapitalit

Mitat Dautaj

Universiteti Katolik ZKM Tiranë

### Hyrje

Historia për më se dy dekada e gjysëm në Shqipëri ka njohur zhvillime të qenësishme ekonomike shoqërore, që në të shumtën e rasteve janë paraprirë nga ndryshime konceptuale të së drejtës, ku kjo e fundit ka luajtur një rol të rëndësishëm duke iu paraprirë këtyre zhvillimeve, si një kusht i domosdoshëm për të kaluar nga një ekonomi tërësisht e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë.

Formëzimi i një të drejte tregtare solli një risi edhe lidhur me administrimin e shoqërive tregtare, duke u parë administrimi i sipërmarrjeve tregtare si një garant jo vetëm për shoqërinë dhe ortakët e veçantë të saj, por ajo çka është më e rëndësishme në raport me të tretët, kreditorë të shoqërisë.

Administratorët e shoqërive të kapitalit, mund të përgjigjen për veprimet e tyre kundrejt shoqërisë, ortakëve të veçantë dhe kreditorëve të shoqërisë. Ata duhet të përmbushin detyrimet e tyre ligjore dhe statutore me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm të kërkuar nga vetë natyra e detyrës së besuar dhe nga kompetencat e tyre të veçanta. Kur nuk respektojnë detyrimet e mësipërme, administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë dhe janë të detyruar të dëmshpërblejnë dëmet eventuale që ajo ka pësuar.

Për të kuptuar përgjegjësinë e administratorëve nevojitet të analizojmë marrëdhënien e tyre me shoqërinë, burimin e të drejtave dhe detyrimeve që ata kanë në shoqëri.

### Marrëdhënia e administrimit

Administratorët apo administratori i vetëm dhe këshilli administrativ përbëjnë një *organ* të nevojshëm të shoqërive të kapitalit, krahas asamblesë së ortakëve, këshillit mbikqyrës (në sistemin me dy nivele) dhe ekspertëve kontabël të autorizuar. Personi juridik nuk mund të ekzistojë dhe as të veprojë në mungesë të këtij organi, i cili merr fuqitë në mënyrë të shprehur me aktin e emërimit dhe nga pasojat ligjore që rrjedhin prej tij.

Ideja e organit na lejon të evitojmë konfigurimin e marrëdhënies së administrimit në kufijtë e kontratës së porosisë, çka gjendet shpesh edhe e shprehur në fillimet e legjislacioneve tregtare apo në botime të ndryshme (Mignoli & Nobili, 1958, 130; Berberi, 2004, 72). Gjithashtu, aq më pak nevojitet të individualizohet si një kontratë më vehte atipike e administrimit, që përfundohet midis shoqërisë dhe administratorit (Minervini, 1956, 71). Ideimi i figurës së kontratës së administrimit, në të cilën propozimi do të përbëhej nga komunikimi i vendimit të asamblesë për emërimin e administratorit dhe, pranimi nga depozitimi i firmës në regjistrin tregtar, do të kish si objekt kryerjen e punëve në kuptimin e gjerë të fjalës dhe kushtet e përgjithshme të kontratës do të përfshiheshin në aktin e themelimit. Natyrisht autorë të ndryshëm i janë kundërvënë këtij ideimi të marrëdhënies së administrimit si një

kontratë dhe, së fundmi, një pikpamje e tillë ka mbetur në minorancë. Një teori e tillë është kritikuar gjerësisht nga Galgano (Galgano, 1999, 257). Akti i emërimit është burimi eskuziv i fuqive të administratorit dhe se emërimi s'është tjetër veçse një akt tregues e përzgjedhës. Do të ish e vështirë të justifikohet lidhja me kontratën e porositë apo me kontratën atipike të administrimit, për faktin se një emërimi i vjen pas një pranim. Mjafton të merret në konsideratë se edhe likuidatori emërohet e më pas duhet të pranojë detyrën, por askush nuk ka mendur se burimi i fuqive të tij do të ish kontrata. Në këto raste, pranimi i detyrës nga ana e administratorit vlen si një kusht i efektshmërisë së aktit të njëanshëm të emërimit dhe jo si pranim i një propozimi kontraktor. Marrëdhënia e administrimit lind si një konkurim i vendimit të emërimit dhe pranimit nga i emëruari, jo si një përputhje e dy vullneteve, ai i shoqërisë dhe ai i të emëruarit (Ferri, 1987, 493).

Po aq e vështirë do të ish lidhja me kontratën e punës. Në botime shkencore gjejmë të shprehur faktin se marrëdhëniet e administratorit me shoqërinë rregullohen nëpërmjet kontratës së punës, e cila i nënshtrohet regjimit ligjor në fuqi mbi marrëdhëniet e punës (Malltezi, 2011, 51). Në asnjë nen apo paragraf të ligjit Nr. 9901 datë 14.4.2008 të ndryshuar me ligjin Nr. 129/2014, nuk gjejmë një justifikim të marrëdhënies administrator - shoqëri tregtare mbi bazën e kontratës së punës. Është i vërtetë parashikimi i nenit 95 pika 6 apo 157 pika "1" e ligjit Nr. 9901, se paditë e lidhura me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Parashikim të njejtë e gjejmë edhe lidhur me shpërblimin e likuidatorit në nenin 193 pika 2. Dispozitat e mësipërme kanë të bëjnë *vetëm me shpërblimin* në rastin e shkarkimit dhe, kurrësesi me marrëdhënien juridike që lind për përmbushjen e detyrës si administrator. Për më tepër edhe shpërblimi i administratorëve në vehtëvete vendoset nga asambleja e ortakëve (nenet 81 dhe 135 shkronja "d" të ligjit Nr. 9901). Lidhja me kontratën e punës është e pamundur, pasi edhe vetë Kodi i Punës<sup>1</sup>, në nenin 5 shkronja "a" parashikon përjashtimin nga fusha e zbatimit të tij, të veprimtarisë, që kufizohet vetëm në ushtrimin e detyrës së këshilltarit ose anëtarit të organit të administrimit të personit juridik, që ka formën juridike të një shoqërie, kur kjo veprimtari përmban vetëm ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo detyrë. Nga sa sipër parashtruar del konkluzioni, se *marrëdhënia e administrimit nuk lind dhe rregullohet nga kontrata, por nga ligji dhe aktet e shoqërisë*, ku akti i emërimit mbetet burimi i *vetëm i fuqive* (të drejtave dhe detyrimeve) të tyre.

Akti i emërimit (i shprehur në aktin e themelimit apo në vehte), i ndërthurur me dispozitat e ligjit, përbën *burimin* dhe *individualizon* natyrën e marrëdhënies së administrimit, që pikërisht për këtë iu atribuon administratorëve *një pushtet autonom dhe të drejtëpërdrejtë*. Megjithë marrëdhënien e unifikimit organik, që vendoset midis shoqërisë së kapitalit dhe administratorit, pasojat e akteve juridike të kryera nga ky i fundit si i tillë, nuk kushtëzohen në kohë me qëndrimin në detyrë të personit fizik si administrator. Pranimi se administratorët janë të kushtëzuar nga kontrata e administrimit, vështirë të justifikonte regjimin e përfaqësimit organik. Sa sipër mund të kundërshtohet me faktin se, administratorët nuk janë pjesë e aktit të themelimit, pra që ky akt nuk mund të sjellë pasojat të drejtëpërdrejta kundrejt tyre. Sipas nenit 691 të Kodit Civil parashikohet se, kontrata mund të ketë efekt ndaj të tretëve në rastet e

<sup>1</sup> Kodi i Punës, miratuar me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, përditësuar së fundmi me ligjin Nr. 136/2015;

parashikuara në ligj. Por, në vijim të këtij arsyetimi do të thoshim, se është pikërisht ky një nga rastet që nuk përfshihet në nenin 694 të K.Civil; në rastin tonë statuti do tu jepte të tretëve (administratorëve) të drejta, por njëkohësisht do i ngarkonte edhe me detyrime, në pritje që ata me pranimin e emërimit tu nënshtroheshin rregullave të formuara nga të tretët (ortakët).

Nga karakteri i drejtëpërdrejtë dhe i pavarur i pushtetit rrjedh që *organi administrativ nuk i nënshtrohet asamblesë*, edhe pse kjo e fundit ka fuqinë e emërimit, të shkarkimit dhe të kërkit të përgjegjësive të tyre. Në fakt asambleja nuk mund të revokojë aktet e kryera nga administratorët, as të realizojë vetë drejtëpërsëdrejti pushtetin e administrimit. Në këtë kontekst shpjegohen edhe detyrimet e administratorëve, të cilët edhe kundër vullnetit të asamblesë, duhet të kërkojnë zvogëlimin e kapitalit në shoqëri, kur ai është më i vogël se vlera nominale e nënshkruar, për shkak të humbjeve të pësuar. Në të kundërt, mosveprimi nga ana e administratorit sjell përgjegjësinë civile të tij. Po kështu, administratori është përgjegjës dhe duhet të kërkojë gjyqësisht anulimin e atyre vendimeve të asamblesë, që janë në kundërshtim me ligjin apo statutin.

### Përgjegjësia e administratorëve

Parimi kryesor në ushtrimin e detyrave të administratorëve, ortakëve apo aksionerëve është *detyrimi i besnikërisë* ndaj interesave të shoqërisë dhe ortakëve apo aksionerëve të tjerë. Lidhur ngushtë dhe si mishërim i këtij parimi është detyrimi i administratorëve për *informimin* e të gjithë ortakëve apo aksionerëve të shoqërisë për ecurinë e veprimtarisë tregtare. Zbatimi i detyrimit për informim, kurrësesi nuk përjashton përgjegjësinë e administratorëve për *ruajtjen e sekretit tregtar*, brenda kufijve të përcaktuar në pikën "1" të nenit 18 të ligjit Nr. 9901. Shkelja e detyrimeve të tilla, apo të atyre që kanë të bëjnë *ndalimin e konkurrencës dhe abuzimin me formën e shoqërisë* mund të sjellin përgjegjësinë e administratorëve.<sup>2</sup>

Parashikimet e mësipërme lidhur me detyrimin e besnikërisë lënë një hapësirë të madhe gjykatave për të zhvilluar standartet e zbatimit të këtij detyrimi. Natyrisht, në kushtet aktuale të rendit juridik në Shqipëri, do të merrte një rëndësi të madhe si burim i së drejtës, çka më vonë mund të përpunohej nga doktrina, rastet e përgjegjësive të administratorëve të shqyrtuara nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përgjegjësia e administratorëve është e natyrës civile, por ndryshe nga përgjegjësia kontraktore,<sup>3</sup> ajo paraqet veçoritë specifike të parashikuara në dispozita të veçanta të ligjit Nr. 9901, i cili duke qenë një ligj i veçantë (*lex specialis*) merr përparësi në zbatim referuar normave, që rregullojnë përgjegjësinë civile kontraktore apo atë nga shkaktimi i dëmit.

### Elementët e përgjegjësive

Elementët përbërës të përgjegjësive të administratorëve, si çdo formë e përgjegjësive civile, duke ju referuar parimeve të përgjithshme, janë para së gjithash *mospërmëshja* e një apo më shumë detyrimeve të parashikuara nga ligji apo aktet e shoqërisë; së

<sup>2</sup> Nenet 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit Nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;

<sup>3</sup> Neni 476-495 të Kodit Civil;



dyti *dëmi*, që në vetëvehte përcaktohet nga njera anë nga shkelja e një norme që ka vendosur detyrimin ndaj administratorit dhe nga ana tjetër në dëmin e ardhur nga kjo mospërbushje; së treti nga *lidhja shkakësore* midis mospërbushjes dhe dëmit të ardhur dhe, së fundi *faji*.

Për tu përjashtuar nga përgjegjësia administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara<sup>4</sup>, çka do të thotë se në përgjegjësinë e administratorëve do të zbatohen rregullat e prezumimit të fajit.

Por, i bie paditësit (pavarësisht se si i tillë mund të paraqitet shoqëria, ortaku apo i treti si kreditor) të provojë ekzistencën e tre elementëve:

- Mospërbushjen nga ana e administratorit të një detyrimi të përgjithshëm apo të veçantë të parashikuar në ligj apo në aktet e shoqërisë;
- Dëmi i pësuar në pasurinë e shoqërisë, të ortakut të veçantë apo kreditorit;
- Lidhjen shkakësore midis mospërbushjes së detyrimit dhe dëmit.

I përket në të kundërt, administratorit të paditur të provojë pafajësinë e tij, të japë prova mbi fakte se ai i ka kryer detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, prova këto që mund të përjashtojnë apo pakësojnë përgjegjësinë e tij.

Nuk ka rëndësi për të përjashtuar përgjegjësinë e administratorëve, fakti se ata kanë vepruar për të ekzekutuar një vendim asambleje. Në një rast të tillë do të konkuronte sëbashku me përgjegjësinë e administratorëve ajo e ortakëve, që kanë votuar pro një vendimarrje të tillë.

### 1. *Mospërbushja*

Janë paraqitur interpretime të ndryshme në literaturën e huaj për të pasur një parashtrim sa më të qartë të elementit të parë, atë të mospërbushjes së detyrimeve nga administratorët. Një grupim autorësh kanë përdorur edhe kritere për t'i kategorizuar detyrimet e mospërbushura në "*të veçanta*" e "*të përgjithshme*" (Bonelli, 2003, 550), ku të parat janë ato të parashikuara nga ligji, që përcakton edhe përmbajtjen, ndërsa të dytat janë ato që rrjedhin nga detyrimi i përgjithshëm i "besnikërisë" dhe, në veçanti, nga ai i ushtrimit të detyrave të tyre me *profesionalizëm* dhe *kujdesin e nevojshëm* (nenet 98 dhe 163, pika 1, shkronja "dh" e ligjit Nr. 9901). Ligji shqiptar sqaron se ç'duhet të kuptojmë me *standarte profesionale*, duke referuar në përcaktimin e listës shteruese që përmbajnë pikat 1 dhe 2 të nenit 98, pavarësisht faktit, se ushtrimi me profesionalizëm është një nga detyrimet e përmendura në vetë pikën 1 shkronja "dh". Përsa i përket teknikës legjislative do të kish qenë më e qartë, në se pika "dh" do ish formuluar si një fjali më vehte, duke ju referuar të gjitha detyrimeve të parashikuara me shkronja të veçanta në pikën 1. Ndërsa, përsa i përket "*kujdesit të nevojshëm*" ligji lë hapësirë, duke mos e specifikuar kuptimin. Në këto raste, pra për të vlerësuar në se administratori ka vepruar apo jo me kujdesin e nevojshëm, rol përcaktues merr interpretimi dhe vlerësimi i gjyqtarit.

Autorë të tjerë (Salafia, 2005, 233; Marchetti, 2015, 2) i kanë kategorizuar detyrimet që bien mbi administratorin duke u nisur nga funksionet që kryejnë: tek grupi i parë hynë ato detyra që i përkasin *funksionimit organizativ* të shoqërisë dhe, tek të dytat ato që lidhen me *administrimin e aktivitetit* të shoqërisë tregtare. Të parat do të konsistojnë për shembull, në detyrat, që administratorët duhet të kryejnë për thirrjen

<sup>4</sup> Nenet 98 e 163, pika 3 të ligjit Nr. 9901, të sipërcituar;

dhe vendimarrjen e organeve të shoqërisë, rregullshmërinë e mbajtjes së librave të shoqërisë si dhe në detyrimin e depozitimit të akteve në Regjistrin Tregtar; të dytat, mund të përcaktoheshin nga njera anë me aktet materiale, si ato të organizimit të veprimtarisë së brendëshme në funksion të objektit të aktivitetit që shoqëria ka dhe, nga ana tjetër, me aktet juridike, si nënshkrimi i kontratave të nevojshme për t'i mundësuar shoqërisë zhvillimin e aktivitetit të saj.

*Kujdesi i nevojshëm* - Standarti i kujdesit të nevojshëm (Neni 98 dhe neni 163 pika 1/dh) është një "kusht i përgjithshëm", me të cilin duhet të përputhen të gjitha sjelljet e administratorëve, pavarësisht faktit në se janë rezultat i parashikimit nga ligji apo statuti i shoqërisë. Përgjegjësia e administratorëve është e lidhur me detyrimin e mjeteve të përdorura në kohën e duhur dhe interesin më të mirë të shoqërisë, që vlerësohen me kujdesin e sjelljeve të veçanta të administratorëve dhe, jo me rezultatet në tërësi të administrimit. Në këtë drejtim është shfaqur mendimi, se performanca e administratorit të shoqërisë lidhet ngushtë dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me performancën e shoqërisë (Kromiçi, 2015, 177). Një përfundim i tillë i pranueshëm në përgjithësi, kurrësi nuk mund të përdoret në rastet e përgjegjësisë së administratorit. Përgjegjësia e administratorit nuk mund të bazohet vetëm në faktin e rezultatit negativ të administrimit, por nevojitet një tregues specifik i sjelljeve tipike të administratorëve, të mbajtura në kundërshtim me detyrimin për të treguar kujdesin e nevojshëm gjatë përmbushjes së detyrimeve të veçanta që lidhen me ardhjen e pasojës së dëmshme. Për këtë qëllim ligjvënësi, lidhur me standartet për individualizimin e shkallës së kujdesit të nevojshëm nga ana e administratorëve në përmbushjen e detyrave të tyre, referon duke i parë ngushtë me profesionalizmin, dhe duke i parashikuar në të njëjtën shkronjë "dh" të pikës 1 të nenit 98 dhe 163. Në analogji me legjislacionin italian, për aq sa është e mundur në fushën e interpretimit, nëpërmjet një deduksioni, identifikimi i kujdesit të nevojshëm lidhet me:

1 Natyrën e detyrës (si kriter objektiv);

2 Kompetencat e veçanta, që çdokush prej tyre disponon (kriter subjektiv).

1. *Natyra e detyrës* nënkupton kujdesin profesional. Kujdesi i nevojshëm në këtë rast kurrësi nuk mund të jetë i njëjtë me atë që kërkohet ndaj njerës palë në kontratat e përgatitura nga pala tjetër dhe, me të cilat lidhet efektshmëria e kontratave (neni 686 i KC). Shkalla e kujdesit që kërkohet nga administratori nuk mund të jetë thjesht e njëjtë as me atë të porosisë, por duhet të vlerësohet në lidhje me natyrën e veçantë të veprimtarisë së ushtruar.

Kujdesi i nevojshëm nga administratori është *kujdes tipik për atë që gjeron profesionalisht sipërmarrjen e tjetrit*, e përcaktuar jo si diçka abstrakte, por duke ju referuar konkretisht:

- Karakteristikave objektive të sipërmarrjes (*përmasave, veçorive organizative, fushës së veprimtarisë, strukturës së shoqërisë*, etj.);

- Funkcionit konkret të kryer nga çdo administrator më vehte apo brenda një organi kolegjal (president i këshillit administrativ, administrator brenda këshillit administrativ, qoftë me kompetenca të drejtëpërdrejta administrimi, ashtu edhe me kompetenca kontrolli - sistemi me një nivel tek SHA).

Përsa i përket mundësisë së përfshirjes të një *hetimi* dhe *vlerësimi* të kujdesit të nevojshëm të treguar nga administratorët, nenet 98 e 163 të ligjit Nr. 9901 kanë referuar kushtet dhe mënyrën e përmbushjes të detyrave prej tyre, çka do të thotë se administratorët duhet t'ju përmbahen me rigorozitet, që të provojnë kujdesin e

nevojshëm dhe profesionalizimin, si elementë thelbësorë të besnikërisë së tyre ndaj shoqërisë. Sa sipër, nuk do të thotë që ata të jenë domosdoshmërisht specialistë apo ekspertë të kontabilitetit, në fushën financiare apo në çdo sektor tjetër të administrimit të sipërmarrjes tregtare, por duke arsyetuar *a contrario* duhet thjesht, që zgjedhjet e tyre të paraprihen nga *mbledhja e informacionit dhe vlerësimi paraprak*, të mbështetur në njohjet përkatëse dhe fryt i një vlerësimi *me përgjegjësi*, çka nënkupton llogaritje të rrezikut, pjesë e pandarë e vetë konceptit të sipërmarrjes tregtare. Për rrjedhojë, veprimet e tyre nuk duhet të jenë rezultat i papërgjegjshmërisë apo improvizimit të pakujdeshëm (qoftë kjo vetëbesim i tepruar apo neglizhencë).

2. *Kompetencat e veçanta të administratorëve*, si kriter subjektiv, do të thotë se detyrat e administratorëve të parashikuara në ligj apo në aktet e shoqërisë duhet të karakterizohen në përmbushjen e tyre jo vetëm nga profesionalizmi, por edhe nga kujdesi i nevojshëm, duke pasur parasysh veçoritë e kompetencave (aftësive) që ai vetë disponon.

Me fjalë të tjera, për të përcaktuar kujdesin e nevojshëm nga çdo administrator nevojitet të mbahet parasysh edhe *cilësia, kompetencat dhe aftësitë personale* që secili prej tyre ka dhe, që në fakt duhet të përbëjnë edhe bazën për emërimin e tyre në detyrë. Ligji tregtar Nr. 9901 nuk parashikon në mënyrë të shprehur kushte për personin fizik si administrator të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (veç ndalimeve që përmban neni 13). Ndërsa për shoqëritë aksionare, për shkak se kjo formë e organizimit të shoqërisë është karakteristikë e sipërmarrjeve të mëdha tregtare, parashikon shprehimisht<sup>5</sup> se deklarata e mirëadministrimit duhet të përmbajë një profil të administratorëve, si dhe të shpjegojë elementët dhe faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat që u janë caktuar.

## 2. Dëmi

Administratorët janë të detyruar "*t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes*". Kjo dispozitë, që i detyron të dëmshpërblejnë dëmet e shkaktuara, ka një rëndësi të madhe për të siguruar një administrim sa më të mirë. Administratori është i ndërgjegjshëm se të administrosh një pasuri që nuk të përket (apo aq më shumë, kur është edhe vetë ortak dhe zotërues përpjestimisht i kapitalit), duhet të respektosh një seri detyrimesh. Ai e di gjithashtu se, në se shkel këto detyrime përgjigjet ndaj shoqërisë. Detyrimi për të shpërblyer dëmin ka jo vetëm një funksion "*riparues*" sa herë që pasoja ka ardhur, por edhe një funksion "*parandalues*", duke e detyruar administratorin që të sillet me të gjithë kujdesin e nevojshëm për të shmangur pakësimin e pasurisë së shoqërisë.

Përgjegjësia e administratorëve kërkon si kusht ekzistencën e dëmit efektiv shkaktuar pasurisë së shoqërisë nga mospërmbushja e detyrimeve të parashikuara në ligj apo aktet e shoqërisë. Dëm është çdo pakësim i pasurisë së shoqërisë, i ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të kryera nga administratorët në kundërshtim me detyrimet e tyre.

Për shkak të natyrës së shpërblimit të dëmit që ka përgjegjësia e mësipërme, shkelja nga ana e administratorëve të detyrave që ju janë besuar në ligj apo aktet e shoqërisë (statut, akt themelimi, akti i emërimit të administratorit, vendim asambleje për përcaktimin apo ndryshimin e kompetencave të tyre) nuk mund të jetë kusht i mjaftueshëm për konstatimin e një përgjegjësie ndaj tyre, në se mungon prova, se

<sup>5</sup> Neni 134, pika 2 e ligjit Nr. 9901, të sipërcituar;

nga kjo shkelje i është shkaktuar një dëm i drejtëpërsëdrejtë pasurisë së shoqërisë. Shkelja e detyrimeve prej administratorëve në mungesë të pasojës (dëmit) mund të përbëjë shkak për humbje të besimit, i cili në vehtëvete mund të përdoret nga asambleja e shoqërisë si një shkak i arsyeshëm për shkarkimin e tij, por kurrësi për përgjegjësinë civile ndaj tyre. Në këtë kuadër, ligji tregtar Nr. 9901 i ndryshuar nuk parashikon asnjë pengesë lidhur me shkarkimin e administratorëve, pra nuk kërkon një shkak të arsyeshëm. Mjafton në këto raste të respektohet kuorumi i kërkuar për vendimarrjet e asamblesë së zakonshme. Por, sikundër jemi shprehur më parë (shif marrëdhënia e administrimit), shkak i arsyeshëm do të ishte i vlefshëm vetëm për të shmangur përgjegjësinë e shoqërisë ndaj shkarkimit të administratorit lidhur me shpërblimet eventuale të kërkuara prej tij.

Ndërsa, përsa i përket përbajtjes së detyrimit për shpërblimin e dëmit, tashmë është një parim i qartë në vijueshmëri edhe të sa sipër paraqitur, që administratori është i detyruar të dëmshpërblejë sipas parimeve të përgjithshme civile, që përfshijnë si dëmin efektiv, ashtu edhe fitimin e munguar, por brenda kufijve të përgjegjësisë që përmban ligji i posaçëm Nr. 9901 në dispozitatat e veçanta të tij, ku parashikohen detyrimet konkrete për administratorin dhe respektivisht përgjegjësia e tij në funksion të llojit të detyrimit të mospërbushur. N.q.s. do t'i referoheshim konkretisht rastit të shkeljes nga ana e administratorit të detyrimit për të mos lejuar shoqërinë të vazhdojë ushtrimin e veprimtarisë tregtare, nga çasti që ka marrë apo duhet të kishte marrë dijëni, që shoqëria nuk ka kapital të mjaftueshëm për të përbushur detyrimet ndaj palëve të treta, përgjegjësia e administratorëve kundrejt shoqërisë kufizohet deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë, që kanë lindur nga momenti kur duhet të kishin marrë dijëni për paaftësinë paguese të saj. Po kështu, në rastin e shkeljes së detyrimit të ndalimit të konkurrencës, përgjegjësia e administratorëve për shpërblimin e dëmit ndaj shoqërisë mund të konsistojë në pranimin e kalimit për llogari të shoqërisë të transaksioneve të kryera për llogari të tyre si dhe, transferimit shoqërisë të të gjitha përfitimeve që kanë realizuar nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë dhe, të të drejtave apo kredive, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve të tilla.

Dëmi që i shkaktohet shoqërisë mund të paraqitet edhe si dëm jopasuror. Në këto raste duhet të shpërblehet edhe dëmi jopasuror, sa herë që nga veprimi i paligjshëm i administratorit do të rezultojnë pasoja të dëmshme ndaj shoqërisë për reputacionin, kredibilitetin apo imazhin e saj, të cilat nuk japin drejtëpërsëdrejtë një vlerësim monetar në treg, por bëjnë të nevojshme një shpërblim në masë të barabartë mbi bazën e të gjithë elementëve të faktit dhe rastit konkret.

Gjykata shqiptare<sup>6</sup>, në një rast gjykimi mbi bazën e padisë së administratorit për shpërblim dëmi për shkarkim të padrejtë, nuk merr në konsideratë prapsimet e palës së paditur (shoqërisë), e cila pretendon se veprimet e administratorit kanë çenuar imazhim e saj (nga rrethanat e faktit administratori i një shoqërie sigurimi ish konfrontuar me punonjësit e shoqërisë së siguruar). Konfrontimi i administratorit të një shoqërie sigurimi me punonjës të një shoqërie të siguruar prej shoqërisë së parë, paraqet në vehtëvete dëmtim të imazhit të një shoqërie sigurimi, që mund të çojë edhe në prishjen e kontratës me shoqërinë e siguruar, apo edhe të dëmtojë reputacionin e saj në treg.

<sup>6</sup> Vendim i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë Nr. 10036 datë 8.10.2013;

### 3. Lidhja shkakësore

Lidhja shkakësore midis mospërmbushjes së detyrimit (veprimit ose mosveprimit) dhe dëmit, si kusht i domosdoshëm i përgjegjësisë së administratorëve del nga dispozitat e ligjit Nr. 9901, ku parashikohet qartë se “administratorët janë të detyruar t’i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes”. Lidhja shkakësore duhet të jetë e verifikueshme gjyqësisht dhe konkretisht, duke u mbështetur në kushtet dhe rregullsinë e normalitetit shkaksor. Është e rëndësishme në përcaktimin e lidhjes shkakësore të individualizohet pikërisht shkelja konkrete e administratorit, që ka qenë *shkaku përcaktues* në ardhjen e dëmit që ka pësuar shoqëria. Në praktikë është e nevojshme të verifikohet, në se duke shmangur hipotetikiisht shkeljen (mospërmbushjen e detyrimit) nga administratori, dëmi nuk do të ekzistonte, do të ish më i vogël, apo dëmi do të shfaqej njësoj. Në se dëmi do të kish ardhur njësoj (çka do të thotë pavarësisht nga sjellja e administratorit), lidhja shkakësore mungon. Në jurisprudencën shqiptare nuk gjejmë raste të analizës së lidhjes shkakësore. Por në jurisprudencën e huaj gjejmë raste të tilla, p.sh. gjykata e kasacionit në Itali në vitin 2005 shprehet se, në se administratori është përgjegjës për shkeljen e detyrimeve, ndaj tij nuk mund të pretendohet çdo dëm pasuror që shoqëria mund të ketë pësuar, por vetëm dëmi, që paraqitet si pasojë e menjëhershme dhe e drejtëpërdrejtë me shkeljen e detyrimeve të administratorit. Shoqëria duhet të provojë jo vetëm një sjellje të administratorit në kundërshtim me detyrat e tij, por edhe atë të ardhjes së një dëmi efektiv të lidhur drejtëpërdrejt me sjelljen e administratorit.<sup>7</sup>

Në gjykime të tilla mund të konkurojnë në formimin e bindjes përfundimtare tek gjyqtari prezumime të veçanta, por duhet sigurisht të përjashtohet që përdorimi i prezumimit (që mund të mbështetet në përgjithësi tek kriter i probabilitetit të arsyeshëm, apo mbi bazën e rasteve të nxjerra nga jurisprudenca ose doktrina), të zbatohet pa një verifikim serioz mbi qëndrueshmërinë logjike në lidhje me faktet e veçanta që shqyrtohen.

### 4. Fajësia

Përgjegjësia e administratorëve ndaj shoqërisë është një përgjegjësi subjektive që lidhet me fajësinë e tij, pra një përgjegjësi personale, duke përjashtuar mundësinë e përdorimit të kriterëve të fajësisë si tek përgjegjësia e prejardhur për dëmet e shkaktuara nga të tretë. Përgjegjësia e administratorit është e pakufizuar, ndryshe nga ajo e ortakëve tek SHPK-të apo e aksionerëve tek SHA-të. Administratorët janë të detyruar t’i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Mbi ta bie *barra e provës* për të vërtetuar kryerjen në mënyrë të rregullt të detyrave të tyre të parashikuara në ligj apo aktet e shoqërisë. Pra, ligjëvënësi niset nga prezumimi i fajësisë së administratorit, për dëmet që shoqëria ka pësuar nga shkelja konkrete e detyrës që ai ka në bazë të ligjit apo statutit. Por megjithatë, administratori mund të përjashtohet nga përgjegjësia, sa herë që në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse rezulton se veprimi ose mosveprimi i tij është kryer në mirëbesim. Sa sipër mund të shprehemi, se nisur nga vetë formulimi i ligjit, përgjegjësia e administratorit është e kushtëzuar më ekzistencën e fakteve apo rrethanave përkatëse që provojnë mirëbesimin në përmbushjen e detyrave prej tij.

<sup>7</sup> Vendim i gjykatës së kasacionit Itali Nr. 3774 datë 23.02.2005;

## Përgjegjësia solidare

Në se asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë, veç përjashtimeve që mund të bëhen në aktin e emërimit apo në statut.<sup>8</sup> Kolegjialiteti i organit administrativ sjell në parim, që ata përgjigjen në mënyrë solidare për dëmet që shoqëria ka pësuar nga mosrespektimi i detyrave që ligji dhe statuti ju kanë besuar. Por, siç jemi shprehur më sipër (shif - fajësia), përgjegjësia e administratorëve është personale dhe, e konceptuar nga bashkekzistenca e katër elementëve (shkelja e detyrës, dëmi, lidhja shkësore dhe faji). Për rrjedhojë, vetëm kur shkelja është kryer bashkarisht, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Në këto raste secili prej administratorëve është i detyruar të shpërblejë dëmin dhe, për këtë qëllim, shoqëria mund të veprojë ndaj njerit prej tyre pa qenë e nevojshme që t'i padisë të gjithë, duke u zbatuar më pas dispozitat për të drejtën e regresit në detyrimet solidare. Sa sipër është evidente në shoqëritë aksionere, që kanë zgjedhur qeverisjen e tyre nëpërmjet sistemit me një nivel. Në rastet kur dëmi është pasojë e drejtëpërdrejtë e një vendimarrje nga këshilli i administrimit, atëherë të gjithë anëtarët e këshillit do të përgjigjen në mënyrë solidare.

Administratorët, sidoqoftë duhet të individualizohen në mënyrë të pavarur si bashkëpërgjegjës për dëmin specifik që pretendohet konkretisht, mbi bazën e evidentimit të një lidhje shkësore të përpiktë midis sjelljes që ju atribuohet atyre personalisht dhe dëmit të ardhur. Në marrëdhëniet e brendëshme, përkundrazi administratori, që nuk ka bashkëpunuar në kryerjen e akteve (veprim ose mosveprim), që kanë shkaktur pasojën e dëmshme, nuk mund të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë, pasi vetëm kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Megjithatë, përsa përmendur më sipër, duhet të paraqesim në përfundim se natyra solidare e përgjegjësive së administratorëve ndaj shoqërisë do të përjashtohet, në bazë të karakterit personal të përgjegjësive së mësipërme, kur bëhet fjalë për detyra të atribuara konkretisht administratorëve të veçantë<sup>9</sup> dhe faktit, se edhe pse mund të kenë administruar bashkarisht, për njerin prej tyre veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve.

## Administrator fakti

Nga pikpamja e nevojës së individualizimit të përgjegjësive së administratorëve, jurisprudenca dhe doktrina e huaj kanë njohur figurën e administratorit të faktit, që nënkupton *personin që ushtron funksione gjerimi dhe administrimi të një shoqërie pa qenë rregullisht i veshur me pushtetet përkatëse*. E përgjithshmeja në përcaktimin e mësipërm, sjell me vehte që kjo figurë nuk mund të kufizohet vetëm në rastet në të cilat një administrator të ketë administruar, edhe pse akti i emërimit të ketë qenë i pavlefshëm apo i pa rregullt. Mund të bëhet fjalë edhe në rastet kur dikush, edhe pse i pajustificuar nga një marrëdhënie juridike administrimi, megjithatë është në gjendje të influencojë deri në atë pikë mbi administrimin apo deri aty sa të zevëndësojë administratorët

<sup>8</sup> Neni 95 pika 5; neni 158 pika 6; të ligjit Nr. 9901 të ndryshuar;

<sup>9</sup> Neni 154, pika 1/f, i ligjit Nr. 9901 të ndryshuar;

ligjërish të emëruar (Dautaj, 2013, 113).

Administrator fakti është ai që ka kryer konkretisht veprimtari administruese (jo thjesht ekzekutuese) të shoqërisë dhe, kjo veprimtari të ketë pasur karakter të vazhdueshëm, duke mos qenë e përfshirë veprimtaria që konsiston në përmbushjen e disa akteve të natyrës së veçantë apo të rastit. Për këtë arsye, figura e administratorit të faktit përcaktohet nga ekzistenca e elementëve të mëposhtëme:

- Mungesa e një akti formal (emërim, autorizim, porosi, kontratë, etj) të asamblesë, apo dhe mbarimi i kohëzgjatjes së përcaktuar në akte të tilla;
- Ushtrimi i veprimtarisë në mënyrë të vazhdueshme (jo në mënyrë të rastit);
- Veprimtaria e zhvilluar hyn në kompetencat e administratorëve;
- Autonomia vendimarrëse (të paktën bashkëpunuese dhe jo e varur) në krahasim me administratorët e ligjshëm.

Rëndësia e normave të parashikuara për organizimin e shoqërive mund të përjashtojë çdo vlerësim mbi këtë figurë, duke vendosur se vetëm kush është formalisht administrator mund t'i nënshtrohet disiplinës përkatëse. Do të na duhej kështu të procedonim me vendosjen e kësaj figure në kuadrin jashtë së drejtës, duke e njohur si një marrëdhënie e tillë fakti e parëndësishme për të drejtën. Në jurisprudencën shqiptare, edhe pse bazuar në legjislacionin e mëparshëm tregtar (ligji Nr. 7638) kemi qëndrime të ndryshme ndaj këtij fenomeni. Përsa i përket përgjegjësisë penale, gjykatat kanë konkluduar se, edhe pse ortaku i shumicës nuk ka qenë administrator i emëruar, ai është sjellë si administrator dhe, do të mbajë përgjegjësi penale për aktet e kryera. Ndërsa për të njejtin fenomen, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në një çështje civile, edhe pse nga rrethanat e faktit rezultonte se personi, ortak i shoqërisë kish vepruar si administrator në vazhdimësi, përjashtohet përgjegjësia e tij duke i dhënë rëndësi mungesës së formalizimit të emërimit të tij: "Gjatë shqyrtimit të akteve që ndodhen në dosje, ndryshe nga ç'thuhet në vendimin e përmendur të asamblesë së ortakëve, paditësi nuk figuron të ketë qenë emëruar as administrator i saj, as i punësuar në këtë shoqëri. Përkundrazi, sipas nenit 22 të Statutit të Shoqërisë Tregtare "Birra Korça"-sh.p.k., i punësuar ishte caktuar i ati i paditësit, veprimet e të cilit mund të kenë qenë shkaku që mund të ketë sjellë dëmin ekonomik të pretenduar nga ortakët në mbledhjen e datës ...".<sup>10</sup>

Fenomeni i mësipërm është i pranishëm në të gjitha vendet në të cilat veprojnë shoqëri kapitali; dhe në të gjitha këto vende problemet janë të përbashkëta: *t'ju drejtohen këtyre personave normat e përcaktuara për administratorët e ligjshëm, përsa i përket përgjegjësisë për aktivitetin e dëmshëm të ushtruar?* Në përgjithësi, kriteri për të identifikuar figurën e administratorit të faktit mund të ndjekë dy drejtime. I pari, më i afërt me përmbajtjen e detyrimeve të administratorit, që përqendrohet në veprimet konkrete të kryera nga personi në vazhdimësinë e aktivitetit shoqëror dhe, ndikimit që ai ka pasur në vlerësimin e të tretëve. I dyti, në të kundërt, më i afërt përsa i përket kërkesave minimale, që lejojnë t'i jepet një legjitimitet formal marrjes përsipër në mënyrë të parregullt të detyrës drejtuese (Franzoni 2002, 77). Praktika gjyqësore e huaj paraqitet e ndryshme jo vetëm në vende të ndryshme, por edhe brenda të njejtin vend. Kjo praktikë në një rast kërkon që "për t'i atribuar cilësinë e administratorit të faktit të një shoqërie kapitali një personi, nuk mjaftojnë akte të veçanta të ndërhyrjes së administratorit të faktit të pretenduar në administrimin e shoqërisë, nevojitet një

<sup>10</sup> Vendim Nr. 39 datë 30.05.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

ndërhyrje e qëndrueshme, që zgjat një periudhë të konsiderueshme kohore dhe që shfaqet nëpërmjet kryerjes së përsëritur të akteve tipike të administrimit. (gryketa e Milanos, Itali, 1994); në analogji ka raste të tjera, ku praktika gjyqësore shprehet se “ai që ushtron konkretisht funksionet e administratorit të një shoqërie kapitali me pëlqimin e të gjithë ortakëve, edhe pse jo me një vendim të shprehur formalisht të asamblesë, duhet të konsiderohet administrator fakti i shoqërisë”; apo “nuk nevojitet një akt formal emërimi për t’i atribuar një subjekti, që konkretisht ushtron funksionet e administratorit, që të cilësohet administrator fakti”.

Duke përgjithësuar sa sipër shpreh idenë se kjo figurë duhet të njihet edhe nga jurisprudenca shqiptare. Në praktikë ekzistojnë rastet e shfaqjes së këtij fenomeni. Mund të kujtojmë, që pas etiketës së “administratorit të faktit” gjendet si ai, që është emëruar në mënyrë të parregullt, pra ka filluar ushtrimin e funksioneve përpara emërimit formal e pranimit; po ashtu ai që qëndron akoma në detyrë edhe pse nuk është kryer publikimi në regjistrin tregtar; ai që ka uzurpuar funksionet e tjetrit e drejton e sillet si përfaqësues pa pasur fuqitë; kush, akoma sillet si administrator i fshehtë, jo i drejtëpërdrejtë, apo drejton dhe administron nëpërmjet administratorit ligjërish të emëruar. Veç faktit të pranisë së fenomenit në realitet, në aspektin ligjor<sup>11</sup>, parashikohet se çdo parregullsi në emërimin e përfaqësuesit ligjor nuk përjashton apo kufizon përgjegjësinë e shoqërisë ndaj palëve të treta. Duke u nisur nga sa sipër, përderisa shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve për akte të personave që përmbushin detyrat e administratorit, pa qenë të emëruar formalisht dhe në mënyrë të rregullt, do të përbënte një risi jo vetëm në garantimin e interesave të shoqërisë, por edhe të tretëve, trajtimi dhe njohja nga gjykatat shqiptare të kësaj figure dhe vlerësimi e atribuimi i përgjegjësisë përkatëse ndaj saj.

### Konkluzione

<sup>2</sup> A. Buda, Stellung und Bedeutung der Stadt Voskopoja in der albanischen Kulturgeschichte des 18. Jahrhunderts, në: Structure sociale et développement culturel des villes sud-est européenne et adriatiques aux XVIIe et XVIIIe siècles, Bucarest, 1975; M.D.Peyfuss, Die Druckerei von Moschopolis 1731-1769, bot.2-te, Wien-Köln-Weimar, Bot.2, 1996; P.Xhufi, Shekulli i Voskopojes (1669-1769), Tiranë 2010; R.Rousseva, Iconographic Characteristics of the Churches of Moschopolis and Vithkuqi (Albania), Makedonika 35, (2005-2006), f.163-18; G.Koch, Albanien. Kunst und Kultur im Land der Skipetaren, Köln, 1989; I.M.Qafëzezi, Voskopoja e vjetër edhe rrebesimi i parë 1338-1769, në: „Minerva“, nr.16,24 dhjetor 1933, f.23-24; nr. 17, 1 janar 1934, f. 22-25.

lartpërmendur përbën monografia e historianit austriak Max D. Peyfuss. Hulumtimi i tij kushtuar shtypshkronjës së Voskopojës por dhe përgjithësisht historisë së këtij qyteti, shqyrton në mënyrë kritike materialet historike të mëparshme, e i plotëson ato më të dhëna të tjera arkivore, duke formuluar një gjykim logjik të historisë dhe kulturës së Voskopojës dhe zonës përreth. Gjithashtu një trajtim kritik, të bazuar në të dhëna dokumentare për shpjegimin e hovit të përgjithëshëm të Voskopojës në kapërcimin e shekullit XVII në të XVIII na prezanton Prof. Pëllumb Xhufi. Dhe Prof. Xhufi e sheh fenomenin e zhvillimit të Voskopojës të pashkëputur nga mjedisi përreth, ku që në fillim të studimit të tij shprehet, se „kemi refuzuar ta trajtojmë Voskopojën si një „ishull“, të palidhur e të pangjizur me mjedisin përreth..... përkundrazi, e kemi projektuar rastin Voskopojë në një kuadër shumë më të gjerë, në lidhjet e saj të shumëllojshme me mjedisin e afërt“ (Xhufi, 2010, 10). Një ndër vendasit që iu përkushtua historisë së Vithkuqit dhe Voskopojës ishte mësuesi nga Vithkuqi, Ilo Mitke Qafëzezi (1882-1964). Ai ushtroi veprimtarinë e tij në Korçë dhe botoi disa shkrime mbi historinë dhe kulturën kryesisht të Voskopojës dhe zonave përreth, duke ndihmuar kështu kritikën shkencore (Qafëzeza, 1935, 510-514).

Vithkuqi, një vend i begëte baritor, ndodhet në një pozicion skajor gjeografik. Të mirat natyrore të kesaj zone arritën nëpërmjet mundësive dhe manovrimeve tregëtare të fshatarëve vendas të zhvillohen më së miri në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Situata fetaro-politike e Vithkuqit, si dhe e gjithë zonës përreth, varej nga disa faktorë, si: vendi që zinte ky fshat në sistemin e Perandorisë Osmane, situata e Perandorisë Osmane në shek. XVII, marrëdhënia që kishte ky fshat me Patrikanën e Ohrit e me atë të Stambollit, por dhe lidhjet që gëzonte kjo zonë me botën perëndimore, si me Hungarinë, Austrinë, Venedikun etj. Ishte bashkëveprimi i frytshëm i gjithë këtyre faktorëve ndikues në një moment të përbashkët, që bënë të mundur shkëlqimin e shpejtë të këtyre zonave, por dhe rënien po aq të shpejtë të këtij shkëlqimi. Mوندohemi t'i ndjekim disa faktorë të rëndësishëm politikë, ekonomikë dhe fetarë të kesaj zone në periudhën e lartpërmendur.

Në zhvillimin ekonomik të Vithkuqit, Voskopojës dhe zonave të tjera pranë, si Shpaska e Nikolica, pati rëndësi pa dyshim pozita juridike e tyre nën regjimin e Perandorisë Osmane. Rregjistrimet e para kadastrale osmane në Shqipëri, që na njohin me sistemin agrar që vendosën pushtuesit osmanë në Shqipëri e në Ballkan, janë ato të viteve 1431-1432, të emërtuara si „Regjistri i Sanxhakut Shqiptar“ (Defter-i Sancak-i Arvanid)<sup>3</sup>. Të dhënat e këtij regjistri për praninë e sistemit të timarit në Shqipëri janë fare të pakta e kanë të bëjnë me krahinën e Korçës e të Përmetit. Në këtë rregjistrim nuk përmendet asnjë nga fshatrat e malësisë së Oparit, vetëm fshatrat e pjesës fushore të trevës së Korçës (Xhufi, 2010, 38). Kjo ndoshta, ngaqë malësia e Oparit ishte një zonë ende e panështruar, dhe si e tillë, jo objekt i rregjistrimit (Xhufi, 2009, 358-359). Që më parë njiheshin këto zona për një profil të tillë: „Në këtë kuptim, kesaj copëze të Shqipërisë bukolike dhe banorëve të saj, duket se i shkojnë mbrekullisht për shtat fjalët e udhëtarit të huaj, i cili në vitin 1308 shkruante për ato popullsi shqiptare, të cilat, sipas tij, „nuk jetojnë në qytete, kështjella, fortesa apo fshatra, por në kolibe, pasi lëvizin vazhdimisht nga njeri vend në tjetrin të ndarë në grupe e sipas fisit“ (Xhufi, 45).

<sup>3</sup> Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.378.

Në vitin 1484 sulltan Bajaziti II i dhuroi si mylk<sup>4</sup> ish-sanxhakbeut të Janinës dhe dhëndrit të sulltan Mirahor Iljas Beut fshatrat Peshkopje (aty ku u shtri më vonë qyteti i Korçës), Panarit, Treskë, Leshnjë, Boboshticë dhe Vithkuq të krahinës së Korçës (Pulaha, 1988, 176). Në shek. XVI thuajse u nderpre praktika e dhurimit të mylqeve tokësore, kurse ato ekzistuese u shndërruan në shumicën e tyre në vakëfe<sup>5</sup>. Me 1505 Mirahor Iljas beu tokat e tij në fshatrat Peshkopje, Vithkuq, Leshnjë, Boboshticë etj. i ktheu në vakëf<sup>6</sup>, status që ofronte privilegje të veçanta (Peyfuss, 38). Këto toka ishin pjesë e kazasë së Korçës<sup>7</sup>. Në regjistrimin e parë kadastral të viteve 1568-70, Vithkuqi shfaqet si një vendbanim rural me 343 kryefamiliarë (Pulaha, 1988, 176) dhe është një nga zonat me popullsinë më të dendur.

Që në fund të shek. XVI në qytetet dhe fshatrat shqiptare filloi të funksionojë zejtaria si një bazë e re ekonomike<sup>8</sup>. Zejtaritë që morrën hov të shpejtë ishin ato që lidheshin më tepër me përpunimin e produkteve bujqësore-blegtorale, si regjia e lëkurëve dhe përpunimi i leshit. Megjithatë, për shkak të shkallës ende të ulët të zhvillimit ekonomik, ritmi i ngritjes së këtyre zonave eci me hap relativisht të ngadalshëm<sup>9</sup>. Vithkuqi në këtë periudhë ishte ende një vend kryesisht blegtoral, që si grupet e tjera blegtorale të malësive të Ohrit, Prespës, Kolonjës e Oparit, zbrisnin në dimër në fushat e sanxhakut të Vlorës, dmth. në Myzeqe (Pulaha, 1978, 127-130). Ata vazhdonin të njejtën mënyrë jetese, të përcaktuar nga nevojat e jetës baritore, me shpërngulje sezonale nga kullotat verore në ato dimërore e anasjelltas.

Defteri tjetër përmbledhës osman, ai i vitit 1668/9, nuk përmend Vithkuqin, por përmend kazanë e Korçës, ku bënte pjesë dhe Vithkuqi. Kazaja e Korçës figuron aty si kazaja me numrin më të madh të haneve të rregjistruara (569) në kuadrin e Sanxhakut

<sup>4</sup> Tokat private (mylk) ishin zotërime të dhëna përgjithëmonë dhe të pakushtëzuara me detyrimin ushtarak. Nga fondi i tokave shtetërore, me anë të një akti të veçante pronësimi, sulltanët u dhuronin komandantëve të shquar të ushtrisë ose funksionarëve të lartë të administratës, për merita të veçanta ndaj shtetit osman. Pronarët e këtyre zotërimeve gëzonin mbi to të gjitha të drejtat e një prone të plotë. Ata mund t'i shisnin, t'ua linin trashëgim pasardhësve të tyre, t'i dhuronin ose t'i kthenin në prona institucionesh fetare myslimane. Pronat mylk në trojet shqiptare zinin një sipërfaqe shumë të vogël të tokës së punueshme në krahasim me sipërfaqen e tokës së shpallur shtetërore dhe të ndarë në zotërime ushtarake e administrative si në vendet e tjera të perandorisë. Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.522-23.

<sup>5</sup> Tokat e vakëfuara nuk mund të shiteshin, të dhuroheshin ose ktheheshin në prona individuale. Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.523.

<sup>6</sup> Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.523.

<sup>7</sup> Zgjerimi i Perandorisë Osmane, pas pushtimeve të realizuara në shek.XV, bëri të nevojshëm ndryshimin e organizimit të saj shtetëror. Gjate mbretërimit të Sulltan Sulejmanit II (1520-66) u krye një organizim i ri i shtetit. Në përfundim të këtij riorganizimi, territoret e gjithë Perandorisë u ndanë në 32 ejalete, që ishin njësi më të vogla administrative. Krahinat e Gadishullit Ballkanik u përfshinë në tri ejalet: ejaleti i Bosnjes në veri të gadishullit, ejaleti i Rumelisë në qendër dhe ejaleti i Detit në ishujt e detit Egje. Territoret e Shqipërisë bënin pjesë në ejaletin e Rumelisë. Çdo ejalet u nda më tej në një numër sanxhakësh dhe sanxhakët u ndanë në njësi më të vogla që u quajtën kaza. Vithkuqi, si zonat e tjera përreth, ishte pjesë e kazasë së Korçës, dhe sanxhakut të Manastirit. Në fillim të shek. 16-të, sanxhaku i Manastirit fitoi një rëndësi të veçantë, sepse selia e bejlerbeut të Rumelisë u zhvendos nga Shkupi në Manastir, prandaj dhe ai njihet me emrin pashasanxhaku i Manastirit. Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.516.

<sup>8</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.549.

<sup>9</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.550.

të Rumelisë (Manastirit) (Stojkov, 1970, 210). E gjithë kjo trevë pra, gëzonte një farë mirëqenieie në krahasim me kazatë e tjera të po të njejtit sanxhak. Vithkuqi, duke përfutuar nga terreni i mbrojtur që i ofronin malet, si dhe nga pozita gjeografike pranë rrugëve të komunikacionit<sup>10</sup>, kishte mundësinë që nga profili i thjështe baritor të kalonte në një zonë zeytare e tregëtare. Zhvillimi i prodhimit dhe qarkullimi i tij çuan edhe në zonën „tonë” në krijimin e esnafeve të para<sup>11</sup>, atyre bashkimeve të prodhuesve të vegjël në organizata të veçanta sipas profesioneve, me rregulla të detyrueshme për të gjithë ushtruesit e zejeve dhe të tregëtisë.

„Nuk do të gabonim po të thoshim, se faza e parë e begatisë ekonomike (se Voskopojës) i detyrohet esnafeve, te cilat edhe në shek. XVIII për nga numri ishin më të rëndësishme se sa shtëpitë e mëdha tregtare me filialet e tyre në Evropën Juglindore dhe Qendrore” (Peyfuss, 36) . Dhe vertetë, dimë se fshatarët e këtyre zonave të begata, që nga mesi shek. XVI nuk duhet të prodhojnë vetem për të mbuluar nevojat e tregut krahinor. Ato nëpërmjet lidhjeve dhe tregëtise me karvane në rrugën e njohur, që nëpërmjet luginës së Devollit ose asaj të Osumit të çonte drejt portit të Durrësit në Adriatik, arrinin të mbulonin dhe tregun european<sup>12</sup>. Gjithë marrëdhëniet sociale e tregëtare organizoheshin nëpërmjet esnafeve. Esnafet patën një rëndësi të madhe për fshatrat dhe qytetet e kësaj periudhe jo vetëm në aspektin ekonomik, por dhe në atë shoqëror dhe kulturor. „Esnafet ishin katalizatorë të një solidariteti mbi baza ekonomike e sociale... ata merrnin përsipër vepra publike në shërbim të gjithë komunitetit”(Xhufi, 2010, 159).

Rritja dhe zhvillimi i këtyre qendrave baritore në juglindje të Shqipërisë, dhe hovi që mori prodhimi dhe përpunimi i lëndëve të para, si leshi dhe lëkura, të mbledhura fillimisht nga prodhuesit vendas, drejtoheshin në fillim të shekullit të XVII drejt tregjeve të veriut, ku kishte lindur një kërkesë, që për dhjetra vjet erdhi gjithnjë e në rritje (Xhufi, 2010, 300). Në periferinë veriore të Ballkanit, po përqendrohej e po përforcohej gjithmonë e më shumë linja kufitare ndarëse e Perandorisë së Habsburgëve, me roje kufitare ballkanase (e një numër të madh shqiptarësh) nga zonat e pushtuara të Perandorisë Osmane. Përqendrimi i vëmendjes së Perandorisë Osmane në këtë pikë të nxehtë luftarake çoi në një lloj tolerance të përkohshme ndaj zonave të pushtuara.

Nga ana tjetër, ushtria austro-hungareze, me kolonat shumëmijshe, kryesisht fshatare, të fushuara për një kohë të gjatë në kufirin austro-turk, kishte nevoja të shumta për ushqime, veshmbathje e mbulesa të ngrohta më bazë leshi (Xhufi, 2010, 307). Sasitë e mëdha të leshit të papërpunuar, ishin malli kryesor i eksportit që mbushnin anijet veneciane në fund të shekullit të XVII<sup>13</sup>. „Aktiviteti frenetik tregtar i voskopojarëve, që dëshmohet aq

<sup>10</sup> Vithkuqi, si Voskopoja ishin nyje të brendshme, të cilat të paktën nga kohët bizantine lidhnin pellgun e Korçës me Beratin, Vlorën e Durrësin. S. Adhami, Të dhëna rreth fizionomisë urbanistike dhe arkitektonike të qytetit mesjetar të Voskopojës, në: „Monumentet“, nr. 3, Tiranë, f.103.

<sup>11</sup> Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002, f.551; P.Xhufi, Shekulli i Voskopojës (1669-1769), Tiranë 2010, f.153; M.D.Peyfuss, Die Druckerei von Moschopolis, 1731-1769, Buchdruck und Heiligenverehrung im Erzbistum Achrida. Wien-Köln-Weimar, Bot.2, 1996, f.36.

<sup>12</sup> Studiuesi austriak Peyfuss, sheh lulëzimin e tregëtisë së Voskopojës të lidhur ngushtë me tregëtinë e Adriatikut. Sipas tij, vetëm atëherë grumbullohej kapitali në Voskopojë. Me zhvendosjen e veprimtarive tregëtare në rrugët tokësore, e me ngritjen e selive të Voskopojarëve në vendet e Europës Qendrore, u zhvendos dhe kapitali i akumuluar prej tregëtisë në këto zona të sigurta të Europës. M.D.Peyfuss, f.38.

<sup>13</sup> Fatura të ruajtura nga Konsullata e Vendikut mbi ngarkesat e mallrave të tërhequra nga anijet veneciane dëshmojnë mbi sasitë e mëdha të leshit, krahas mallrave të tjera, si dyll apo shajak. Z.Shkodra, Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: letra të konsujve venedikas të Durrësit, vëll. I (1696-1707), Tiranë, 1975,

mirë në kapërcim të shek. XVII-XVIII, u nxit nga kjo kërkesë në rritje leshi në funksion të përqendrimeve ushtarake përgjatë kufirit austro-turk..." (Xhufi, 2010, 310). Në fakt, leshi dhe produktet e tij konsideroheshin nga Porta e Lartë si materiale luftarake dhe bënin pjesë në listën e mallrave të ndaluara, që nuk lejoheshin të nxirreshin jashtë territoreve të Perandorisë Osmane. Por, meqenëse financat e Perandorisë Osmane në këtë periudhë ishin të rrënuara nga lufrat ekspansioniste, arriti ajo ta tolerojë një tregëti të tillë, për hir të taksave që do të pagonin tregtarët e leshit në formën e „rajave“ drejt Portës së Lartë në Stamboll (Mantran, 2004, 244). Një zinxhir i tillë interesash, që funksionoi deri në fund të shek. XVII erdhi më së miri në dobi të ekonomisë së këtyre fshatrave malore të Korçës. Por megjithëse është vlerësuar roli i madh i përparimit të organizuar të tregëtisë brenda kufijve të një sundimi mysliman, zhvillimi dhe shtytja e vërtetë që çojnë në mirëqenien e madhe të Voskopojës (apo Vithkuqit aty pranë) dhe zonave të tjera të ngjashme përreth, nuk është qartësuar ende (Xhufi, 2010, 58). Fakt është, që në gjysmën e dytë të shek. XVII, ashtu si Voskopoja e Vithkuqi u zhvilluan në një formë të ngjashme një numër jo i vogël qendrash tregtare, si Shipska, Nikolica, Nausa, Siatishta, Ampelaki, Kozani, Kosturi etj (Xhufi, 2010, 58).

Veç pozitës gjeografike në të njejtin pellg shqiptaro-maqedonas-thesal, një fakt i përbashkët që lidh këto qendra tregëtare me njëra-tjetrën, e që padyshim ka një influencë të madhe në zhvillimin e tyre në këtë periudhë, është ai, që të gjitha këto vatra të zhvillimit të gjithanshëm çuditërisht të shpejtë, drejtoheshin nga i njejtë faktor epror fetaro-kulturor. Ishte ky faktor i rëndësishëm drejtues, që përdori ekonominë në zhvillim, për forcimin e klerit vendas, e në këtë kuadër dhe ngritjen e një sërë ndërtimesh dinjitoze fetare e kulturore, të cilat vlejnë si dokumente të qarta historike ende në ditët tona.

### Bibliografi

- A. Buda, *Stellung und Bedeutung der Stadt Voskopoja in der albanischen Kulturgeschichte des 18. Jahrhunderts*, në: Structure sociale et développement culturel des villes sud-est européenne et adriatiques aux XVIIe et XIIIe siècles, Bucarest, 1975.
- G.Koch, *Albanien. Kunst und Kultur im Land der Skipetaren*. Köln, 1989.
- R.Rousseva, *Iconographic Characteristics of the Churches of Moschopolis and Vithkuqi (Albania)*, Makedonika 35, (2005-2006).
- M.D.Peyfuss, *Die Druckerei von Moschopolis 1731-1769*, bot.2-te, Wien-Köln-Weimar, Bot.2, 1996.
- P.Xhufi, *Shekulli i Voskopojës (1669-1769)*, Tiranë 2010.
- I.M.Qafëzezi, *Voskopoja e vjetërë edhe rrebesimi i parë 1338-1769*, në: „Minerva“, nr.16,24 dhjetor 1933.
- S. Adhami, *Marrëdhëniet ekonomike, shoqërore dhe kulturore midis Vithkuqit dhe Voskopojës në shekullin e lulezimit të tyre*, në: Monumentet 1978, 15-16.
- Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë, 2002.
- S.Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, Tiranë, 1988.
- R.Stojkov, *La division administrative de l'eyalet de Roumelie pendant les années soixante du XVII siècle*, ne: Studia Balcanica", Sofija, 1970.
- R.Mantran (bot.), *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë, 2004.

## **Adoptimi i shërbimeve mobile qeveritare në Republikën e Kosovës**

**Fakije Zejnullahu**

*Ministria e Administratës Publike, Republika e Kosovës*

**Bekim Stafai**

*Universiteti European i Tiranës, Fakulteti ekonomik, Departamenti i Financave*

**Indrit Baholli**

*European University of Tirana*

### **Abstrakt**

Qeveritë në gjithë botën janë orientuar në integrimin e teknologjive mobile në operacionet e brendshme qeveritare për të komunikuar dhe ofruar shërbime tek përdoruesit në kohe-reale, kudo që ndodhen dhe përdoruesit ata janë në lëvizje.

Ndonëse këto zhvillime ofrojnë shume përfitime për qytetare, biznese dhe njësitë qeveritare, investimi në shërbimet mobile qeveritare jo gjithmonë rezultojnë të jete i suksesshëm dhe fitimprurës. Pak vende në zhvillim arrijnë të implementojnë suksesshëm m-Government.

Praktikat tregojnë se përdorimi i këtyre shërbimeve nuk ka rezultuar të jete i kënaqshëm. Shumë qeveri janë përballur me nivelin e ulët të adoptimit të shërbimeve mobile qeveritare. Edhe projektet m-Government të projektuara mire dhe të financuara mjaftueshëm mund të dështojnë nëse nuk adoptohen nga një mase kritike e përdoruesve të synuar.

Shfrytëzimi nga përdoruesit fundor në mënyrë efektive i këtyre shërbimeve të reja, mbetet aspekti më sfidues në suksesin e m-Government.

Që të mund të inkurajohen përdoruesit fundor për konsumimin e shërbimeve të reja mobile qeveritare, duhet kuptuar dhe shpjeguar faktorët që ndikojnë në vendimin e një individit për të pranuar ose refuzuar adaptimin e këtyre shërbimeve.

Ky dokument prezanton një model konceptual që mund të shfrytëzohet për të vlerësuar gatishmërinë e qytetarëve Kosovar për të adaptuar sistemin mobil për Menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve. Korniza konceptuale e propozuar integron dy modelet të mirënjohura TAM dhe DOI, si dhe variabilet e jashtëm "Imazhi" dhe "Besueshmëria" në një model e vetëm.

**Fjalët kyçe:** Adoptimi i m-Government, TAM, UTAUT, DOI, TRA, TPB.

### **Hyrje**

Avancimet në shërbimet mobile dhe rritja spektakulare e penetrimit të pajisjeve mobile dhe internetit mobil janë force nxitëse për qeverinë që të marre një drejtimi të ri: m-government (Kushchu & Kuscu, 2004: 2).

Përdorimi i teknologjive mobile në aktivitetet e qeverise dhe në shpërndarjen e informatave /shërbimeve e referuar si m-Government, është një mundësi e mire për të rritur nivelin e kualitetit dhe të shpërndarjes të shërbimeve publike, dhe një veprim i pashmangshëm që duhet të ndërmarrin qeveritë për të transformuar vetveten në një qeveri mobile të kudondodhur.

Por, pavarësisht mundësitë që krijon qeverisja mobile, nuk duhet inspirojmë shpresat



optimiste dhe fantazitë për një pranim gjithëpërfshirës të këtyre shërbimeve nga përdoruesit fundore dhe për një progres pa sfida.

m-Government(m-G) mund të përballë me shumë barriera gjatë procesit të implementimit si; zhvillimi i infrastrukturës, privatësia dhe siguria, çështjet ligjore, kompatibiliteti, shkalla e penetrimit mobil dhe qasja (Kushchu & Kuscu, 2004:9).

Megjithëse këto janë çështje të rëndësishme në implementimin m-G, kapërcimi i këtyre pengesave nuk garanton se investimi i bërë në këto projekte do të jetë profitabil dhe i sigurt. Shfrytëzimi nga përdoruesit fundor në mënyrë efektive i këtyre shërbimeve të reja të ofruara nga qeveria, mbetet aspekti më sfidues në suksesin e m-Government.

Globalisht ka shumë investime në projekte e-Gov dhe m-Gov, por për fat të keq pranimi për t'u përdorur i këtyre shërbimeve nuk ka rezultuar të jetë i kënaqshëm. Shumë qeveri janë përballur me nivelin e ulët të adoptimit të shërbimeve mobile qeveritare (Sultana & Ahlan, 2014:3).

Edhe projektet m-government të projektuara mire dhe të financuara mjaftueshëm mund të dështojnë nëse nuk adoptohen nga një masë kritike e përdoruesve të synuar (Althunibat, A. Alrawashdeh & Muhairat, 2014:738).

Mungesa e gatishmërisë për të përdorur Sistemet e reja të Informacionit është një nga pengesat më të rëndësishme në suksesin e këtyre sistemeve. Davis këtë e sheh si faktor përcaktues të suksesit ose dështimit të një sistemi të informacionit (D.Davis,1993: 475).

Prandaj dështimi i pranimin dhe përdorimit të shërbimeve mobile qeveritare nga përdoruesit e synuar do të qojë në dështimin e programit të m-Government. (OECD/ITU, 2011: 66) dhe përpjekja e qeverive që të përmirësojnë performancën, duke ofruar shërbime mobile do të rezultojë e pasuksesshme.

Investimet në projekte të cilat mund të jenë të padëshirueshme dhe të refuzuara nga përdoruesit, mund të parandalohen duke vlerësuar paraprakisht nëse sistemi do të jetë i pranueshëm për t'u përdorur, duke diagnostikuar arsyen se përse sistemi i planifikuar mund të mos jetë plotësisht i pranueshëm për përdorim dhe të ndërmerren veprime korrekte për të rritur pranimin e sistemit. (Davis, Bagozzi & Warshaw, 1989:999)

Hulumtues dhe praktikues të ndryshëm kanë adresuar çështjen e gatishmërisë për të pranuar m-government, në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, duke identifikuar një varg faktorësh që mund të ndikojnë në përdorimin ose refuzimin e shërbimeve mobile qeveritare, por meqenëse këta faktorë mund të ndryshojnë nga ata që mund të ndikojnë popullatën Kosovare, është i nevojshme një hulumtim për rrethanat në Kosovë. Kjo veçanërisht është emergjente në këtë fazë të hershme të zhvillimit m-G në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij hulumtimi është zhvillimi i një modeli konceptuar i cili do të përdoret për të matur perceptimin e qytetarëve kosovar në lidhje me përdorimin e sistemit mobil qeveritar për Menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve, i cili model do të mund të shfrytëzohet për të parashikuar adoptimin e sistemeve mobile qeveritare në përgjithësi.

Sistemi mobil për menaxhimin dhe Arkivimin e Dokumenteve(mSMAD), është një sistem i centralizuar për menaxhimin elektronik të kërkesave zyrtare dhe arkivimin e lëndes në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe Universitete, i cili

është në fazën përfundimtare të implementimit dhe pritet së shpejti të lëshohet në shfrytëzim.

mSMAD është ndër sistemet e para elektronike qeveritare i qasshëm nga pajisjet mobile, që u mundëson qytetareve të iniciojnë kërkesat e tyre nga pajisjet mobile dhe të dërgojnë ato për shqyrtim tek të gjitha institucionet e Kosovës dhe Universitete si dhe të marrin përgjigjeje mbi statusin e kërkesës.

### **Shqyrtimi i Literaturës**

Parashikimi i përdorimit të një teknologjie është bërë fushe interesi për shumë hulumtues dekada me parë. Me rritjen e kërkesave për teknologji në vitet e 70' dhe rritjen e dështimit të adaptimit të sistemeve në organizata(Chuttur, 2009:1), filluan përpjekjet e studiuesve të ndryshme për të parashikuar se cilët ishin faktorët që do të mund të ndikojnë tek përdoruesit që të adaptojnë dhe të përdorin një sistem.

Crëgëtimi drejt përmirësimit të përdorimit të Sistemeve të Informacionit vazhdon edhe sot, katër dekada pas.

Akademik dhe praktikues të ndryshëm po përpiqen të gjejnë faktorët të cilët ndikojnë gatishmërinë e individit për të përdorur teknologjitë e Informacionit, në kontekste të ndryshme, në mënyrë që të përmirësohet përdorimi i tyre.

Edhe në kontekstin e qeverisjes mobile, shumë studiuesve që janë të fokusuar në kërkimet m-government, kanë provuar që të përcaktojnë faktorët që ndikojnë vendimin e individit për të pranuar ose refuzuar një sistem mobil qeveritar.

Hulumtues të cilët kanë bërë përpjekje për të trajtuar këtë çështje, në punë e tyre kanë adaptuar modele dhe teori ekzistuese të mirënjohura në Adoptimin e Teknologjisë si: Technology Acceptance Model (TAM), Diffusion of Innovations (DOI), Theory of Planned Behaviour (TPB) dhe Unified Theory of Acceptance and Use of Technology (UTAUT) duke i zgjeruar këto teori me faktorë shtese për të prodhuar modele të reja për ekzaminim të adaptimit të sistemeve mobile.

### **Modelet Ekzistuese në Adoptimin e Teknologjisë**

Shtjellimi i Adoptimit të një teknologjie të re shpeshherë përshkruhet si një nga fushat hulumtuese me e matuar në literaturën bashkëkohore të sistemeve të informacionit. Kërkimet në këtë fushe kanë rezultuar në disa modele teorike me zanafillë në Sisteme të Informacionit, Psikologji dhe Sociologji, të cilat kërkuesit i vënë përballë një mori modelesh nga të cilët ata mund të zgjedhin konstruktet përgjatë modeleve ose të zgjedhin modelin e preferuar. (Venkatesh, Morris, B. Davis & D. Davis, 2003:426).

Modelet dhe teoritë ndër më të aplikuarat në këtë domen janë: Theory of Reasoned Action (TRA), Diffusion of Innovations (DOI), Technology Acceptance Model (TAM), Theory of Planned Behaviour (TPB) dhe Unified Theory of Acceptance and Use of Technology (UTAUT).

Secila nga këto teori/modele përmban grupe të ndryshme të përcaktuesve të pranimit dhe adaptimit të një teknologjie. Në tabelën nr. 1. jepet një përshkrim i secilës nga këto teori/modele dhe konstruktet baze.

Tabela Nr. 1. Modelet në adaptimin e Teknologjisë.

Theory of Reasoned Action (TRA)	Konstruktet bazë	Definicioni
<p>E zhvilluar nga Martin Fishbein dhe Icek Ajzen( në vitin 1967), është një nga teoritë më themelore dhe dominuese për parashikimin e sjelljes se vullnetshme njerëzore.</p>	<p>Pikëpamja ndaj sjelljes  (ang.Attitude Towad Behavior-A)</p>	<p>Opinioni pozitiv ose negativ i një personi në lidhje me kryerjen e sjelljes të synuar (Fishbein &amp; Ajzen, 1975:216).</p>
<p>Sipas Theory of Reasoned Action , sjellja e një Individidi(p.sh. përdorimi ose refuzimi i një teknologji) është e përcaktuar nga synimi/gatishmëria e përdoruesit për të kryer sjelljen(ang.Behavior Intention-BI). Nga ana tjetër BI është përcaktuar bashkërisht nga këndvështrimi i personit (ang.Attitude Towad Behavior-A) në lidhje me sjelljen në fjalë dhe nga norma subjektive (SN) (Davis, Bagozzi &amp; Warshaw,1989:983). Sa me i fuqishëm të jetë BI, aq më shumë është e pritur që personi të provojë sjelljen dhe mundësia me e madhe që sjellja të kryhet në të vërtetë.( Ajzen &amp; J.Madden , 1986:454).</p>	<p>Norma Subjektive  (ang.Subjective Norm-SN)</p>	<p>Perceptimi i një personi se shumica e njerëzve që janë të rëndësishme për të mendojnë se ai/ajo duhet ose nuk duhet ta kryej sjelljen në fjalë (Fishbein &amp; Ajzen, 1975:302)</p>
<p>TRA përveç që konsiderohet si predikues i mire i BI dhe i sjelljes(ang.Behavior ) kjo teori vlerësohet dhe si shume e dobishme për te identifikuar se ku dhe si të planifikohen strategjitë për ndryshimin e sjelljes (J. Madden, S. Ellen &amp; Ajzen,1992:2)</p>	<p>Synimi/Gatishmëria ndaj sjelljes(ang. Behavioral Intention - BI)</p>	<p>Probabiliteti subjektiv i një personi se ai do të kryej sjelljen në fjale(Fishbein&amp;Ajzen,1975:288).</p>




Fig.Nr.1 Theory of Reasoned Action (Fishbein & Ajzen, 1975:16)

<p>Fig.Nr.1 Theory of Reasoned Action (Fishbein &amp; Ajzen, 1975:16)</p>		
<p>Technology Acceptance Model (TAM)</p>	<p>Konstruktet bazë</p>	<p>Definicioni</p>
<p>Technology Acceptance Model, i krijuar nga Fred Davis(1985) është një nga modelet më dominues dhe gjerësisht i aplikuar për të parashikuar dhe shpjeguar përdorimin e një Sistemi të Informacionit dhe zgjerimi me influencues i Theory of Reasoned Action (TRA)(Al-Busaidi, 2012:38)</p> <p>Sipas Davis “përdorimi aktual i sistemit” është “një sjellje” , prandaj ai TRA-në e vlerësoi si model shumë të përshtatshëm për të shpjeguar dhe parashikuar këtë sjellje.</p>	<p>Dobia e perceptuar  (ang.Preceived Usefulness-PU)</p>	<p>“Është shkalla në të cilën një person beson se përdorimi i një sistemi te caktuar do përmirësojë performancën e tij/saj në punë”(Davis, 1989: 320)</p>
<p>Davis fitoi Technology Acceptance Model duke bërë dy modifikime në TRA. Se pari ai nuk i morri në konsiderate “Normat Subjektive “ në parashikimin e sjelljes aktuale të individit dhe se dyti për parashikimin e Synimit/gatishmërisë për të përdorur një teknologji të re (ang. Intention to Use-ITU) ai</p>	<p>Lehtësia e perceptuar e përdorimit (ang.Perceived Ease of Use-PEOU).</p>	<p>“Është Shkalla në të cilën një person beson se përdorimi i një sistemi të caktuar nuk kërkon shumë përpjekje/mundim” F. D. Davis, 1989: 320)</p>
<p>Davis fitoi Technology Acceptance Model duke bërë dy modifikime në TRA. Se pari ai nuk i morri në konsiderate “Normat Subjektive “ në parashikimin e sjelljes aktuale të individit dhe se dyti për parashikimin e Synimit/gatishmërisë për të përdorur një teknologji të re (ang. Intention to Use-ITU) ai</p>	<p>Synimi/ Gatishmëria për të përdorur(ang. Intention to Use –ITU)</p>	<p>Synimi ose planifikimi i dikujt për të përdorur një sistem të Informacionit (Sawalha &amp; Abu-Shanab, 2015:60). Probabiliteti subjektiv që personi do të përdor Sistemin e Informacionit</p>

përdori dy besimet: Dobia e perceptuar (ang.Preceived Usefulness-PU) dhe Lehtësia e perceptuar e përdorimit (ang.Perceived Ease of Use- PEOU).




Fig. Nr. 2. Technology Acceptance Model,(Venkatesh & D. Davis, 2000:187).

Gjithashtu TAM teorizon se PU influencohet nga PEOU, pasi qe sipas Davis sa me i lehte të jetë përdorimi i sistemit aq më i dobishëm mund të jetë ai .(Venkatesh & D. Davis, 2000:187)

Ndërkohë që modeli TAM vazhdon të përdoret gjerësisht, hulumtues të ndryshëm kanë provuar të bëjnë zgjerimin e këtij modeli duke integruar variabile të ndryshme në TAM.

Dy nga zgjerimet më të njohura janë TAM2 dhe TAM3.

Zgjerimi i pare i TAM u bë dhjetë vite pas paraqitjes se tij nga Venkatesh & Davis(2000), të cilët në përpjekje për ta zgjeruar impaktin shpjegues të modelit zhvilluan dhe testuan modelin e zgjeruar të quajtur:TAM2.


Ndërsa, zgjerimi i dyte ndodhi pothuajse dy dekada nga paraqitja e TAM, nga Venkatesh & Bala (2008) të cilët propozuan TAM3

Theory of Planned Behaviour (TPB)	Konstruktet bazë	Definicioni
<p>Theory of Planned Behaviour është gjithashtu zgjerim i Theory of Reasoned Action.</p> <p>I propozuar nga Icek Ajzen(1985), TPB përveç dy përcaktuesve që përmban TRA si: Pikëpamja ndaj sjelljes(ang. Attitude Towad Behavior) dhe Norma subjektive (ang.Subjective Norm), përfshin edhe konceptin “Perceived Behavioral Control” si përcaktues plotësues te synimit/gatishmërisë për të kryer sjelljen (ang. Behavior Intention) dhe Sjelljes(ang.Behavior).</p>	<p>Pikëpamja ndaj sjelljes</p> <p>(ang.Attitude Towad Behavior-A)</p>	<p>E adaptuar nga TRA</p>
<div data-bbox="151 815 589 1152" data-label="Diagram"> <pre>             graph LR             A[Attitudes towards behavior] --&gt; BI[Behavioral Intention]             B[Subjective Norm] --&gt; BI             C[Perceived Behavioral Control] --&gt; BI             BI --&gt; D[Perceived Behavioral Control]             </pre> </div>	<p>Norma Subjektive</p> <p>(ang.Subjective Norm-SN)</p>	<p>E adaptuar nga TRA</p>
<p>Fig.Nr.3. Theory of Planned Behaviour (J. Madden, S. Ellen &amp; Ajzen, 1992:4)</p>	<p>Perceived Behavioral Control</p>	<p>Perceptimi i një personi se sa e lehte ose e vështire mund të jete kryerja e një sjellje. (Ajzen &amp; J.Madden,1986:457).</p>
<p>Diffusion of Innovations Theory (DOI)</p>	<p>Konstruktet bazë</p>	<p>Definicioni</p>
<p>Diffusion of Inovation Theory është teori sociologjike që merret me mënyrën në të cilën një inovacion migron prej krijimi deri ne përdorim. (Sawalha &amp; Abu-Shanab, 2015:58). DOI është një nga modelet me të përdorura në fushën e difuzionit dhe adaptimit te teknologjisë( Ismail</p>	<p>Avantazhi Relativ(ang.Relative Advantage-RA)</p>	<p>Është shkalla në të cilën një inovacion është perceptuar si më i dobishëm dhe më i mire se sa ideja /produkti që e zëvendëson, në aspektin ekonomik, status-shoqëror, komoditet dhe</p>

<p>Sahin, 2006:14).</p> <p>E zhvilluar nga Rogers, sipas kësaj teorie, shpjegues më të mire të shkallës së adaptimit të një inovacioni janë pesë karakteristikat e inovacioni : Avantazhi relativ, Kompleksiteti, Kompatibiliteti, Provueshmëria dhe Dallueshmëria) ( M.Rogers, 1995:15-16).</p> <div data-bbox="164 536 579 833" data-label="Diagram"> <pre>             graph LR             RA[Relative Advantage] --&gt; A[Adoption]             C[Compatibility] --&gt; A             CO[Complexity] --&gt; A             T[Trialability] --&gt; A             O[Observability] --&gt; A             </pre> </div> <p>Figure 4. Diffusion of Innovation Theory(Turan &amp; Tunç, &amp; Zehir, 2015:46).</p> <p>DOI është rafinuar nga Moore &amp; Benbasat (1991), të cilët modelit baze i shtuan edhe dy përcaktues: Imazhin(ang.Image) dhe Vullnetarizmi(ang.Voluntarism)</p>	<p>performance.</p> <p>(M.Rogers, 1995:15).</p> <p>Kompleksiteti (ang. Complexity- C)</p> <p>Provueshmëria( ang. Trialability- TRI)</p> <p>Dallueshmëria (ang.Observability OBV)</p> <p>Kompatibiliteti (ang. Compatibility-COM)</p>	<p>performance.</p> <p>(M.Rogers, 1995:15).</p> <p>Është shkalla në të cilën inovacioni është perceptuar si i vështirë i për t'u kuptuar dhe përdorur nga adaptuesit potencial. (M.Rogers, 1995:15).</p> <p>Është shkalla në të cilën një inovacion mund të provohet në baza të limituara përpara se të implementohe. ( M.Rogers, 1995:16).</p> <p>Është shkalla në të cilën rezultate e inovacionit mund të dallohen lehtë nga të tjerët, dhe se individit lehtësisht mund të diskutoje dhe të prezantoje idenë e re tek koleget shokët ose anëtarët e familjes ( M.Rogers, 1995:16).</p> <p>Kompatibiliteti është shkalla në të cilën një inovacion është perceptuar se është në përputhje me normat dhe vlerat e sistemit shoqëror, eksperiencat e kaluara dhe nevojat e adaptuesve potencial. ( M.Rogers, 1995:16).</p>
--	--	---

Unified Theory of Acceptance and Use of Technology (UTAUT)	Konstruktet bazë	Definicioni
<p>Në përpjekje për të gjetur një metodë të unifikuar për të vlerësuar suksesin e mundshëm të një teknologjie të re të lansuar dhe për të identifikuar se çfarë i shtynë përdoruesit drejt pranimit të kësaj teknologjie, autorët Viswanath Venkatesh, Michael G. Morris, Gordon B. Davis dhe Fred D. Davis (në vitin 2003), bënë një krahasim empirik të tetë modeleve: 1. Theory of Reasoned Action (TRA), 2. The Technology Acceptance Model (TAM), 3. The Motivational Model (MM), 4. The Theory of Planned Behavior (TPB), 5. A model combining the TAM and TPB (C-TAM-TPB), 6. The model of PC utilization (MPCU), 7. The Innovation Diffusion Theory, dhe 8. Social Cognitive Theory.</p>	<p>Pritshmëria në performancë (ang. Performance Expectancy-PE)</p>	<p>Definohet si shkalla në të cilën një person beson se përdorimi i sistemit do të sjellë dobi në performancën e punës. (Venkatesh, G. Morris, B. Davis, D. Davis, 2003: 447)</p>
<p>Ata analizuar tetë modelet, përfshirë edhe zgjerimet e tyre dhe duke konsoliduar elementet themelore nga këto modele formuluan një model të unifikuar të quajtur: Unified Theory of Acceptance and Use of Technology (UTAUT) (Venkatesh, G. Morris, B. Davis, D. Davis, 2003: 467).</p>	<p>Pritshmëria në përpjekje (ang. Effort Expectancy-EE)</p>	<p>Definohet si shkalla e lehtësisë në të cilën personi beson se do të hasë në lidhje me përdorimin e sistemit. (lehtësia e përdorimit të sistemit). (Venkatesh, G. Morris, B. Davis, D. Davis, 2003: 450)</p>
<p>UTAUT përmban katër konstrukt kyçës, tre nga të cilët janë përcaktues direkt të "Intention to use" si: Pritshmëria në performancë (ang. Performance Expectancy), Pritshmëria në përpjekje (ang. Effort Expectancy) dhe Ndikimi Social (ang. Social Influence), dhe i katërti "Rrethanat ndihmese (ang. Facilitation Conditions)" - përcaktues direkt ne</p>	<p>Ndikimi Social (ang. Social Influence-SI)</p>	<p>Definohet si shkalla në të cilën një individ percepton se personat të cilët janë të rëndësishëm për të mendojnë se ai/ajo duhet të përdor sistemin e ri. (Venkatesh, G. Morris, B. Davis, D. Davis, 2003: 452)</p>
	<p>Rrethanat ndihmese (ang. Facilitation Conditions-FC)</p>	<p>Definohet si shkalla në të cilën një individ beson se ekziston infrastruktura organizative dhe teknike për të mbështetur përdorimin e sistemit (Venkatesh, G. Morris, B. Davis, D. Davis, 2003: 452)</p>



<p>“Use Behavior”.</p> <p>Gjithashtu në model integrohen edhe katër moderues: Eksperienca, Gjinia, Moshja dhe Vullnetarizmi, te cilët moderojnë ndikimin e katër konstruktorëve kyçës në “Behavioral Intention” dhe “ Use Behavior”</p>  <p>Fig.5. Unified Theory of Acceptance and Use of Technology. (Venkatesh, G. Morris, B. Davis, D. Davis, 2003:447)</p>		
--	--	--

Studimi i punës se deritanishme në fushën e pranimit dhe adoptimit të m-Government vë në pah se TAM është një nga modelet me te përdorura në shumicën e këtyre studimeve i integruar me teori tjera dhe/ose i zgjeruar me varibla shtesëm. (Abdelghaffar & Magdy, 2012:333-341; Al-Busaidi, 2012:1-213; Almarashdeh & Alsmadi, 2017: 194-199; Abu-Shanab & Haider, 2015: 223-240; Alotaibi & Roussinov, 2016: 746- 752; Almuraqab & Jasimuddin, 2016:1-12; Al-Hujran & Migdadi, 2013: 242-463; Almuraqab & M. Jasimuddin, 2017:11-23; Liu, Li, Kostakos, Goncalves, Hosioa & Huc, 2014:432-442; Shareef, Archer & K. Dwivedi, 2015:39-49; Althunibat, A. Alrawashdeh & Muhairat, 2014 :733-740; Althunibat, Zain & Sahari @Ashaari, 2011:13030-13043; Sultana & Ahlan, 2014:1-19; Osman, 2013:1-8; Almuraqab, Jasimuddin & Mansoor, 2017:14-19; Alloghani, Hussain, Al-Jumeily & Abuelma'atti, 2015:1-6; Babullah, Dwivedi & Williams, 2015; Sultana, Ahlan & Md. Habibullah, 2016: 49-60; Hung, Chang & Kuo, 2013: 33–44)

Rekomandim i shume studiuesve është që modeli TAM të integrohet me teori të tjera që të mund të përballoje ndryshimet e shpejta në IS/TI. Studiuesit, zgjerimin e TAM e vlerësojnë të nevojshme për ta përshtatur atë për natyre e veçantë të sistemeve mobile qeveritare dhe për të përmirësuar specifikat dhe fuqinë shpjeguese të modelit.

## Zhvillimi i modelit konceptual dhe metodologjia

Pas rishikimit të teorive/modeleve të mësipërme dhe studimeve të bëra në fushën e adaptimit të m-Government, ne zhvilluam modelin tone (fig.6), duke integruar dy teoritë më të rëndësishme në të kuptuarit e adaptimit, pranimit dhe përjashtimit të një inovacioni teknologjik: Technology Acceptance Model (TAM) dhe Innovation Diffusion Theory (IDT) përfshirë edhe dy variabla të derivuara nga literatura e studiuar si: “Imazhi i perceptuar” dhe “Besueshmëria e perceptuar”, të gjitha këto në një model të vetëm.

Si baze e modelit është aplikuar TAM, nga i cili model janë inkorporuar dy konstruktet “Dobia e Perceptuar” dhe “Lehtësia e perceptuar e përdorimit”. Nga DOI janë përfshirë në model tre konstruktet: “Kompatibiliteti”, “Provueshmëria” dhe “Dallueshmëria”, ndërsa dy variablet tjera si: “Imazhi i perceptuar” dhe “Besueshmëria e perceptuar”, janë derivuar nga literature e studiuar.

Konstrukti ‘Intention to Use’ është përdorur si variabël kryesore e varur për të matur qëllimin/synimin e qytetareve për të përdorur mSMAD.




Fig. 6. Modeli konceptual.

Imazhi definohet si “Shkalla në të cilën përdorimi i një Inovacioni perceptohet se do ta përmirësojë Imazhin ose statusin në një sistem shoqëror” (Moore & Benbasat 1991:195).

Një sistem i cili perceptohet nga përdoruesit se mund të ndikojë në rritje të imazhit ka shumë mundësi të pranohet më lehtë nga përdoruesi.

Besueshmëria e perceptuar, është besimi i përdoruesit në atë se shërbimi i caktuar nuk përben kërcënim të sigurisë dhe privatësisë (Abdelghaffar & Magdy, 2012:335). Në shumicën e vendeve në zhvillim, besimi tek institucionet qeveritare është i zbehur, veçanërisht në ato vende që nuk kanë stabilitet politik dhe me nivel të lartë të korrupsionit (Sultana, Ahlan & Md. Habibullah, 2016:56), prandaj ka shumë mundësi që pavarësisht përfitimeve që mund të sjellë një shërbim, ai mund të mos pranohet nga përdoruesit e synuar për shkak të mungesës së besimit ndaj Organizatës që ofron shërbimin.

Për të testuar variablat në modelin e hulumtimit kemi propozuar hipotezat e mëposhtme:

H1: Dobia e perceptuar e mSMAD ka efekt pozitiv në ITU mSMAD.

H2: Lehtësia e perceptuar e përdorimit të mSMAD ka efekt pozitiv në ITU mSMAD.

H3: Lehtësia e perceptuar e përdorimit e mSMAD ka efekt pozitiv në Dobinë e perceptuar të mSMAD.

H4 Kompatibiliteti i perceptuar i mSMAD ka efekt pozitiv në ITU mSMAD.

H5: Provueshmëria e perceptuar e mSMAD ka efekt pozitiv në ITU mSMAD.

H6 Dallueshmëria e perceptuar e mSMAD ka efekt pozitiv në ITU mSMAD.

H7 Imazhi i perceptuar i mSMAD ka efekt pozitiv në ITU mSMAD.

H8 Besueshmëria e perceptuar e mSMAD ka efekt pozitiv në ITU mSMAD.

Për testimin modelit konceptual do të përdoren të dhënat sasiore që do të mbliidhen përmes një pyetësoi i përberë nga dy seksione. Pjesa e pare do të grumbullon të dhënat faktike në lidhje me karakteristikat demografike të anketuarve, të dhënat nëse me parë kanë përdorur shërbime elektronike qeveritare, si dhe preference e tyre në lidhje me kanalet e komunikimit përmes të cilëve do të informohet rreth mSMAED, që do të ishin me bindëse. Pjesa e dyte mbledhë të dhëna për perceptimet/besimet e të anketuarve në lidhje me përdorimin e mSMAD, për të parashikuar ITU. Në ndërtimin e pyetësorit janë shfrytëzuar matësit ekzistuese të cilat janë validuar në hulumtimet paraprake. Dy matësit për TAM: PU, PEOU janë importuar nga Davis(1989), kjo për arsye se këto matës jo vetëm që janë validuar në hulumtimet paraprake, por validitetin dhe besueshmërinë e tyre e ri-konfirmojnë edhe Moore& Benbasat.( Moore& Benbasat, 1991:2010). Matësit për DOI(TRI, COM, OBV) dhe Imazhi janë adaptuar prej Moore& Benbasat(1991), ndërsa matësi për Besueshmëri është adaptuar nga Bélanger & Carter (Bélanger & Carter 2008).

Pyetësoi është në ndërtim e sipër. Përpara se pyetësor të vihet në dispozicion në internet do të nënshtrohet një testimi paraprak(pilot-test).

### Konkluzion

Pas rishikimit të modeleve/teorive ekzistuese në adaptimin e një teknologjie të re dhe studimeve të bëra në lidhje me pranimin dhe përdorimin sistemeve m-Government, kemi identifikuar si nevojë emergjente investigimin e faktorëve që mund të ndikojnë në vendimin e qytetarëve kosovar për të pranuar ose refuzojnë një sistem të ri mobil qeveritar.

Ky hulumtim është fokusuar në zhvillimin e një modeli konceptual që mund të shfrytëzohet për të vlerësuar gatishmërinë e përdoruesve të synuar për të adaptuar shërbimet mobile qeveritare. Korniza konceptuale e propozuar integron dy modelet të mirënjohura TAM dhe DOI, si dhe variablat e jashtëm "Imazhi" dhe "Besueshmëria" në një model të vetëm.

Gjate këtij studimi identifikohen shtate variabla që mund të ndikojnë adoptimin e sistemeve mobile qeveritare(PU, PEOU, TRI, OBV, COM, Imazhi dhe Besueshmëria). Të kuptuarit e faktorëve të tilla është shumë e rëndësishme për qeverinë që të gjejë mënyra për të inkurajuar konsumimin e këtyre shërbimeve nga përdoruesit e synuar, në mënyrë që investimi në adaptimin e teknologjive mobile në shërbimet qeveritare të jetë fitimprurës dhe i sigurtë si dhe të zhvillojë strategji që të adresojë me kohe pengesat për një implementim gjithëpërfshirës të shërbimeve të reja. Përveç kësaj hulumtimi ynë synon të kontribuojë në literaturën ekzistuese m-G në përgjithësi dhe adoptimin/pranimin e m-G në veçanti.

## Referencat

- Abdelghaffar.H & Magdy.Y(2012), "The Adoption of Mobile Government Services in Developing Countries The Case of Egypt", International Journal of Information and Communication Technology Research, Volume 2, No. 4.pp.(333-341).
- Abu-Shanab.E & Haider.SH (2015), "Major factors influencing the adoption of m-government in Jordan", Electronic Government, an International Journal, Volume 11, Issue 4, pp.(223-240).
- Ajzen.I & Madden.J.TH (1986),"Prediction of Goal-directed Behavior: Attitudes, Intention and Perceived Behavioral Control", Journal of Experimental Social Psychology 22, pp.(453-473).
- Al-Busaidi.H.A.S (2012), "A Model of Intention to Use Mobile Government Services",pp. (1-213). [https://books.google.com/books/about/A\\_Model\\_of\\_Intention\\_to\\_Use\\_Mobile\\_Gover.html?id=f1GIAQAACAAJ](https://books.google.com/books/about/A_Model_of_Intention_to_Use_Mobile_Gover.html?id=f1GIAQAACAAJ)
- Al-Hujran.O & Migdadi.M, (2013),"Public Acceptance of M-Government Services in Developing Countries: The Case of Jordan", E-Government Implementation and Practice in Developing Countries , Copyright © 2013, IGI Global, pp.(242-463).
- Almarashdeh.I & Alsmadi.M.K(2017)," How to make them use it? Citizens acceptance of M-government", Applied Computing and Informatics, Volume 13, Issue 2, July 2017, pp.(194-199).
- Almuraqab.N.S&Jasimuddin.S&Mansoor.W(2017),"Mobile government (mGovernment) Adoption factors in the UAE: A conceptual Framework based on UTAUT", International Journal of Engineering Technology, Management and Applied Sciences, Volume 5 Issue 3, pp.(14-19).
- Almuraqab.N.S & Jasimuddin.S.M (2016),"A literature survey of m-government services adoption: Lessons for a smart city Success", GCC Smart government & Smart cities conference, At Dubai, UAE, Volume: 22, pp.(1-12).
- Alotaibi.S, & Roussinov.D(2016) "Developing and Validating an Instrument for Measuring Mobile Government Adoption in Saudi Arabia", International Journal of Social, Behavioral, Educational, Economic, Business and Industrial Engineering Vol:10 No: 3, pp.(746-752).
- Althunibat.A & Alrawashdeh.TH.A & Muhairat.M,(2014) "The Acceptance of Using M-Government Services in Jordan" Journal of Theoretical and Applied Information Technology. Vol.63, No.3, pp(733-740).
- Althunibat.A & Zain.N.A.M & Sahari.N @Ashaari (2011), "Modelling the factors that influence mobile government service acceptance" African Journal of Business Management Vol. 5(34), pp.(13030-13043).
- Alloghani.M & Hussain.A & Al-Jumeily.D & Abuelma'atti.O(2015)," Technology Acceptance Model for the Use of M-Health Services among health related users in UAE", International Conference on Developments of E-Systems Engineering (DeSE)/58, pp.(1-6).
- Babullah.A & Dwivedi.Y & Williams.M(2015), "Saudi Citizens' Perceptions on Mobile Government (mGov) Adoption Factors", UK Academy for Information Systems Conference Proceedings 2015. 8. <http://aisel.aisnet.org/ukais2015/8>
- BÉLANGER, F. & CARTER, L. 2008. Trust and risk in e-government adoption. *The Journal of Strategic Information Systems*, 17, 165-176.
- Chuttur .M. (2009). "Overview of the Technology Acceptance Model: Origins, Developments and Future Directions ," Indiana University, USA . Sprouts: Working Papers on Information Systems, pp.(9-37).
- D.Davis.F(1993) User acceptance of Information Technology:system characteristics,user perceptions and behavioral impact, International Journal of Man-Machine Studies, Volume 38, Issue 3, pp.(475-487).
- Davis..D.F & Bagozzi.P.R & Warshaw.R.P (1989)," User acceptance of computer technology: A comparison of two theoretical models" Management Science, Vol.35. No. 8, Printed in USA, pp. (982-1003).
- Davis.D.F, (1989) "Perceived usefulness, perceived ease of use, and user acceptance of information technology," MIS quarterly, pp. (319-340).
- Fishbein.M & Icek Ajzen.I(1975), "Belief, Attitude, Intention, and Behavior: An Introduction

to Theory and Research". Reading, MA: Addison-Wesley. <http://people.umass.edu/aizen/f&a1975.html>

- Hung.S.H.Y & Chang.C.H.M & Kuo.S.H.R(2013)," User acceptance of mobile e-government services: an empirical study". *Government Information Quarterly*, 30(1), pp.(33–44).
- Kushchu.I & M. Halid Kusc.H (2004)." From e-Government to m-Government: Facing the Inevitable", *Mobile Government Lab (mGovLab)*, pp.(1-12).
- Liu.Y & Li.H & Kostakos.V & Goncalves.J & Hosioa.S & Huc.F, (2014)" An empirical investigation of mobile government adoption in rural China: A case study in Zhejiang province", *Government Information Quarterly*, pp.(432-442).
- Madden.J.TH, Ellen.S.P & Ajzen.I(1992), "A Comparison of the Theory of Planned Behavior and the Theory of Reasoned Action". *Personality and Social Psychology Bulletin*. Published by: SAGE Publication.
- Moore.C.G & Benbasat.I(1991), "Development of an Instrument to Measure the Perceptions of Adopting an Information Technology Innovation", *The Institute of Management Sciences*, pp(192-222).
- OECD/ITU (2011)." M-Government: Mobile Technologies for Responsive Governments and Connected Societies", OECD Publishing. [Online] Available: <http://dx.doi.org/10.1787/9789264118706-en>
- Osman.N.B(2013)," Extending the Technology Acceptance Model for Mobile Government Systems", *The International Arab Conference on Information Technology (ACIT'2013)*, <http://acit2k.org/ACIT/2013Proceedings/191.pdf>
- Rogers.M.E(1995),"Diffusion of Innovations, Fourth Edition" The Free Press, A Division of Simon & Schuster Inc. New York.
- Sahin.I (2006), "Detailed review of Rogers' Diffusion of Innovations Theory and educational technology-related studies based on rogers' theory", *The Turkish Online Journal of Educational Technology – TOJET* , volume 5 Issue 2 Article 3. pp(14-23).
- Sawalha.D & Abu-Shanab.E,(2015)," Financial Information Systems in Governments: Is it accepted by Public Employees?", *International Arab Journal of e-Technology*, Vol. 4, No. 2, pp.(57-66).
- Sultana.R & Ahlan.A.R & Md. Habibullah(2016)," A Comprehensive Adoption Model Of Mgovernment Services Among Citizens In Developing Countries,*Journal of Theoretical and Applied Information Rechnology*, 15th, Vol.90,No.1, pp.(49-60).
- Sultana.R & Ahlan.A.R(2014),"Understanding Citizen's Intention to Use Mobile Government Services in Bangladesh: Role of Perceived Good Governance and Less Corruption" , Conference paper: *International Conference on Governance and Innovation (GAIN2014)*, pp.(1-19).
- Shareef.M.A & Archer.N & Dwivedi.Y.K (2015), "Examining Adoption Behavior of Mobile Government", *Journal of Computer Information Systems*, Volume 53, Issue 2, pp.(39-49).
- Turan.A & Tunç.Ö.A, & Zehir.C(2015)," A Theoretical Model Proposal: Personal Innovativeness and User Involvement as Antecedents of Unified Theory of Acceptance and Use of Technology", *4th International Conference on Leadership, Technology, Innovation and Business Management*. pp(43-52).
- Venkatesh.V& Davis.D.F (2000), "A Theoretical Extension of the Technology Acceptance Model: Four Longitudinal Field Studies", *Management Science* © 2000 INFORMS Vol. 46, No. 2, pp. (186 –204).
- Venkatesh.V, Morris.G. M, Davis.B.G & Davis.D.F, (2003), "User Acceptance of Information Technology: Toward a Unified View", *MIS Quarterly*, Vol. 27, No. 3 pp.(425-478).

## Rehabilitimi i një populli pas përjetimit të traumës kërkon rregullimin e mirëqenies socio-ekonomike dhe sundimin e ligjit në vend: Shembulli i Kosovës

Edona Berisha Kida

Departamenti i Psikologjisë/Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës


### Abstrakt

Dukuria e emigracionit në Kosovë ka qenë e motivuar kryesisht nga arsye ekonomike, me përjashtim të eksodit të refugjatëve si rezultat i konfliktit dhe luftës në fund të viteve 1990 prej nga shumica e të ikurve u riatdhesuan me vetdëshirë menjëherë pas stabilizimit të gjendjes; Por, zhvillimet e fund vitit 2014 dhe fillimit të vitit 2015 kanë alarmuar politikëbërësit vendor dhe ata të Bashkimit Evropian (BE-së). Më shumë se 100,000 kosovarë kaluan kufirin e BE-së në mënyrë jo të rregullt, shpesh duke përdorur sistemin e azilit si mënyrën e vetme për të siguruar qëndrim në BE. Gjendja e rëndë ekonomike, mungesa e mirëqenies sociale, papunësia janë disa nga faktorët që i janë atribuar arsyeve se pse shumë kosovarë ndjekën rrugët ilegale për të migruar në vendet e Bashkimit Evropian. Sidoqoftë deri më tani asnjë kritikë e lere më studim, nuk ka provuar të tërheq një paralele në mes të të ashtuquajturit “Eksod socio-ekonomik” dhe rrjedhës-akumulimit të traumës pas përfundimit të luftës. Ky studim i natyrës cilësore, me qasje fenomenologjike tenton të kuptoj esencën e traumës kulturore të manifestuar përmes një eksodi të dytë brenda 15 vitesh.

**Fjalët kyçe:** Imigracioni kosovar, eksod, luftë, traumë, mirëqenie socio-ekonomike.

### Hyrje


Pjesa më e madhe e emigracionit Kosovar ka qenë e motivuar nga arsye ekonomike dhe nga konflikti i armatosur në fund të viteve 1990. Migrimi me paratë e dërguara nga diaspora kanë qenë një valvul sigurimi për familjarët që janë lënë prapa në Kosovë, duke siguruar jetesën e tyre në një vend që edhe sot ka papunësinë dhe normat e varfërisë ndër më të lartat në Evropë (Banka Botërore, 2011;ESI, 2015). Arsyeja kryesore për largim nga Kosova është konstatuar të jetë “punësimi”. Sidoqoftë, më parë lufta ishte një shkak madhor i migrimit (UNDP, 2014). Varijimi ndër vite i faktorëve kryesor që kanë kontribuar në migrim është paraqitur në figurën e mëposhtme (ASK, 2014).



### Figura1. Arsyet kryesore te migrimet Kosovar (ASK, 2014)

Sipas të dhënave zyrtare nga regjistrimi i popullsisë, në total numri i personave (vetëm të lindurit në Kosovë) të emigruar nga Kosova ishte 380,826 persona. Sipas këtyre të dhënave, në raport me popullsinë rezidente në Kosovë, u konstatua se 21.4 % e popullsisë jetonte jashtë vendit (ASK, 2014).

Historikisht Kosova është njohur me emigrimin për shkaqe ekonomike. Për shkak të zhvillimit të ultë dhe pamundësisë së punësimit, pjesëtarë nga zonat rurale janë detyruar të punojnë jashtë vendit për t'iu siguruar mbijetesën familjarëve të tyre. Në tregimet, këngët dhe poezitë popullore migrimi është cituar si ekuivalent i vuajtjes. Thëniet dhe këngët popullore me vargjet “Të ndarë dhe në azil, për vetëm një dinar”, “Ai që nuk ka njohur vuajtjen e migrimet nuk e di çka është jeta”, “Kush i pari bani kurbetin, atij Zoti kurrë mos ia dhashtë selametin” janë të kënduara brez pas brezi në vend (ESI,2015). Sidoqoftë, nga të dhënat e Agjensionit Kosovar të Statistikave në figurën 2 të vendosur më poshtë, vërehet një dallim në rrjedhën e emigrimit. Në vitet 1998-1999 shihet pika kulmore e valës së emigrimit e cila për nga natyra dallon nga emigrimi i mëhershëm ekonomik. Kjo pikë kulmore ishte rezultat i Eksodit Kosovar në periudhën e luftës së fundit. Mirëpo, menjëherë me stabilizimin e situatës në vend, kjo amplitudë bie në mënyrë drastike në vitet 2000. Karakteristikë e veçantë e periudhës 1999-2000 u bë edhe fluksi i kthimit me vetëdëshirë, gjë që për dallim nga rastet e ngjashme të emigrimit në baza lufte (si për shembull krahasuar me rastin e Bosnës dhe Hercegovinës), kjo dukuri u raportua të ketë çuditur opinionin ndërkombëtar (ASK, 2014)..



### Figura 2. Emigrimi sipas viteve 1969-2010 (ASK, 2014)

Fundi i epokës së emigrimit masiv ishte natyrisht reflektim i një zhvillimi pozitiv, e që kishte të bënte me fundin e represionit politik në Kosovë. Me marrjen e udhëheqësisë së institucioneve vendore dhe daljen nga një situatë e rëndë konflikti ndëretnik, kosovarët i ngjallën shpresat për një jetë më të mire. Megjithatë, 15 vitet e pas luftës nuk treguan ndonjë ndryshim të rëndësishëm në situatën e përgjithshme ekonomike në Kosovë (ESI, 2015) dhe si rezultat, në mënyrë të pakontrolluar dhe jo shumë të parashikuar, ndodh edhe një fluks i emigrimit të cilin mediat dhe analistët e quajtën “Eksodi i madh socio-ekonomik i kosovarëve”.

### Problematika për studim

Lufta në Kosovë ka pasur një ndikim të thellë në jetën e popullatës civile. Ajo ishte shkak i kryesor i shkatërrimit material, social dhe shëndetësor. Mizoritë e luftës gjatë

periudhës 1998 -1999, u vlerësua të ishin: 11.840 viktima, 1450 të humbur, 20400 femra të dhunuara, 863,000 civilë të larguar si refugjatë jashtë Kosovës, 590,000 civilë të zhvendosur brenda vendit dhe shume raste te tjera (Kienzler,2010; Osman, 2013). Me përfundimin e luftës, duke qenë në protektorat ndërkombëtarë, Kosova dhe populli i saj me entuziazëm dhe shpresë, filluan fazën e rindërtimit, rehabilitimit dhe reformimit. Kosova hyri në një tranzicion të përgjithshëm institucional e socio-ekonomik i cili rezultoi të ishte kronologjikisht i gjatë dhe nuk përfundoi por u intensifikua me shpalljen e Pavarësisë së vitit 2008. Situata ekonomike në vend vazhdon të jetë sfiduese. Kosova aktualisht mbetet ndër vendet më të varfëra në Evropë, ku 18% e popullatës jeton në varfëri ekstreme me 0.90 euro në ditë, ndërsa 60 për qind e të varfërve janë deri në moshën 30 vjeçare (SOK, 2011; WorldAtlas, 2017). Varfëria, si shkaktar i njohur i emigrimit, edhe kësaj radhe u konsiderua të jetë shkaktari kryesor për eksodin e fundit, i cili u bë lajmi më bombastik i fund vitit 2014 dhe fillim vitit 2015 në Evropë. Më shumë se 100,000 kosovarë kaluan kufirin e BE-së në mënyrë jo të rregullt<sup>1</sup>, shpesh duke përdorur sistemin e azilit si mënyrën e vetme për të siguruar qëndrim në BE (RTK, 2015). Situatën alarmante e raporton edhe Ministria e Arsimit në Kosovë e cila deklaroi se nga dhjetori 2014, 5200 nxënës kishin braktisur shkollën për t'iu bashkuar familjeve në emigrim (RTK, 2015) (Alexander, H. 2015). Në figurën e mëposhtme paraqitet rruga ilegale të cilën e ndiqnin këto familje për të arritur në vendet Evropiane.




Figura 3. Rruga e migrimit ilegal për në BE 2014-2015 (Alexander, 2015).  
Meqë fenomeni i emigrimit si rezultat i varfërisë nuk është i panjohur për kosovarët, e mistershme për njerëzit që nuk menduan të largohen por edhe për institucionet

<sup>1</sup> Kosova është i vetmi vend në Evropën jug-lindore që nuk posedon lëvizje të lirë në vendet e Evropës



e vendit ishte arsyeja pse të emigrohet tani dhe me një hov kaq të madh (EurActiv, 2015). Pse pikërisht tani fenomeni i emigrimit po funksiononte sipas efektit të topit të borës përderisa situata ekonomike ishte thujt e njejtë edhe në vitet e mëhershme? Lider politik, analist të ndryshëm e media i dhanë pasqyrë politike këtij fenomeni, duke varijuar si palë me akuza të ndryshme ndaj njëra tjetrës (prej arsyetimit me keqpërdorimin e marrëveshjes për lëvizje të lirë nga ana e Serbisë (Rusila, 2015) e deri te akuzat se populli i Kosovës dëshiron të ketë shtet Serbinë meqë kërkon të pajiset me dokumente udhëtimi nga ky vend (RTK, 2015).

Nga konteksti ekonomik, vlerësimet e situatës reale në teren treguan se kompani e punëdhënës të ndryshëm kishin filluar të mbeten pa punëtorë. Pra, nuk iknin vetëm personat e papunë por edhe ata që punonin. U raportuan raste të personave me pagë rreth 600 Euro (e cila konsiderohet një pagë mesatarisht e lartë për standardin e Kosovës) që braktisën vendin. Sipas një analize realizuar nga Radio Televizioni i Kosovës (RTK, 2015), të ardhurat personale të punonjësve të sektorit publik në Kosovë, ishin mesatarisht 100 euro më të larta se në vendet fqinje (Serbi, Mal i Zi, Maqedoni dhe Shqipëri). Pavarësisht kësaj, emigracioni po ndodhte dhe Kosova sërish po figuronte si vendi më i varfër në rajon (RTK, 2015; WorldAtlas, 2017).

Pra, të dhënat e listuara më lartë reflektojnë se një eksod masiv si ai i fund vitit 2014 dhe fillim vitit 2015 nuk u shkaktua vetëm nga situata e rëndë ekonomike por edhe nga korrupsioni e krimi i organizuar, dështimi i misionëve ndërkombëtare dhe atyre vendore për të vendosur sundimin e ligjit, situatat kaotike politike që stagnonin funksionimin e mirëfilltë të institucioneve vendore, shpërthimi i kohëpaskohshëm i protestave në baza etnike apo edhe arsye të tjera.

Atëherë në kontekstin psikologjik, do të kërkonim reflektim mbi hipotezën nëse kjo periudhë tranzicionale e zgjatur dhe keq adresuar (efektet e ndryshme të ngjarjeve e fenomeneve të përmendura më lartë), kanë rënduan mirëqenien psikologjike të popullit në Kosovë, aq sa të mjaftonte vetëm një thashetheme se kinse Evropa ka hapur kufijtë dhe ata të bënin torbat gati për emigrim?

### Qëllimi i studimit

Studimi aktual synon ofrimin e të dhënave kualitative të lidhura me eksperiencat specifike traumatike dhe me stresorët e ndryshëm jetësorë të cilët e pasojnë situatën traumatike në një vend. Studimi synon të adresoj akumulimin e traumës dhe efektet e saj në një popullatë të veçantë. Më konkretisht, qëllimi i këtij studimi është që të tërheq një paralele në mes të dy eksodeve masive në Kosovë, eksodit të dhunshëm të vitit 1999 dhe atij “të vullnetshëm” të vitit 2014-2015. A ekzistojnë faktor psikologjik si ata që kanë të bëjnë me traumën dhe akumulimin e saj, të cilët shtyjnë individë në reagime të tilla “kërkim shpëtimi” (si ne rastin e eksodit të fundit). Shumë burime konstatuan se bazë e gjithë asaj ikjeje të fund vitit 2014 dhe fillim vitit 2015 ishin kushtet e mjerueshme socio-ekonomike por edhe humbja e besimit në shtetin e Kosovës (EurActiv, 2015; RTK, 2015; Rusila, 2015), sepse edhe para shpalljes së pavarësisë edhe pas shpalljes së saj mungonte adresimi i mirëfilltë i çështjeve elementare dhe problemeve fundamentale me të cilat ballafaqohej populli i Kosovës. Atëherë, sa është e mundur që situata e mjerueshme e para shpalljes së Pavarësisë të jetë e lidhur me rënkimin e vuajtjeve të luftës dhe shpresën për ditë më të mira në rast të krijimit të

shtetit për të cilin ishte luftuar? Pra, a ka mundësi që trauma psikologjike e përjetuar nga lufta të jetë menaxhuar individualisht përmes reliziences dhe rritjes/pjekurisë pas-traumatike (post-traumatic growth) duke poseduar shpresën për ditë më të mira dhe duke synuar shpalljen e Pavarësisë së vendit si pikësynim mbarë popullor. A është e mundur që ngarkesa traumatike (traumatic load) të ketë intensifikuar efektin e funksionimit veçanërisht pas shpalljes së Pavarësisë së vitit 2008? Për shembull, si ndryshon kualiteti i përjetimit të eksperiencave të ngjashme të varfërisë në vitet para dhe pas shpalljes së Pavarësisë? A është eksodi i fundit një reagim impulsiv traumatik që vjen si rezultat i akumulimit të të gjitha këtyre pakënaqësive dhe stresorëve të një pas njëshëm?

### Rëndësia e studimit

Përshkrimet konkrete mbi efektet e traumës në popullatën e Kosovës dhe lidhjet e mundshme me rrethanat shoqërore, mbështetjen sociale në përgjithësi dhe statusin ekonomik e politik në veçanti, janë të rëndësishme bazuar në disa arsye:

1. Rezultatet që vijnë nga një vend origjine ku ka ndodhur situata traumatike dhe ku çështjet pasuese politike, socio-ekonomike e kulturore merren në konsideratë, shërbejnë si asete shtesë për literaturën e përgjithshme mbi traumën. Ato i shërbejnë veçanërisht elaborimit të mëtutjeshëm të konceptit “akumulim traume” (traumatic load) në fushën e psikologjisë klinike mbi traumën (Kolassa, I.T, Kolassa, S., Ertl, V., Papassotiropoulos, A., De Quervan, D.J., 2010) (Wilker, S., Pfeiffer, A., Kolassa, S., Koslowski, D., Elbert Th., Kolassa, I.T, 2015) (Neuner, F., Schauer, M., Karunakara, U., Klaschik, Ch., Robert, Ch., Elbert, Th., 2004).
2. Njohjet e tilla të akumulimit të traumës janë të rëndësishme për të avancuar qasjet e ndërhyrjeve psiko-sociale (këshilluese) në trajtimin e Çrregullimit të Stresit Pas Traumatik krahasuar me ndërhyrjet vetëm klinike<sup>o</sup>,
3. Studimi ofron një perspektivë edhe mbi faktorët e bartjes së traumës nga gjenerata në gjeneratë dhe krijimi i një traume kulturore, çfarë kërkon të adresohet në rrafshin praktik të eliminimit të stresorëve të drejtpërdrejte.

### Përspektiva teorike

Literatura moderne identifikon katër faza të në të cilat eksperiencia e mundshme traumatike mund të qoj deri te shqetësimet e mëdha psikologjike:

1. Trauma para migrimit (ngjarjet dhe stresorët e përjetuar para migrimit),
2. Ngjarjet traumatike të përjetuara gjatë tranzicionit për në vendin e synuar,
3. Vazhdimi i eksperiencave traumatike gjatë fazave të azil kërkimit, dhe
4. Kushtet jo të mira jetësore dhe diskriminimi. (Foster, P.R 2001).

Një studim i bërë në 447 refugjatë të Azisë juglindore, tregon se faktorë më parashikues për çrregullime psikologjike janë eksperiencat traumatike para migrimit dhe ato pas migrimit të cilat zakonisht lidhen me kushtet e vështira ekonomike (Foster, 2001)(Pfarrëaller. & Suris, 2012).

Në paralelen në mes të dy eksodeve të popullatës së Kosovës, në rastin e parë ekziston përjetimi i situatave ekstreme traumatike që lidhen me luftën dhe largimin masiv si refugjatë, ndërsa në rastin e dytë ekziston ikja nga kushtet e rënda politike, socio-

ekonomike dhe ballafaqimi me situata traumatike të përjetuara gjatë këtij largimi. Në njëfarë mënyre në nivel të masës ekziston një duplikim i ngarkesës traumatike. Ndërsa literatura moderne mbi traumën kolektive tutje thotë se sistemet sociale të çfarëdo niveli të funksionimit nuk mund të krijojnë efektin e traumës kolektive pa u shënduar ndenja e humbjes së shpresës në diçka kulturore për atë shoqëri (Alexande J.C., Eyerman, R., Giesen, B., Smelser, N.J, Sztompka. J, 2004) gjë që ia vlen të eksplorohet në rastin konkret.

### **Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit**

Dizajni i studimit është kualitativ dhe synon ofrimin e një pasqyre mbi motivet e eksodit të fundit nga Kosova. Mund të cilësohet si studim fenomenologjik meqë bën përpjekje për të kuptuar thelbin e këtij fenomeni duke i shqyrtuar mendimet dhe ndjenjat e individëve që kanë përjetuar ngjarjen. Janë aplikuar intervista gjysmë të strukturuar me 20 subjekte, 13 nga të cilët ishin ende në vendet e destinacionit, ndërsa 7 ishin të kthyer në Kosovë. Prej tyre, 3 ishin veteran të luftës. Një intervistë e veçantë u zhvillua edhe me përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës. Grupi subjekteve që nuk ishin prezent në Kosovë, u intervistua përmes metodave moderne virtuale me përdorimin e mundësive të ndryshme të komunikimit me internet (Kryesisht Skype dhe Viber). Gjithsej: 7 intervista ishin të drejtpërdrejta, 8 u realizuan përmes Skype dhe 5 përmes Viber. Subjektet u identifikuan përmes kërkimit në komunitet dhe kontaktet u siguruan nga të afërmit e tyre. Pasi u kontaktuan, u njoftuan me qëllimet e studimit dhe u pajtuan në lidhje me intervistën. Poashtu, pjesëmarrësit u siguruan se identiteti i tyre do të jetë anonim.

Dy ndër pikat kyçe të intervistës ishin a/ të bëhet dallimi në mes të perceptimit të gjendjes socio-ekonomike para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe të vërehej nëse subjektet bëjnë ndonjë krahasim të eksperiencës së fundit me eksperiencat traumatike të luftës dhe eksodit të vitit 1999. Krahas intervistave gjysmë të strukturuar, u bë analiza e raporteve të institucioneve dhe medias në lidhje me fenomenin si dhe një intervistë e veçantë u realizua me përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës. Poashtu u shtjellua literatura shkencore mbi traumën kolektive dhe faktorët socio-ekonomik që mund të akumulojnë traumë. Analiza e të dhënave u bë përmes programit softuerik Weft QDA 1.0.1, i cili mundësoi që përmbajtja e të dhënave narrative të ruhet dhe të përdoret me lehtësi.

### **Gjetjet dhe diskutimi**

Nga analiza e të dhënave të raportuara në media dhe deklaratat e subjekteve në lidhje me eksodin e fundit, u arrit një sintezë e përgjithshme se eksodi masiv nuk ndodhi vetëm për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike por edhe për shkak të humbjes së çdo lloji shprese për ndryshime pozitive. Duket se përjetimi subjektiv, perceptimi i vështirësive socio-ekonomike ka ndryshuar në raport me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Me kalimin e viteve pas shpalljes së Pavarësisë, vërehet se bie shkalla e durimit dhe shpresës. Në intervistën që në kuadër të këtij studimi është realizuar me përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës (OVL), raportohet se pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, me 17.02.2008, kjo organizatë ka pranuar një numër të madh

të ankesave personale nga veteranët në lidhje me kushtet e jetesës, gjë që nuk ishte dukuri në periudhën e pasluftës. Kjo e dhënë klinikisht mund të cilësohet dhe/apo adresohet si një tipar i karakteristikave të traumës që zbulohet në rrethana të caktuara si rezultat i akumulimit të stresorëve pas traumatik (Wilkeret al., 2015). Përfaqësues të OVL-së u deklaruan se edhe pse lufta kishte përfunduar 15 vite më parë, veteranët për arsye të ndryshme vetëm tani fillojnë të ankohen për veten dhe situatën e tyre familjare. Ata ankohen tani meqë perceptojnë se është realizuar qëllimi. Në këtë intervistë u tha se veteranët, përkundër nevojës që mund të kenë pasur, nuk i kanë dhënë vetës të drejtë të vendosin nevojat personale në rend të parë dhe të kërkojnë ndihmë para se të jenë siguruar se qëllimi i tyre, kauza për shpalljen e Pavarësisë së plotë është realizuar.

Pra, synimi për Pavarësi ishte një shtysë psikologjike për të arsyetuar dhe tejkaluar parregullsitë politike e socio-ekonomike, ngjashëm me nivelin e durimit dhe fuqisë psikologjike për të përballuar presionin dhe trysinë në periudhën e para luftës duke synuar njëjtë kauzën për Liri dhe Pavarësi. Andaj, rrethanat e drejtpërdrejta socio-politike mund ta kenë bërë vërtetë të vështirë për një numër të madh të veteranëve që të merren me gjendjen e tyre personale menjëherë pas përfundimit të luftës. Poashtu literatura tregon se si rezultat i ndjenjës së fitores, në periudhën e pas luftës në Kosovë, është shfaqur një lloj relizience dhe rritje/pjekurie pastraumatike e cila i ka shërbyer masës për rehabilitim të simptomave të stresit akut pastraumatik dhe ka prevenuar shfaqjen e Çrregullimit të Stresit Pas Traumatik (CSPT) (Tzipi, W. & Berger, R. (Arenliu, A & Landsman, M.), 2010). Por, vështirësitë e përditshme të jetës në Kosovë (të tilla si problemet me punësimin) mund të kenë kontribuar në ngarkesën (akumulim) traumatike dhe si rrjedhojë të kenë iniciuar zhvillimin e mëtuajtshëm të simptomave dhe shfaqjen e vonshme të CSPT. Studime të veçanta klinike do të duhej të adresonin dhe vlerësonin tutje këto analiza hipotetike të bazuara në literaturën psikologjike mbi traumën dhe rrjedhën e ngjarjeve në Kosovë.

Konkludimet e ngjashme mund të mbështeten edhe me të dhënat e intervistave gjysmë të strukturuar me individë të përfshirë në eksodin e fundit (tre prej të cilëve ishin veteran të luftës). Nga subjektet e intervistuar kishte të tillë që e kishin përjetuar dhe e mbanin mend mirë eksodin e parë të vitit 1999. Por, për këtë eksperiencë u diskutua edhe me ata subjektë që në atë kohë ishin shumë të vegjël për të raportuar se e mbajnë mend në detaje këtë eksod. Sidoqoftë, në kuptimin psikologjik të gjithë subjektet bën një lidhje në mes të ngjashmërisë në përjetimin e këtyre eksperiencave. Ndër përshkrimet nga grupi i parë mbi përjetimin e eksperiencave nga largimi i fundit, mund të veçojmë shprehjet " *Mu duk se e përjetova edhe një herë Bllacën*", " *E kisha ndjenjën se po ikim prej shqijëve*" etj. ndërsa grupi i dytë interpretonte këto eksperiencia duke bërë krahasime me atë çfarë kanë ndëgjuar apo kanë parë në media në lidhje me eksodin e parë. Figurat 4 dhe 5 tërheqin një paralele vizuale në mes të dy llojeve të eksperiencave për të cilat u diskutua në intervistat me subjekte. Prandaj të dhënat nga këto intervista na bëjnë të konkludojmë se mekanizmat shoqërorë të transmetimit të traumës ndërmjet gjeneratave kontribuojnë në transferimin e ndjenjave destruktive nga një brez tek tjetri dhe kjo lidhet me numrin e madh të reagimeve të ndryshme në mesin e grupeve të ndryshme (Apprey, 1999, p.32).



Figura 4. Eksodi 2015 (Imazhi huazuar nga Sueddeutsche.de)



Figura 5. Eksodi 1999 (Imazhi huazuar nga BBC News)

Një e dhënë interesante nga subjektet që tashmë ishin të kthyer në Kosovë, u raportua se do të tentojnë sërish të dalin meqë nuk kanë shpresë për ndryshime pozitive. Thëniet “Boll kemi prit!” “Ma s’dojmë me na mashtru” etj. ishin më të shpeshtat ndër subjektë. Ndërsa nga grupi i të intervistuarve që ende ishin në vendet e Evropës, vërehej një ankth i shtuar dhe shprehje pasigurie në lidhje me të ardhmen afatshkurtër. Si përfundim mund të konkludohet se kthimi masiv i qytetarëve të Kosovës në vitin 1999, pas largimit me dhunë në formë eksodi masiv, kishte të bënte me atdhedashurinë dhe shpresën se me largimin e forcave serbe, në Kosovë do të ketë një jetë më të mirë (veçanërisht zhvillim ekonomik). U mendua se do të ketë investime ndërkombëtare, e meqë Kosova është një vend i vogël, shpresa ishte se me shumë pak investime do të arrihej një gjendje stabile ekonomike. Por, vitet treguan se një gjë e tillë nuk ndodhi, situata politikave nuk jep indikacione që mund të ketë investime e as krijim të kushteve elementare për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale në vend. Premtimet e mëdha të politikanëve, të bëra në fushata zgjedhore, për hapjen e vendeve të reja të punës dhe mos realizimi i tyre, ka bërë që qytetarët ta humbin shpresën. Humbja e shpresës ka dëmtuar relizencën dhe ka stagnuar funksionimin e rritjes/pjekurisë pas-traumatike. Në anën tjetër, krahas shërbimeve jo adekuate shëndetësore e psiko-sociale, ballafaqimi me stresorë të vazhdueshëm si rezultat i gjendjes së rëndë socio ekonomike, nuk i ka lënë vend rehabilitimit por i ka kontribuar edhe më shumë akumulimit/ngarkesës traumatike. Akumulimi i të gjitha këtyre pakënaqësive dhe rëndimi i vazhdueshëm i mirëqenies psikologjike ka bërë që të ketë një reagim masiv psikologjik i cili rezultoi në eksod. Ky eksod u quajt “Eksodi i madh socio-ekonomik i shqiptarëve të Kosovës” por nuk guxon të shihet vetëm si i tillë. Ky reagim masiv psikologjik duhet të shihet edhe si thirrje e fundit, e dëshpëruar për ndihmë në eliminimin e stresorëve socio-ekonomik që po vazhdojnë të akumulohen në traumën kolektive, duke mos i dhënë hapësire rehabilitimit dhe duke rrezikuar shfaqjen e reagimeve të ngjashme të paparashikueshme. Andaj, Kosova është shembull i qartë se rehabilitimi i popullit pas përjetimit të traumës kërkon stabilizim të gjendjes socio-ekonomike dhe sundim të ligjit në vend.

## Shënim

Lidhur me pajtueshmërinë me Standardet Etike, autorja deklaron se nuk ka konflikt interesi dhe nuk ka mbështetje financiare për studimin. Studimi ka ndjekur Principet Etike të APA-së dhe Kodin e Sjelljes për psikologë.

## Referencat

- ASK (2014) Migrimi Kosovar. Prishtinë.
- Alexande J.C., Eyerman, R., Giesen, B., Smelser, N.J, Sztompka. J(2004) Cultural Trauma and Collective Identity. University of California Press.
- Alexander, H. (2015) Exodus from Kosovo: Why thaousands have left the Balkan. Retreived from <http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/kosovo/11426805/Exodus-from-Kosovo-Why-thousands-have-left-the-Balkans.html>
- Apprey, M. (1999) Reinventing the self in the face of received transgenerational hatred in the African American community. *Journal of Applied Psychoanalytic Studies*.
- Banka Botërore (2011) Migrimi dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë. Prishtinë.
- ESI (2015) Pse Kosovës i nevojitet migrimi. Prishtinë.
- EurActiv. (2015). *Varferia nxit migrimin masiv nga Kosova*. Gjetur July 25, 2017, nga eurospeak.al: <http://eurospeak.al/zgjerimi/287-varferia-nxit-migrimin-masiv-nga-kosova>).
- Kolassa, I.T, Kolassa, S., Ertl, V., Papassotiropoulus, A., De Quervan,D.J ., (2010, Feb 15). The risk of posttraumatic stress disorder after trauma depends on traumatic load and the catechol-o-methyltransferase Val(158)Met polymorphism. *Biological Psychiatry*, 64(4), 304-8.
- Neuner, F., Schauer,M., Karunakara,U., Klaschik,Ch., Robert, Ch., Elbert, Th. (2004). Psychological trauma and evidence for enhanced vulnerability for posttraumatic stress disorder through previous trauma among West Nile refugees. *BMC Psychiatry*.
- SOK (2011). *Consumption Poverty in the Republic of Kosovo in 2009*. The World Bank.
- Tzipi, W. &Berger, R.(Arenliu, A & Landsman, M.). (2010). *Posttraumatic Growth and Culturally Competent Practice. Lessons Learned from Around the Globe*. Neë Jersey: John Wiley & Sons,Inc.
- Wilker,S., Pfeiffer,A., Kolassa,S., Koslowski,D., ElbertTh., Kolassa, I.T. (2015, Nov 19). How to quantify exposure to traumatic stress? Reliability and predictive validity of measures for cumulative trauma exposure in a post-conflict population. *European Journal of Psychotraumatology*.
- WorldAtlas. (2017, April 18). *Poorest Contries in Europe*. Gjetur July 27, 2017, nga <http://www.worldatlas.com/articles/the-poorest-countries-in-europe.html>
- <http://www.rtklive.com/?id=2&r=12665>
- <http://www.sueddeutsche.de/politik/plaene-der-bundesregierung-exodus-aus-kosovo-1.2346195>
- [http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/politics/351314.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/politics/351314.stm)

## Këngët kreshnike – shtrirja e tyre modale

**Kushtrim Jakupi**

*Kolegji AAB, Muzikologji – Prishtinë*

### Abstrakt

Këngët kreshnike u bënë objekt i studimeve të shumta dhe zgjuan interes të veçantë, ndër etnomuzikologët shqiptar, por edhe më gjerë. Në studimet e tyre paraqitën shumë aspekte të këtyre këngëve duke potencuar tiparet karakteristike të tyre, tematikën, prejardhjen, antikitetin, ndikimet nga elementë të ardhur më vonë, pastaj studime për trevat, ku paraqiten ato, personazhet kryesore si dhe materiale të tjera të përmendura në këngët kreshnike- mjetet e luftës- shpatate, koburet, e deri te veset e ndryshme dhe traditat që kanë të bëjnë me jetën e përditshme. Në këtë drejtim është arritë të ndriçohet shumë çka në lidhje me vlerat e mëdha të cilat i kanë këto këngë për folklorin tonë, pra jo vetëm në aspektin muzikor, por edhe më gjerë. Sa i përket elementeve muzikore konsiderohet se ato kanë arritë të ruajn originalitetin e tyre, normalisht gjatë kohës duke pësuar edhe ndryshime, por kryesisht jo thelbësore, sa i përket elementeve muzikore- ritmit, melodisë etj, sepse në fakt edhe pikërisht te këto elemente qëndron edhe karakteristika thelbësore e këtyre këngëve. Në këtë drejtim është konstatuar edhe se Këngët e kreshnikëve qëndrojnë në një harmoni të plotë, me krijimet e tjera artistike popullore të krahinave të veriut“(Sako & Haxhihasani, 1966, 7). Këngët kreshnike paraqesin një cikël të këngëve të shoqëruara me lahutë<sup>1</sup>. Në këto këngë trajtohen kryesisht ngjarje rreth trimërisë së dy personazheve, Halilit dhe Mujës të bazuar në elementet përrallore mitologjike, të moçme dhe me burime shqiptaro-ilire. Trajtohen figurat e besimit popullor shqiptar, zanat e malit, armët e vjetra shqiptare, etj. Elemente të cilat dëshmojnë për një origjinë të lashtë. Në këtë drejtim edhe organizimi modal i Këngëve kreshnike është një dëshmi tjetër për originalitetin e tyre dhe është e rëndësishme që ajo të studiohet.

**Fjalë kyçe:** Këngët kreshnike, modaliteti, diatonike, kromatike, lahuta.

### Hyrje

Këngët kreshnike kryesisht këndohet në Malësinë e Madhe, Dukagjin, Has, me qendrat Pejë, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Deçan, Istog e Suharekë (Daja, 1989, 8). Deri diku aty nga mesi i shek. XX, janë kënduar vetëm në shtëpi apo oda të të afërmeve, kuvendet e burrave si dhe në festa familjare. Lahutari gjatë këndimit nuk është ndërprerë asnjëherë edhe përkundër gjatësisë kohore të këngëve dhe është trajtuar si i privilegjuar, sikurse edhe vet instrumenti i lahutës i cili konsiderohej “i shenjtë” duke u vendosë në vende të posaçme në odat familjare<sup>o</sup>. Kjo formë e këndimit është e trashëguar brez pas brezi, nga shumë gjenerata dhe konsiderohet si shumë origjinale. Shumë studiues bëjnë edhe krahasime të eposit të kreshnikëve me format tjera unike të pasurisë kulturore botërore, si eposin homerik, sagat skandinave, kalevalën, nilinat ruse, etj (Tole, 2007, 432).

<sup>1</sup> Brahaj, J. citat nga dokumentari: Lahuta dhe Eposi i Kreshnikëve (dokumnetar) [Online]: <https://www.youtube.com/watch?v=vITQIRexOVM>

## Baza modale

Në aspektin muzikor melodika e këngëve kreshnike është kryesisht një motiv dhe jo shumë i zhvilluar. Shtrirja melodike është e limituar në ambitus të ngushtë dhe shpesh kalon në formë të recitativit (Daja, 1989, 108-109), për këtë arsye edhe nganjëherë, hasim në pohime nga studiues të profileve jomuzikore se “këngët që thuhën me lahtë më shumë recitohen se këndohen” (Elsie, 1959, 82). Sigurisht që ky përkufizim nuk mund të konsiderohet si i saktë. Roli i muzikës, sidomos vijës melodike të këngëve, krahas elementit poetik, sjellë vlera të rëndësishme në formësimin e Këngëve të kreshnikëve si dhe konsiderohet me interes për originalitetin e tyre arkaik (Zheji, 1998, 72).

Përkundër kësaj, melodia e eposit është kryesisht e njëtrajtshme dhe ka strukturë një motivore, gjë e cila është dëshmi për një të menduar muzikorë të hershëm (Shkreli, 1987, 3). Ky mendim muzikor u tregua i afërt me atë verior, por edhe me ngjashmëri dhe dallime të tij me eposin e sllavëve të jugut. Ndonëse për meloditë nuk ka të dhëna nga një periudhë relativisht më të hershme, megjithatë duke marrë parasysh disa tipare thelbësore të eposit si: karakterin recitativo-melodik, karakterin improvizues, transmetimin gojor, etj. vijmë në përfundim se ka tendencë të vazhdueshme drejt një evoluimi të vazhdueshëm të melodisë së eposit.

Karakterin epiko-heroik i cili përmban bazën e Këngëve të kreshnikëve karakterizohet me këto melodi të thjeshta dhe me karakter recitativ, me lëvizje graduale dhe melodi kryesisht zbritëse, ngritje të përnjëhershme në hyrje dhe përfundim të këngës të shoqëruara edhe me glisando, si dhe elemente të veçanta të mënyrave të interpretimit dhe të ekzekutimit (Daja, 1989, 31). Në forcimin e karakterit epiko-heroik luajnë rol edhe lëvizjet intervalore për sekundë të madhe si dhe përfundimet me nëntingullin final. Gjithashtu për shkak të karakterit lirik dominon karakteri minor (mol) i reflektuar me paraqitjen e tercës së vogël (C-es) bazuar në tingullin final. Krahas kësaj shpesh vendoset edhe terca tjetër e madhe b-d, si dhe një tjetër tercë e madhe es-g, duke e formësuar vargun i cili dominon në këngët e eposit b-C-(des)d-es-f-g. Gjithashtu edhe lëvizja për sekundë të vogël në mes të tingullit të parë dhe të dytë (C-des) paraqet karakterin elegjik shpesh herë e pasuar me tercën e madhe (C-e) e cila nganjëherë është e padefinuar mirë, varësisht prej karakterit të këngës. Në bazë të këtyre karakteristikave krijohet baza modale frigjike e cila karakterizohet me lëvizjen për gjysmë toni në mes të gradës së parë dhe dytë të modit. Në këtë mënyrë epika dhe heroika e eposit shprehet me dy forma të interpretimit, duke ndërthurrur molin dhe durin varësisht nga rasti.



Këngët e kreshnikëve kanë në bazë një varg melodik, kryesisht të thjeshtë, të përafërt me ndërtimin e fjalisë\*. Kjo thjeshtësi motivore rrjedh nga vet shpirti i rapsodëve dhe mund të konsiderohet si një lloj “zbulimi” i llojit të vet, i qartë në ndërtimin e tij në mënyrë, që të mbahet në mend më lehtë dhe të identifikohet më lehtë, por gjithnjë duke patur kujdes në “formulën” fillestare- vijën kryesore melodike (vokali),e



cila zhvillohet në parimin e përsëritjes me anë të një variacioni. Ky variacion ruan strukturën e ndërtimit të këngës si dhe karakterin e saj. Meloditë e këngëve ndërtohen me radhitjen graduale të tingujve, përmes sekondave të mëdha dhe të vogla dhe më rrallë tercave të vogla (jo të temperuara mirë) dhe të mëdha. Në fillim prezantohet struktura motivore e këngës, kryesisht zbritëse, duke përdorur një koloriti të llojllojshëm të figuracioneve (kthyeset, kalimtare, etj.) dhe një lloj kadencimi, ku më pas vazhdon strukturimin e këtij motivi fillestar, duke krijuar njëkohësisht në mënyrë të rrjedhshme dhe të njëpasnjëshme “variacionet” e tija. Për këtë arsye kjo formë e këndimit ndryshe, mund të konsiderohet si formë e “këndimit me variacione”. Kapërcimet e tjera edhe pse më të rralla nuk mungojnë – kuarta dhe kuinta e pastër të cilat, paraqiten kryesisht në hyrje dhe përmbyllje të këngës.

Zëri i solistit tek këngët kreshnike përcillet me lahutë (Polena & Tole, 2015, 206). Ajo zakonisht paraqitet në shtrirjen prej 4 tingujve, që përkon me përdorimin e katër gishtërinjëve të dorës së majtë, (si rezultat i vendosjes specifike të dorës gjatë interpretimit me lahutë). Ky fond prej 4 tingujve mund të jetë provë e lashtësisë së këngëve kreshnike pasi që dihet që edhe në kulturat antike tetrakordi ka shërbyer si bazë e formësimit të melodive. Në raport me këte, zëri i vokalit ka tendencë të zhvillimit më të madh se 4 tinguj, prandaj edhe shpesh krijohet një shkëputje e herëpashershme e vokalit me lahutën e cila mundohet ta përcjell vokalin brenda ambitusit të saj duke krijuar një “dizërësh spontan”.

### Shembulli 1

#### N'nade herët qyqja kenka que

Hot i ri - Shkodër  
Egzekutoi Prek Ue Smajli

O n'na - djet he - rët qy - qja ken - ka qu - e a - n'vorr - r'Ha -  
5  
- li - lit - qy - qja - ken - ka - ra e me ka - ni - se he - rët - ne vorr e i vaj - to - në  
10 *tr* *perfundimi*  
ë - ma fort me fja - le o. Ha - li - lin prozh - mon e - no Prap në  
15  
shpin' a j - gjo - gut - na j ka ra me shuosh e mir' mo - re n'Jud - bi -  
19  
- ne m'kish ar - dhu - no.

#### N'nade herët qyqja kenka que

Hot i ri - Shkodër  
Egzekutoi Prek Ue Smajli

O n'na - djet he - rët qy - qja ken - ka qu - e a - n'vorr - r'Ha -  
5  
- li - lit - qy - qja - ken - ka - ra e me ka - ni - se he - rët - ne vorr e i vaj - to - në  
10 *tr* *perfundimi*  
ë - ma fort me fja - le o. Ha - li - lin prozh - mon e - no Prap në  
15  
shpin' a j - gjo - gut - na j ka ra me shuosh e mir' mo - re n'Jud - bi -  
19  
- ne m'kish ar - dhu - no.

Kryesisht struktura modale është e fokusuar rreth vargut të njejtë, por që në brendësi

të saj varion dhe nuk, mund të paraqitet në mënyrë besnike me sistemin notal, sepse nuk i përket gamës tonale të temperuar. Këtu sidomos bën pjesë grada e dytë (d-des) e cila nuk është aspak stabile. Në shtjellimin e kësaj melodie rol të veçantë, luan interpreti i cili ia jep edhe variantin e vet, të plotësuar me ornamentet individuale. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe akordimi i instrumentit- lahutës, gjë të cilën e bën gjithashtu rapsodi, sikurse edhe mënyra e interpretimit e cila mund “të tërhhjek kah vetvetja” vijën melodike. Megjithatë, struktura melodike qëndron në një bazë e cila vendoset dhe mbetet kryesore, rreth së cilës edhe “rrotullohet” melodia, prandaj mund të konsiderohet se sistemi muzikor, që përdor rapsodi ruan karakteristika origjinale të tingëllimit. Kjo tingëllimë është krijuar the fiksuar gjatë një zhvillimi jashtëzakonisht të gjatë historik dhe natyral. Në përgjithësi, gama e tingujve kryesisht shtrihet në gjashtë tinguj (heksakordale), por nganjëherë ka edhe shtrirje më të gjera të cilat e arrijnë edhe vargun prej tetë tingujve.

Në këndimin e eposit të kreshnikëve në bazë të asaj që u tha më lartë vijmë në përfundim se në vargun tonal, disa prej tingujve janë më të qëndrueshëm dhe më të fiksuar, për dallim prej disa të tjerëve të cilët paraqiten më jostabil. Tingulli final është ai më i qëndrueshëm dhe fiksohet, pasi që edhe instrumenti i lahutës akordohet bazuar në atë. Lartësia e tij mund të jetë më lartë apo më poshtë, varësisht nga kërkesat dhe mundësitë e ambitusit të të kënduarit të rapsodit, duke bërë që pastaj në bazë të këtij tingulli bazë të akordohen edhe tingujt tjerë. Tingujt tjerë stabil paraqiten edhe ai i katërt, i pestë dhe nëntingulli. Më pak i qëndrueshëm, paraqitet tingulli i tretë i cili konsiderohet teoritikisht si tercë e vogël, por zakonisht ajo lëshohet më poshtë nga tingulli i temperuar. Edhe më shumë i paqëndrueshëm paraqitet tingulli i dytë i cili zakonisht qëndron në mes të sekondës së madhe dhe asaj të vogël, prandaj edhe në shenjimet notale të vargut modal e gjejmë të luhatur si *d* dhe *des*.

Vargu i ngushtë prej katër tingujve – tetrakordale, në të shumtën e rasteve e gjejmë në dy variante: frigjike dhe dorike

### Shembulli 2 - Frigjike

## Tridhjet agë n'mejhanë jan' mbledhë

Vermosh - Kelmend  
Kënd. Gj. Martini

At'-her' fo - li Der-dar Os-man A - - - i - ga

### Shembulli 3 - Dorike

Ku - ve - noj - në a - ga - të bie - se - dojn' i do - ni

Të dy variantet e lartëshënuara janë nga e njëjta këngë e eposit, por jo brenda një fraze. Prandaj edhe nga kjo rrjedh konkludimi se këngët e eposit të kreshnikëve kryesisht konsiderohen si këngë bimodale. Kjo nuk do të thotë se të gjitha kanë këtë karakter, sepse varësisht prej tematikës të cilën e shtjellon kënga, mundësia e paraqitjes së vetëm një modi brenda një këngë është, krejtësisht e mundshme dhe e natyrshme. Ky rast mund të vërehet te kënga "Halili bashkon lepurin e malit me edha t'vet", ku rapsodi duke u bazuar në përmbajtje, skercoze të këngës ka tentuar që të mos braktisë bazës modale minore, duke kaluar nga bimodaliteti në vetëm një bazë modale.

#### Shembulli 4

#### Halili bashkon lepurin e malit me edha t'vet

Shkrel - Shkoder  
Kend. Pal Vuksani

Vokali

Lahuta

He - o ku - rë jo - në

ke - no - ni Mu - ji me Ha - li - lin...

#### Halili bashkon lepurin e malit me edha t'vet

Shkrel - Shkoder  
Kend. Pal Vuksani

Vokali

Lahuta

He - o ku - rë jo - në

ke - no - ni Mu - ji me Ha - li - lin...

## Halili bashkon lepurin e malit me edha t'vet

Shkrel - Shkoder  
Kend. Pal Vuksani

The musical score is written for voice and lute. It features a key signature of one flat (B-flat) and a 4/4 time signature. The vocal line is in the upper staff, and the lute accompaniment is in the lower staff. The lyrics are: "He - o ku - re - jo - ne ke - no - ni Mu - ji - me Ha - li - lin...". The score includes a treble clef, a key signature of one flat, and a 4/4 time signature. The lute part is written in a style that suggests a specific tuning, with a key signature of one flat and a 4/4 time signature. The score is divided into measures, with some measures containing rests and others containing notes. The lyrics are written below the vocal line.

Variant tjetër shumë më i rrallë është edhe paraqitja e njëpasnjëshme e gjysmëtoneve, që në një mënyrë tjetër, paraqitet ndjenja e një kromatizmi.

Këngët e eposit të kreshnikëve kanë ngjashmëri të madhe me ato të eposit historik. Para së gjithash, është karakteri epik-heroik ai i cili, i lidh këto dy forma muzikore. Këngët epike-historike shënojnë një fazë të mëvonshme të historisë së kulturës tonë. Këtu mendohet para së gjithash në fazën e cila fillon nga pushtimi osman i trojeve shqiptare duke reflektuar lëvizjen e popullit shqiptar për liri. Për dallim nga eposi i kreshnikëve, eposi historik trajton, ngjarje historike të vërteta, jo legjendare dhe të zmadhuara dhe zbukuruara deri në imagjinatë të skajshme. Edhe në rafshin muzikor, epika historike është shumë e ngjajshme me eposin e kreshnikëve. Hyrja me lahutë, kapërcimi me glisando në fillim të këngës, struktura modale (bimodale) e saj. Shtrirja melodike pothuajse në çdo fjali, është gjashtë tingullshi (heksakordi). Struktura modale qëndron e njejtë, përveç dallimeve të shënuara në kadencime të cilat nuk do të thotë të jenë gjithmonë me paraprirje të nën tingullit, por me forma tjera.

Duke marrë parasysh se kjo formë e të kënduarit paraqitet në kohën e ndikimit osman në trojet shqiptare, ajo ka arritë të ruhet nga ndikimi i mundshëm i saj, Kjo sigurisht falë shtrirjes së saj kryesisht në viset malore, jo shumë të ndikuara sikurse viset e ulëta. Mirëpo ka raste kur edhe kromatizmi i theksuar paraqitet te disa raste të eposit historik.

### Shembulli 5

The musical score is written for voice and lute. It features a key signature of one flat (B-flat) and a 4/4 time signature. The vocal line is in the upper staff, and the lute accompaniment is in the lower staff. The lyrics are: "O daj - ku - fi - - nin. hej po kon a - ni hej". The score includes a treble clef, a key signature of one flat, and a 4/4 time signature. The lute part is written in a style that suggests a specific tuning, with a key signature of one flat and a 4/4 time signature. The score is divided into measures, with some measures containing rests and others containing notes. The lyrics are written below the vocal line.

The image shows a musical score for a piece titled 'Vokali' and 'Lahuta'. It is written in 4/4 time and the key signature has two flats (B-flat and E-flat). The score consists of three systems. The first system has two staves: the top staff is for the voice ('Vokali') and the bottom staff is for the lauta ('Lahuta'). The lyrics for the first system are 'O daj ku - fi - - nin.' The second system also has two staves, with the lyrics 'hej po kon hej a - ni hej'. The third system shows a single staff with a melodic line, likely for the lauta, with a '3' above it indicating a triplet. The lyrics 'hej po kon hej a - ni hej' are written below the notes.

Në traditën muzikore mund të gjejmë edhe këndimin e eposit historik pa përcjellje instrumentale. Te këto forma të të kënduarit zakonisht melodia është më e zhvilluar dhe e pavarur nga interpretimi instrumental, prandaj edhe shtrirjet e ambitusit kalojnë edhe sekstën duke arritë edhe deri në oktavë. Përkundër kësaj brenda fjalive të këngëve nganjëherë, ka edhe reduktime në shtrirjen melodike në struktura pentakordale, tetrakordale dhe më rrallë edhe triakordale. Mirëpo edhe përkundër të gjitha rrethanave këndimi i eposit të kreshnikëve krahasuar edhe me eposin historik i ruajn tiparet modale, duke u bazuar në vetëm dy prej tyre- modin frigjik dhe modin dorik.

Në përgjithësi, nga shembujt e shumtë, mund të konsiderojmë se në këngët e kreshnikëve, dominojnë modet diatonike dhe paraqesin një veçori dalluese, në disa drejtime, si, ambitusi i ngushtë, lartësia origjinale e disa tingujve të modit, etj. të cilat janë edhe dëshmi të lashëtisë dhe origjinalitetit të tyre. Në aspektin muzikor vijmë në përfundim se këndimi verior, në të cilin bëjnë pjesë edhe Këngët kreshnike, paraqitet si homofonik, duke rezultuar me elemente të përafërta strukturore dhe modale me format tjera muzikore të trevave veriore. Karakteri recitativ dhe improvizues, shtrirja e kufizuar modale, etj, janë vetëm disa veçori të përbashkëta në mes eposit të kreshnikëve dhe formave tjera, si këngët malësorçe, gjamat, vajet, etj.

## Referencat

- Elsie, R. (1959). Historia e letërsisë shqipe. Tiranë, 82.  
Daja, F. (1989). Muzika e eposit heroik legjendar. Tiranë, 8, 31, 108-109.  
Despic, D. (1980), Nauka o muzickim oblicima. Beograd, 38.  
Polena, I. & Tole, V. (2015), Fjalor i muzikes klasike dhe popullore, Tirane, 206.  
Sako, Z. & Haxhihasani, Q. (1966), Epika Legjendare I. Tiranë, 7.  
Shkreli, K. (1987), Çështje të folklorit shqiptar. Tiranë, 3.  
Tole, V. (2007), Folklori muzikor, Tiranë, UEGEN, 432.  
Zheji, Gj. (1998), Folklori shqiptar, Tiranë, 72.

## Joint property of spouses – According to Kosovo legislation

PhD (C.) Nehat Idrizi

*Judge at the Court of Appeal in Pristina and PhD Candidate at UET in Tirana*

### Abstract

Spouses, when entering a marriage relationship, in addition to creating personal relationships between them, they also create property relations. The Family Law of Kosovo (FLK) regulates in more detail property relations between spouses in marriage and after the dissolution of marriage.

Spouses may request the division of property during marriage and after its dissolution. In practice, the division of property primarily takes place after the dissolution of marriage and much less during its existence. The main factors that prompt the spouses to request the division of property after the dissolution of the marriage are disputes between them and in such cases, competent for the division of property is the Court. A special feature in judicial practice is that, almost completely, women are those who initiate court proceedings for division of property. Spouses requesting such a thing are from the employed and unemployed sector or those who are not in employment or are housewives. When assessing their contribution, the increase of joint property is based on a number of criteria and circumstances such as personal income, child care, property maintenance, housework, and any other form of contribution.

**Keywords:** Joint property, separate property, division of property, contribution, criteria.

### Introduction

Spouses when entering into marriage or cohabitation, enter into property relations that are governed by the legal norms of the Family Law and other laws such as the Law on Gender Equality that deal with property relations. Property of spouses may be separate and joint property. The Family Law of Kosovo stipulates that spouses are equal in all personal and property relations. However, from the statistics and court practice, it is concluded that the wives are those who seek the division of the joint property in court proceedings. This fact shows that practically there is no equality between spouses, even though this is guaranteed by law.

Division of joint property can be done by agreement during the existence of marriage, but in practice, these cases are very rare. The most common cases of joint property division of spouses are those through litigation, due to disagreements between them. This part is equally divided and each one receives his/her share as entitled based on the contribution during the existence of marriage and joint work. The assessment of the contribution of spouses is based on several criteria, such as: personal income and other income of the spouses, child care and education, property maintenance, managing of housework and other forms of work regarding the maintenance and increase of joint property. The personal income criterion is mainly expressed with the employed spouses and those who have other sources of income.

Other criteria related to childcare and housework apply mainly in cases where spouses are unemployed or housewives.

## 1. Types of property of spouses: separate and joint property of spouses

The Family Law of Kosovo defines property of spouses as separate property and joint property of spouses.<sup>1</sup> These two types of properties vary from one another and have specific characteristics.

**1.1. Separate Property of Spouses** – Separate property is the property the couple of spouses had at the moment of wedlock, as well as the property acquired in wedlock in any lawful manner allowed, but not by work (Podvorica, 2011, 244). As separate property of spouses is also property acquired through inheritance, donation, or other form of acquiring property by intellectual, artistic work, or compensation of nonmaterial damages in court proceedings that is assigned to the spouse. Some of the characteristics of the separate property are: this property is administered by each spouse, separately and independently. It is defined and cannot be acquired as joint property.

**1.2. Joint Property of Spouses** – Joint property of spouses is the property acquired through work during the course of the marriage as well as income deriving from joint property. From this definition, it results that for the acquisition of this property two conditions must be met cumulatively:

- *existence of marriage, and*
- *work of spouses during the existence of the marital community.*

**(1) Existence of marriage** – is an essential condition for the acquisition of joint property, which means that, in order to acquire this property in the marital community, there must exist a marriage. Without the existence of this community, there can be no question of the existence of joint property because in this case, there would be no legal basis on which the joint property is created (Podvorica, 2011, 246).

**(2) Work of spouses during the marital community** – The work of spouses during marriage is a necessary condition for the creation of joint property, which means that a joint property of spouses is possible to be created only with work during the existence of marriage.

Work can be individual and joint. Individual work is when the spouse performs work individually and independently and creates income and profits that increase the value of the joint property. Meanwhile, joint work is when spouses, by their joint action, create income which increases or creates property in the family.

The joint marital property is characterized by the lack of definition of the part of the item or the respective claim of each of the spouses, unlike the ideal or real parts of the co-ownership and the particular part of the property that is determined. As a result of the non-specification of the belonging of parts of the spouses, the spouses cannot dispose with that property individually, but only together until that property is divided. Spouses may dispose with immovable joint property, and the joint property of spouses cannot be alienated without the consent of both spouses.<sup>2</sup>

The legal provisions regulating the joint property of the spouses are of a cogent nature, so the legal work concluded in violation of these provisions is null.

## 2. The rights of spouses on immovable property

Rights of spouses provided for in Article 50 of the FLK, are recorded in the public register for immovable property on behalf of both spouses as joint property with

<sup>1</sup> Article 45 of the Family Law of Kosovo.

<sup>2</sup> Article 16.9 Law on Gender Equality of Kosovo.

undetermined shares. Whereas, Article 50 par. 2 of FLK defines that when only one of the spouses is registered as property right holder of the joint property in the immovable property rights register, it shall be considered as if registration was carried out on behalf of both spouses. In practice, the registration of the joint property is almost entirely under the name of the male spouse, respectively the husband, and in many rare cases under the name of the wife. The property cannot be alienated or administered without the consent of both spouses as defined by the applicable law. When both spouses register in the public register relating to immovable property as joint owners for determined shares, it shall be considered that they have portioned out the joint property.

**2.1 Administration of joint property** - Spouses may contract that the administration and disposition of the joint property in whole or part of it be administered by one of the spouses. Contracting may be restricted to administration or disposition only. When it is not contracted otherwise, administration includes also the possession within the activities such as: care and maintenance of property. However, if we do not have any contract, then the joint marital property is administered together by the spouses. In cases where there is no common agreement in relation to the administration of property, competent to resolve these disputes is the competent court in non-contentious procedure, which, unlike the procedure of division of property which is initiated by lawsuit, here the procedure starts with the submission of the proposal in the non-contentious procedure.<sup>3</sup>

**2.2 Property relations extramarital spouses** - According to the provisions of the FLK, property gained through corporate work of husband and wife in an extra marital community is considered their common marital property.<sup>4</sup> The property acquired during the factual community (extramarital community) and property which is subject to sharing or division is considered as joint property. The provisions of the FLK, which apply to the division of married spouses, are applied analogously also to property relations of persons in extramarital community.

### 3. Apportioning of joint property of spouses

It is regulated by Article 52 of the FLK, which states that none of the spouses shall arbitrarily be deprived of their property. The Family Law of Kosovo has determined that spouses in married communities are equal in all personal and property relations. By this principle, the Family Law of Kosovo protects both spouses by building all marital relations on the principle of equality. Spouses may share their property during marriage, but also after its dissolution, which means that at any time spouses can divide their joint property by agreement. Article 54 of the FLK clearly defines how the evaluation of joint property may be made in the case of disputes of spouses and that the court is competent in the case of disputes over the division of property. The decision shall be based on the spouses' contribution, by evaluating all circumstances and considering not only personal income and other revenues of each spouse, but assistance of one spouse provided to the other spouse, i.e. children's care, conduct of housework, care and maintenance of property and any other form of work and co-operation pertaining to the administration, maintenance and increase of joint property. Therefore, the court must necessarily consider the abovementioned

<sup>3</sup> Article 191 of the Law on Out Contentious Procedure of Kosovo.

<sup>4</sup> Article 58 of the Family Law of Kosovo.



criteria to determine the share of joint property for each spouse. When sharing a joint property, all common debts must first be eliminated because the spouses have to respond to all their obligations deriving from the joint property and then to divide the remaining property. Personal items when considering the joint property will be separated and handed over to the spouse they belong even if the value of these items is not proportional to the total value of the joint property.

#### **4. Apportioning of joint spousal property in court proceedings**

In cases where the spouses have agreed to share the joint property, then they do so by agreement. Meanwhile, when the agreement on the division of the joint property is not reached, it is decided by the Court.<sup>5</sup> Often, even in normal situations, but mainly in situations of crisis or uncertainty, spouses feel unclear and concerned about the qualification of certain properties, created before or after marriage, jointly or individually, donated or inherited, moveable or immovable (Mandro, 2009, 215). In court proceedings, the Court, in order to determine the value of the spouse's contribution, in most cases is based on the expertise of the professional expert of actuaries, who in a detailed and professional manner takes into account all the circumstances, facts and any form of contribution made by spouses in the increase of the joint property. Practically, the court proceedings for the division of the joint property are made after the dissolution of marriage between spouses. In the procedure of division of property, the courts face great difficulties as a spouse who denies the right to property of the other spouse in different ways and methods attempts to deny or minimize the other spouse's contribution, in order to exclude him/her from participation in the joint property. In practice, it is not even excluded the case when the spouse previously transfers the immovable property onto another close relative of his or hers, or even alienate it in order to prevent the division of property. When evaluating the contribution, some criteria are taken into account based on whether the spouse has been in employment, has had any business, craft, or has been a housewife. Also, as an important criterion is that whether the housewife has lived in the village or in the city. Another significant criterion is the duration of marriage and if they have any children.

#### **5. Criteria for assessing contribution of spouses to joint property**

During the existence of marriage, spouses contribute to the increase of joint property in different forms and ways. The spouses' contribution to the increase of the joint property is direct and indirect. The direct contribution exists when the spouse carries out income-generating activity, whether in cash or in kind or in both of these cases.<sup>6</sup> The indirect contribution differs from the direct one because the spouse in this case carries out other activities that do not generate income but indirectly contribute to the increase of joint property such as: child care and housework, maintenance of the

<sup>5</sup> Article 57 of the Family Law of Kosovo states: if the agreement is not reached when the share of each of the spouses belongs to the joint property, it must be decided by the court. The decision shall be based on the spouses' contribution, by evaluating all circumstances and considering not only personal income and other revenues of each spouse, but assistance of one spouse provided to the other spouse, i.e. children's care, conduct of housework, care and maintenance of property and any other form of work and co-operation pertaining to the administration, maintenance and increase of joint property.

<sup>6</sup> Ibid, page 247.

house, the preparation of food and laundry, and other work with the help of which the other spouse is assisted. In this way, it is indirectly contributed to the realization of revenues. The contribution through income or salary is influential and easy to be proved. While the most difficult criterion to assess is the case when the spouse, according to the division of family work, carries out common housework chores, which are not in a small number.

Salary, as a major source of personal income, is an income which greatly contributes to the increase of the spouses' joint property. Spouses who are employed have the material opportunity to contribute to the increase of joint property unlike the spouses who are unemployed. When calculating the contribution of housewife spouse, the main factors considered are: average personal income of skilled, semi-skilled and unskilled employees.<sup>7</sup> The Government of Kosovo, based on the proposal of the Economic and Social Council of Kosovo, with its decision no. 04/33 dated 17.08.2011 has determined the amount of the national minimum wage for 2011 which is in the amount of 130 Euros to Employees up to the age of 35 and 170 euros for employees over the age of 35 and up to 65 years of age. Another important criterion is that the spouse lives in the city or in the village, as well as the age criterion. As far as the first criterion is concerned, housewives living in the village and having immovable property are more privileged because they can carry out other agricultural chores besides housework and childcare. Depending on the extent of the property in possession of spouses, such as immovable property, the area of orchards, the number of cattle and poultry, the value of the spouse's contribution is also determined. Regarding the age criterion, the age at which the spouse is, the young or the old age is also considered.

**Assessment of the contribution to household work that is taken into account consists of:**

- preparation and serving of food,
- washing and ironing of clothes,
- washing of dishes,
- maintaining of a residential facility (house or apartment),
- maintaining of hygiene,
- supplying of food and other items,
- caring and looking after children and elderly persons,
- education of children.

If we take into account the fact that the spouse-housewife has lived in the village or in the city, we can say that housewives in the village are more favoured because: apart from the daily and occasional household work they can also perform other jobs in the field of agriculture, livestock, poultry, orchard, crops and other. All this depends on what property the housewife possesses in her family household, e.g., how much land, the number of livestock, agrotechnical equipment, orchard area, number of poultry or beekeeping.

In cases where the housewife has lived in a family household in the city, she can,

---

<sup>7</sup> Unskilled employees are workers with primary education who have basic skills, respectively have the initial level of vocational training.

Semi-skilled employees are workers with primary secondary who are specialized and must have completed compulsory education.

Skilled employees are those workers who are prepared for specific occupations in the labour market..

apart from household chores, contribute with her work to the business success of her husband.

## 6. Cases from judicial practice

During the work on this paper, ten cases were taken and analysed from different courts of Kosovo, presenting some of the personal characteristics of claimants such as gender, length of marriage, living in the village or city, age of claimants, employment relations and approval of the claim.

**Table 1. Gender of claimants, duration of marriage, living in village or city, age of claimants, employment relationship and claim**

Claimant		Marriage duration	Residence		Age	Employment		Court Decision	
Female	Male		Village	City		Employed	Unemployed	Approved	Rejected
10	0	9-41 y.	4	6	43-64 y.	6	4	9	1

From the study of 10 cases that have been analysed and researched, it is characteristic that in these cases, female gender is presented as a claimant. As far as the duration of marriage is concerned, the table shows that it has been at least 9 years and at most 41 years. During the study of these cases. it was noticed that the majority of spouses (claimants) live in the city, in total 6 of them, and 4 in the village. Age is an important criterion in assessing the joint contribution and, from statistical data, it can be seen that the age of the spouses who submit claims is mainly the average age of about 50 years. From the table can be seen that employed women initiate most of the court proceedings, which is an indication of the strong economic position that makes the women more powerful and more persistent in protecting their property rights. Whereas, on the other hand, unmarried wives find themselves less powerful and hesitate to initiate court proceedings for division of the joint property. This may also be due to insufficient knowledge of their property rights.

In the cases dealt with, the majority of claims for division of joint property have been approved by the court, while only one has been rejected.

## Conclusions

Joint property represents a challenge that spouses face when implementing this legal right. Treated and analysed cases for the division of joint property indicate that wives are those who initiate court proceedings, which implies that in reality they are violated the right to share joint property. Institutions, civil society and courts, in the future, should contribute towards the realization of the property rights of the wife. The issue to be raised regarding the division of joint property is the denial of this right, predominantly by the husbands.

## References

Acts

- European Convention on Human Rights and Fundamental Freedoms.
- Constitution of the Republic of Kosovo, Prishtina, 2008.

- Family Law of Kosovo, Prishtina, 2006.
- Law on Gender Equality of Kosovo, Prishtina, 2004.
- Law on Out Contentious Procedure of Kosovo, Prishtina, 2008.

#### **Legal Literature**

- Dr. Hamdi Podvorica, E drejta familjare (Family Law), Faculty of Law in Prishtina, Prishtina, 2011.
- Dr. Arta Mandro, E drejta familjare (Family Law), Tirana, 2009.

#### **Court Decisions**

- Basic Court in Prishtina, Decision no. 1370, dated 21.06.2013.
- Basic Court in Prishtina, Decision no. 418, dated 27.11.2013.
- Municipal Court in Gjilan, Decision no. 623, dated 21.12.2009.
- Municipal Court in Peja, Decision no. 1077, dated 10.09.2007.
- Basic Court in Gjilan, Decision no. 787, dated 10.06.2013.
- Basic Court in Prishtina, Decision no. 1176, dated 18.06.2012.
- Municipal Court in Glogoc, Decision no. 147, dated 24.09.2009.
- Municipal Court in Podujeva, Decision no. 242, dated 10.08.2006.
- Basic Court in Prishtina, Decision no. 389, dated 07.05.2004.
- Basic Court in Prishtina, Decision no. 1847, dated 12.09.2013.

## Revolta e qenies Post-modernizmi, filozofia e ndryshimit të natyrshëm

Eriseld Kalemaj

### Abstrakt

Çdo shoqëri që po i drejtohet një ndryshimi; gjëja e parë që i paraprin ngritjes në fuqi janë rregullat dhe përcaktimet, të cilat duke i kuptuar si universale, shpesh janë të pa nevojshme, jo efikase, të dhunshme, jo kompetente. Për të besuar realisht tek një proces ndryshimesh, fillimisht ato vihen re tek kriza antropo – kulturore e një shoqërie. Momenti, ku vetë shoqëria nuk lejon të dal në pah individualiteti i antarëve të saj.

Post-modernizmi, si një filozofi e devijimit nga format klasike, si një botëkuptim me burim pikërisht tek nevoja për kapërcim të gjendjes (krizës), është vetëdijësuar për situatën kalimtare (tranzitore) të Qenies, larg formave të standartizuara të jetës. Më tepër se kaq, parimisht, filozofia postmoderne ka si fokus soditjeje, këtë dinamikë njerëzore.

Kur jeta konsumohet apo nuk lë më hapësirë për ta shtrirë në dimensione dhe përvoja të reja sepse është krejt e ezauraur, atëhere të duhet të kapërcesh kufijtë e të zakonshmes. Kjo 'kërkesë' e vetes së humbur, për të gjetur hapësira të tjera, më domethënëse është nisja dhe motivimi i parë për të lënë pas kompleksitetin e kohës së cilës i përket. Kthesa është për një vëmendje ndaj jetës, gjendjes reale të qenies. Thelbi i ngjarjes është ndeshja e individualitetit përballë totalitetit të forcave anonime.

Atëhere, përse lind nevoja për mënyra të reja? Sepse përshkrimi i realitetit të jashtëm dhe të brendshëm nuk jep asgjë të re dhe skemat konceptuale janë të paplota, të pakuptueshme. Në këto kushte, kur mënyrat e reja janë 'levat e Arkimit' për të vërtetën, si duhet ta pranojmë ndryshimin?

**Fjalë kyçe:** Kohezion social; Revolta e qenies; Pluralitet; Shpëtim estetik.

### Shpërbërja e koherencës (autoritetit) social

Njeriu kur vjen në jetë është i paidentitet. Ai vjen si një krijesë e kulluar, si një shpirt identik me veten, si një kohë e pastër, unike dhe e pakrahueshme. Në kuptimin e subjektit, ai thjesht '*ka ndërgjegje*'. Brendësia karakterizohet nga dinamika dhe aftësia krijuese. Pra, ai është një potencial mundësish, por pa një formë apo përmbajtje konkrete. Ky është vrulli jetësor i tij! Liri e kulluar e individualitetit si prirje (aftësi) për t'u shpalosur. Qenia e tij hapet, çelet me gjithë fuqinë e saj dhe kompleksitetin e shumëllojshëm që e specifikon.

Qenia krijohet në një marrëdhënieje intensive midis mundësive të subjektit dhe botës jashtë tij. Kurrësesi nuk mund të jetë kjo marrëdhënie një '*tabula rasa*', sepse nuk është thjesht një akumulim i jashtësisë në brendësi. Qenia nuk është kujtesë e kulluar. Thënë ndryshe, qenia nuk është e izoluar, nuk kuptohet si vetizolim i botës, si fikcion i saj. Ajo karakterizohet nga dinamika dhe intesiteti i vazhdueshëm, në një proces që nuk është standard, por i ndryshueshëm, i papërsëritshëm në kohë. E gjithë kjo përmbledhet tek togfjalshi '*përvojë jetësore*', duke i dhënë qenies një kuptim unik dhe historik. Tek kjo ngjarje qenia kërkon të realizojë veten, duke interpretuar botën, pa e

njohur objektivisht atë.

Gjithsesi, njeriu socializohet brenda një mjedisi të caktuar shoqëror. Ai përfshihet dhe përshtatet në marrëdhënie me të tjerët. Përvetëson realitetin dhe bëhet një nga të tjerët. Njeriu merr identitetin e tij, pasi ka bërë pjesë të vetes; vlerat, normat, optikën e të parit të botës. *“Portreti që nxjerr në bashkëkohësve të mi bëhet pasqyrë”* - do të shkruante shkrimtari ekzistencialist A. Kamy (Kamy, 2000, f.135). Ne kemi ‘thithur’ botën brenda qenies sonë, ose më saktë, ashtu natyrshëm bëhemi pjesë e kohës së shoqërisë së cilës i përkasim. Nuk është një qenie e kulluar, por në subjektin e tij përjetohet një botë e panjohur dhe gradualisht merr formën e kontekstit social në të cilin ndodhet. Qenia tjetërsohet, bëhet ajo që nuk është! Njeriu merr formën dhe përmbajtjen antro-po-kulturore të kontekstit social ku ndodhet. Mirëpo a mund ta quajmë të realizuar individin në këtë proces. A është ky fundi i njeriut? Po me kohën e tij unike ç’bëhet?

Kultura shoqërore, morali, opinioni publik është një sistem social i cili vepron brenda një kohezioni të caktuar. Si të thuash është një kohë universale, e cila përfshin të gjithë individët të jetojnë kohën e saj në kohën e tyre të veçantë (unike, subjektive). Shoqëria, në këtë kuptim është homogjenitet qeniesh, pra, uniformitet pa diversitet, por qenie identike me njëra tjetrën.

Nisur nga konceptet ‘unifikim’ dhe ‘natyrë dinamike’ duket qartë se kemi kontradiksion. Konflikti individ – shoqëri është natyral, i cili në thelb konsiston tek mospërputhja e autentikes me të përgjithshmes, orgjinalitetit me artificialen, kohës subjektive me kohën objektive. Të kesh kohën tënde unike, e cila nuk është aspak statike, por gjithmonë në ndryshim të vazhdueshëm dhe ta reduktosh atë tek një sistem i mbyllur, uniform, siç është kohezioni social do të thotë të *‘humbasësh qenien’*. Skematizimi i qenies dhe njohja e saj në bazë të disa njësive nënkulturore mbetet një shpjegim sipërfaqësor, i cili nuk e kap dinamikën jetësore të saj, thelbin e qenies. Njohja brenda këtyre kornizave do të thotë ta denatyrosh atë, ta paraqesësh me naivitet dhe lirinë individuale ta shohësh si të përputhur me format klishe të kulturës së zakonshme të një shoqërie. I zakonshmi nuk arrin më minimumin, të zotërojë veten, por mbetet objekt pasiv i forcave impersonale. Autoriteti i kësaj force bëhet dominuese, shtypse madje edhe dhunuese, ku njeriu humb vrullin jetësor, duke e parë gjendjen e tij si të përcaktuar.

Qenia, koha e saj, fshihet dhe shfaqet si koha të cilën jeton. Fsheh qenien reale dhe shfaqet me mënyrën e të qenit. Koha subjektive, ai vrulli jetësor, aftësia e saj krijuese nuk do të thotë se është eliminuar, ajo është tërhequr në vetvete. Tërheqje nuk do të kuptohet me një gjendje pasiviteti, përkundrazi, ajo është gjithmonë duke soditur jashtësinë, duke u ballafaquar me tjetërsimin dhe përgatit gradualisht shembjen e këtij tjetërsimi. Fuqia e saj është më e madhe se autoriteti i kohezionit objektiv. Këtu kemi shpalosjen e orgjinalitetit të qenies.

Pra, jo vetëm përvetësimi i botës, por edhe reagim ndaj saj, një kundërvënie për ta ndryshuar botën dhe veten. Kjo jo për të ndërtuar apo ngritur themele të reja, por për të jetuar jetën kundrejt disa normave apo kulturave tashmë ndrydhëse, imponuese, absolute, të ngurta. Kjo përbën arsyen se pse qenia nuk mund të objektivizohet apo konceptualizohet. Ajo vetëm shfaqet, ndodh. Rrjedhimisht ajo nuk mund të kuptohet vetëm në kufijtë e koncepteve. Ndaj Haidegeri thekson se: *“...për qenien mund të flihet vetëm në rrafshin e ngjarjeve ku përcaktohen mënyrat e ndryshme, sipas të cilave formësohet*

*përvoja e botës dhe e njeriut të kohëve të ndryshme historike. Qenia nuk është objekt, por është hapja brenda së cilës vetëm njeriu dhe bota mund të hyjnë në marrëdhënie, si subjekt dhe objekt. Meqenëse hapjes nuk mund t'i vishet qëndrueshmëria e objektit, (që jepet vetëm brenda disa hapjeve të veçanta), qenia do të mendohet si 'ngjarje'; e në të vërtetë, qenia nuk është, por jepet, ndodh" (Vattimo, 2007, f. 20).*

Ky është momenti i konfliktit, ku individit revoltohet me atë që e rrethon. Ashtu si në mitologjinë greke, kur Kronosi (koha) tredh babain e tij, Uranin. Simbolika është tejet domethënëse në këtë ngjarje mitike. Koha subjektive (në simbolikë Kronosi) që kërkon të çlirohet nga pushteti i një kohe tjetër (koha objektive, Urani). Kjo ngjarje mitike ka të bëjë me çeljen e individualitetit, me hapjen e kohës jetësore, duke mohuar tërësinë dominuese. Frojdi e përdori këtë ngjarje mitike në këtë kontekst, për të shpjeguar momentin kur fëmija del kundët pushtetit prindëror (Gudrich, 2006, f. 61). Shprehja e guximit për të thyer disa themele që në ndjesinë personale ishin të panevojshëm, të padobishëm dhe shumë të konsumuara. Momenti, ku me pasionin më të madh, kërkon të thyesh heshtjen hipokrite dhe t'i bësh vend shpalosjes së kohës tënde, të qenies tënde. Ky është çasti i moskonformizmit me botën dhe shprehje e lirisë ekzistenciale

### Revolta e Qenies (Ndryshimi)

Ikja nga dominimi i opinionint publik, tradita apo format kulturore, tashmë të kthyer në demodé apo folklorizma që nuk i përshtaten asnjë lloj gjendjeje ekzistenciale, rrjedhimisht, nxjerrin në pah unikalitetin e qenies. Dalja e individit nga kornizat dhe thyerja e tabuve fillimisht shoqërohet nga një proces ankthi dhe refleksioni. Dilema qëndron midis guximit dhe tërheqjes. Aty ku guxon do të përballë me një përgjegjësi të madhe mbi ndërgjegjen e tij. Mbajtja e vetes në këto kushte është tepër e rëndë dhe e vështirë. Më shumë se kurrë, peshon tepër individualiteti, autenticiteti i qenies

*"...në të gjitha epokat e historisë së mendimit ka pasur çaste të thella ndryshimi, ku kushtet e ndryshueshme të ekzistencës nuk mund të kuptoheshin sipas sistemeve në fuqi; në këto çaste, lindi disa forma të mendimit jo sistematik, më të çlirëta dhe më 'subjektive', të cilat Dilte i quan "filozofi të jetës" (Vattimo, 2007, f. 34). Kohezioni social pëson ndryshimet e veta. Ashtu ngadal por ndryshon. Ka raste që ndryshimi vjen edhe i befte, që nuk mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë, por gjithsesi pasojat vihen re më pas. Që ndryshimi të marrë kuptim duhet të thyesh, të mohosh autoritetin social, duhet të shpërbësh atë kohezion, atë autoritet që nuk ka se ç'të të ofrojë më. Ajo është konsumuar dhe individit e ndjen, e ka kuptuar tashmë. Kohezioni social është ezauruar. Individit brenda këtij sistemi ka konsumuar çdo përvojë. Ritmi i jetës së tij kërkon më tepër, kërkon përjetime të reja. Kërkon më shumë jetë, në kuptimin cilësor të fjalës.*

Ky është momenti i rebelimit të vetes me identitetin (kohën) social që qenia jeton. Si një moment krisje e kësaj marrëdhënieje. Një refleksion i thellë në vete, për gjendjen në të cilën ndodhet. Nevoja për një shpëtim nga tradita, konsumi dhe të qenit 'fytyra' e të gjithëve, është shprehje e 'revoltës së qenies'. Qenia nuk ka themel dhe as e kërkon një të ri. Ajo kërkon të shfaqet, të ndodh, të shpaloset në natyshmërinë e saj të lirë.

Në pamje të parë duket si një shqetësim tërësisht personal, por kjo shkon përtej. Qenia revoltohet ndaj botës që e gjenë tek vetja. Ajo synon ta ndryshojë botën dhe ndryshimi revolta nis nga vetja. Përtej asaj që është, përtej asaj që ke, revolta e saj

flet hapur 'bëju ai që je'. Shpëthimi i lirisë subjektive kërkon veçansinë individuale. "Veçansinë tonë duhet ta marrim si detyrë – kjo është liria jonë - shprehen stoikët (Gadamer, 2008, f. 87). Vlerën e individit si entitet i afirmuar. Vështrimi i personit në vlerën e vet dhe jo kategorizimi i tij me shoqërinë, familjen, profesionin, grupin etnik, fenë etj. Forca tërsisht universale me një pamje standarde për të ekspozuar një individ me një vlerë dhe natyrë tërësisht specifike. Kjo duket paradoksale! Impersonaliteti i forcave të tilla, identifikuese për individin, e vesh atë, në kuptim e qenies, me cilësi dhe veti jashtë fuqisë unike që e karakterizon. Prandaj ky guxim i qenies është një sulm ndaj autoritetit shoqëror në tërësi. Njeriu social dhe njeriu individual shihen si një dialektikë midis universales (totalitetit) dhe natyrës unike të qenies. Çelja, hapja e saj shfaqet e tillë kur njeriu social mënjanohet dhe qenia përpiqet të nxjerrë në pah gjendjen autentike të ekzistencës së vetë. Pra, kemi shpalljen e kohës subjektive në kohezionin shoqëror. Ekzistenca autentike si një përplasje midis asaj që qenia ndodhet (gjendja) dhe pjesëmarrjes së saj nëpërmjet parimeve sociale. Ky është një moment reflektimi me pasojë ndryshimin. Ndryshimi në kuptimin e qenies në aktualitetin e saj. Qenia shprehet në botë dhe kjo është revolta individuale, por edhe ndryshimi i kohezionit social. Pyetja që lind këtu është se; ky rebelim i qenies, a mund ta thyej kohezionin social dhe me tej akoma organizmin, themelet ku ngrihen marrëdhëniet njerëzore? E thënë shkurt, a rrezikojmë gjendjen e kaosit shoqëror?

'Kërkesa' për kapërcimin e kësaj situatë nuk vjen në mënyrë të paramenduar nga subjekti. Ajo vjen natyrshëm, si ndjesi, përjetim i vetes si një qenie potencialisht jo komode. Koha që jeton (ajo e zakonshme) nuk përputhet me kohën e tij, atë jetësore. Hapja e qenies është revolta ndaj çfarëdo lloji strukturimi të panatyrshëm që bëjnë sistemet e mbyllura, hermetike, konservatore. Revolta e qenies shprehet kur bota nuk e lejon të shprehet, të tregojë dhe jetojë origjinalitetin e vetë! Revolta e qenies nuk është thjesht një frustim psikologjik, por një 'kërkesë' për të shpallur veten. Besimi i saj tek momenti i jetuar dhe jo tek format që nuk i ngjajnë jetës. Përjetimi i aktualitetit të saj tregon autenticitetin e vetes... gjendjen e saj reale dhe vërtetësinë që nis aty dhe përfundon aty.

Ndryshimi i natyrshëm i kohezionit social vjen si pasojë e këtij rebelimi individual. Kujtojmë ndryshimet dhe kthesat e mëdha që historikisht ka bërë njerëzimi. Personalite të fushave të ndryshme kanë dhënë nga koha e tyre për të rikonceptuar, ripërjetuar kohën që jetonin. Duhet theksuar se këto ndryshime shpesh vijnë me pasoja tragjike dhe të dhimbshme. Kjo për vetë faktin se autoriteti social ka qenë i pacënueshëm, i izoluar. Shpesh në shoqëritë e prapambetura, të ngurta në aspektin moral, kulturor, politik, kjo lloj revolte nuk vjen ashtu natyrshëm, por me kriza dhe thyerje të mëdha. Mos pranimi i së resë ose pranimi me vështirësi i saj sjellë ndrydhje të individualitetit. Vështrimi me mosbesim ka si pasojë demotivimin... dhe humbjen e ndryshimeve të natyrshme. Shoqëritë që stimulojnë dhe besojnë tek ky individualizëm kanë ditur të shkojnë përpara. Kanë kuptuar se emancipimi nuk është besnikëri e verbër, por mohim i ideve që për individin nuk kanë asnjë lloj vlere, por qëndrojnë aty për shkak të traditës. Ndryshimi triumfon për faktin se ka zgjuar zemrat e individëve të tjerë... që ndoshta e kanë kuptuar konsumin e kohës që jetojnë dhe kërkojnë dimensione të reja jetese. Idet e reja zgjonin lirinë e tyre, e cila në thelb është shtimi i hapësirave shpirtërore për të jetuar.



## Zbehja e realitetit homogjen dhe krijimi i botës` plurale

Shpërbërja e kohezionit social do të thotë të mos kesh besim tek themelet e një shoqërie, tek format absolute të të jetuarit. Ndryshueshmëria e vazhdueshme dhe akoma më tej fokusi tek individualiteti ka krijuar një pluralitet botësh. Humbja e 'boshtit' do të thotë se flasim për një realitet më të brishtë, ku ai varet kryekëput nga marrëdhënia plurale midis këtyre botëve. Atëhere si qëndron ky realitet dhe si është natyra e këtij relacioni?

Shpesh dëgjojmë të tjerët, shpesh ja themi edhe vetes se; *'duhet të ndryshoj!' ... 'nuk janë të gjitha gjërat kështu, duhet mendur ndryshe'*. Në fakt ne gjithmonë jemi ndryshe. Asnjë herë nuk jemi të ngjashëm me veten, *'si dikur'*. Burimi i mënyrës se si jemi asnjëherë nuk mund të prek një themel të sigurt. Filozofia klasike, metafizika e saj e ka orientuar refleksionin drejt gjetjes së substancës së qëndrueshme, nga ku merr jetë dhe kuptim çdo gjë.

Shqetësimi është metodik; si është shoqëria dhe cila është vlera e individit në të? Ballafaqimi është midis autoritetit dhe lirisë! Në ide, aspekti metodik i shoqërisë, si një sistem është pikëpamje e filozofisë klasike, metafizikës dhe pozitivistëve. Të cilët nuk besonin tek individi, por tek themelet e forta, ku duhej të ngrihej kjo tërësi. E për të shkuar tek themeli duhej të gjendej rruga më e sigurt, sa ndonjëherë... filozofia klasike e humbi (ndoshta në mënyrë të pavetëdijshme) interesin për të vërtetën dhe u fokusua tek autoriteti metodik për të kapur fundin, themelin, absoluten, idealen, duke ndërtuar sisteme apo doktrina filozofike të përsosura.

Fokusi tek individualiteti dhe tek gjendja e tij është kthesa që bëri filozofia bashkëkohore ndaj filozofisë klasike. Kur flasim për individualitet duhet t'u besojmë post-modernëve, se si e paraqesin ata këtë shpjegim për njeriun.

Metafizika e filozofisë klasike, por edhe racionaliteti universal i pozitivistëve që kërkonin të vërtetat absolute (objektive), sigurinë më të pastër dhe sitemet më ideale u 'shpërblyen' me epokën modern të prodhimit, teknikës dhe zhvillimit shkencor. Kësisoj, reduktuan qenien në thjesht mekanike ose njeriun në një qenie të cekët biologjike<sup>1</sup>. Si të thuash, ata ndërtuan kohën e tyre. Kjo formë ideale solli një autoritet të pakundëstueshëm dhe pasojat i vuajti shekulli i XX me rregjimet totalitare që e karakterizuan. Besimi tek raca më e mirë (nazizmi), besimi tek teoria socio – ekonomike më e përsosur (komunizmi, pa përmendur këtu forma të tjera totalizuese), të gjitha vinin si pasojë e një kulture filozofike të trashëguar nga metafizika klasike.

Ndërtimi i sistemeve filozofike nuk e zgjidhi përfundimisht problemin që ka sot njeriu, pikërisht *'njeriun'*. Hedhja e vështrimit vetëm tek një dimension, unifikimi me të tjerët bëri që njeriu të humbasë veten, fuqinë e mundësive për t'u vet-realizuar.

Fundi i Shekullit të XX ishte momenti ndryshimeve, i rikonceptimeve dhe i ribërjes së vlerave të reja (nuk është fjala vetëm për ndryshimet politike). Tashmë kishte ardhur çasti i një metamorfoze të njeriut. Çasti i kapërcimit të një jete të

<sup>1</sup> Autoriteti i teknikës moderne e kthehu njeriun vetëm në qenie të varur. Ai shihesh më shumë si një qenie ekonomike. Ai prodhonte dhe konsumonte. Revolucioni Industrial ishte hapi i parë drejt këtij moderniteti. Krijimi i qëndrave të mëdha prodhuese e bënë njeriun (në perfieri) të ishte pashmangshmërisht i lidhur me qëndërzimin e kohës ku jetonte. Ndaj, epoka moderne ka një marrëdhënie autoriteti dhe një komunikim vertikal. Zhvillimi i komunikimit (masmedia, komunikimi online, globalizmi etj) krijoi një realitet tjetër, ku njeriu merr pozitën e vetë dhe që andej shpalo veten. Kështu, shpërbëhet ky sistem centralizues. Ajo verpron në atë që motivon apo shpalo periferia.

konsumuar, të një kulture dhe ekzistence në krizë<sup>2</sup>. Gjendja e krizës karakterizohet nga konfuziteti, ambiguiteti dhe paqartësia, por që themelore për qenien është nevoja për çelje, për ndryshim, për hapjen dhe krijimin e një dimensionit tjetër. Këtu shprehet domosdoshmëria për revoltë të qenies, atëherë kur shpirti njerëzor kërkon një kohë tjetër, një rikonceptim të jetës dhe hapësirës.

Në këtë kuptim, modernizmi u konsumua si epokë, si kohë. Qenia kërkon kapërcimin e këtij momenti. Filozofia post-moderne e kuptoi papërsosmërinë e qenies dhe duke 'luftuar' ndaj doktrinave hermetike shkoi tek krijimi i një realiteti plural. Qenia e vërtet kuptohet në individualitetin e vet.

Për filozofinë post-moderne, duke qenë se ne jemi të papërsosur, ajo gjithmonë lë një shteg për kritika, për të diskutuar, modifikuar apo ndryshuar. Pra, nuk ka konkluzione dhe vërtetime, por vetëm interpretime. Qenia hapet, çelet ndaj botës, por e tillë mbetet edhe kur bota shkonë drejt saj. Këtu ngrihet një shqetësim se si duhet të jetë ky interpretim? Revolta e qenies dhe shprehja e një ndryshimi të vazhdueshëm, a nuk na rrezikon të biem në atë që e shprehëm më lartë, pra, në relativizmin individual?

Hapje e qenies, vendosja e saj në një marrëdhënie fenomenologjike me botën dhe papërsosmëria e saj, krijojnë kushtet për të kuptuar natyrën e interpretimit. Interpretimi është krijimtari e qenies. Shpallja e saj do të thotë se ajo ka përmbajtje, është e mbushur dhe di se çfarë kërkon. Interpretimi është një përjetimi autentik i situatës. Gjykimi nisur nga gjendja e aktualitetit, tani - këtu. Fuko përdor togfjalshin, "ontologji e aktualitetit". Në shpjegimin që i bën Vatimo – "...këtu, ka kuptimin e një diskutimi që kërkon të sqarojë se çfarë domethënie ka qenia në gjendjen e tanishme" (Vattimo, 2007, f. 17). Gjendja reale, në të tashmen e ekzistencës si një optikë subjektive e të gjykuarit të vetes dhe realitetit. Pra, jo e mbyllur, aspak e objektivizuar. Përkundrazi, gjendja e qenies kërkon ta shfaqet në realitet (domosdoshmëria e Tjetrit) dhe këtu është e hapur ndaj diskutimit me fokus të vërtetën reale, kritikën dhe vetreflektimin (auto-kritikën). Pluraliteti do të kuptohet si bashkëbisedim për shqetësimin e ngritur. Bashkëbisedim që nuk gjenë asnjë herë fundin, por ngelet gjithmonë si një proces të bëri, si bashkëkrijim në një dinamikë të vazhdueshme. Ballafaqimi i optikave të ndryshme do të thotë respektim dhe pranim i Tjetrit. Nuk bëhet fjalë për një individualizëm në egoizëm (të izoluar) që kënaqet vetëm me veten. Kjo do ta na shqetësonte seriozisht për një rrezik nga relativizmi.

Veç sa thamë, interpretimi të ofron 'komoditetin' e lirisë. Liri, e cila është argumetuese ndaj realitetit përjetues, pra, shkon përtej mendimit. Interpretimi i qëndron besnik jetës reale dhe s'ka se si të bëhet dogmatik apo manipulues. Nëse do të ishte e kundërta, qenia nuk është vetvetja ose është e zbrazët. E vërteta është se me botë purale do të kuptojmë zbehjen e realitetit apo humbjen e themeleve të tij, por jo rënie në fantazi dhe relativizëm.

### **Filozofia post-moderne dhe shpëtimi estetik i botës**

Të interpretosh, të jesh plural (vlerë si entitet) do të thotë të krijosh. Të krijosh në lirinë tënde në gjendje ekzistenciale që je. Të krijosh duke qenë i hapur ndaj botës, do të thotë të kesh nevojë për të, por jo domosdoshmërisht të jesh si ajo. Distançimi nga tërësia e rreme të bën të përgjegjshëm për individualitetin tënd. Të vendosesh në

<sup>2</sup> Mjafton të kujtojmë letërsinë e Kafkës, Kamysë etj, ku në qëndër ishte kriza ekzistenciale e njeriut të kohës.

raport me kohën e jashtme që jeton, por pa bërë kompromis me të. Nisur nga gjendja e vetes, përjetohet prirja për të kaluar realen si një kohë e kufizuar (e homogjenizuar). Sepse jeta nuk ka kuptim të kufizohet, është paradoksale t'i vendosësh limite. Ajo vjen si përjetësi!

*"Pra, njeriu ishte një sintezë e shpirtit dhe trupit, por në të njëjtën kohë, ai është një sintezë e kohës dhe e përjetësisë"* – shkruan filozofi danez Soren Kierkegard (Kierkegard, 2006, f. 94). Koha ka kuptimin e jashtësisë, kurse përjetësia është gjendja e qenies, kuptimi i ekzistencës tani – këtu. Këtë pikëtakimi, Kierkegardi, do ta quante 'çast', duke i paraprirë mendimit postmodern. Po ashtu, shihet lindja e një tjetër shoqërie, tjetër qytetërimi. Për ta ilustruar, Kierkegardi na sjellë simbolikën e kryqit të krishterë: *"Kryqi është prerja e dy dimensioneve. Çasti, kjo çarje ekzistenciale e kohës nëpërmjet një lirie, mund të jetë e përfaqësuar me anë të një kryqi; koha është elementi horizontal në të cilin lidhen si një zinxhir shkaqet dhe pasojat* (koha homogjene, uniforme, statike, e pandryshueshëm), *elementi vertikal* (koha autentike e qenies, individualiteti), *është çarje që prodhohet"* (Hersh, 2005, f. 251). Ky është momenti i ndryshimit, krijimtarisë, i një botëkuptimi tjetër. Kjo është dialektika që nxjerrë në pah një realitet autentik. Për post-modernët, kjo është një formë estetike e të jetuarit.

Ashtu si artisti flet me një kohë tjetër (që s' gjendet ndokund), për të përcjell mesazhe përtej kohës së zakonshme që ai jeton. Ai nuk është rob i kohës së vet objektive. Nuk qëndron në kufizimet e kohës që jeton. Ai e thyen këtë ndërtim artificial, duke u ngritur në gjendjen e përjetësisë (të papërcaktueshmërisë). Ky është aspekti përmbajtësor. Në aspektin formal qenia në botëkuptimn post-modern merr një liri prej artisti, ku të vërtetat shprehen nëpërmjet gjendjes së qenies dhe gjendja e tij është njëkohësisht vepra e tij. Ndryshimi i formës është njëkohësi me ndryshimin e përmbajtjes. Ide që në dukje janë të reja, por që nuk është gjë tjetër veç një vazhdimësi inovacionesh dhe interpretimesh nga pikëpamje të reja. Të shkatërrosh kohezioni social, duke ndërtuar veten në kushte reale, autentike. Të besosh dhe të krijosh jetën në ritmet e saj të ndryshimit. Të zhbësh duke bërë. Këtë donte të kuptonte dhe Niçe kur shkruante se – *"...nuk mund të ndërtohet pa shkatërrua"* (Vattimo, 2007, f. 10). Ashtu si agu vjen në pakohësi, pa e dalluar qartësisht natën nga dita (në shpërbërjen e natës krijohet dita). Të evoluosh natyrshëm pa pasur nevojë për revolucione artificiale. Ndaj, botëkuptimi postmodern e sjellë natyrshëm ndryshimin.

Artisti nuk ndërton sisteme, nuk është i mbyllur, nuk është doktrinar në atë që krijon, nuk është as shkencëtar me racionalitet të ftohtë dhe as një teknikien. Ai është më shumë se kaq. Ai është një shkrirje e racionalitetit dhe përjetimin, është shprehje e një qenie që çelet me gjithë potencën e saj. Ky është edhe njeriu plural i post-modernitetit. Ai nuk është një besnik i koncepteve të ngurta filozofike, por integrohet me to duke krijuar kështu forma të çlirtam narrative, tregimtare të marrëdhënieve ndërnjerëzore. Për të jetuar, duhet të synojmë të përsosurën, por duhet gjithmonë të jemi të vetëdijshëm se asnjëherë nuk do ta arrijmë atë, sepse ne nuk jemi qenie të përcaktuara. Natyra unike e gjithësecilit prej nesh do të thotë diversitet qeniesh. Qenia kuptohet në aktualitetin e saj. Për të mos qenë thjesht individ, sepse qenia jonë nuk do të ketë kuptim, na duhet Tjetri i ndryshëm. Për të pranuar Tjetrin dhe anasjelltas, në formë e në përmbajtje ne duhet të jemi artist (çelja e vetes). Këtu gjen shpëtim bota. Ndryshe, individë të ngurtë, shoqëri kulturalisht konservatore, sisteme politike totalizuese, në kushtet e një teknike që kemi trashëguar nga epoka moderne, globalizimi, komunikim

intensive do të sjellin konflikte të shpeshta e të ashpra.

### Bibliografia

1. Agamben. G, "*Çelnaja*", Botimet "Zenit", Tiranë 2005.
2. Berlin. I, "*Idetë filozofike të shekullit XX*", Botimet "Onufri", Tiranë 2003.
3. Deleuze. G, Guattari. F, "*Ç'është filozofia*", Botimet "Zenit", Tiranë 2008.
4. Gadamer.H.G, "*Historia e filozofisë*", Botimet "Plejad", Tiranë 2008.
5. Gudrich. G. D, "*Mitet, më të famshmet e lashtësisë*", Botimet "Max", Tiranë 2006.
6. Hersh. Zh, "*Habia filozofike*", Dituria, Tiranë 2005.
7. Kamy. A, "*Rënia*", Naim Frashëri", Tiranë 2000.
8. Kierkegard. S, "*Koncepti i ankthit*", Plejad, Tiranë 2006.
9. Lyotard. J. F, "*Kushti postmodern*", Botimet "ISP&Edlora", Tiranë 2011.
10. Niçe. F, "*Kështu foli Zarathustra*", Botimet "Phoenix", Tiranë 1996.
11. Nietzsche. F "*The will to power*", Division of Random House Vintage Books Edition, New York September, 1968.
12. Poper. K, "*Për filozofinë dhe shkencën*", Botimet "Fan Noli, Tiranë 2009.
13. Shiler. F, "*Mbi edukimin estetik të njeriut*", Botimet "Plejad", Tiranë 2004.
14. Vattimo. G, "*Nihilizmi dhe emancipimi*", Botimet "Dita 2000", Tiranë 2007.

## Historia e kërkimeve arkeologjike në Anamoravë

**Riza Fazliu**

*Spektori i inspeksionit per arsim – Regjioni Gjilan*

### Abstrakt

joined more often adult-oriented crowds. The authors explain the positive effects of authoritative parenting by describing how parents influence the development of positive social relationships of teenagers with peers through modeling and practicing social interactions as well as their involvement in engaging in activities that provide opportunities for developing relationships. Appropriate social services. The results have shown that adolescents with tolerant and neglecting parents are more likely to be oriented towards peer groups displaying deviant behavior. Meanwhile, no pertinent influence of authoritarian parental style on teenage group affiliation has been revealed (Durbin et al., 1993). Fuligni and Eccles (1993) also discovered that the nature of the parent-child relationship during adolescence was predictive to understanding adolescent orientation towards their peers. These studies emphasize the importance of the parent-child relationship that allows the teenager to create his individuality by parents, working to create an independent identity, and providing the necessary security and support during this difficult transition.

A number of studies have shown that adolescents with authoritative parents have more positive experiences of psycho-social functioning and are more capable than adolescents with authoritarian, tolerant, and negligent parents. Teenagers with tolerant parents are more likely to be oriented towards peer groups displaying deviant behavior (Lamborn, Mounts, Steinberg, and Dornbusch, 1991).

Different parental styles affect the ability of the adolescent to adapt to various aspects, in particular to his ability to create supportive social relationships that are important to him, just as much as the transition to adult age.

### **Methodology**

This is a quantitative study that was realized during February – March 2017, in Shkodra city (Albania). The purpose of this study is to evaluate if parenting style influences the importance of the close friendship functions in middle adolescence.

### **Hypothesis**

The parenting style affect the importance that teenagers (in middle adolescence) give to the functions of their close friendships.

### **Participants**

In this study participate 252 adolescents of 15-17 years old, of which 147 females and 105 males. They were randomly selected from 4 high schools such as "Jordan Misja", "28 Nëntori", "Oso Kuka" and "Shejnaze Juka". The selection of the respondents for each school was based on the 10% of the total number of pupils. Concretely, "28 Nëntori" from 735 were selected randomly 74 pupils; "Jordan Misja" from 760 were selected randomly 76 pupils; "Oso Kuka" from 601 were selected randomly 60 pupils; "Shejnaze Juka" from 418 were selected randomly 42 pupils. Even for the gender aspect was preserved the same percentage.

### **The questionnaires**

The questionnaire 1 used in this study is "Active Parenting Publishers", wich is

devided into two parts with fifteen statements each. Part I is designed to help the adolescents to identify their beliefs about parenting. Part II is focused on their current home situation. As they read each statement, decide how much they agree with it. Then write the number from 1 to 5 that corresponds to their level of agreement: 1.strongly disagree; 2.disagree; 3.neutral; 4.agree; 5.strongly agree. Regarding to the scoring questionnaire, the thirty statements are grouped into six groups, according to the three parenting styles they refer (beliefs and actions/each ones). So, we have:

Autocratic belief score: statements 2+4+8+12+13

Permissive belief score: statements 1+5+7+11+15

Democratic/Authoritative belief score: statements 3+6+9+10+14

Autocratic action score: statements 17+19+22+24+28

Permissive action score: statements 16+20+23+25+29

Democratic/Authoritative action score: statements 18+21+26+27+30

We collect the resulting sums of beliefs and actions for each parenting style's group. The highest combined score possible for each style is 50. The highest combined score, therefore, suggests the style of parenting that adolescent's parents are currently using. The questionnaire 2 used in this study is "McGill Friendship Questionnaire--Friend's Functions" (MFQ-FF). This one was designed to assess the degree to which a friend fulfills the six friendship functions. It contains 48 items grouped into six main functions (1) Stimulating companionship (2) Help (3) Intimacy (4) Reliable alliance (5) Self validation (6) Emotional security. Each item is a positive statement about a specific friend fulfilling a friendship function. The respondent indicates "how often [the] friend is or does what the item says" on a 9-point scale (0 - 8), on which five of the points are labelled (0 = never, 2 = rarely, 4 = once in a while, 6 = fairly often, and 8 = always). The rating scale for each function of this questionnaire is: (not important) 0-8 points, (less important) 9-32 points and (very important) 33-64 points, cause the minimal value is 0-1 and the maximal one is 64; so the medium value is 32.

The following definitions describe what are clearly six conceptually distinguishable functions of friendship:

*Stimulating Companionship* refers to doing things together that arouse enjoyment, amusement, and excitement. This quality seems to be an important expectation of friends at all ages. Some measures have focused mainly on doing things together (Buhrmester, 1990; Bukowski et al., 1994; Parker & Asher, 1989; Sharabany, 1974), but it seems important to stress the fun and excitement in common activities (Jones, 1991; Wright, 1991).

*Help* refers to providing guidance, assistance, information, advice, and other forms of tangible aid necessary to meet needs or goals. Thus, it need not be reciprocal (Jones, 1991). Help has been assessed in specific subscales (Bukowski et al., 1994; Parker & Asher, 1989; Wright, 1991) and it has also been combined with support (Bukowski et al., 1994; Sharabany, 1974). However, the instrumental aspect of support tapped by help is distinguishable from other aspects of support tapped by Emotional Security and Self-Validation.

*Intimacy* refers to sensitivity to the other's needs and states, providing an accepting context in which personal thoughts and feelings can be openly and honestly expressed, and openly and honestly disclosing personal information about oneself. A number of researchers have Intimacy subscales (e.g., Buhrmester & Furman, 1987), although Mannarino (1976) and Buhrmester (1990) assess it as a composite along with companionship. Sharabany's (1974) Sensitivity and Knowing subscale stresses

the importance of knowing without any explicit disclosure. Wright (1991) does not include such a subscale except as it pertains to selfaffirmation or the expression of true feelings.

*Reliable Alliance* refers to being able to count on the continuing availability and loyalty of the friend. This was an important dimension underlying Selman's (1980) distinction between a fair-weather friend who would end the relationship if conflict or strains arose and a more durable friend. It is assessed in a specific Conflict and Betrayal subscale (Parker & Asher, 1989) and in a Trust and Loyalty subscale (Sharabany, 1974). Bukowski and colleagues' (1994) *Reliable Alliance* subscale concerns self-disclosure, which is referred to here as *Intimacy*; but they combine it with a *Transcending Problems* subscale that is closer to the definition of *Reliable Alliance*.

*Self-Validation* refers to perceiving the other as reassuring, agreeing, encouraging, listening, and

otherwise helping to maintain one's self-image as a competent and worthwhile person. This is often achieved through social comparison and consensual validation of one's attributes and beliefs. Similar items have been referred to as *Attachment* (Sharabany, 1974), as *Ego Support and Self-Affirmation* (Wright, 1991), and as *Reflected Appraisal* (Bukowski et al., 1994), although that was combined with an *Affective Bond* subscale as part of *Closeness*.

*Emotional Security* refers to the comfort and confidence provided by the friend in novel or threatening situations. Although the emotional support provided by a friend is considered to be important, only Wright (1991) includes items in a *Security* subscale to assess perception of the friend as safe and unthreatening because he or she does not betray one's trust or draw attention to one's weaknesses.


### The procedure

For the data processing I used SPSS program; I do crosstabulations between gender (females and males) and all three parenting styles. Also, I do Pearson correlation between parenting style and functions of close friendship.

### Results ( Crosstabulations / Correlations )

Tab.1 Gender

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Female	147	58.3	58.3	58.3
Male	105	41.7	41.7	100.0
Valid Total	252	100.0	100.0	



**Tab.2 Parenting style**

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Authoritarian	80	31.7	31.7
	Permissivd	39	15.5	47.2
	Democratic / Authoritative	133	52.8	100.0
	Total	252	100.0	100.0





**Stili prinderimit \* Gjinia Crosstabulation**

Count		Gjinia		Total
		Femer	Mashkull	
Stili_prinderimit	Autoritar	57	23	80
	Tolerues	21	18	39
	Demokrat	69	64	133
Total		147	105	252

Korelacion

**Tab. 3 Parenting style \* Gender Crosstabulation**

Count		Gender		Total
		Female	Male	
Parenting style	Authoritarian	57	23	80
	Permissive	21	18	39
	Democratic / Authoritative	69	64	133
Total		147	105	252

Tab.4 Correlations

		Gender	Parenting style	Stimulating companionship	Help	Intimacy	Reliable alliance	Self validation	Emotional security
Gender	Pearson Correlation	1	.170 <sup>**</sup>	.438 <sup>**</sup>	.383 <sup>**</sup>	-.692 <sup>**</sup>	.146 <sup>*</sup>	-.174 <sup>**</sup>	-.561 <sup>**</sup>
	Sig. (2-tailed)		.007	.000	.000	.000	.020	.006	.000
	N		252	252	252	252	252	252	251
Parenting style	Pearson Correlation	.170 <sup>**</sup>	1	-.006	-.363 <sup>**</sup>	-.147 <sup>*</sup>	.682 <sup>**</sup>	.676 <sup>**</sup>	.559 <sup>**</sup>
	Sig. (2-tailed)	.007		.924	.000	.020	.000	.000	.000
	N		252	252	252	252	252	252	251
Stimulating companionship	Pearson Correlation	.438 <sup>**</sup>	-.006	1	-.066	-.107	-.435 <sup>**</sup>	-.442 <sup>**</sup>	-.552 <sup>**</sup>
	Sig. (2-tailed)	.000	.924		.293	.090	.000	.000	.000
	N		252	252	252	252	252	252	251

	Pearson Correlation	.383**	-.363**	-.066	1	-.460**	-.084	-.445**	-.489**
Help	Sig. (2-tailed)	.000	.000	.293		.000	.183	.000	.000
	N	252	252	252	252	252	252	251	251
	Pearson Correlation	-.692**	-.147*	-.107	-.460**	1	-.121	.001	.334**
Intimacy	Sig. (2-tailed)	.000	.020	.090	.000		.055	.984	.000
	N	252	252	252	252	252	252	251	251
	Pearson Correlation	.146*	.682**	-.435**	-.084	-.121	1	.603**	.508**
Reliable alliance	Sig. (2-tailed)	.020	.000	.000	.183	.055		.000	.000
	N	252	252	252	252	252	252	251	251
	Pearson Correlation	-.174**	.676**	-.442**	-.445**	.001	.603**	1	.722**
Self validation	Sig. (2-tailed)	.006	.000	.000	.000	.984	.000		.000
	N	251	251	251	251	251	251	251	251
	Pearson Correlation	-.561**	.559**	-.552**	-.489**	.334**	.508**	.722**	1
Emotional security	Sig. (2-tailed)	.000	.000	.000	.000	.000	.000	.000	
	N	251	251	251	251	251	251	251	251

\*\* . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

\* . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

## Discussion and conclusions

We can notice from the cross tabulation between gender and parenting styles (Tab.3) that the democratic (authoritative) parenting style dominates in both genders (69 females; 64 males). Also, we can say that the less prevailing one is permissive parenting style, for both genders (21 females; 18 males).

If we refer to the correlation between gender and the parenting style, we can notice that the correlation is significant ( $r = 0.170^{**}$ ).

Regarding to the correlation between functions of close friendship and the parenting style, we can notice that the correlation is significant between:

- parenting style and help ( $r = -0.363^{**}$ );
- parenting style and reliable alliance ( $r = 0.682^{**}$ );
- parenting style and self-validation ( $r = 0.676^{**}$ );
- parenting style and emotional security ( $r = 0.559^{**}$ ).

But less significant is between parenting style and intimacy ( $r = -0.147^*$ ).

About the hypothesis, this study proves that parenting style can affect the importance that teenagers in middle adolescence give to the functions of their close friendship. So, it's clearly by Tab.4 that parenting style is more correlated with 'reliable alliance' function and less correlated with 'help' function.

## References

1. Bornstein. H. M., (2002). Handbook of parenting, botimi II, vol. 4, LAWRENCE ERLBAUM ASSOCIATES, PUBLISHERS, Mahwah, New Jersey.
2. Darling. N., "Parenting style and its correlates", University of Illinois, 51 Gerty Drive,

Champaign, Illinois 61820-7469.

3. Darling. N, Steinberg. L., (1993). *"Parenting style as a context: An integrative model"*, Psychological Bulletin, Vol. 113, No. 3, 487-496.
4. Gambini P., (2007). *"Psicologia della famiglia. La prospettiva sistemico-relazionale"*, Franco Angeli (Milano).
5. Hoskins. H. D., (2014). *"Consequences of Parenting on Adolescent Outcomes"*, Journal Societies 4, 506–531; doi:10.3390/soc4030506.
6. Komko. K., (2007). *"Parenting styles and adolescents"*, Cornell University, Agricultural Experiment Station (Hatch funds) and Cornell Cooperative Extension (Smith Lever funds).
7. Laboviti. B., (2015). *"Marrëdhënia mes stileve prindërore dhe statuseve të identitetit në adoleshencë"*, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale (Tiranë).
8. Web – bibliography
9. <http://termcoord.eu/2016/01/what-does-a-close-friend-mean-for-you/>
10. [www.devpsy.org/teaching/parent/baumrid\\_styles.html](http://www.devpsy.org/teaching/parent/baumrid_styles.html)

## Kuptimi i procesit të rregullt ligjor sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me theks të veçantë në të drejtën e aksesit të gjykatë

PhD (C.) Artan Qerkini  
Universiteti Europian i Tiranës

### Abstrakt

Nocioni të drejtat e njeriut, mbështetet në teorinë e të drejtave natyrore. Ato janë attribute apo cilësi që një person i zotëron si qenie njerëzore dhe si të tilla, ato janë të pandashme nga njeriu. Për këtë arsye shtetit nuk i ngelet gjë tjetër veçse t'i njohë dhe t'i garantojë. Njohja dhe garantimi nuk nënkupton vetëm një sanksionim formaltë të drejtave në akte juridike, por njëkohësisht nënkupton krijimin e mekanizmave dhe garancive të cilat mundësojnë mbrojtjen reale dhe efektive të tyre. Në një shoqëri demokratike në qendër është individi. Ruajtja e të drejtave të njeriut përbën themelin dhe bazat e veprimtarisë të një shteti të së drejtës dhe procesi i rregullt ligjor është një ndër garancitë bazë që shtetet ofrojnë në mbrojtjen e të drejtave të tjera.

**Fjalët kyçe:** Procesi i rregullt, neni 6, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### Hyrje

Parimi i procesit të rregullt ligjor si një parim i përbotshëm, i sanksionuar edhe në akte të tjera me karakter ndërkombëtar përcakton se, çdo e drejtë subjektive e individit në një konflikt gjyqësor duhet të kalojë e të analizohet në testin procedural të procesit të rregullt ligjor, përndryshe, gjykata ka dhënë një vendim krejt të paligjshëm duke çenuar të drejtat kushtetuese themelore të individëve. Kjo e drejtë është tërësia e parimeve të përmendura më sipër, të cilat së bashku përbëjnë garancinë e individit se pushteti gjyqësor po realizon funksionin kushtetues të dhënies së drejtësisë pa arbitraritet.

E drejta zakonore e ka zhvilluar konceptin e procesit të drejtë ligjor përmes doktrinës së të « drejtave natyrore » sipas të cilës gjykatat dhe organet e tjera zyrtare dhe quazi zyrtare, do të veprojnë vetëm sipas njoftimit të palëve të prekura dhe pasi që ato të kenë pasur mundësinë për t'u përgjigjur dhe vetëm atëherë kur vetë gjyqtarët janë liruar nga çdo lloj animi i kotë.

Për herë të parë, e drejta për proces të rregullt, gjendet e sanksionuar në një akt me karakter juridik, në Anglinë e mesjetës. Elementët e parë të saj, do t'i gjejmë të pasqyruar në Kartën e Madhe të Lirive (*Magna Charta Libertatum*) në vitin 1215. Nëpërmjet kësaj karte, u bënë përpjekjet e para për të kufizuar pushtetin absolut të mbretit, dhe u sanksionua e drejta për *një gjykim të ligjshëm*, e cila synonte minimizimin e ushtrimit pushtetit arbitrar të tij ndaj individëve. Kështu, aty parashikohej se " *Asnjë nuk mund të arrestohet, të burgoset, të largohet nga prona e tij apo të nxirret jashtë ligjit në qoftë se kjo nuk bëhet në zbatim të një gjykimi legal të vendit*".

Më vonë, në vitin 1625, u hartua deklarata e *Petition of Right*, e cila vendoste se " *Askush nuk duhet të detyrohet të japë taksë, hua, dhurata ose formë të tilla shpenzimesh, pa miratimet përkatëse me aktet parlamentare. Në të kundërt, çdo mbledhje e tyre e paligjshme, e detyruar*

ose e falsifikuar është e dënueshme me burgim. Asnjë njeri i lire nuk mund të privohet nga liria ose nga pronat e tij pa një proces të ligjshëm”.

Në gjysmën e dytë të shek të XIX e drejta për proces të rregullt, sanksionohet në një sërë aktesh juridike me karakter ndërkombëtar. Dokumente të tillë si, Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, përkatësisht në vitet 1948 dhe 1966, sanksionojnë në mënyrë evolutive të drejtën për proces të rregullt. Kështu, në qoftë se në aktet më të hershme, në të cilat thjesht përmenden terma të tilla si *gjykim legal* apo *proces i ligjshëm*, nuk jepet një kuptim i qartë dhe i plotë se çfarë do të kuptohet me këtë standart. Ndërkohë që, në aktet ndërkombëtare të shek të XIX, bëhet një përkufizim ezaurues i procesit të rregullt ligjor me të gjithë elementët përbërës të tij si dhe krijohen mekanizmat dhe garancitë për ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

### Procesi i rregullt ligjor sipas KEDNJ-së

Kupimin më të plotë për procesin e rregullt gjyqësor e jep Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (Më poshtë Konventa) e cila u nënshkrua nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës më 4 nëntor 1950 dhe hyri në fuqi më 3 shtator 1953. Në nenin 6 të saj parashikohet se « 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e çila do të vendosë qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë gjithë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralitetit, rendit publik ose të sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces e kërkon këtë, ose në masën e gjykuar krejtësisht të domosdoshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të ishte i një natyre që do të dëmtonte interesat e drejtësisë ».

Këshilli i Europës, nëpërmjet Konventës krijoi Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë Gjykata) si një mekanizëm të përhershëm që do të siguronte respektimin e detyrimeve që rridhnin për shtetet palë kontraktuese nga konventa dhe protokollat shtesë të saj<sup>1</sup>. Vendimet përfundimtare që merr kjo Gjykatë janë detyruese për palët në mosmarrëveshje<sup>2</sup>, **por në të njëjtën kohë ato kanë vlerën e precedentit në çështje të ngjashme**. Kështu, ka qënë precedenti (*stare decisis*) që i ka dhënë një kuptim të plotë të drejtës për proces të rregullt ligjor dhe elementëve përbërës, duke zgjeruar dimensionet dhe fushën e zbatimit të nenit 6 të Konventës nëpërmjet interpretimit evolues. Kjo për arsye se një mbrojtje efektive e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtës për proces të rregullt ligjor në veçanti, mund të bëhet vetëm me anën e një interpretimi që mban parasysh rrethanat aktuale të jetës në zhvillim si dhe kërkesat e një shoqërie për standarte më të larta në lidhje me të drejtat e njohura nga Konventa<sup>3</sup>. Gjithashtu, vullenti me të cilin janë pranuar vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut demonstroi lindjen e një fakti

<sup>1</sup> Shih nenin 19 të K.E.D.NJ.

<sup>2</sup> Shih nenin 46 të K.E.D.NJ.

<sup>3</sup> Xhezair Zaganjori, Të Drejtat e Njeriut në Europë, faqe 5.

të ri kyç në traditën ligjore perëndimore: një sistem efektiv i së drejtës ndërkombëtare, që rregullon disa nga fushat më sensitive të asaj që më parë është menduar të jetë brenda domenit ekskluziv të sovranitetit kombëtar.<sup>4</sup>

## E drejta e aksesit në gjykatë

E drejta e aksesit në gjykatë nuk parashikohet shprehimisht nga neni 6/1 i Konventës. Në çështjen *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>5</sup>, Gjykata ishte e detyruar t'i jepte përgjigje kësaj pyetje. Mbështetur në objektin dhe qëllimin e Konventës dhe mbi parimin e shtetit të së drejtës, arriti në përfundimin që e drejta e aksesit në gjykatë garantohej nga neni 6 i Konventës. Gjykata vendosi, se edhe pse nuk ishte mohuar formalisht e drejta për akses në gjykatë, praktikisht i ishte mohuar, duke mos i caktuar një avokat për çështjen e tij. Sipas gjykatës edhe pse neni 6 i Konventës nuk e përcakton qartë të drejtën për akses në gjykatë, ajo nënkuptohet prej tij. Ky akses përbën një aspekt të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. "*Në çështjet civile individëve nuk mund t'i cënohen të drejtat e tyre pa patur mundësi t'i drejtohen gjykatës [...] Garancitë procedurale të parashikuara në nenin 6/1 nuk do të mund të zbatoheshin gjatë një çështje konkrete nëse nuk do të garantohej më parë e drejta e aksesit në gjykatë. Konceptet gjykim i drejtë, publik dhe garancitë e tjera procedurale të parashikuara në nenin 6/1 të Konventës nuk do të kishin asnjë lloj vlere nëse nuk do të kishte fare procedim*"<sup>6</sup>.

E drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (shih vendimet nr. 7, datë 11.03.2008; nr. 14, datë 03.06.2009; nr. 4, datë 23.02.2011; nr. 6, datë 26.02.2013 dhe nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese)<sup>7</sup>.

E drejta e aksesit në gjykatë ka rëndësi kryesisht në çështjet civile. Çdo person i cili është palë në një mosmarrëveshje civile, duhet t'i garantohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për të mbrojtur të drejtat e tij civile. Në çështjen *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>8</sup> Gjykata u shpreh se: "*Mundësia e një personi për të realizuar të drejtën që pretendon nuk varet vetëm nga fakti nëse kjo e drejtë e tij parashikohet shprehimisht nga ligji*

<sup>4</sup> Mark E. Janis, Richard S. Kay, Anthony E. Bradley, E drejta evropiane e të drejtave të njeriut, shtëpia botuese Libri Shkollor Prishtinë, faqe 5.

<sup>5</sup> Golder kundër Britanisë së Madhe, datë 21.02.1975, A. 18, par. 38.

<sup>6</sup> Golder kundër Britanisë së Madhe, datë 21.02.1975, A. 18, par. 34 dhe 35.

<sup>7</sup> Vendimi nr. 8 datë 26.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese të RSH.

<sup>8</sup> Fayed kundër Britanisë së Madhe, datë 21.09.1994, A-295B, par.65.

kombëtar por edhe nga ekzistenca e pengesave procedurale, të cilat e pengojnë ose e kufizojnë mundësinë që pretendimin e tij t'ia paraqesë gjykatës". Institucionet e parashikuara në Konventë nëpërmjet interpretimit të nenit 6/1 nuk mund të krijojnë një të drejtë civile thelbësore, e cila nuk gjen pasqyrim shprehimisht në të drejtën e brendshme të shtetit anëtar. Nëse një shtet anëtar në mungesë të kontrollit apo të kufizimeve të vendosura nga institucionet e Konventës, heq nga juridiksionet e gjykatave të tij një rreth të gjerë çështjes civile ose u garanton imunitet ndaj padive civile një rrethi të gjerë subjektësh, kjo do të binte ndesh me parimin e shtetit të së drejtës ose me parimet e parashikuara në nenin 6/1 të konventës.<sup>9</sup>

E drejta e aksesit në gjykatë nuk ka karakter absolut. Në çështjen **Golder kundër Britanisë** së Madhe, Gjykata u shpreh se rastet kur kufizohet e drejta për akses në gjykatë duhet të përcaktohen shprehimisht.<sup>10</sup> Kjo e drejtë i përket vlerësimit të shteteve anëtare dhe këto kufizime nuk duhet të jenë deri në atë masë sa të çenohet dhe vetë thelbi i së drejtës. Këto kufizime nuk duhet të vendosen në mënyrë arbitrare, por duhet të jenë të justifikuar dhe në proporcion me synimin që kërkohet të arrihet. "E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute dhe mund të kufizohet. Duke u nisur nga vetë natyra e kësaj të drejte, e cila kërkon ndërhyrjen e shtetit për t'u rregulluar, kufizimet variojnë në kohë dhe në vende të ndryshme në përputhje me nevojat dhe burimet e shoqërisë dhe të individëve [...] Këto kufizime janë objekt i vlerësimit nga vetë shtetet."<sup>11</sup> Por, vlerësimi final nëse janë rrespektuar kërkesat e Konventës i takon Gjykatës. Detyra e saj nuk qëndron në zëvendësimin e organeve të shteteve anëtare për vlerësimin e politikave optimale në këtë fushë.<sup>12</sup> Në çështjen **Shkalla kundër Shqipërisë**, Gjykata u shpreh se, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës", nga e cila e drejta për akses është njëri aspekt, nuk është absolute; ajo u nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin heshturazi veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, meqenëse nga vetë natyra kërkon rregullimin nga Shteti, i cili gëzon një kufi të caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë apo pakësojnë aksesin e një personi në një mënyrë apo shtrirje të tillë që dëmton vetë thelbin e së drejtës. Së fundi, kufizime të tilla nuk janë në përputhje me nenin 6 § 1, nëse ato nuk ndjekin qëllimin e legjitimuar ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur (...). Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar do të thotë mohim i pajustificuar i së drejtës së ankuesit për akses në Gjykatën Kushtetuese. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.<sup>13</sup>

Gjykata gjatë gjykimeve ka vënë re kufizime të ndryshme të së drejtës së aksesit në gjykatë. Detyrimi për të paguar taksën e gjykatës në vetvete nuk përbën një kufizim të së drejtës së aksesit, për sa kohë kjo taksë është proporcionale. Në çështjen **Tolstoy kundër Britanisë së Madhe**, aplikanti duhej të paguante si taksë shumë prej 124,900 paund brenda një afati kohor relativisht të shkurtër. Gjatë gjykimit Gjykata mori në konsideratë gjëndjen financiare të aplikantit për të arritur në përfundimin nëse taksa ishte disproporcionale.<sup>14</sup> Nuk do të kemi shkelje të Konventës as në rastin kur legjislativi i shteteve parashikon gjobë në rast të ushtrimit të drejtës së ankimit në një

<sup>9</sup> Deëer kundër Belgjikës, datë 27.02.1980, A-35, par. 49.

<sup>10</sup> Golder kundër Britanisë së Madhe, datë 21.02.1975, A. 18, par. 37-39.

<sup>11</sup> Ashingdane kundër Britanisë së Madhe, date 28.05.1985, A-93, par. 57.

<sup>12</sup> Klass dhe të tjerë kundër Gjermanisë, datë 06.09.1978, A-28, par 49.

<sup>13</sup> Shkalla kundër Shqipërisë nr. aplikimit. 26866/05, datë 10.05.2011

<sup>14</sup> Tolstoy kundër Britanisë së Madhe, date 13.07.1995, A-323, par. 64.

gjykatë më të lartë, e cila është haptazi në kundërshtim me ligjin<sup>15</sup>. Vendosja e detyrimit për të caktuar një mbrojtës si kusht për t'iu drejtuar gjykatës, me qëllim për të garantuar një mbrojtje efektive dhe një proces të suksesshëm, nuk përbën një shkelje të nenit 6/1 të Konventës.<sup>16</sup> Gjykata nëpërmjet jurisprudences së saj ka pranuar dhe disa kufizime të së drejtës së aksesit, të cilat lidhen thelbësisht me cilësitë e kërkuesit. E drejta për akses u kufizohet të miturve<sup>17</sup>, të sëmureve mendore të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të tyre<sup>18</sup>, personave që kanë deklaruar falimentimin<sup>19</sup> dhe kërkuesve me vullnet të vesuar<sup>20</sup>. Megjithatë, një mohim i plotë i mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës përbën një cënim të nenit 6 të Konventës.

Në çështjen e *Kishës Katolike Canea kundër Greqisë*, kërkuesit iu mohua e drejta për të mbrojtur të drejtën e saj të pronësisë, pasi gjykata kombëtare deklaroi se Kisha sipas së drejtës së brendshme nuk kishte personalitet juridik dhe për këtë arsye nuk mund të vinte në lëvizje gjykatën.<sup>21</sup> Qëndrim të ndryshëm mbajti Gjykata në çështjen *Lithgoë kundër Britanisë së Madhe*. E drejta kombëtare parashikonte krijimin e një komisioni të përbashkët, i cili do të zgjidhte mosmarrveshjet në lidhje me kompensimet. Ortakët nuk kishin të drejtë t'i drejtoheshin gjykatës në këtë rast. Meqë interesat e secilit ortak janë të mbrojtura në mënyrë indirekte, ky kufizim i së drejtës së aksesit në gjykatë nuk përbën në këtë rast cënim të nenit 6/1 të Konventës.<sup>22</sup> E drejta e aksesit në gjykatë gjen aplikim dhe në procesin penal. Por kjo e drejtë nuk është absolute. Kjo e drejtë nuk përfshin të drejtën e viktimës nga një vepër penale që t'i drejtohet gjykatës. Viktima e një veprë penale nuk ka të drejtë personalisht që të nisë një procedim penal dhe as t'i kërkojë autoriteteve proceduese të nisin një procedim penal (*Kiss kundër Britanisë së Madhe*).<sup>23</sup> Në çështjen *Mateos e Silva Lda dhe të tjerë kundër Portugalisë*, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kemi cënim të së drejtës së aksesit, në rast se pala e përfaqësuar nga avokati ka mundësi të ngrejë padi lirisht, të paraqesë argumente në mbështetje të saj dhe të apelojë vendimet e dhëna.<sup>24</sup> Shkelje të Konventës nuk do të kemi as në rastin kur shteti anëtar i njeh imunitet një organizate ndërkombëtare, ku anëtarët, punonjësit dhe stafi i saj përjashtohen në rast konflikti nga e drejta e aksesit në gjykatë. Por kjo për sa kohë që organizata ndërkombëtare u garanton subjekteve të mësipërm mbrojtje gjyqësore të brendshme, ekuivalente me atë që garantohet nga juridiksioni gjyqësor kombëtar.<sup>25</sup>

Problem nuk përbën as fakti i kufizimit të së drejtës për akses në rastin kur i njihet imuniteti një shteti të huaj.<sup>26</sup> Në çështjen *Fogarty kundër Britanisë së Madhe*, Gjykata theksoi se njohja e imunitetit sovran të shtetit në procesin civil pajtohet me të drejtën

<sup>15</sup> X kundër Suedisë, datë 06.10.1982, Nr. Aplikimit 9707/82, par. 223.

<sup>16</sup> Gnahre kundër Francës, 19.09.2000, nr. Aplikimit 40031/98, par. 38-42.

<sup>17</sup> M. kundër Britanisë së Madhe, date 04.05.1987, nr. Aplikimit 12040/86.

<sup>18</sup> Ënterëerp kundër Hollandës, date 24.19.1979, A-33, par. 75.

<sup>19</sup> M. kundër Britanisë së Madhe, date 04.05.1987, nr. Aplikimit 12040/86.

<sup>20</sup> H. kundër Britanisë së Madhe, datë 02.12.1985, nr. Aplikimit 11559/85 në të cilën aplikanti duhet të pajisej me leje për t'iu drejtuar gjykatës pasi ishte subject i ligjit që rregullonte vullnetin e vesuar.

<sup>21</sup> Kisha Katolike Canea kundër Greqisë, date 16.12.1997, raportrr nr. 2843, par. 40-42.

<sup>22</sup> Lithgoë a.o kundër Britanisë së Madhe, datë 08.07.1986, A-102, par. 196.

<sup>23</sup> Kiss kundër Britanisë së Madhe, datë 16.12.1976, nr. Aplikimit 6224/73 dhe T. kundër Belgjikës, datë 14.07.1983, nr. Aplikimit 9777/82.

<sup>24</sup> Mateos e Silva Lda dhe të tjerë kundër Portugalisë, datë 16.09.1996, RJD 1996-IV, par.64.

<sup>25</sup> Spans kundër Hollandës, date 12.12.1988, nr. Aplikimit 12516/86, par. 119 dhe Van der Peet kundër Gjermanisë, datë 12.04.1996, nr. Aplikimit 26991/95, e publikuar.

<sup>26</sup> Kalogeropoulou a.o kundër Gjermanisë dhe Greqisë, date 12.12.2002, nr. Aplikimit 59021/00.



ndërkombëtare dhe ka për qëllim forcimin e marrëdhënieve të mira midis shteteve. Masat e marra nga shtetet, të cilat respektojnë parimet e njohura gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare publike, të cilat i referohen imunitetit të shtetit, nuk mund të quhen në parim kufizim joproporcional i së drejtës së aksesit në gjykatë.<sup>27</sup> Në çështjen *Ernst kundër Belgjikës*, Gjykata ka pranuar se nuk kemi kufizim të së drejtës për akses si pasojë e imunitetit të garantuar ndaj juridiksionit gjyqësor të anëtarëve të sistemit gjyqësor. Ky i imunitet i garantuar gjyqtarëve nga legjislacioni i disa vende anëtare, ka si qëllim të garantojë një sistem gjyqësor të pavarur.<sup>28</sup> Në lidhje me imunitetin që i është njohur autoriteteve kombëtare, gjykata ka mbajtur një qëndrim më kritik. Në çështjen *Osman kundër Britanisë së Madhe*, kërkuesi u ankua kundër një politike të ndjekur nga shteti, sipas së cilës policët nuk mund të paditeshin se kishin vepruar në mënyrë neglizhente gjatë ushtrimit të detyrave të tyre hetimore dhe parandaluese.

Gjykata u shpreh se synimi i rregullit përjashtues mund të pranohet si legjitim, duke qenë se i drejtohet ruajtjes së efikasitetit të policisë në parandalimin e krimit dhe cënimit e rendit publik. Por në çështjen konkrete Gjykata deklaroi se ky kufizim ishte diproporcional dhe mohonte në mënyrë thelbësore të drejtën e individit për akses në gjykatë dhe të drejtës që të dëgjohej për pretendimin e tij.<sup>29</sup> Kufizimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës mund të kufizohet dhe për shkak të imunitetit parlamentar. E drejta për akses nuk do të thotë se gjykatat kanë juridiksion të pakufizuar.<sup>30</sup> Në çështjen *Cordova kundër Italisë* Gjykata arriti në përfundim, se mbas miratimit të akteve nga parlamenti italian, kërkuesi nuk kishte pasur mjete të tjera të mundshme për të pasur në dispozicion për mbrojtjen e tij, prandaj sipas kësaj gjykate u konsiderua si shkelje të nenit 6/1 të Koventës.

Nuk do të kemi kufizim apo mohim të së drejtës për akses, nëse nga kjo e drejtë është hequr dorë në mënyrë vullnetare dhe pa ekuivoke.<sup>31</sup> Palët me pëlqimin e tyre të lire mund të vendosin se konfliktet midis tyre të mos jenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, por të zgjidhen në mënyra të tjara të parashikuar nga vetë e drejta si psh. arbitrazhi.

E drejta për akses duhet të garantojë në mënyrë efektive nga shteti. Sistemi i mbrojtjes gjyqësore që u ofrohet individëve duhet të jetë "i qartë dhe koherent".<sup>32</sup> E drejta për akses në gjykatë ka të bëjë jo vetëm me të drejtën për të nisur një proces gjyqësor, por edhe të drejtën që gjykata të shprehet me vendim përfundimtar në lidhje me çështjen që po shqyrton. Vendimi gjyqësor duhet të zbatohet.<sup>33</sup> Edhe kalimi i një kohe të gjatë nga marrja e vendimit deri në ekzekutimin e tij mund të zbehë efektivitetin e ushtrimit të së drejtës. Sipas Konventës neni 6 i siguron çdokujt të drejtën për t'u paraqitur përpara gjykatës për t'u ankuar për të drejtat e tij të shkelura. Por kjo e drejtë do të ishte thjeshtë iluzion, nëse legjislacioni i brendshëm e bënte një vendim gjyqësor të paefektshëm, dmth të pazbatueshëm. Sipas kësaj gjykate do të ishte e pakonceptueshme, që neni 6 i kësaj Konvente të parashikonte qartë mjetet dhe garancitë procedurale të kujdo për t'u

<sup>27</sup> Fogarty kundër Britanisë së Madhe, datë 21.11.2001, Dhoma e Madhe, par. 34-36.

<sup>28</sup> Ernst kundër Belgjikës, datë 15.07.2003, nr. Aplikimit 33400/96.

<sup>29</sup> Osman kundër Britanisë së Madhe, datë 28.10.1998, raport nr. 3124, par. 147-154.

<sup>30</sup> Cordova kundër Italisë, datë 30.01.2003, nr. Aplikimit 40877/98. Kërkuesi i cili ishte prokuror kishte ngritur akuza për shpërblimin e dëmeve kundrejt reputacionit të tij, si rezultat i deklaratave të dy anëtarëve të parlamentit.

<sup>31</sup> Deëer kundër Belgjikës, datë 27.02.1980, A-35, par. 49.

<sup>32</sup> De Geouffre de la Pradelle kundër Francës, datë 16.12.1992, A-253-B, par. 33-35.

<sup>33</sup> Hornsby kundër Greqisë, date 19.03.1997, raport nr. 495, par. 40.

paraqitur në gjykatë dhe mos të garantonte ekzekutimin e këtyre vendimeve. Prandaj, sipas Strasburgut, ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga ana e Çdo gjykate duhet të konsiderohet si një pjesë e gjykimit për qëllime të nenit 6.

Po kështu përbën një cënim të së drejtës për akses, në rast kur autoritetet kompetente nuk kanë marrë masat e nevojshme për miratimin në kohë të kuadrit ligjor, i cili do të garantonte ekzekutimin pa vonesa të vendimit.<sup>34</sup> Gjykata mban qëndrimin se neni 6 synon të garantojë jo vetëm të drejta që janë në kuadrin e teorisë apo që janë iluzion, por të drejta që janë praktike dhe efektive. Neni 6, sipas kësaj Gjykate, garanton çdo individ t'i drejtohet gjykatës për të marrë një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen dhe jo që ajo të rri e ngrire për një kohë të gjatë. Do të ishte iluzion, në rast se do ti lejohej shtetit për të bërë një padi civile pa siguruar nga ai që çështja të zgjidhet me një vendim përfundimtar.

Si një "detyrim pozitiv" i shtetit është garantimi i ndihmës ligjore. Në rastin e çështjeve penale ky është një detyrim që buron direkt nga neni 6/3 c. Në çështjen *Artico kundër Italisë* Gjykata e zgjeroi përdorimin e këtij parimi dhe në gjykimet civile, në rast kur qytetarët nuk mund të realizojnë vetë një mbrojtje efektive. Gjykata duke interpretuar nenin 6/3 arrin në përfundim se shtetet anëtare të Konventës nuk duhet vetëm të krijojnë mundësitë për "caktimin" e një avokati, por mundësinë e dhënies ndihmë me anë të një avokati. Jurisprudenca e Gjykatës zhvilloi dy kritere mbi të cilat do të përcaktohej se kur pala ka të drejtën e një ndihme ligjore falas. Këto dy kritere ishin: ashpërsia e dënimit dhe kompleksiteti i çështjes.<sup>35</sup> Në rast së rrezikohet liria e personit është e domosdoshme prania e mbrojtësit.<sup>36</sup> Vetëm caktimi i një mbrojtësi nuk është e mjaftueshme. Autoritetet duhet ta zëvendësojnë atë ose ta detyrojnë të përmbushë detyrën nëse kanë dijeni se mbrojtësi nuk po garanton një mbrojtje efektive.<sup>37</sup> Shteti ndërhyr vetëm në rastet kur është e dukshme që nuk po e ushtron detyrën siç duhet ose kur problem sillet në vëmendjen e tij nga të tjerët.<sup>38</sup>

Në çështjen Akson Ad kundër Bullgarisë (nr. aplikimit 9970/05, datë 16.10.2012), Gjykata vlerësoi se, njohja e së drejtës për shpenzimet procedurale, edhe pse më vete, duhet të konsiderohet si pjesë e një procesi të tërë që kërkuesi të realizojë të drejtat dhe detyrimet e tij civile. Që të garantohet një proces i drejtë dhe i rregullt sipas nenit 6/1 të Konventës, duhet që gjykatat kombëtare të bëjnë një analizë të plotë të provave, fakteve dhe rrethanave të çështjes. Neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt, ky nen nuk rregullon mënyrën për marrjen e provave. Kjo duhet të rregullohet nga ligji i brendshëm. Mospranimi i kërkesës së aplikantit nga Gjykata e Kasacionit me justifikimin se, pala e cila dështoi t'i paraqiste këto prova gjatë gjykimit kryesor nuk mund t'a rregullojë këtë me anë të kërkesës për rishikim, e cila mund të bëhet vetëm për kërkesa që kanë lidhje me kërkimin kryesor, e vë kërkuesin në një pozitë më pak të favorshme. Gjykata u shpreh se, arsyet e dhëna nga gjykata në lidhje me identitetin e palës së bashku me arsyen se kërkesa për rishikim nuk mund të bëhet për ekzaminimin e provave të reja në përcaktimin e shpenzimeve procedurale,

<sup>34</sup> Kutic kundër Kroacisë, datë 01.03.2002, nr. Aplikimit 48778/99, par. 25-33.

<sup>35</sup> Granger kundër Britanisë së Madhe, datë 28.03.1990, A-174, par 47 dhe Quaranta kundër Zvicrës, datë 24.05.1991, A-205, par. 32-38.

<sup>36</sup> Boner kundër Britanisë së Madhe, datë 20.10.1994, A-300-B, par. 41.

<sup>37</sup> Artico kundër Italisë, datë 13.05.1980, A-37, par. 33.

<sup>38</sup> Kamasinski kundër Austrisë, datë 19.12.1989, A-168, par. 65 dhe Daud kundër Portugalisë, datë 21.04.1998, raport nr.739, par. 38.

e bëjnë të parregullt procesin gjyqësor. Gjykata i ka mohuar pales kërkuese të drejtën e aksesit në gjykatë, e cila përbën shkelje të nenit 6/1 të Konventës.

### Përfundim

Procesi i rregullt ligjorë garantohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por në lidhje me këtë të drejtë ekziston një praktikë gjyqësore e begatë e GJEDNJ-së. Vlenë të potencohet se jurisipodenca e GJEDNJ-së është obligative edhe për Republikën e Kosovës, e cila nuk është nënshkruese e KEDNJ-së, por në bazë të nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, këto vendime janë obligative edhe për gjykatat e Kosovës. E drejta për akses në gjykatë është pjesë e gjykimit të drejtë, sepse as që mund të bëhet fjalë për një gjykim të drejtë nëse subjekteve juridike i'u pamundësohet qasja në gjykatë. Sipas Jurisipodencës së GJEDNJ-së edhe mosekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë përbënë mohim të së drejtës për qasje në gjykatë. Si një "detyrim pozitiv" i shtetit është garantimi i ndihmës ligjore. Në rastin e çështjeve penale ky është një detyrim që buron direkt nga neni 6/3 c. Në çështjen *Artico kundër Italisë* Gjykata e zgjeroi përdorimin e këtij parimi dhe në gjykimet civile, në rast kur qytetarët nuk mund të realizojnë vetë një mbrojtje efektive.

## Roli i terapisë psikologjike në burgje

Edlira Jahiu Ylli

Në vitin 2001, është hartuar në Mbretërinë e Bashkuar, dokumenti "Ndryshimi i pikëpamjeve: Strategjia e zhvillimit dhe e modernizimit të shëbimit në shëndetin mendor në bugje (DH and HMPS 2001)<sup>1</sup>. Bazuar në këtë dokument u vendos të hartohet dhe të zbatohet plani 5 vjeçar për përmirësimin e shërbimit mjekësor për të burgosurit. Ky dokument parashtron parimin e "barazisë, sipas të cilit "të burgosurit duhet të kenë akses në shërbime sipas nevojave ashtu si dhe gjithë popullsia trajtohet nga shërbimi kombëtar shëndetësor. Shëndeti mendor në burgje është prezantuar në Britaninë e Madhe midis vitit 2003 dhe vitit 2006, për të mundësuar dhënien e ndihmës të dënuarëve të cilët shfaqin probleme të shëndetit mendor.

Në praktikë, shëndeti mendor në burgje është përpjekur të plotësojë nevojat e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor duke përfshirë depresionin, dëmtimin e vetvetes dhe çrregullme të stresit post-traumatik (PTSD). Megjithatë, akoma mbetet një numër i lartë i problemeve mendore të pa adresuara<sup>2</sup> por që ofrimi i shërbimit të terapisë psikologjike është i garantuar jashtë ambjentëve të burgut.

Në nivelin e politikë-bërjes janë ndërmarrë një sërë masash për të theksuar rëndësinë e plotësimit të kërkesave të të dënuarve, por mbetet për t'u diskutuar sesi plotësohen këto kërkesa në praktikë. Është e rëndësishme të theksohet se domosdoshmëria dhe kërkesa për shërbime në fushën e shëndetit mendor në burgje i tejkalon burimet të cilat mund të nevojiten për ti plotësuar këto kërkesa<sup>3</sup>.

Është e dokumentuar se personat e vendosur në burgjet e Anglisë, kanë vështirësi të shumta psikologjike<sup>4</sup>. Në të njëjtën kohë përveç se vuajnë nga shqetësimet mendore, të dënuarit vuajnë dhe për shkak të fenomenit të përjashtimit social. Sipas të dhënave të referuar nga Njësia e Përjashtimit Social, rezulton se të dënuarit ndryshojnë nga njerëzit në komunitet, kjo bazuar në të dhënat ku 27 % e të dënuarëve të mitur janë marrë nën kujdesje (krahasuar me 2% të popullsisë), 32 % ishin të pa strehë (krahasuar me 0.9% të popullsisë), 67 % janë të papunë (krahasuar me 0.9 % të popullsisë), 65 % të tyre kanë vështirësi në lexim dhe matematike (krahasuar me 23% të popullsisë)<sup>5</sup>.

Duke analizuar nevojat për kujdes ndaj shëndetit mendor në burgje, autori Singleton, nxorri në pah se gati 90% e të dënuarëve janë të diagnostifikuar me të paktën një problem të shëndetit mendor. Këto probleme përfshijnë depresionin, ankthin, psikozën, dhe çrregullime të personalitetit. Sipas këtij studimi është gjetur se shkalla e prevalencës për psikozë është ndërmjet 6 përqind dhe 13 përqind në mesin e të burgosurve, krahasuar me 0.4 përqind të popullsisë së përgjithshme<sup>6</sup>. Një normë

<sup>1</sup> DH and HMPS (2001) Changing the Outlook: A Strategy for Developing and Modernising Mental Health Services in Prisons. London: Department of Health.

<sup>2</sup> Durcan, G. and Knowles, K. (2006) London's Prison Mental Health Services: A Review. London: Sainsbury Centre for Mental Health.

<sup>3</sup> Brooker, C., Duggan, S., Fox, C., Mills, A. and Parsonage, M. (2008) Short Changed: Spending on Prison Mental Health Care. London: Sainsbury Centre for Mental Health.

<sup>4</sup> (Singleton et al. 1998; Fazel and Danesh 2002; Rickford and Edgar 2005; HMCIP 2007; Bradley 2009; Corston 2007; Romily and Bartlett 2010).

<sup>5</sup> Social Exclusion Unit 2002.

<sup>6</sup> Singleton, N., Bumpstead, R., O'Brien, M., Lee A. and Meltzer, A. (2000) Psychiatric Morbidity Among

e prevalencës midis 40 përqind dhe 76 përqind u gjet për çrregullime neurotike, krahasuar me 17.3 përqind të popullatës së përgjithshme. Gjithashtu 50 përqind dhe 78 përqind e të burgosurve plotësojnë kriteret për një çrregullim të personalitetit në krahasim me 3.4 përqind dhe 5.4 përqind të popullatës së përgjithshme<sup>7</sup>.

Sipas të dhënave të referuara nga një inspektim tematik i kryer nga inspektorët e Inspektoriatit të Madhërisë së Saj për Burgjet në UK (HMCIP), referohet së 65 përqind e grave dhe 52 përqind e burrave kanë marrë pikët më të larta në testin GHQ-12, i cili përdoret si mjet për matjen e stresit dhe ankthit psikologjik<sup>8</sup>. Kërkime të shumta janë kryer në lidhje me vetë-dëndimit dhe vetëvrasje në burgje. Sipas të dhënave rezultojnë se numri i të burgosurve që përfundojnë në vetëvrasje është rritur në periudhën kohore nga viti 1978 deri në vitin 2003. Në ditët e sotme të burgosurit kanë pesë herë më shumë gjasa për të përfunduar në vetëvrasje se sa njerëzit në komunitet<sup>9</sup>.

Në një përmbledhje të kërkimeve në sistemin e burgjeve gjatë 10 viteve të fundit në Australi, konkludohet se "sjellja e vetë-dëmtimit ndodh në një kontekst ku niveli i stresit tek të dënuarit është shumë i lartë" dhe një prej gjetjeve qendrore në studime është fakti se të burgosurit që vetë-dëmtohenin raportonin një reagim të vafër në përgjigje sesa të dënuarit që nuk vetë-dëmtohenin. Studimi nxorri në pah se të burgosurit e vetë dëmtuar ndikohen nga faktorë të ndryshëm nxitje. Faktorët që ndikojnë në kryerjen e një tentative suicidale janë të ndarë në bazë të këtij studimi në pesë grupe kryesore: ndikim nga një ngjarje stresuese brenda burgut, pasoja e izolimit (p.sh. mungesa e anëtarëve të familjes), ngjarje që ndodhin jashtë burgut, simptomat psikologjike (p.sh. simptoma PTSD) dhe aspekte të tjera të sistemit të drejtësisë penale. Arsyeja më e përdorur për vetë dëmtim rezultojnë të jetë ajo e një ngjarje stresuese që ndodh brenda burgut<sup>10</sup>.

Për shumë njerëz, burgu mund të duket si një mundësi për të gjetur një stabilitet dhe të largohen nga jeta e përditshme dhe e vështirë e saj, megjithatë është i trishtë fakti se për disa njerëz humbja e lirisë mund të duket mundësia më e mirë që kanë.

Dhe shumë njerëz të tjerë burgim është një eksperiencë e vështirë dhe destabilizuese. Edhe pse burgjet ndryshojnë në ofrimin e kushteve edhe pse individët reagojnë dhe përballen në mënyra të ndryshme me të qenit në burg (shih Adams 1992; Liebling dhe Maruna 2005), pa dyshim eksperiencat e izolimit paraqet për shumë prej të dënuarve sfida praktike, sociale dhe psikologjike.

Gjatë periudhës të burgimit, është përcaktuar se momenti më i vështirë gjatë gjithë kohës së burgimit është momenti i hyrjes në burg. Ky moment shoqërohet dhe karakterizohet nga shqetësime mbi ndarjen nga të afërmit, humbjen e lirisë, mungesa e sigurisë, paqartësi dhe ecuria e proceseve gjyqësore (Liebling 1999; Harvey 2007)<sup>11</sup>. Në një studim mbi adaptimin e të dënuarve gjatë burgimit, në muajt e parë të paraburgimit, ka rezultuar se të dënuarit të cilit kishin vështirësi në rregullimin e

Adults Living in Private Households 2000. London: Office for National Statistics.

<sup>7</sup> Singleton, N., Meltzer, H. and Gatward, R. (1998) Psychiatric Morbidity Among Prisoners. London: Office for National Statistics.

<sup>8</sup> [https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/248370/0118.pdf](https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/248370/0118.pdf), fq.27.

<sup>9</sup> Jenkins, R., Bhugra, D., Meltzer, H., Singleton, N., Bebbington, P., Brugha, T., Coid, J., Farrell, M., Lewis, G. and Paton, J. (2005) 'Psychiatric and social aspects of suicidal behaviour in prisons', *Psychological Medicine*, 35.

<sup>10</sup> [https://www.griffith.edu.au/\\_data/assets/pdf\\_file/0017/518102/Suicide-Research-Text-Vol1.pdf](https://www.griffith.edu.au/_data/assets/pdf_file/0017/518102/Suicide-Research-Text-Vol1.pdf)

<sup>11</sup> Davies, P (1999) Gender, Crime and Victimisation, pg 152

emocioneve të tyre dhe nivel të lartë stresi në momentin e pranimit, kishin më shumë vështirësi në përshtatje gjatë gjithë kohës së qëndrimit në burg<sup>12</sup>.

Kjo kategori e të dënuarëve me përvojë më të dhimbshme të burgimit ishin të ndikuar më shumë nga mjedisi i jetesës dhe e kishin më të vështirë për të kërkuar dhe pranuar çdo lloj ndihmë të ofruar për të kaluar këtë situatë.

Një studim i gjërë mbi ekzaminimin e gjëndjes psikologjike të të dënuarëve gjatë kohës së hyrjes është kryer dhe nga Zamble dhe Porporino (1988). Studimi i tyre kishte si qëllim studimin e sjelljes dhe përshtatjes së të dënuarëve në Kanada. Të dënuarit u intervistuan disa javë pas hyrjes së tyre në paraburgim dhe u ri-intervistuan në një periudhë kohe pas katër dhe gjashtëmbëdhjetë muajsh.

Gjatë kohës së hyrjes në institucionin e paraburgimit të paraburgosurit kishin kaluar kohë të vështira dhe kishin shfaqur nivele të larta të shqetësimit dhe stresit. Megjithatë, disa problematika u vëzhguan dhe u identifikuan nga intervistat e kryera pas disa javësh të qëndrimit të tyre në paraburgime të Kanadasë. Disa prej shqetësimeve të referuara nga vetë të paraburgosurit gjatë periudhës së paraburgimit janë renditur sipas kategorive të mëposhtme: mungesa e familjarëve; mungesa e lirisë; mungesa e aktiviteteve ose objekteve specifike; konfliktet me të dënuarit e tjerë; keqardhje për të shkuarën; shqetësime mbi të ardhmen; mërzitje; kushtet e jetesës në burgje; mungesën e ndihmës nga ana e stafit të burgut; shqetësimi mbi sigurinë; mungesë e programeve dhe aktiviteteve. Në të vërtetë, të qenit larg familjarëve dhe shokëve ka qënë një nga problemet më të vështira për të paraburgosurit gjatë javëve të para të paraburgimit.

Ndëveprimi midis individit dhe mjedisit është një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e eksperiencës së burgimit. Në mënyrë që individi të përshtatet me jetesën brenda burgut dhe të mbijetojë psikologjikisht është aftësia e kombinimit të kërkesave individuale me mjedisin. Nga studiuesit në këtë fushë janë përcaktuar shtatë nevoja kryesore të një të dënuari: siguri, privatësi, strukturë, reagim emocional, mbështetje, aktivitete dhe liri<sup>13</sup>. Kur ka një "përshtatje" midis kërkesave të individit dhe aftësisë së mjedisit për të përmbushur këto kërkesa, atëherë mund të ndodhë një rregullim i suksesshëm.

Duke u bazuar në këto studime duket qartë lidhja e mjedisit me përvojën e burgimit. Për më tepër, duket se mjedisi mund të kompensojë ankthin dhe stresin e përjetuar nga të burgosurit. Nga ana tjetër të burgosurit me një histori të vështirësive psikike dhe sjelljeve për vetë-dëmtim rezultojnë të shfaqin më pak ankth kur përshihen më shumë në aktivitete si ajrim, punësim, shtimi i kontakteve me anëtarët e familjes si dhe pjesëmarrja në kurse të ndryshme. Nga ana tjetër të dënuarit me probleme të para-ekzistuese të shëndetit mendor duket se burgu mund të jetë faktor në rikthimin e gjëndjes së tyre problematike, ose mund të kontribuojë më tej duke shtuar ankthin dhe problemet psikologjike si përgjigje ndaj mjedisit që i rrethon<sup>14</sup>. Shumë të burgosur përjetojnë probleme të shëndetit mendor para se të hyjnë në portën e burgut dhe përvoja e burgut mund të shfaqë sfida të mëtejshme sociale dhe psikologjike. Pra, si mund ti përgjigjet stafi nevojave psikologjike të të burgosurve? Si mund të burgosurit

<sup>12</sup> Harvey, J. (2007) *Young Men in Prison: Surviving and Adapting to Life Inside*. Cullompton: Willan Publishing.

<sup>13</sup> Toch, H. (1977/1992) *Living in Prison: The Ecology of Survival*. Washington, DC: American Psychological Association.

<sup>14</sup> Liebling, A. and Maruna, S. (eds) (2005) *The Effects of Imprisonment*. Cullompton: Willan Publishing.

të ndihmohen për tu përbulluar me eksperiencën e burgut? Në të vërtetë, si mund të parandalohen problemet psikologjike burgosurve nga ana e stafit multidisiplinar? Alternativa më e mirë është ajo e ofrimit të terapisë psikologjike dhe metodave të tjera ndihmëse në parandalimin dhe trajtimin e problemeve mendore të të dënuarve dhe paraburgosurve.

Përse është e nevojshme terapia? Psikoterapia përkufizohet si “një proces ndërpersonal i krijuar për të modifikuar ndjenjat, perceptimet, qëndrimet dhe sjellen që shfaqen tek një individ dhe që kërkon ndihmë nga një profesionist i fushës”<sup>15</sup>. Format e terapive që praktikohen janë shumë dhe janë klasifikuar në shtatë fusha kryesore: psikodinamika; konjitive biheviore; ndërpersonale; strategjike ose sistematike; mbështetëse dhe eksperimentale; grupe dhe këshillim .<sup>16</sup>

Shumë studime meta-analitike kanë identifikuar terapinë konjitive – biheviore (TKB) si një ndërhyrje efektive në reduktimin e recidivizmit tek kategoria të mitur të paraburgosur/të dënuar dhe të dënuar kategori e rritur. Për këtë qëllim autorët Pearson, Lipton, Cleland, dhe Yee (2002), kanë ndërrmarë rreth 69 studime kërkimore mbi programet biheviore dhe konjitive –biheviore të cilat zbatohen në burgje.

Nga studimet e kryera ato gjetën se programet konjitive – biheviore ishin më efektive në reduktimin e recidivizmit sesa vetë programet e sjelljes (biheviore), me ulje të recidivizmit sipas target grupit rreth 30%. Po ashtu edhe në studimet e kryera nga autorët Wilson, Bouffard, dhe MacKenzie (2005)<sup>17</sup> të cilët studiuuan 20 programet konjitive biheviore, të ndara sipas kategorive specifike të trajtimit, ku rezultoi se trajtimi konjitiv bihevioral ishte shumë efektiv në reduktimin e sjelljes kriminale. Në analizën e tyre autorët argumentuan se të dënuarit të cilët ishin trajtuar me programet konjitive biheviore kishin rezultuar në zvogëlim të recidivizmit në masën 20-30%. Këto studime gjithashtu ofruan një indikacion të fortë mbi efikasitetin e trajtimit konjitiv bihevioral për të dënuarit, si dhe nënvizuan një ndryshueshmëri të konsiderueshme brenda kategorisë së të dënuarve, rezultateve të variablëve, cilësisë së studimit të hartuar dhe variacionit se çfarë është marrë në konsideratë si trajtim konjitiv–bihevioral.

Studimi i ndërmarrë nga Lipsey, Chapman, dhe Landenberger (2001) ekzaminoi 14 studime eksperimentale dhe gjysmë-eksperimentale që vendosnin theksin tek ndryshimet konjitive si një kusht i përcaktimit të terapisë konjitive biheviore, duke konsideruar vetëm efektet tek të dënuarit që kanë rikryer një krim, tek recidivizmi si një rezultat i trajtimit. Rezultatet treguan se shanset për të rikryer krimin tek të dënuarit të cilët kishin qënë pjesëmarrës në programet e trajtimit konjitiv bihevioral ishin rreth 55% sesa tek të dënuarit që nuk kishin marrë pjesë në këto programe.

Si përfundim mund të themi se: bazuar në një mesatare studimet kanë treguar se trajtimi konjitiv bihevioral ka një efekt pozitiv në recidivizëm. Megjithatë, duhet të merret në konsideratë variablat mbi madhësinë e efekteve të trajtimit.

Identifikimi i variablave që përshkruajnë karakteristikat e studimit të lidhura me

<sup>15</sup> Roth, A. and Fonagy, P. (2005) What Works For Whom? A Critical Review of Psychotherapy Research. London: The Guilford Press.

<sup>16</sup> Po aty, kapitulli 1

<sup>17</sup> Wilson, D. B., Bouffard, L. A., & MacKenzie, D. L. (2005). A quantitative review of structured, group-oriented, cognitive-behavioral programs for offenders. *Criminal Justice & Behavior*, 32, 172-204.

<http://www.ndcrc.org/content/quantitative-review-structured-group-oriented-cognitive-behavioral-programs-offenders>

efektet e mëdha dhe të vogla mund të hedhë dritë mbi efektshmërinë e TKB-së tek të dënuarit.

## Referenca

- Brooker, C., Duggan, S., Fox, C., Mills, A. and Parsonage, M. (2008) Short Changed: Spending on Prison Mental Health Care. London: Sainsbury Centre for Mental Health.
- Davies, P (1999) Gender, Crime and Victimization, pg 152.
- Durcan, G. and Knowles, K. (2006) London's Prison Mental Health Services: A Review. London: Sainsbury Centre for Mental Health.
- DH and HMPS (2001) Changing the Outlook: A Strategy for Developing and Modernising Mental Health Services in Prisons. London: Department of Health.
- Harvey, J. (2007) Young Men in Prison: Surviving and Adapting to Life Inside. Cullompton: Willan Publishing.
- Jenkins, R., Bhugra, D., Meltzer, H., Singleton, N., Bebbington, P., Brugha, T., Coid, J., Farrell, M., Lewis, G. and Paton, J. (2005) 'Psychiatric and social aspects of suicidal behaviour in prisons', *Psychological Medicine*, 35.
- Liebling, A. and Maruna, S. (eds) (2005) *The Effects of Imprisonment*. Cullompton: Willan Publishing.
- Roth, A. and Fonagy, P. (2005) *What Works For Whom? A Critical Review of Psychotherapy Research*. London: The Guilford Press.
- Singleton, N., Bumpstead, R., O'Brien, M., Lee A. and Meltzer, A. (2000) *Psychiatric Morbidity Among Adults Living in Private Households 2000*. London: Office for National Statistics.
- Singleton, N., Meltzer, H. and Gatward, R. (1998) *Psychiatric Morbidity Among Prisoners*. London: Office for National Statistics.
- Social Exclusion Unit 2002.
- Toch, H. (1977/1992) *Living in Prison: The Ecology of Survival*. Washington, DC: American Psychological Association.
- Wilson, D. B., Bouffard, L. A., & MacKenzie, D. L. (2005). A quantitative review of structured, group-oriented, cognitive-behavioral programs for offenders. *Criminal Justice & Behavior*, 32, 172-204.
- <http://www.ndcrc.org/content/quantitative-review-structured-group-oriented-cognitive-behavioral-programs-offenders> [https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/248370/0118.pdf](https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/248370/0118.pdf)
- [https://www.griffith.edu.au/\\_data/assets/pdf\\_file/0017/518102/Suicide-Research-Text-Vol1.pdf](https://www.griffith.edu.au/_data/assets/pdf_file/0017/518102/Suicide-Research-Text-Vol1.pdf)



## Vet-koncepti dhe çrregullimet e të ngrënit

**Semiramida Manaj**

*Doktorante, Universiteti i Tiranës*

### Abstrakt

Studime te ndryshme sasiore kanë treguar marrëdhënien midis çrregullimeve të të ngrënit dhe vetkonceptit, megjithatë pak dihet mbi mënyrën se si ndodh kjo marrëdhënie dhe janë të pakta studimet cilësore të realizuara në këtë fushë. Studimi aktual ka si qëllim të sjell një kuptim më të thellë të përvojës së vetes dhe çrregullimeve të të ngrënit, duke përdorur një qasje cilësore. Studimi u fokusua mbi përvojat e vajzave në adoleshencën e vonë dhe moshën e rritur të hershme dhe synohej t'i jepej përgjigje pyetjes : Si e përshkruajnë veten e tyre vajzat që kanë një çrregullim të ngrëni; mendimet dhe përvojat e tyre se pse e shohin veten në këtë mënyrë; dhe mendimet dhe përvojat e tyre në lidhje me faktin nëse ato mendojnë se ekziston një lidhje midis pikëpamjes së tyre për veten dhe çrregullimit të tyre të të ngrënit.

Intervistat e thelluara gjysmë të strukturuara janë kryer me katër vajza që janë diagnostikuar dhe janë nënshtruar trajtimit për një çrregullim të të ngrënit. Analiza e këtyre intervista u bë duke përdorur Analizën Interpretative Fenomenologjike (AIF). Gjithashtu është përdorur metoda biografike dhe shqyrtim i dokumentacionit në mbledhjen e të dhënave. Rezultatet: Përdorimi i Analiza interpretuese fenomenologjike lejoj depërtimin në thellësi të përvojave të pjesëmarrësve. Analiza rezultoi në katër tema të mëdha : Përjetimi i një ndjenjë të një vete të brishtë, e cila lidhet me perceptimet aktuale të tyre; Ndikimet e të tjerëve në vetë-perceptim; Strategjitë e përdorura për të menaxhuar ndjenjën e vetes, përfshirë marrëdhëniet midis vet-konceptit dhe çrregullimit të të ngrënit; Ndikimin e zgjatur të përvojave të hershme të së kaluarës tek vet-koncepti. Rezultatet e analizës janë konsideruar në përputhje me teoritë ekzistuese dhe implikimet e tyre klinike.

**Termet kyç:** vet-koncept, çrregullime të të ngrënit, vetëvlerësim.

### Hyrje

Studimi aktual është një Analizë Interpretative Fenomenologjike (Smith & Osborn, 2003; Smith, Flowers & Larkin, 2009) e vet-konceptit dhe çrregullimeve të të ngrënit tek vajzat adoleshente. Në këtë hyrje do të paraqitet qëllimi i këtij studimi dhe arsyet e përdorimit të Analizës Interpretative Fenomenologjike. Gjithashtu do të paraqitet informacion mbi literaturën ekzistuese mbi çrregullimet e të ngrënit dhe rolit të vet-konceptit. Qëllimi i studimit aktual është për të sjellë një kuptim të thellë të përvojës së vetes për vajzat me një çrregullim të ngrëni, duke përdorur një Analizë Interpretative Fenomenologjike (AIF) (Smith & Osborn, 2003, Smith, Flowers & Larkin, 2009).

Pyetja kryesore kërkimore është : Cili është vet-koncepti i vajzave me çrregullime të të ngrënit? Në lidhje me këtë pyetje kryesore kërkimore, janë hulumtuar fushat e mëposhtme të interesit: 1) Si e përshkruajnë aktualisht veten pjesëmarrëset në studim? 2) Nëse pjesëmarrësit kanë përjetuar ndryshime në pikëpamjen e tyre për veten në situata të ndryshme dhe me njerëz të ndryshëm? 3) Si e kanë parë veten pjesëmarrëset në të kaluarën e tyre (duke përfshirë periudhën para fillimit të çrregullimit të tyre të të ngrënit)? 4) Këndvështrimi i pjesëmarrësve se pse e shohin veten në këtë mënyrë

dhe me çfarë përvojash e lidhin këtë? 5) Cilat janë pikëpamjet e pjesëmarrësve mbi çështjen nëse ka ndonjë marrëdhënie midis mënyrës se si ato e shohin veten dhe çrregullimit të tyre të të ngrënit?

### Vet-koncepti

Epstein (1973) solli një këndvështrim të dobishme të teorive të vet-konceptit duke përmbledhur karakteristikat kryesore të vetë-konceptit: 1.Ai është një nënsistem i qëndrueshmërisë së brendshme, konceptet organizuar në mënyrë hierarkike të përfshira në kuadër të një sistemi më të gjerë konceptuale. 2.Ai përmban vete të ndryshme empirike, si vetja e trupit, vetja shpirtërore dhe një vetja sociale. 3.Ai është një organizëm dinamik që ndryshon me përvojën. 4.Ai zhvillohet nga përvoja, sidomos ndërveprimi social është shumë i rëndësishëm. 5.Vet-koncepti është esencial për funksionimin e individit. Kur vetë-koncepti kërcënohet, individit përjeton ankth dhe bën përpjekje për të mbrojtur veten nga kërcënimi. Nëse mbrojtja është e pasuksesshme, niveli i stresit rritet duke sjelle një çorganizim tërësor të individit. 6.Ekziston një nevojë themelore për vetë-vlerësim e cila ka të bëjë me të gjitha aspektet e vetes dhe është më e rëndësishme se gjithë nevojat e tjera. 7.Vetë-koncepti ka të paktën dy funksione themelore. Së pari, organizon gjithë përvojën tonë, veçanërisht përvoja që përfshijnë ndërveprim social. Së dyti, vetë-koncepti lehtëson përpjekjet për të përmbushur nevojat dhe për të shmangur zhgënjimin dhe ankthin.

### Perspektiva Konjitiv-Bihejviorale

Ky seksion bazohet në literaturën mbi rolin e vetë-skemës, vetvlerësimit, pakënaqësisë ndaj trupit dhe mekanizmit të "shmangies së problemit".

*Skema negative e vetes* -Vitousek dhe Hollon (1990) propozuan një kornizë të skemës së vetes për një kuptim njohës të çrregullimeve të të ngrënit, duke u bazuar në teorinë e skemës së vetes së Markus (1977). Përkufizimi në vijim i skemës së vetes është cituar nga Vitousek dhe Hollon (1990, p.195): Sipas Markus (1977), "Skema e vetes lidhet me përgjithësimet konjitive rreth vetes, që rrjedhin nga përvoja e kaluar dhe që organizojnë dhe udhëheqin përpunimin e informacionit të vetes lidhur me përvojat sociale të individit"(p.64)" Në rastin e çrregullimeve të të ngrënit, Vitousek & Hollon (1990) sugjerojnë se të individët më çrregullime të të ngrënit zhvillojnë skema mendore e rreth peshës dhe implikimet e saj për veten, të cilat ndikojnë negativisht tek perceptimet, mendimet dhe sjellja e tyre. Ata gjithashtu propozojnë që këto procese skematike bëjnë të mundur thjeshtëzimin, organizimin dhe stabilizimin e marrëdhënies mes personit me çrregullim të ngrëni dhe të mjedisit të jashtëm. Stein & Corte (2007) sugjerojnë se kjo dobësi e individëve me çrregullime të të ngrënit për t'u përballur me botën e jashtme bën të mundur që ta shohin pesën e trupit dhe formën trupore si një burim kryesor të vetë-përkufizimit.

*Vetëvlerësimi* - Vetëvlerësimi është një çështje e rëndësishme kur flasim për çrregullimet e të ngrënit. Nga shumë teoricienë është bërë e njohur se vetvlerësimi dhe çrregullimet e të ngrënit janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën dhe studime të ndryshme janë bërë për të parë shkallën në të cilën këto dy elementë lidhen më njëri-tjetrin. Shumë kërkime studimore kanë treguar se individët të cilët kanë çrregullime të ngrëni kanë më shumë

gjasa të kenë vetëvlerësim më të ulët sesa individët të cilët nuk kanë çrregullime me të ngrënit (De la Rie, Noordenbos, & Furth, 2005). Këto studime dhe studime të tjera kanë treguar se çrregullimet e të ngrënit janë të lidhura ngushtësisht me nivele të ulëta të vetëvlerësimit dhe vet-konceptit. Përveç kësaj, studime të fokusuara në lidhjen midis gjinisë dhe vetvlerësimit, kanë treguar se vajzat më shumë se djemtë kanë predispozitë të kenë nivele më të ulëta të vetëvlerësimit dhe të çrregullimeve të të ngrënit (Green, Scott, Cross, Liao, Hallengren, Davids, & Jepson, 2009). Lidhja midis vetëvlerësimit dhe çrregullimeve të të ngrënit është provuar empirikisht kohë pas kohe. Në disa raste, dëshmia për këtë marrëdhënie është aq e fortë saqë disa studiues mendojnë se vetëvlerësimi i ulët është një parakusht kryesor i nevojshëm për çrregullimet e të ngrënit (Silverstone, 1992). Një profil i komponentëve të vetë-konceptit që janë karakteristikë e vetëvlerësimit të ulët janë: pasiguria, gjenjdje e keqe humori dhe depresioni, imazhi i dobët për trupin, ndjenjat e paaftësisë sociale dhe tërheqjen personale, aftësi të dobëta të përshtatjes, dhe vendosja e qëllimeve jorealiste të larta (Steinhausen, 1993). Të gjitha këto tipare janë parë mjaft konsistente në pacientët me çrregullimet e të ngrënit.

Përveç kësaj, pacientët me çrregullime të të ngrënit gjithashtu shfaqin tipare të tjera të lidhura me vetëvlerësimin e ulët, të tilla si probleme me vetë-imazhin e përgjithshëm të tyre, shqetësimin e tepruar mbi peshën dhe formën trupore, dhe globalisht qëndrimet negative për vetkontrollin dhe disiplinën (Button, 1997). Metodologjia për kërkime që çon në këto përfundime rreth çrregullimeve të të ngrënit dhe vetëvlerësimit të ulët përfshin elemente të tilla si pyetësorë për shqyrtimin e sjelljeve të të ngrënit, instrumenta për matjen e vetëvlerësimit dhe për mirëqënien e përgjithshme psikologjike (të tilla si pyetësor vetë-imazhi), depresioni dhe shkalla e vetvlerësimit (të tilla si shkalla e vetëvlerësimit e Rosenberg) intervista personale me mjekë, psikologë dhe studiues, dhe më në fund testet projektuar posaçërisht për çrregullime të të ngrënit.

*Imazhi për trupin* - Stein & Corte (2003) deklarojnë se shumica e hulumtimeve për rolin e vetes në çrregullimet e të ngrënit është fokusuar mbi imazhin e trupit, praninë e një imazhin negativ për trupin duke qenë një simptomë si e anoreksisë dhe e bulimisë në DSM-IV-TR (APA, 2000). Imazhi negativ për trupin përfshin dy dimensione të ndryshme: shtrembërim i perceptimit të formës trupore dhe pakënaqësi ndaj formës trupore (Cash & Deagle, 1997). Hulumtimet kanë treguar se femrat me anoreksi dhe bulimi kanë më shumë gjasa për të përshkruar veten si të shëndosha dhe të pakënaqura me peshën e tyre trupore (Cash & Deagle, 1997), dhe se këto mendime të deformuara për peshën dhe formën trupore janë parashikuese të kontrollit të peshës dhe të ngrënit.

*Arratisja nga problemi* - Heatherton dhe Baumeister (1991), kanë propozuar një model të procesit kontrollit të të ngrënit si një mënyrë për të ikur nga vetja. Modeli fillon me propozimin që individët me çrregullime të të ngrënit kanë standarde dhe pritshmëri jashtëzakonisht të larta. Kjo përfshin si standardet e tyre dhe atë që ata e perceptojnë që të tjerët presin prej tyre, dhe mendohet që kanë të bëjnë jo vetëm me standardet për formën trupore, por edhe standardet për arritje në fusha të tjera. Këto standarde jashtëzakonisht të larta mund të rezultojnë në dështime të pashmangshme, duke rezultuar në një perceptim të vetes si të pamjaftueshme. Ky perceptim i vetes ndikon duke rritur nivelin e ankthit dhe humor të ulët. Për t'ju shmangur dështimit që mund

të sjellin standartet dhe pritshmëritë shumë të larta, gjejnë një rrugë më të lehtë për t'u përballuar me botën dhe për t'u ndjerë të vlerësuar.

### **Kërkimet cilësore ekzistuese për vet-konceptin dhe çrregullimet e të ngrënit**

Brooks, LeCouteur dhe Hepworth (1998) kryen një analizë diskursi të intervistave me dhjetë gra dhe një burrë me bulimi nervore. Qëllimi i tyre ishte të analizonin shumëllojshmërinë e versioneve të vet-konceptit tek bulimikët bazuar tek gjuha e përdorur. Ata identifikuan repertorë të ndryshëm të përdorur nga pjesëmarrësit, shumica e të cilëve jepnin versione shumë negative të vetes, të tilla si "viktimë", "i/e dobët", "fëminore", "mungesë energjie", "jonormal", dhe "fanatik". Megjithatë, tek pjesëmarrësit u vunë re edhe kontradikta në repertorin e tyre duke përdorur disa përshkrime më pozitive të vetes si "në kontroll" dhe "të veçantë". Përveç pyetjeve ndaj pjesëmarrësve për të përshkruar veten dhe eksperiencën e tyre me buliminë, intervista 50-90 minutëshe synonte të eksploronte gjithashtu mendimet e pjesëmarrësve se : pse bulimia është më e zakonshme në femrat sesa për meshkujt; krahasimet midis anoreksisë dhe bulimisë; komente mbi përkufizimin DSM-IV të bulimisë si çrregullim të ngrëni, sëmundje dhe sëmundje mendore; dhe përshkrimet për eksperiencat e tyre të trajtimit dhe përvojat me ndihmën profesionale, nëse kishin marrë një të tillë.

Një tjetër analizë diskursi për çrregullime të të ngrënit dhe vet-konceptit është kryer nga Hayes et.al (2006) këtë herë me pesë gratë diagnostikuar me anoreksi nervore. Gjatë intervistës, pjesëmarrësit u inkurajuan të "përshkruajnë plotësisht pikëpamjet e tyre për veten dhe rrethanat që kanë sjellë çrregullimin duke bërë krahasimin para dhe pas terapisë" (fq 24). Një pjesëmarrës e përshkroi veten si "një person në thelb i shëndetshëm e cila thjesht e kishte ekzagjeruar me kontrollin ndaj ushqimit "" (fq 25) dhe i cila kishte qenë "budallaqe" për të lejuar që situata të arrinte në këtë fazë për të kërkuar trajtim spitalor. Një tjetër pjesëmarrës përshkruan veten e saj "të shëndetshme, por e plagosur vazhdimisht nga kërkesat sociale dhe kritike, ndërkohë që vetja e saj anoreksike kërkonte thjesht të mbrohej". Në fjalët e katër pjesëmarrësve të tjerë anoreksia e tyre shihej si një "gjendje të përsosur" dhe veten e tyre si të dështuar për të arritur atë, gjendje në të cilën ata do të ndiheshin "më të fortë", "superiore" dhe "të shëndetshëm".

Norbo, Espeset, Gulliksen, Skarderud & Holte (2006) aplikuan një qasje përshkruese fenomenologjike në një studim të tetëmbëdhjetë vajzave të moshës midis 20 dhe 34 vjeç me anoreksi. Qëllimi i këtij studimi ishte shqyrtonin kuptimin që pjesëmarrësit i atribuonin sjelljes së tyre anorektike. Rezultatet e analizave ishin të ndara në tetë konstrukte, dy nga më të rëndësishmet ishin për vetë-konceptin: "Vetë-besimi", që përfshinte ndjesinë pozitive të pjesëmarrësve gjatë së marrjes komplimenteve për humbje peshe, dhe "Identiteti", e cila është përshkruar nga pjesëmarrësit si arrija e një identitet të ri përmes anoreksisë për t'u bërë më të këndshëm, më e fortë dhe më të prekshëm. Në këtë studim është përdorur një analizë interpretative fenomenologjike.

## **Metodologjia**

Për të sjellë një këndvështrim më të thellë të çështjes zgjedha një metodologji cilësore. Qasjet cilësore kanë avantazhin e të parit në thellësi dhe studim të hollësishëm të fenomeneve që nuk janë lehtësisht të matshme, si në këtë studim të "përvojës së vetes / vet-konceptit". Analiza interpretative fenomenologjike (IPA) (p.sh. Smith & Osborn,

2003; Smith, Flowers & Larkin, 2009) është metoda cilësore e zgjedhur për këtë studim, sepse është në përputhje me qëllimet e hulumtimit, për shqyrtimin e mënyrës se si njerëzit i japin kuptim përvojave të mëdha të jetës së tyre (Smith et al. 2009).

*Dizajni i kërkimit:* Studimi ka dizajn kërkimor cilësor ndërsektorial. Është zgjedhur një kampion pjesëmarrësish në mënyrë të qëllimshme, në përputhje me kërkesat e IPA-s për një kampion të vogël. Në studim janë përdorur metodat : 1.Intervista të thelluara, të cilat u regjistruar në audio, u transkriptuan fjalë për fjalë dhe më pas u analizuan duke përdorur IPA-n; 2.Metoda biografike, në të cilën është analizuar fenomeni i shtrirë në kohë dhe janë analizuar faktor të ndryshëm gjatë jetës të cilët kanë ndikuar në konceptin për veten tek vajzat më çrregullime të të ngrënit; dhe 3. Shqyrtimi i dokumentacionit, ku përfshiheshin dosjet klinike të pjesëmarrësve dhe shqyrtimi i literaturës ekzistuese. Përmes këtyre metodave është arritur në një të kuptuar më të thellë të mënyrës se si e shohin veten vajzat pjesëmarrëse me çrregullime të të ngrënit. *Rekrutimi i pjesëmarrësve:* Pjesëmarrëset në studim janë 4 vajza të rekrutuara nga Qëndrat Komunitare të Shëndetit Mendor 1, 2 & 3 në Tiranë. Vajzat me çrregullime të të ngrënit aktualisht marrin trajtim psikologjik dhe mjekësor në këto qendra. Pse katër raste? Jonathan Smith dhe kolegët e tij (2009) kanë publikuar “Interpretative Phenomenological Analysis: Theory, Method and Research”, në të cilin tregohet mënyra e përdorimit të analizës interpretative fenomenologjike dhe faktit se hulumtuesit cilësor së fundmi po përdorin në studimet e tyre gjithmonë edhe më shumë një numër të vogël rastesh, madje edhe një studim rasti të vetëm.

*Kriteret përfshirëse dhe përjashtuese:* Pjesëmarrëset në studim duhet të ishin të diagnostikuara me një çrregullim të të ngrënit (anoreksi nervore, bulimi nervore, çrregullim të ngrëni i paspecifikuar gjetiu, çrregullim i dëshirës së lartë për të ngrënë). Pjesëmarrëset duhet të ishin femra midis 16-25 vjeç. Çrregullimet e të ngrënit janë probleme më të vërejtura në adoleshencën e vonë dhe tek femrat e në fillim të moshës së rritur të hershme dhe janë të lidhura me komplikacione psikiatrike dhe mjekësore (American Psychiatric Association, 2000). Gjithashtu janë përzgjedhur vetëm pjesëmarrëse femra sepse përafërsisht 90%-95% të pacientëve me çrregullime të të ngrënit janë femra (Steiner & Lock, 1998). Në studim nuk janë përmendur emrat e pjesëmarrësve, por ato janë zëvendësuar me emra të tjerë.

Tabela 1. Të dhëna për pjesëmarrëset në studim

Pjesëmarrëset	Mosha	Diagnoza	Kohëzgjatja e çrregullimit
Klara	17 vjeç	Anoreksi	3 vjet
Ana	24 vjeç	Bulimi	5 vjet
Diana	19 vjeç	Çrregullim i paspecifikuar gjetiu	3 vjet
Nela	20 vjeç	Anoreksi	4 vjet

*Mbledhja e të dhënave* - Për mbledhjen e të dhënave u përdorën intervista gjysmë të

strukturuara, të cilat ishin në përputhje me qëllimin e studimit tim. Për ndërtimin e intervistave jam bazuar tek literatura përkatëse dhe udhëzimet e botuara për zhvillimin e intervistës (p.sh. Smith & Osborn, 2003). Çështjet e intervistës janë trajtuar në mënyrë fleksibile, në mënyrë që të lejohej trajtimi i çështjeve të papritura që mund të dilnin gjatë intervistës.

*Konsiderata metodologjike* - Një pikë e fortë e metodologjisë së përdorur është depërtimi në thellësi të eksperiencës së pjesëmarrësve. Intervistat janë analizuar në çdo detaj dhe me shumë kujdes për të garantuar rigorozitetin e studimit dhe për të lehtësuar procesin analizues interpretativ. Numri i vogël i pjesëmarrësve në studim është një pikë e fortë e studimit dhe siguron një analizë të thellë të zërit të secilës pjesëmarrëse. Një tjetër pikë e fortë e studimit është përfshirja e vajzave me çrregullime të të ngrënit të diagnostikuara nga një ekip multidisiplinar në qendrat ku ato aktualisht marrin trajtimin e duhur.

## Rezultatet

Në seksionin e mëposhtëm të gjetjet do të diskutuan në lidhje me teorinë dhe evidencat ekzistuese, rëndësia e studimit dhe sugjerime për kërkime të ardhshme.

### Perceptimi aktual i vetes

Rezultatet treguan se pjesëmarrëset kishin një vete të brishtë, perceptimi i vetes ishte kryesisht negativ dhe kjo dukej edhe në nivelet e tyre të lartë të perfeksionizmit dhe vetë-kritikës. U gjet se pjesëmarrëset kishin vet-konceptet mjaft të brishtë dhe për shkak të përvojave të tyre ndiheshin të pasigura në lidhje me veten (Nela, Diana dhe Klara), madje kishin ndjenjën e të qënurit "e fragmentuar" (Ana). Kjo pasiguri dhe përvoja e të ndjerit e fragmentuar mund të ketë qenë rezultat i përdorimit të strategjive shmangëse përballuese (Heatherton & Baumeister, 1991; Hayes, Strosahl dhe Wilson, 1999), një strategji e cila është diskutuar më tej në seksionin më poshtë. (Kennerly, 1996) ka gjetur se disocimi (për shembull, si një mënyrë për të përballuar traumën) mund të lidhet me fragmentimin e identitetit, siç është gjetur në çrregullimin e disocuar të identitetit (Kennerly, 1996, Mollon, 2001).

Gjetjet se pjesëmarrësit kishin aktualisht pikëpamje kryesisht negative për veten është në përputhje me gjetjet e mëparshme, nga Bruch (p.sh. 1973). Gjetjet janë gjithashtu në përputhje me studimet e mëparshme cilësore, të tilla si Brooks, LeCouteur dhe Hepworth (1998) mbi analizën e diskursit me gratë bulimike, tek të cilat u gjetën kryesisht pikëpamje negative të vetes, të tilla si "e dobët", "mungesë energjie" dhe "e parregullt".

Një tjetër gjetje ishte që tek pjesëmarrëset vihen re nivele të larta të perfeksionizmit dhe tendenca e vetë-kritikës. Lidhja midis perfeksionizmit dhe çrregullimeve të të ngrënit është treguar edhe nga studime të ndryshme që kanë synuar të zbulojnë këtë marrëdhënie (Bardone-Cone et al 2007; Sherry & Hall, 2009).

## **Ndryshimet në konceptin për veten në situata të ndryshme dhe me njerëz të ndryshëm**

Gjetjet ishin që tek pjesëmarrëset perceptimi i vetes ishte i ndikuar nga ndërveprimet e tyre me të tjerët, si pozitivisht dhe negativisht. Kjo është në përputhje me teoritë e përgjithshme rreth vetes, që thotë se vetja është përjetuar në mënyrë racionale (p.sh. Mead, 1934), dhe kështu që nuk është një tipar i vetes tek vajzat me çrregullime të të ngrënit në mënyrë specifike. Megjithatë, shkalla e ndikimit e përshkruar në përgjigjet e pjesëmarrësve duket të jetë e një shkalle më të madhe se zakonisht. Për shembull, ndjenja e Anës e të qenit "shumë e fuqishme" kur merr një vlerësim pozitiv nga miqtë e saj dhe ndjenja e Klarës e të qenit "një hiç" në lidhje me familjen e saj, tregojnë për dy implikime negative dhe pozitive, të cilat janë shpjeguar në paragrafët më poshtë.

### **Vet-koncepti në kohë të ndryshme dhe origjina e vet-konceptit**

Gjetjet lidhur me faktorët që pjesëmarrësit i atribuojnë përvojave të tyre ndahen në tre kategori kryesore: kritika e brendësuar nga kujdestarët, rolet e ndryshme të marra nga anëtarët e familjes dhe ndikimi i traumave.

*Kritika e brendësuar nga kujdestarët* - U gjet se kritika nga kujdestarët kryesorë u interpretua nga pjesëmarrësit si e brendësuar, duke çuar në vetë-kritikë. Në shumicën e pjesëmarrësve kjo erdhi nga prindërit e tyre. Këto gjetje tregojnë që përgjithësisht pacientët me çrregullime të të ngrënit përshkruajnë një mjedis familjar kritikues dhe prindër kontrollues (Hepworth, 1999). Këto gjetje janë gjithashtu në përputhje me vëzhgimet klinike të Bruch (1973) që prindërit perfeksionist kufizon mundësinë e fëmijës për të qënë një individ autonom, dhe për këtë arsye ndërhyjnë në zhvillimin e një koncepti të qartë për veten.

*Rolet familjare* - U gjet se rolet familjare kanë pasur shumë ndikim në zhvillimin e vet-konceptit të pjesëmarrësve dhe rrjedhimisht edhe me sjelljet e tyre të të ngrënit. Këto rezultate tregojnë ndikimin e sistemeve familjare në çrregullimet e të ngrënit (p.sh. Dare & Eisler, 1997), si dhe studimet më të fundit tregojnë për rolin e natyrës së marrëdhënieve midis motrave/vëllezërve, (p.sh. Bachner-Melman, 2005) tregojnë ndikim të rivalitetit midis motrave / vëllezërve në çrregullimet e të ngrënit.

*Ndikimi i traumave* - Gjetjet e këtij studimi tregojnë se abuzimi dhe trauma mund të kenë efekt negativ në vet-koncept dhe se ky është një faktor që çon në zhvillimin e çrregullimeve të të ngrënit. Lidhja midis përvojave negative të hershme dhe vet-skemave negative është mbështetur edhe në literaturë (p.sh. Beck et al 1979). Teoritë që tregojnë lidhjen midis simptomave disociative dhe traumës (Kennerley, 1996) gjithashtu ofrojnë një shpjegim për pse trauma mund të çojë në probleme me vet-konceptin.

### **Marrëdhënia midis vet-konceptit dhe çrregullimeve të të ngrënit**

U gjet se pjesëmarrëset janë përpjekur të largohen nga mënyra se si ato e shohin veten realisht përmes sjelljeve të tyre të të ngrënit. Në rastin e Anës ajo shprehet se "kontrolli i ushqimit dhe peshës më largon nga mënyra se si unë ndjehen për veten time. Gjithashtu për pjesëmarrëset e tjera këto sjellje të të ngrënit janë funksionale

për t'i ndihmuar ato të shmangin emocionet negative që ato ndiejnë për veten. Për shembull, Klara përshkruan kufizimi i ushqimit e ndihmon për të përballuar mendimet negative për veten, ndërsa Diana dhe Nela shprehën se përdorur ushqimin dhe ushtrimet fizike për të menaxhuar stresin. Këto rezultate përshtaten me "bllokimin" e emocioneve dhe tendencës për t'iu shmangur problemit real të diskutuara në hyrje (Heatherton dhe Baumeister, 1991).

Në përgjigjet e Dianës dhe Nelës vihet re përdorimi i të ngrënit dhe ushtrimeve fizike si një mënyrë për të arritur një ndjenjë kontrolli dhe vetë-efikasiteti përballë rrethanave të tjera pakontrollueshme dhe të vështira. Fairburn et al (2009) thekson se individët të cilët kanë nivele të larta të përfeksionizmit, por vet-efikasitet të ulët, kanë nevojë për kontroll absolut mbi të paktën një fushë të jetës, një propozim që ka qenë i përfshirë në modelet e mëvonshme të çrregullimeve të të ngrënit.

Klara përshkroi se ndihej e vet-realizuar përmes humbjes së peshës, e cila ishte e vetmja sferë e jetës në të cilën ajo ndihej kështu. Mënyra e saj e përjetimit duket se përshtatet më së miri me përshkrimin e Bruch (1973) për anoreksinë nervore si "një betejë të dëshpëruar për një identitet me vet-respekt"(fq 250).

## Diskutim

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të sillte një kuptim më të thellë të perceptimit të vetes tek vajzat me çrregullime të të ngrënit. Përdorimi i Analiza interpretuese fenomenologjike lejoj depërtimin në thellësi të përvojave të pjesëmarrësve. Analiza rezultoi në katër tema të mëdha :Tema e parë "Unë pyes gjithmonë veten kush jam unë?": Përjetimi i një ndjenjë i një vete të brishtë, e cila lidhet me perceptimet aktuale të tyre. Tema e dytë :“Ndikimet e të tjerëve në vetë-perceptim.” Tema e tretë : “Kontrolli i ushqimit dhe peshes më bëri të ndihem më mirë me veten time”: Strategjitë e përdorura për të menaxhuar ndjenjën e vetes, përfshirë marrëdhëniet midis vet-konceptit dhe çrregullimit të të ngrënit. Tema e fundit e dalë nga analiza ishte : "Unë nuk mundem të largohem nga fëmijëria ime": Ndikimin e zgjatur të përvojave të hershme tek vet-koncepti"

## Përfundime

Rezultatet e gjetura nga ky studim janë në përputhje me teoritë dhe literaturën ekzistuese dhe u diskutuan kryesisht në lidhje vet-konceptin e brishtë të gjetur në përshkrimet e pjesëmarrësve; strategjitë shmangëse përmes çrregullimeve të të ngrënit dhe rolin e përfeksionizmit të dëshiruar social. Ky studim synoi të siguronte një përfaqje më në thellësi të eksplorimit të lidhjes ndërmjet vet-konceptit dhe çrregullimeve të të ngrënit, në një përpjekje për të ndriçuar proceset e përfshira në këtë marrëdhënie.

## Bibliografia

1. American Psychiatric Association (2000). Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders: Fourth Edition, Text Revision. Arlington, VA: American Psychiatric Association.
2. Beck, A. T., Rush, A. J., Shaw, B. F. & Emery, G. (1979). Cognitive therapy of depression.



- New York: Wiley.
3. Bruch, H. (1973). *Eating Disorders: Obesity, Anorexia Nervosa, and the Person Within*. United States: Basic Books.
  4. Brooks, A., LeCouter, A. & Hepworth, J. (1998). Accounts of Experiences of Bulimia: A Discourse Analytic Study. *International Journal of Eating Disorders*, 24, 193-205.
  5. Button, Eric J., Philippa Loa Jo Davies, and Edmund Sonuga-Barke. "Self-esteem, eating problems, and psychological well-being in a cohort of schoolgirls aged 15-16- A questionnaire and interview study". *International Journal of Eating Disorders*. Vol. 21, (1), 39-47. 1997.
  6. Cash, T. F. & Deagle, E. A. (1997). The nature and extent of body-image disturbances in anorexia nervosa and bulimia nervosa: A meta-analysis. *International Journal of Eating Disorders*, 22, 107-125.
  7. De la Rie, S. M., Noordenbos, G., & van Furth, E. F. (2005). Quality of Life and Eating Disorders. *Quality of Life Research*, Vol. 14.
  8. Epstein, S. (1973). The self-concept revisited, or a theory of a theory. *American Psychologist*, 28, 404-416.
  9. Fairburn, C. G., Cooper, Z., Doll, H. A., O'Connor, M. E., Bohn, K., Hawker, D. M., Wales, J. A. & Palmer, R. L. (2009). Transdiagnostic Cognitive-Behavioural Therapy for Patients with Eating Disorders: A Two-Site Trial With 60-Week Follow-Up. *American Journal of Psychiatry*, 166, 311-319.
  10. Green, M. A., Scott, N. A., Cross, S. E., Liao, K., Hallengren, J. J., Davids, C. M., & ... Jepson, A. J. (2009). Eating disorder behaviors and depression: a minimal relationship beyond social comparison, self-esteem, and body dissatisfaction. *Journal of Clinical Psychology*, 65(9), 989-999.
  11. Hayes, S. C., Luoma, J. B., Bond, F. W., Masuda, A. & Lillis, J. (2006). Acceptance and Commitment Therapy: Model, processes and outcomes. *Behaviour Research and Therapy*, 44, 1-25.
  12. Heatherton, T. F. & Baumeister, R. F. (1991). Binge eating as escape from self-awareness. *Psychological Bulletin*, 110(1), 86-108.
  13. Kennerly, H. (1996). Cognitive therapy of dissociative symptoms associated with trauma. *British Journal of Clinical Psychology*, 35, 325-340.
  14. Mollon, P. (2001). *Releasing the self: The healing legacy of Heinz Kohut*. London: Whurr Publishers.
  15. Nordbo, R. H. S., Espeset, E. M. S., Gulliksen, K. S., Skårderud, F. & Holte, A. (2006). The Meaning of Self-Starvation: Qualitative Study of Patients' Perception of Anorexia Nervosa. *International Journal of Eating Disorders*, 39(7), 556-564.
  16. Silverstone, P.H. "Is chronic low self-esteem the cause of eating disorders?". *Medical Hypotheses*. Vol. 39, 311-315. 1992.
  17. Smith, J. A., Flowers, P. & Larkin, M. (2009). *Interpretative Phenomenological Analysis: Theory Method and Research*. London: Sage.
  18. Smith, J. A. & Osborn, M. (2003). Interpretative phenomenological analysis. In J. A. Smith (Ed.) *Qualitative Psychology: A practical guide to research methods*. London, Sage
  19. Stein, K. F. & Corte, C. (2007). Identity Impairment and the Eating Disorders: Content and Organization of the Self-Concept in Women with Anorexia Nervosa and Bulimia Nervosa. *European Eating Disorders Review*, 15, 58-69.
  20. Steiner H, Lock J. Anorexia nervosa and bulimia nervosa in children and adolescents: a review of the past ten years. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1998; 37:352-359.
  21. Vitousek, K. B. & Hollon, S. D. (1990). The Investigation of Schematic Content and Processing in Eating Disorders. *Cognitive Therapy and Research*, 14(2), 191-214.

## The role of human resources in economic development in the Republic of Kosovo

PhD (C.) Ibrahim Kryeziu  
*European University of Tirana, Albania*

### Abstract

Human resources are one of crucial agents in the development of one Country. The Employees through their knowledge, capabilities and innovation are to a large extent contributing in labor production and in the same time in economic development. The Methodology of this study is based upon the quality of human resources and in its impact on overall development. The Government through investment in human resources, affects in capacity building of the employees which at the same time influences the overall economic development of the Country. The dynamics of economic development in a Global Market, in particular in the field of Technology, Information and Communication, demands knowledge and high level capacity of employees in the Labor Market. In order to have in trend of modern development dynamics of employees, the education ought to be permanent, in particular capacity building of active labor force. The indicators of human resources in the Global index of competition of a National Economy have been shown too. Sa particular emphasis has been put on investments for strategic development purposes of Kosova's human resources and in particular the policies that Government may implement in this field in order to strengthen the educational system and increase of the level of knowledge and expertise as one of important pillar of economic development and a competitive labor force in the Labor market.

**Keywords:** Human Resources, Education, Inovaton, Kosovo Government.

### 1 Introduction

Main agents of economic growth and development are: natural resources and assets. Assets may be in the form of: corporeal asset, money and human resources. The use of these three agents in a most efficient way shall lead to sustainable economic development.

Gary Becker (Gary Becker) in his classic work Human Resources, emphasizes that every activity that has a cost in an actual period and increases the productivity in the future, may be analysed within the Theory of Investments (Grečić, 2004, 111).

The Human Resources summarizes all: knowledge, skills that employees acquire through education, training and working experience. The main form of establishing a Human resources is through education. Countries that aim to achieve a more dynamic economic development, shall find the ways to invest in capacity building of Human resources. Researchers in the field of Human resources do not treat the investment in education as expenditure but rather as investment. The investment in education increases the quality of Human resources, through which the labor productivity and incomes shall increase. Kosova as Country with low economic growth and with the high rate of unemployment shall find forms to increase the Human resources and shall create a capable labor force for a more dynamic development of economy. Moreover

"Eh, sebagai barang simpanan, berbedak, berpakaian bersih-bersih, setahun sekali berjemur di luar menanti suami sampai suka membawa keluar. Kami lain. Kami bimbang nasib kami sendiri, tiada hendak menanti rahmat laki-laki. Memang rumahku di luar rumah. Di sanalah kami merdeka (Pane, 1995:53-54)

"We, the old-fashioned, we stay at home"

"Eh, as a stash, dust with powder, dress clean, bask outside once a year waiting for the husband to bring us out. We are different. We guide our own fate, not wanting to wait for the grace of men. My house is outside the house. There we are free (Pane, 1995: 53-54)

Yah or Rohayah relies on her feelings rather than her logic. She realizes her failure and tries to find a lover. She finally goes back to her old lover dr. Sukartono.

In the novel of *Layar Terkembang*, modern woman is represented by Tuti. She represents the figure of a progressive woman who fights for her ideals. She is a hard and firm thinker. Everything is considered mathematically. Seen from her actions, Tuti is more inclined to rational and logical things. She is also an expressionist woman. She is also rational on religious matters even though she still believes in God. Her mindset is directed at the freedom and the progress of women. Women should not be attached to husbands, should advance and devote their time and activity for the sake of high dignity. Tuti is a female activist who becomes the chairperson of two women organizations. In carrying out her activities, she reads a lot of books and have a lot of discussions. Tuti is always serious and focuses on the activities aimed at promoting women's progress. On numerous occasions, Tuti has always said that women should not be male slaves and they should be equal as human beings.

Ia akan membuka dirinya dalam dunia pengetahuan, ia akan turut menyusun dan mengendalikan negara, ia akan menjelmakan jiwanya dalam seni, ia akan turut bekerja dan memimpin dalam bermacam-macam pekerjaan dan perusahaan. Demikian perempuan yang dicita-citakan oleh **Putri Sedar** bukanlah perempuan yang berdiri di masyarakat sebagai hamba sahaya, tetapi manusia yang sejajar dengan laki-laki (Alisyahbana, 1995)

She will open herself up in the world of knowledge, she will participate in organizing and controlling the state, she will embody her soul in art, she will work and lead in various jobs and companies. The woman aspired by **Putri Sedar** is not a woman standing in society as a servant, but the one who is equal to men (Alisyahbana, 1995)

In the novel of *Pada Sebuah Kapal*, Sri's mindset shifts from Eastern woman's mindset

(Javanese) to a Western woman's mindset because she is accustomed to be in contact with Western culture. Moreover, she is treated unfairly by her husband. A woman can determine her own way if the household does not make her happy. Sri wants to escape from the control of her husband, Charles, to be free and to work to fulfill her needs. She is smart and has advanced thought even though she only graduated from high school. She is able to show her own existence in her work and organisation. As a woman, Sri is responsible for the household. She is not materialistic, can be thrifty but not miserly. The pressure her husband made causes her to rise and dares to ask for a divorce. She wants to show that she can live without a husband. She wants to be equal with men and does not want to be treated like a doll.

"Keluar!"

"Sri, maafkan aku," katanya perlahan  
Aku meronta memukul tangannya.

"Aku tak mau lagi kau sentuh", katanya terisak-isak.

"Sekarang kau yang keluar atau aku yang tidur di kamar sebelah", sambungku terengah-engah.

"Sri kau tak bermaksud..."

"Ya, memang itu yang aku maksudkan. Mulai hari ini aku tidur sendiri. Empat bulan lagi anak kita lahir. Aku sudah terlampau lelah dengan kepadatan perasaanku. Kalau kau mau cerai, aku sangat menyetujui"

"Kau gila", serunya dengan cepat.

"Memang harus ada salah stu yang gila di antara kita berdua (Dini, 1990:122)

"Get out!"

"Sri, I'm sorry," he said slowly

I struggled to hit his hand.

"I do not want you to touch me anymore," she sobbed.

"Now you go out or I sleep in the next room", I panted.

"Sri you did not mean ..."

"Yes, that's what I mean. Starting today I sleep alone. In four months our child is born. I'm too tired with the pressure in my feelings. If you want a divorce, I strongly agree "

"You're crazy", he exclaimed quickly.

"There must be one crazy between us both (Dini, 1990: 122)

## 2. Surrender and Love

Unlike Sri's character in the novel of *Pada Sebuah Kapal* whose mindset has changed into the mindset of Western people, Atik in the Novel of *Burung-Burung Manyar* (1988) has a conventional and nationalist mindset. She has special intelligence. She graduates as a Doctor from Gadjah Mada University with the maxima cum laude award through the disertation entitled *Burung-Burung Manyar*. He hates Setodewo who kills Atik's favorite birds with his slingshot (local weapon). Symptoms of women's emancipation already appear on little Atik who does not really like to be a woman because there are too many rules made for women. Atik loves the world of fauna and flora. It comes from his father, who works in forestry. The influence is so strong that she can compose her dissertation because of her love for the fauna. Her love for nature is expressed on her dissertation and her devotion to Republik Indonesia is shown by becoming a typist and a translator in the Sutan Syahrir Cabinet.

With three young children, she takes three roles at the same time by being a typist, a translator, and a student composing her dissertation. Those three works are done not without risks. Becoming a translator in the pre-independence era was different from the present. Terror and murder could happen at any time. However, Atik still pursues the job with pleasure. She is so diligent and consistent in achieving her goals and finally she succeeds in obtaining her doctorate after intelligently answering the questions of the examiners.

Through the figure of Atik or Larasati, there can be seen a denial of gender ideology which assumes that women are inferior to men. The denial is visible when Larasati will propose and say her love if Setadewa does not propose to her. In the Javanese cultural principle represented by Larasati's mother, it is inappropriate for a woman to propose to a man.

In the novel of *Keluarga Permana* (1978), Saleha has a conventional mindset that focuses fully on family issues. Unlike Sri in *Pada Sebuah Kapal* and Atik in *Burung-Burung Manyar* who are free to make choices as women, Saleha's mindset is only on family economic fulfillment. Saleha has to work while Permana, her husband, is unemployed and he even does not allow her to work because he is jealous of her boss. Her excessive attention to work reduces the intensity of her relationships with her husband and her grown-up daughter, Farida. It brings a tragic event where the only girl gets pregnant out of marriage with FX Sumarto who has different belief with Farida. Permana and Saleha want their daughter to abort the child to cover up the family disgrace. According to Hurlock (1978: 385-387), Saleha's level of development is still in a pre-conventional stage meaning that she still follows the social rule but does not apply what is in her deepest inner heart that aborting a fetus is unlawful, immoral, and sinful.

Lasi or Lasiah in the novel of *Bekisar Merah* (1993) is originally a devoted woman. She is loyal to her husband, Darsa, a seeker of palm-sap used as the main ingredient to make palm sugar. Everyday Lasi and her mother struggle to make palm sugar which is not much. She is dissapointed with her husband because he is forced to impregnate the girl of a massage practitioner who heals his impotence when he falls from a coconut tree. Then Lasi leaves her husband and gets married to Handarbeni, an old, rich and impotent man after they two have been introduced by two pimps, Koneng and Lanting. Indeed, Lasi does not want to part with her mother and the atmosphere of Karangsoga village where she was raised. Lasi who has been disappointed with her household is willing to divorce. With her Japanese-Indonesian look, Lasi actually can accept the love of Kanjat, an agricultural scholar and a son of coconut plantation owner in Karangsoga. However, by using her freedom she chooses Darsa who works as a climber seeking for palm sap coming from a poor family who finally betrays her. With the attitude of a free woman, she dares to leave her husband and find a new way of life even if she is not happy.

### 3. Women's Mindset in Indonesian Novels and the Historical Condition

The depiction of women emantipation in the seven novels under study is manifested in three categories. The first category is emancipation reflected in the characterization. Through female characters, the idea of emancipation comes into being. They are depicted as women working outside their home, except Maryam and Rafiah. In a social theory related to gender issues, those women are called women working in the

public sector, not in the domestic sector (housewives) (Abdulah, 1997: 3). The second category is women's emancipation reflected in their criticism of male domination in domestic life as well as criticism of government policies that harm women. The third category is women's emancipation seen in the disclosure of historical data related to women's emancipation.

The first and second category refer more to liberal feminism manifested in women's awareness of unfair treatments given to them. Liberal feminism emerged in the late 19th century and developed rapidly in the 1960s. In their movement manifesto embodied in the 1984 Seneca Convention, the activists demanded a full right to be able to control their property and opinions, take care of their children, and protect their children. They also demanded abolition of discrimination in any work. The pattern of feminism is always colored by the demands of right equality so that women can have the same rights as men.

Although it is stated in the 1945 Constitution that women have equal rights and opportunities to men, but in practice it has not been fully implemented. Even if a woman can earn money, her income is only considered as an additional income in the family. In many ways, women are always secondary to men in terms of education. This is based on the notion that men are the backbone of families while women only take care of the households.

The symptoms of women's involvement in the public sector such as Corrie, Tini, Maria, Sri, Larasati and Lasiah signify that they are trying to reconstruct the history of their lives by building a new identity for themselves: Maria as a female activist, Sri as a worker, Larasati as a doctor of fauna, and Lasi or Lasiah as a palm sugar maker. They take the roles not only as wives and mothers but also as professional women. What they do is such a denial of the ideology of familianism in the society. In familianism, the roles and duties of women are for their families by living at home and taking care of their husbands and children (Abdulah via Wiyatmi, 1999: 15).

The notion of female emancipation coming from the historical data of the women's emancipation as shown by Tuti in *Layar Terkembang*, Sri in *Pada Sebuah Kapal*, and Larasati in *Burung-Burung Manyar* shows that in the reality, women's roles in public sectors as organizational leaders, queens and prime minister have been existed since time immemorial, although they are still in limited numbers.

### C. Conclusion

The description and analysis on women's mindset in Indonesian novels: *Salah Asuhan*, *Belenggu*, *Layar Terkembang*, *Pada Sebuah Kapal*, *Keluarga Permana*, *Burung-Burung Manyar*, and *Bekisar Merah* can be concluded into the following points. First, the depiction of women's mindset in the seven novels is manifested in three categories. The first category is women are characterized by the author as intelligent women; they act as professional career women; and they desire to have gender equality or equal status between men and women both at home and in society. The second category is criticism of male dominance in household and society conveyed by the female characters. The third category is historical facts show that women's participation in the society and state has occurred long ago, both in the pre-colonial and post-colonial era.

## References

- Abdullah, Irwan (1997) "Dari Domestik ke Publik: Jalan Panjang Pencarian Identitas Perempuan" dalam Irwan Abdullah Ed. *Sangkan Paran Gender*. Yogyakarta Puslit. Universitas Gadjah mada.
- Alisyahbana, Sutan Takdir (1937) *Layar Terkembang*. Jakarta: Balai Pustaka.
- Budiman, Arief (1987) *Pembagian Kerja Secara Seksual*. Sebuah Pembahasan Sosiologis Peran Wanita di dalam Masyarakat. Jakarta: Gramedia.
- Ernesto, Pamusuk (ed) (1982) *Proses Kreatif Pengarang Indonesia*. Jakarta: Gramedia .
- Helwig, Tineke (2003) *In The Shadow of Change: Citra Perempuan dalam Sastra Indonesia*. Jakarta: Women Institute dan Desantara.
- Horlock, Elizabeth B (1978) *Child Development*. London: Mc.Graw-Hill International Book Company.
- Ikram, Achadiati (1991) "Galuh Berperasaan Perempuan: Suatu Usaha Membaca Sebagai Perempuan: Ilmu-Ilmu Humaniora. Yogyakarta: Gadjah Mada University Press.
- Mangunwijaya, YB (1988) *Burung-Burung Manyar*. Jakarta: Jambatan.
- Moeis, Abdul (1928) *Salah Asuhan*. Jakarta: Balai Pustaka.
- Nurgiyantoro, Burhan (1997) *Dasar-Dasar Kajian Fiksi*. Yogyakarta: Gadjah Mada University Press.
- Nurgiyantoro, Burhan (1991) *Citra Wanita dalam Novel Populer Indonesia Muthakir*, Yogyakarta: Lemit IKIP Yogyakarta.
- Pane, Armyn (1940) *Belenggu*. Jakarta: Dian Rakyat.
- Rahayu, Srijati (1997) *Kepribadian dalam Sikap dan Perilaku Sitti Nurbaya*. Yogyakarta: FBS UNY.
- Ramadhan, KH (1978) *Keluarga Permana*. Jakarta: Pustaka Jaya.
- Sayuti, Suminto A (1993) "Peran Sastra dalam Kehidupan Kita" *Bahasa dan Sastra*. Yogyakarta: FBS UNY.
- Tohari, Ahmad (1993) *Bekisar Merah*. Jakarta: Gramedia Pustaka Utama.
- Wiyatmi (1999) *Gagasan Emansipasi Wanita dalam Novel Indonesia Periode 1980-1990-an*. Yogyakarta: Lemlit IKIP Yogyakarta.
- Zuchdi, Darmiyati (1993) *Analisis Konten*. Yogyakarta: UNY Pres.
- Wellek, Renne and Warren, Austin (1990) *Teori Sastra*. (Terjemahan Melani B) Jakarta: Gramedia.

## **Struktura logjike e teoremës dhe metodika e hartimit të testeve**

**Msc. Yllka Hasani**

*Universiteti "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Shqipëri*

**Irilda Olldashi**

*Universiteti "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Shqipëri*

**Dhurata Çabja**

*Universiteti "Aleksander Xhuvani", Elbasan, Shqipëri*

### **PJESA I**

#### **Struktura e teoremës**

#### **Pjesa themelore, kushti dhe përfundimi i teoremës**

Për kryerjen e çfarëdo procesi si dhe për çdo lloj çështje që trajtojmë, është e kuptueshme se më parë ne duhet të përcaktojmë objektin, të cilin do ta studjojmë, pastaj, duke vënë si konditë që ky objekt të gëzojë disa veti, të presim që të marrim një ose disa rezultate, që kushtëzohen prej tyre. Në matematikë, sikurse në çdo shkencë tjetër, si burim fillestar njohurish shërben bota e jashtme, realiteti material objektiv. Studimin e botës materiale matematika e realizon me anën e metodave të saj, të cilat janë të kushtëzuara prej vetë objektit të këtij studimi. Është i njohur përcaktimi filozofik i objektit të matematikës nga Engelsi: «Matematika e pastër ka si objekt të saj format hapësinore dhe marrëdhëniet sasiore të botës reale, pra, një material krejtësisht real.» Duke studiuar marrëdhëniet e botës reale, matematika kufizohet vetëm me një anë të tyre dhe pikërisht me ato marrëdhënie të përgjithshme sasiore dhe forma, që janë karakteristike për çdo përmbajtje të materies .

Duke pasur parasysh se në botën materiale shqyrtimi i marrëdhënieve dhe i formave nis, se pari, duke përcaktuar objektin e studimit; së dyti, duke vecuar kushtet dhe faktorët që veprojnë mbi të dhe, së treti, duke shqyrtuar vetitë që rrjedhin prej tyre, edhe tek teoremat do të reflektohet po e njëjta gjë. Në fillim përcaktohet bashkësia e elementëve ku do të operojmë, pastaj shprehemi : «në qoftë se elementët e kësaj bashkësie gëzojnë disa veti, atëherë do të rrjedhin këto apo ato veti të tjera». Kjo gjë në teoremë, tani për tani, paraqitet metodikisht vetëm nëpërmjet kushtit dhe përfundimit të saj. Duke u nisur nga përcaktimi, që jepet nëpër tekste, në kusht (si të dhëna), përfshihen si bashkësia e elementëve matematike, që po shqyrtojmë (mbasi është e dhënë), ashtu edhe bashkësia e vetive që gëzojnë këto elemente (që dihet se është e vërtetë). Kur thuhet «të ndahet» teorema në tri njësi, duhet nënkuptuar që, kjo njësi e re nuk do të futet në asnjë mënyrë artificialisht, por, sic do të vëmë re, ajo gjendet në vetë përbërjen e teoremës, por nuk shfaqet shpesh aq hapur ; pengesa për shpalljen e «pavarësisë» se saj na nxjerr ndarja e gjertanishme e teoremës në dy pjesë: KUSHT dhe PËRFUNDIM, ndarje të cilën do të mundohemi ta plotësojmë. Duke



u nisur nga shumë paqartësi dhe gabime që rrjedhim shpesh nga një ndarje e tillë metodike e teoremës, të cilat do të sqarohen konkretisht me poshtë, linden këto pyetje:

1. A duhet të shprehet dhe të shënohet në përbërjen e kushtit bashkësia e objekteve (e elementeve) matematike, për të cilën bën fjalë teorema?
2. A duhet të thyhet koncepti i ndarjes metodike të gjertanishme të teoremës në kusht dhe përfundim, nga dy njësi, në tri njësi dhe, nëse po, atëherë cila do të jetë kjo njësi e tretë?
3. Si duhet përkufizuar teorema e anasjelltë e një teoreme të dhënë, apo llojet e tjera të teoremave që lidhen me teoremën e dhënë?

*Përkufizimi 1:* Teoremë e anasjelltë e një teoreme të dhënë quhet ajo, në të cilën si kusht është vendosur përfundimi (ose një pjesë e tij) dhe si përfundim është bërë kushti i teoremës së dhënë (ose një pjesë e tij). Ky përkufizim nuk e zë në gojë vërtetësinë e teoremës, (e cila doemos duhet të përmendet), gjithashtu ka arsye të mendojmë se, një përcaktim i tillë s'është i qartë, sepse përmban shumë mendime ekuivoke. Cilat janë rrethanat që na shtyjnë drejt këtij problemi?

A) Duke mos u thelluar sa duhet në formulimin e teoremës, nuk sqarohet, sic duhet, përkatësia e cdo fjale përbërëse të saj. Kështu që, në detajimin e pjesëve përbërëse vihet re një caktim jo i rregullt i tyre.

B) Për më tepër, nisemi nga fakti se në tekstet mësimore përkufizimi i teoremës së anasjelltë është dhënë, ose i cunguar ose i pasaktësuar.

Po ndalemi për të analizuar fillimisht përkufizimin 1, i cili herë-herë takohet edhe tani në orë mësimi: Pyesim: cdo të thotë «një pjesë e tij»? Cila është ajo? A është i qartë nxënësi për këtë dhe a mund ta zgjedhë vetë dhe si? A nuk sjell ky përkufizim mjaft pasiguri për nxënësin, bile nganjëherë edhe për vetë mësuesin? Së fundi, a s'do të ishte mirë sikur këtë «pjesë» ta përcaktonim një herë e mirë? Mendojmë se përcaktimi i saj, jo vetëm që do të zhdukte tërë këto pikëpyetje që linden në mënyrë të natyrshme (përgjigjet e të cilave shpesh s'do të nxirrnin ndonjë gjë të qartë e të përcaktuar) por, për më tepër, do të na lejonte që të riformulonim një përkufizim të ri, më të saktë për këtë teoremë, që është aq e rëndësishme. Gjithashtu, kjo gjë do të lehtësonte mjaft për një përvetësim të thellë logjik edhe të teoremave të tjera, që lidhen me teoremën tonë. Të mundohemi të sqarojmë se cila është kjo «pjesë». *Le të shqyrtojmë teoremën e mirënjohur të tri pinguleve, që gjendet në tekstin e matematikës së vitit të 3-të të shkollës së mesme: Teorema 6: Në qoftë se një drejtëz  $AO$  është pingule me një plan  $P$  dhe ngakëmba e saj  $O$  hiqet pingulja  $OB$  me një drejtëz (të dhënë) të cfarëdoshme  $d$  të këtij plani  $P$ , atëherë drejtëza që bashkon këmbën  $B$  të pingules së dytë me një pikë  $A$  të cfarëdoshme të drejtëzës  $AO$ , është pingule me drejtëzën  $d$ . Teorema e anasjelltë 6': Në qoftë se nga një pikë cfarëdo  $A$  e pingules  $AO$  me planin  $P$ , hiqet pingulja  $AB$  me një drejtëz cfarëdo  $d$  të këtij plani  $P$ , atëherë drejtëza  $OB$  që bashkon këmbët e këtyre pinguleve, është pingule me drejtëzën  $d$ . Pa i ndarë, si më sipër, shohim qartë se në të dy teoremat shprehjet «drejtëza  $AO$  pingule me planin  $P$ », «një drejtëz cfarëdo  $d$  e këtij plani  $P$ », «pika cfarëdo  $A$  mbi drejtëzën  $AO$ », qëndrojnë krejtësisht të pandryshuara në përbërjen e kushteve të të dy teoremave, ndërsa «pjesët» e mbetura të kushtit dhe të përfundimit të teoremës (6) ndryshojnë përkatësisht vendet në përfundim dhe kusht për teoremën (6').*

Paraqitet pikërisht një gabim i tillë me teoremën (6'), ku, jo rrallë, vihet në përfundim që  $AO$  është pingule me planin  $P$ , për ta vërtetuar (!) nga të dhënat e tjera. Pjesa e re do të sqarojë fillimisht jo vetëm bashkësinë e elementëve (objektin matematik) për vetitë e së cilës bën fjalë ajo taoremë. Funkcionet

e tjera të saj janë të shumta dhe më poshtë do të përmendim disa prej tyre. Këtë njësi të re po e emërtojmë *pjesë themelore*. Kështu që teorema tani do të paraqitet e ndarë metodikisht në tri pjesë: në *pjesën themelore*, në *kushtin* e kulluar dhe në *përfundimin* e saj.

Disa prej funksioneve të *pjesës themelore*:

- a) Pjesa themelore shpreh bashkësinë e objekteve matematike, ku vepron teorema.
  - b) Tregon se ku kanë kuptim kushti dhe përfundimi i teoremës.
  - c) Ndhmon për të përkufizuar më saktë teoremën e anasjelltë, të kundërt etj., të një teoreme të dhënë.
  - d) Ajo shpreh përgjithësimin ose jo të pohimit matematik.
  - e) Përmbajtja e saj influencon në përmbajtjen e teoremës së anasjellë të një teoreme të dhënë.
  - f) Tregon se teorema, që kemi në shqyrtim është një element i bashkësisë së teoremave, që japin sistemin e vetive të një objekti të caktuar matematik.
- C) Përkufizimi (1), sic e shqyrtuam, ishte i pasaktësuar dhe prandaj le të shohim se si mund të jepet përkufizimi i saktë dhe i plotë i teoremës se anasjelltë të një teoreme të dhënë. Ky përkufizim i ri mënjanon paqartësitë që lindin prej përdorimit të termit «pjesë», madje e qartëson këtë të fundit. Ja se si mund të jepet përkufizimi i teoremës së anasjelltë të një teoreme të dhënë, nëpërmjet përdorimit të kuptimit të pjesës themelore të kësaj teoreme të dhënë. *Përkufizimi (\*)*: Teorema e anasjellë e një teoreme të dhënë quhet ajo fjali e vërtetë matematike, e cila përftohet si ndryshim reciprok i vendeve të kushtit dhe të përfundimit të teoremës fillestare, pa ndryshuar pjesën themelore të teoremës së dhënë.

### Forma dhe përmbajtja e teoremës

Në të gjitha dukuritë dhe sendet e natyrës, të shoqërisë dhe të mendimit njerëzor dallohen dy anë të përgjithshme: *përmbajtja dhe forma*. *Përmbajtja* është tërësia e elementëve dhe e funksioneve përbërëse të një objekti të caktuar ; ndërsa *forma* është mënyra e lidhjes së të gjitha elementeve të përmbajtjes, mënyra e shprehjes, mënyra e ekzistencës së përmbajtjes. Përmbajtja dhe forna, duke qënë dy anë të ndryshme të sendeve dhe dukurive reale, nuk janë të ndara por lidhen ngushtë njëra me tjetrën, janë në unitet të pandarë midis tyre; nuk ka përmbajtje pa formë dhe formë pa përmbajtje. Në këtë unitet rolin vendimtar e luan përmbajtja. Por dihet se, format mund të jenë të ndryshme gjer në atë shkallë, sa mund të shërbejnë për të shprehur të njëjtën përmbajtje dhe jo cdo lloj forme mund të shprehë të njëjtën përmbajtje. Mësuesi, për të nxitur tek nxënësi të arsyetuarit logjik, përdor forma të larmishme pune. Në rastin e teoremave, një nga format që përdoret për këtë qëllim është dhe nxitja që i bëhet nxënësit për ta riformuluar teoremën «me fjalët e tij».

Kjo ka rëndësi, sepse eliminohet, në një farë mase, të mësuarit mekanik dhe luftohet për një sistemim dhe përvetësim logjik të materialit matematik që përmban ajo teorermë: gjithashtu zgjon tek nxënësit besimin në vetvete për të shprehur lirisht mendimet e tij. Nganjëherë disa mësues duke i kushtuar rëndësi idesë themelore që përmban teorema

nuk kujdesen për mënyrën e të shprehurit të saj. Me fjalë të tjera, ata pranojnë kështu se nuk është forma ajo që i dallon teoremat njëra nga tjetra.

### **Njohuri metodike mbi llojet e teoremave dhe mbi lidhjen që ekziston midis tyre** *Teorema e anasjellë*

Jepet ky përkufizim për teoremën e anasjellë, i cili nuk ndryshon në asnjërin nga tekstet e klasave shkolllore:

*Përkufizimi 2:* «Në qoftë se duke këmbyer kushtin dhe përfundimin e një teoreme të dhënë, marrim një fjali matematike të vërtetë, atëherë kjo fjali quhet *teoremë e anasjellë* e teoremës së dhënë»

Në qoftë se për një teoremë, e anasjella e saj është e vërtetë, atëherë për këto teorema, duke qënë përkatësisht të anasjella të njëra-tjetrës, nuk ka kuptim të flitet se cila është e para dhe cila është e dyta. Si teoremë *direkte* merret njëra prej tyre.

#### *Kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme (k.n.m.)*

Kuptimi mbi konditat e nevojshme dhe të mjaftueshme ka shumë rëndësi, pasi paqartësitë lidhur me këtë mund të na cojnë në gabime të rënda, përsa u përket gjykimeve matematike. Le të jetë dhënë një bashkësi elementësh  $x$ , të cilën po e shënojmë me simbolin  $E(x)$ . Ndonjë pohim matematik, i cili ilustron vetitë e elementëve të kësaj bashkësie, do të formulohet në trajtën: «Në bashkësinë  $E(x)$ , në qoftë se plotësohet kushti  $p(x)$ , atëherë do të plotësohet edhe përfundimi  $q(x)$ ».

Detajimi metodik i saj do të bëhet kështu:

***Pjesa themelore*** : Në bashkësinë  $E(x)$

***Kushti*** : Plotësohet kondita  $p(x)$ .

***Përfundimi*** : Do të plotësohet edhe  $q(x)$

Në këtë rast ne shprehemi se në bashkësinë  $E(x)$  kushti  $p(x)$  është i mjaftueshëm për ekzistencën e  $q(x)$ .

Le ta konkretizojmë këtë që thamë me anën e kësaj teoreme:

Në të njëjtin rreth, ose në rrathë të barabartë: ***pjesa themelore***

Në qoftë se dy korda janë të barabarta: ***kushti***

Atëherë ato do të tendosin harqe të barabarta: ***përfundimi***

Në këtë rast do të themi se në bashkësinë e rrathëve të barabartë, ose në të njëjtin rreth, kushti që «dy korda janë të barabarta», është i mjaftueshëm për ekzistencën

e «harqeve të barabarta» të tendosura prej këtyre kordave. Supozojme se është i vërtetë edhe pohimi i kundërt i pohimit tonë: «Në bashkësinë  $E(x)$ , në qoftë se nuk plotësohet kushti  $p(x)$ , atëherë nuk plotësohet as përfundimi  $q(x)$  ». Pra:

***Pjesa themelore:*** Në bashkësinë  $E(x)$ .

***Kushti:*** Nuk plotësohet kondita  $p(x)$ .

***Përfundimi:*** Nuk do të plotësohet as  $q(x)$ .

Në këtë rast do të themi se kushti  $p(x)$  është i nevojshëm për ekzistencën e  $q(x)$  në bashkësinë  $E(x)$ .

Si pohim i kundërt i atij që shprehëm më lart shërben teorema, që thotë:

Në të njëjtin rreth ose në rrathë të barabartë: **PJESA THEMELORE**

Atëherë ato nuk tendosin harqe të barabarta: **PËRFUNDIMI.**

Do të shprehemi në këtë rast se në «bashkësinë e rrathëve të barabartë, ose në të njëjtin rreth», kushti që «dy kordat janë të barabarta», është i nevojshëm për ekzistencën e

bashkësisë së harqeve të barabarta:

Sikur pohimi ynë dhe i kundërti i tij të ishin që të dy të vërtetë njëkohësisht, atëherë themi se në bashkësinë  $E(x)$ ,  $p(x)$  është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për plotësimin e përfundimit  $q(x)$ . Në rastin konkret të dy pohimet e paraqitura për ilustrim, janë të vërteta njëkohësisht, prandaj themi se në bashkësinë e rrahëve të barabartë ose në të njëjtin rreth kushti «i barazimit të dy kordave» është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për «barazimin e harqeve përkatese» te tendosur. Pra, që një kusht  $p(x)$  të jetë i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për  $q(x)$ , kërkohet që të vërtetohen njëkohësisht teorema direkte dhe e kundërta e saj. Meqënëse pohimi i kundërt dhe i anasjellë i një pohimi të dhënë janë të njëvlershëm, rrjedh që për të provuar nevojshmërinë dhe mjaftueshmërinë e  $p(x)$  për  $q(x)$ , mjafton të vërtetojmë që pohimi direkt dhe ai i anasjellë, janë të vërtetë njëkohësisht. Për ekzistencën e  $q(x)$  një kusht  $p(x)$  mund të jetë i trellojshëm :

1. Kushti  $p(x)$  është i mjaftueshëm, por jo i nevojshëm
2. Kushti  $p(x)$  është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm
3. Kushti  $p(x)$  është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm

### **Metoda e vërtetimit nga e kundërta ose të sjellurit në absurditet**

Kjo metodë është e njohur nga të gjithë dhe përdoret me shumë sukses në vërtetimin e teoremave, vecanërisht, kur vërtetimi i tyre në rrugën e drejtpërdrejtë paraqet mjaft vështirësi, rruga e tërthortë që ndiqet, përbën thelbin e kësaj metode. Duke u nisur nga njohuritë mbi mënyren e formimit të teoremave të ndryshme dhe njëvlershmërinë ndërmjet tyre, dalin këto përfundime mbi metodën e vërtetimit nga e kundërta: Së pari, metoda e vërtetimit nga e kundërta bazohet në aksiomën e përjashtimit të së tretës, që thote: “Përvec dy pohimeve, «nga A rrjedh B», ose «nga A nuk rrjedh B”, nuk ka pohim të tretë”. Nga kjo aksiomë rrjedh se, në qoftë se njëri nga këto pohime është i gabuar, atëherë tjetri do të jetë patjetër i vërtetë.

Së dyti, teknika e arsytimit që përdoret në këtë metodë, përmbledhet si më poshtë : Nëpërmjet supozimit të gabuar që bëjmë, mohohet përfundimi i teoremës së dhënë dhe ky mohim përdoret përkohësisht si KUSHTI i dhënë (përvec të dhënave të tjera të KUSHTIT). Nga kjo aksiomë rrjedh se, në qoftë se njëri nga këto pohime është i gabuar, atëherë tjetri do të jetë patjetër i vërtetë. Së treti, shqyrtimi i vemëndshëm i kësaj metode na tregon se njëkohësisht me teoremën e dhënë, vërtetojmë herë-herë edhe teoremën (AK) të saj. Kjo gjë ndodh përgjithësisht kur kundërthënia arrihet me të dhënat e kushtit të teoremës së dhënë.

## **PJESA II**

### **Ndërtimi i testeve me fund të mbyllur (me zgjedhje) kontrolli, matja dhe vlerësimi i njohurive. Testet dhe llojet e tyre**

Matja është një përpjekje për të përshkruar në mënyrë sasiore rezultatet e nxënies. Matja e rezultateve e cila realizohet me anë të kontrollit shoqërohet gjithnjë me vlerësimin. Vlerësimi nënkupton vendosjen e vlerës së dickaje. Kjo është cilësia që e bën të ndryshëm nga matja. Kontrolli i njohurive është sistematik e bëhet me gojë e me shkrim ose testimi në mësimdhënie është 3 llojesh që i përgjigjet qëllimeve të

caktuara.

- 1- Testim për të vlerësuar nivelin fillestar të njohurive që zotërojnë nxënësit në fillim të një lënde apo kursi studimi.
- 2- Testim gjatë mësimdhënies.
- 3- Testim në përfundim të mësimdhënies.

Në testet për matjen e njohurive të nxënësve përqëndrimi bëhet në objektivat e sferës njohëse, e cila ka të bëjë me nivelin shkencor të njohurive e realizimi i tyre pasqyrohet nëpërmjet kujtesës e operacioneve të ndryshme të të menduarit. Blum(B.Bloom, Taxonomy of Educational Objectives 1956) i klasifikoi objektivat e sferës njohëse në 6 nivele që tashmë quhet Taksonomia e Blum-it (Taxisrenditje, nomos - ligj)

### Testet objektive

1. I vërtetë ose i rremë
2. Me zgjedhje
3. Me përputhje (ciftëzim) të përgjigjjes së saktë me pyetjen
4. Me plotësim të përgjigjjes
5. Me përgjigje të shkurtër
6. Interpretues.

### Testet subjektive

Këtu futen testet esse. Përgjigjja jepet në mënyrë origjinale nga nxënësi i cili krahas njohurive shpreh mendimet, ndjenjat, emocionet dhe qëndrimet personale. Asnjë nga testet e mësipërme nuk është i përkryer në të gjitha rastet për përdorim. Secili prej tyre ka përparësitë dhe mangësitë e veta .

### Testi me fund të mbyllur

Testi me mundësi të shumta të zgjedhjes së përgjigjjes konsiston në një temë të caktuar për kontrollin e njohurive i cili mund të jetë fillestar, formues dhe përfundimtar. Ai paraqet zgjidhjen e një problemi dhe jepen mundësi të shumta të përgjigjes. Tema mund të jetë: një çështje, një pyetje, një problem ose ushtrim, ose një pohim i pa plotë. Ato përmbajnë përgjigjen e saktë dhe përgjigje të ndryshme të gabuara, që kanë synim të zhvendosin vëmendjen e nxënësit ose ta hutojnë atë. Këto të fundit i quajmë shkurt "distrakte". Një tip tjetër i testit me fund të mbyllur është edhe ai në formën e "përgjigjes më të mirë", në të cilin të gjitha përgjigjet janë pjesërisht të sakta, por njëra është qartësisht më e mirë se të tjerat. Po paraqesim modelet e formulimit të pyetjeve në nivelet: njohja, të kuptuarit dhe aplikimi.

#### 1. Pyetje për njohjen

Testet që përmbajnë çështjet për njohjen matin në mënyrë tipike shkallën në të cilën riprodhohet ose përmendet materjali i mësuar. Pyetjet përqëndrohen në një riprodhim të thjeshtë të informacionit dhe kanë të bëjnë me matjen e termave, fakteve ose aspekte të tjera specifike të njohjes. Le të tregojmë në mënyrë më të

detajuar se si mund të maten rezultatet e të nxënimit duke treguar një kategori të gjerë të njohjes.

- a - Njohja e terminologjisë
- b- Njohja e fakteve specifike
- c- Njohja e rregullave
- d- Njohja e prirjeve dhe pasojave
- e- Njohja e klasifikimeve dhe kategorive
- f- Njohja e kriterëve
- g- Njohja e metodologjisë
- k- Njohja e parimeve dhe e përgjithësimeve
- l- Njohja e teorive dhe strukturave

### *2. Pyetje për të kuptuarit*

Pyetjet e të kuptuarit në mënyrë tipike masin nivelin më të ulët të të kuptuarit nga nxënësit. Ato përcaktojnë nëse nxënësit kanë arritur të kuptojnë materjalin pa i kërkuar ta zbatojnë atë. Të kuptuarit matet duke i kërkuar nxënësve të përgjigjen në rrugë të ndryshme por është e rëndësishme që pyetjet të përmbajnë disa gjëra të reja.

### *3. Pyetje për aplikimin*

Pyetjet për aplikimin matin gjithashtu të kuptuarit, por në mënyrë tipike në një nivel më të lartë se të kuptuarit. Këtu nxënësit mund të demonstronjë atë që ata, jo vetëm kuptojnë informacionin, por gjithashtu mund ta zbatojnë në situata konkrete që janë të reja për ta. Kështu çështjet e aplikimit përcaktojnë shtrirjen në të cilën nxënësit mund të kapërcejnë ose të transferojnë të nxënimit e tyre dhe ta përdorin atë në mënyrë efikase në zgjidhjen e problemeve të reja. Çështjet për të kuptuarit dhe aplikimin së bashku janë të zbatueshme nga të gjitha fushat praktike të përmbajtjes së lëndës. Ato sigurojnë kuptimet bazë për matjen e përvetësimit.

## **Rregulla për formulimin e çështjeve ose pyetjeve me zgjedhje**

Rregullat e mëposhtme janë udhëzime paraprake për përgatitjen e pyetjeve në testet me zgjedhje.

1. Cdo pyetje duhet të matë një përfundim të rëndësishëm të të nxënimit.
2. Të formulojmë qartë problemin që përmban pyetja
3. Duhet të vendosim rrjedhimin e pyetjes në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë.
4. Të vendosim sa më shumë të jetë e mundur fjalë të zgjedhura në një pyetje
5. Të vendosim rrjedhimin e pyetjes në formë pohuese kurdoherë që të jetë e mundur.
6. Duhet të theksojmë formulimin mohues sa herë që e përdorim në formulimin e një pyetjeje.
7. Të jemi të sigurt që përgjigja e parashikuar është e saktë ose qartësisht më e mira.
8. T'i bëjmë të gjitha përgjigjet të qëndrueshme nga pikpamja gramatikore me rrjedhimin e pyetjes dhe paralele në formë.
9. Të shmangim orientimet gojore që i japin mundësinë nxënësit të përzgjedhë përgjigjen e saktë ose të eleminojë një përgjigje jo të saktë.
10. T'i bëjmë distraktet të vlefshme e tërheqëse edhe për nxënësit që njohuritë nuk i kanë të plota.

11. Të ndryshojmë gjatësinë relative të përgjigjes së saktë për të eliminuar sa të jetë e mundur atë përgjigje e cila e zbulon lehtë atë.
12. Të ndryshojmë pozicionin e përgjigjes së saktë në mënyrë të rastësishme.
13. Të sigurohemi që cdo pyetje është e pavarur nga ato që përmbahen në test.
14. Duhet përdorur një format efikas i testit që të lehtësojë evidentimin e të dhënave.

### **Përparësi dhe mangësi të testit**

1. Matja e rezultateve të të nxënësve
2. Përgatitja e pyetjeve
3. Modelimi i përmbajtjes së lëndës ose kursit
4. Kontrolli i përgjigjes së nxënësve.
5. Vlerësimi
6. Ndikimi në të nxënësit
7. Besueshmëria

### **Llogaritja e pikëve**

Formula e mëposhtme për llogaritjen e pikëve të testit bën korigjimin për pikët e fituara në këtë mënyrë:

$PIKET = SAKTE - GABIM/(n-1)$  ose  $P = S - G/(n-1)$  ku: n- numri i përgjigjeve për cdo paragraf. Duke zbatuar këtë korigjim të pikëve të fituar nga hamëndja formula përfshin numrin e përgjigjeve saktë dhe gabim të nxënësve. Paragrafët e lënë pas dore që nuk u është dhënë përgjigje nuk merren në konsideratë nga formula.

### **Cilësitë e testit**

1. Vlefshmëria
2. Besueshmëria
3. Objektiviteti
4. Përdorshmëria.

### **Përfundime**

Në pjesën e parë të kësaj teme u munduam të paraqesim një varg çështjesh që lidhen me trajtimin e teoremës, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë mësuesin gjatë procesit të mësimit të matematikës në shkollë. Termi «PJESË THEMELORE», që u fut si njësi e re në përbërjen e teoremës, është i ri dhe i papërdorur më parë. Prandaj, sic e theksuam më lart, mendojmë se duhet të përdoret si i tillë (pa i ndarë vecan) për të arritur një përvetësim gjithnjë e më të thellë të teoremës. Përveç kësaj, ai ndihmon në dhënien e formulimeve të sakta të të gjitha teoremave që lidhen me një teoremë të dhënë. Vecimi i pjesës themelore shkakton mënjanimin e gabimeve ose paqartësive që mund të shkaktohen nga dhënia e pasaktë e disa prej nocioneve, sic ishte përkufizimi 2 i teoremës së anasjelltë, i cili me përdorimin e tij u bë plotësisht i saktë.

Problemi i formës dhe i përmbajtjes së një teoreme i trajtuar thekson edhe një herë parimin se përveç çështjes së rigorozitetit forma duhet ndryshuar deri në ata kufij në të cilët ruhet e njëjta përmbajtje.

Nën dritën e përdorimit të pjesës themelore si njësi e re, vllente që të ritheksosheshin edhe një herë gjithë llojet e teoremave që lidhen me teoremën tonë. Me këtë rast

iu hodh një sy dhe analizës së dy prej metodave më të rëndësishme matematike: "metodës së vërtetimit nga e kundërta" dhe asaj të «kundërshembullit».

U bë një përpjekje për të sqaruar disa momente të rëndësishme që duhet të përshkojë rruga e arsytimit logjik gjatë vërtetimit të një teoreme. Duke zbuluar para nxënësve shtigjet e arsytimit, si dhe duke i shtyrë ata në veprimtari kërkimore, arrihet synimi i rëndësishëm për një edukim të shëndoshë logjik të nxënësve.

Njohja me këto çështje është kusht mjaft i rëndësishëm i edukatës logjike dhe i kulturës matematike të vetë mësuesit. Rruga e përvetësimit të tyre kërkon shqyrtimin e një numri të madh shembujsh të ngjashëm me këta që përmendëm. Përdorimi i tyre në praktikën e punës mësimore në klasë, do ta shtrojë më me forcë nevojën e përvetësimit të tyre jo vetëm nga mësuesit, por edhe nga nxënësit.

Duke i parë këto çështje nga ky këndvështrim - edhe në tekstet tona mendojmë se duhen pasqyruar një pjesë e tyre, për të arritur një përvetësim të plotë të materialit nga ana e nxënësit, mbasi studimin individual ai e bën kryesisht nëpërmjet tekstit.

Shqyrtimi i bërë për teoremën ka një vlerë të rëndësishme edhe për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve, vecanërisht atyre «me vërtetim» dhe «të ndërtimit». Një analizë e tillë e mjeteve logjike, që u bë për teoremën, ka vlerë të bëhet dhe për disa koncepte matematike të tilla sic janë aksiomat, përkufizimet etj.

Ato që u trajtuan për testin me zgjedhje në pjesën e dytë të kësaj teme, mund të përmbliidhen në pikat e mëposhtëme:

1. Testi me zgjedhje mund të përdoret për matjen e përfundimeve të përvetësimit në një diapazon të gjerë që nga njohuritë më të thjeshta deri te tipet më të ndërlikuara të të nxënësve.
2. Testi me zgjedhje vlerësohet si më i miri dhe ka përdorim më të gjerë se të gjitha llojet e tjera të testeve.
3. Pyetjet e nivelit të njohjes në mënyrë tipike matin thjesht kujtesën e materjalit.
4. Pyetjet e nivelit të të kuptuarit matin shtrirjen në të cilën nxënësit mund të përdorin materjalin në situata konkrete.
5. Pyetjet e nivelit të aplikimit synojnë të matin nëse nxënësit mund të përdorin materjalin në situata konkrete e të panjohura më parë.
6. Pyetjet e hartuara për matjen e përfundimeve të të nxënësve përtej nivelit të njohjes duhet të përmbajnë disa gjëra të reja, novitete.
7. Rrjedhimi për një pyetje me zgjedhje duhet të paraqesë një problem të thjeshtë e të formuluar qartë, që është i lidhur me një përfundim të rëndësishëm të të nxënësve.
8. Përgjigjja e parashikuar duhet të jetë e saktë ose qartësisht më e mira.
9. Distraktet duhet të jenë të besueshme.
10. Pyetjet duhet të shkruhen me gjuhë të thjeshtë, të pastër dhe me përmbajtje funksionale.

## Bibliografia

- Urim Bujari: "Mënyra të ndryshme vërtetimi dhe roli i tyre në procesin mësimor".  
Kujtim Dedej: "Detyra gjeometrike për punë të pavarur", Tiranë 1982.  
Hershel D. Thornbourg: "Introduction to Educational Psychology", Study Guide to Accompany, St.Paul, Minnesota, 1984.  
Rosemary A.Rosser, Glen I.Nicholson: "Educational Psychology", Study guide to Accompany,



Toronto 1984.

Hershel D. Thornbourg: "Introdoction to Educational Psychology", St.Paul, Minnesota, 1984.  
Leonard H. Clark, Irving S. Starr: "Secondary and middle school teaching methods", fifth edition, New Jork, 1986.

"Matematika dhe shkenca e natyrës në shkollë", Tiranë 1986.

Anita E. Woolfolk: "Educational Psychology", Third Edition, New Jersey 1987.

Joseph F.Callaham, Leonard H.Clark: "Teaching in the Middle and Secondary schools", New Jork, 1988.

Norman E.Gronlund: "How to construct Achievement Test", New Jork, 1991.